

**THE
HERITAGE**

ISSN 1857-7482

Nr.4 / 2011



UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR I STRUGËS

THE HERITAGE

REVISTË PERIODIKE

Ribotim

Nr.4 / 2011

Drejtore: **Prof. Dr. Lisen Bashkurti**

l.bashkurti@eust.edu.mk

Kryeredaktor: **Dr. Shpëtim Cami**

sh.cami@eust.edu.mk

Redaktorë të Shkencave Ekonomike

Mr. Nazmie Merko

n.merko@eust.edu.mk

Mr. Biljana Ciglovska

b.ciglovska@eust.edu.mk

Redaktorë të Shkencave Politiko-Juridike: **Dorian Leka**

d.leka@eust.edu.mk

Sekretar teknik: **Alban Gusho**

a.gusho07@eust.edu.mk

Korrektore: **Miranda Goleci**

Këshillit Shkencor

Prof. Dr. Lisen Bashkurti

Prof. Dr. Bashkim Rama

Prof. Dr. Luan Hajdaraga

Prof. Dr. Alqi Naqellari

Prof. Dr. Armend Kadriu

Prof. Dr. Anastas Angjeli

Doc. Astrit Memia

Prof. Dr. Betim Çiço

ISSN 1857-7482



INTERNATIONAL
UNIVERSITY OF STRUGA

Botim shkencor i Universitetit Ndërkombëtar të Strugës

www.eust.edu.mk

Nr.4, 2011

TREGUESI I LËNDËS

Dr. Gëzim MUSTAFAJ, Dr. Edmond BRANESHI, Majlinda CUKALLA LIDERSHIPI DHE E FOLURA NË PUBLIK	7
Doc. dr. Flora SELA (KASTRATI) EUROPA NËN PETKUN E DEMOKRACISË	25
M.A. Mark MOLLA SISTEMI ZGJEDHOR NË SHQIPËRI: REFORMAT, ARRITJET DHE SFIDAT E SË ARDHMES	37
M.A. Flamur HOXHA ARBITRAZHI NDËRKOMBËTAR TREGTAR	53
Ferdinand ELEZI ASPECTS OF THE EFFECT OF ORGANIZED CRIME ON ECONOMY	71
Dr. Gezim SELIMI, NDIKIMI I KAPITALIT TË HUAJ NË ZHVILLIMIN E VENDEVE NË ZHVILLIM DHE VENDEVE NË TRANZICION	79
М-р Билјана Цигловска КАРАКТЕРИСТИКИ НА СОВРЕМЕНАТА МЕЃУНАРОДНА ТРГОВИЈА	95
M.A. Nagip ARIFI DELIKUENCA E TË MITURVE NË REPUBLIKËN E SERBISË PËR PERIUDHËN 2004-2008	106

M.A. Xhevair BEQIRI INTERVALE OSHILUESE TË EKUACIONIT JOLINEAR DIFERENCIAL TË RENDIT TË DYTË	122
Dr. Fatmir TARTALE, Ma. Gerti Tartale E DREJTA PËR INFORMIM SI NJË E DREJTË E ÇDO QYTETARI, E GARANTUAR NGA KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	129
MA. Brahim (IBISH) AVDYLI ZVICRA PËR SHQIPTARËT DHE ÇËSHTJEN SHQIPTARE	143
Dr. Sc. Zija ZIMERI VLERËSIMI I TRASHËGIMISË RURALE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT NË FUSHËGROPËN E KUMANOVËS	153
M.A. Dhurata BILO LLOJET E PERSONAVE JURIDIKË	161
Av. Firdusi AJAZI TRAJTIM I SHKURTER I VEPRAVE PENALE NË LIDHJE ME FENOMENIN E KORRUPSIONIT SI FORMË E SHFAQJES SË KRIMIT TË ORGANIZUAR	171
M.A Edlir AJAZI KËNDVËSHTRIM I PËRGJITHSHËM, BALLKANI DHE KRIMI I ORGANIZUAR	178



Dr.SHPËTIM CAMI

Kryeredaktor

Editor in Chief

Главен и одговорен уредник

1 VIT “THE HERITAGE” - 1 ГОДИНА “ХЕРИТИЦ” - ONE YEAR “THE HERITAGE”

I dashur lexues!

Është privilegj dhe kënaqësi të ndaj me ju sot gëzimin e një vjetorit të themelimit të revistës sonë, “The Heritage”, botim shkencor i Universitetit Ndërkombëtar Strugë. Në këndvështrimin tim, revista është hapi i dytë i rëndësishëm pas themelimit të universitetit. Ajo është tribuna shkencore e këtij institucioni të lartë arsimor, aq i shumë pritur për banorët e këtij qyteti, por jo vetëm. Tashmë Universiteti është i pranishëm më filialet e tij edhe në Gostivar (Maqedoni), Preshevë (Serbi), Prizren (Kosovë) dhe hap pas hapi edhe revista është bërë pjesë e kësaj gjeopolitike arsimore. Ky numër reviste që ju merrni në dorë është i regjistruar edhe në Qendrën Ndërkombëtare të Botimeve Periodike me qendër në Paris, si dhe është pajisur në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Maqedonisë me numrin ISSN

Почитуван читателу!

Е привилегија и задоволство, да ја споделам денес радоста со вас на годишнината на формирањето на нашето научно списание “Hertitage”, на Меѓународниот Универзитет на Струга. Според моето мислење, списанието е вториот важен чекор по основањето на универзитетот. Тоа е научни панел на оваа институција на високо образование многу очекувано за граѓаните од овој град, но не само. Универзитетот веќе е присутен на своите филијали во Гостивар (Македонија), Прешево (Србија) Призрен (Косово) и чекор по чекор списанието стана дел на ова образованска геополитика. Списанието што добивате во рака, е регистрирано во Меѓународниот центар на списанија со седиште во Париз, а е опремено во соработка на Националната библиотека на Македонија со број ISSN (International

Dear Readers,

It is a pleasure and a privilege to share you with you today the first anniversary of our magazine “The Heritage,” a scientific publication of the International University of Struga. In my opinion, the magazine is the second most important step after the founding of the university. It is the stage of this higher education institution where students and professors alike are welcome to contribute. Now the University also has its affiliates in Gostivar (Macedonia), Presheve (Serbia) and Prizren (Kosovo).

This issue of the magazine is also registered in the ISSN center which has its headquarters in Paris, and it's also equipped with an ISSN number. This new standard that has been set for our magazine means that we have to face even more difficult academic challenges as we have to meet international standards. Today there are four issues of the magazine and I remember the meeting of

(International Standart Serial Number).

Ky standard na vë përballë kërkesave akoma më të larta shkencore dhe akademike.

Tashmë, me katër numra reviste në duar, më kujtohet mbledhja e senatit të Universitetit Ndërkombëtar Strugë dhe vendimi për të botuar një revistë shkencore. Me këtë rast dua të shpreh mirënjohjen time më të thellë për rektorin, Prof. Dr. Lisen Bashkurti, kryetarin e Bordit, Prof. Dr. Armend Kadriu, sekretarin e përgjithshëm Guximtar Rushani, dekanët, Prof. Dr. Bashkim Rama, Prof. Dr. Mersim Maksuti, Doc. Dr. Alqi Naqellari etj., të cilët më besuan dhe më mbështetën për botimin e kësaj reviste shkencore.

Sigurisht, fillimet nuk janë të lehta, që nga titulli e deri tek gjetja e fondeve të nevojshme.

Në këto katër numra kanë shkruar që nga personalitetet e larta shkencore dhe akademike e deri tek studentët e universitetit. Harta e saj gjeopolitike shtrihet në Universitetin e Tiranës, Universitetin "UFO", Tiranë, Akademia e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Maqedoni, Kosovë dhe Serbi. Artikuj studimorë na vijnë çdo ditë edhe nga Zvicra dhe vende të tjera të Europës e më gjerë.

Mirënjohje, gjithashtu, për të gjithë kontributorët e deritanishëm, të cilët janë bërë pjesë e historisë sonë të përbashkët.

Standard Serial Number).

Oвој стандард ни става наспроти дури и на повисоки научни и академски барања.

Со четири броја на списаниево' јас се секавам на собирот на сенатот на Меѓународниот Универзитетскиот на Струга и на Одлуката за објавување на научно списание. Во прилика сакам да ја изразам мојата најголема благодарност на ректорот, проф.д-р Лисен Башкurtи, претседател на Одборот, д-р Армен Кадриу, Гујимтар Рушани генерален секретар, деканите, проф. д-р Баским Рама, проф. д-р Мерсим Максuti, д-р Д-р Алқи Наqелари итн, верувајси и поддржајси за објавување на списаниево.

Секако на почеток не е лесно, по-нужќи од насловот и до потребните средства.

Во овие четири броја е напишано од повисоки научни и академски личности и студенти на универзитетов.

Нејзината геополитичка карта се проширува до Универзитетот во Тирана, Универзитетот во НЛО "Тирана, Академија за одбрана на Република Албанија, Македонија, Косово и Србија. Научни написи секој ден се дојде кај нас од Швајцарија и други земји од Европа и пошироко.

Благодарност и на сите досегашни соработници кои станаа дел на нашата заедничка историја.

the senate of the International University of Struga a year ago and the decision that was made to publish a scientific magazine. This wouldn't have been possible without Prof. Dr. Lisen Bashkurti, chairman of the Board, Prof. Dr. Armend Kadriu, Secretary General Guximtar Rushani, and Deans Prof. Dr. Bashkim Rama, Prof. Dr. Mersim Maksuti, Dr. Alqi Naqellari etc. who I would like to express my deepest gratitude to and thank them for giving me this chance to publish such a magazine and trusting and supporting me throughout the whole process. The magazine started out with baby steps because it wasn't easy in the beginning what with finding a title worthy of the articles showcased and also finding all the necessary funds.

In these four issues you can find articles from highly esteemed people of the academic world, to students of the university who worked very hard to get their work published. It's geopolitical map stretches from the University of Tirana, UFO University, the Academy of Defense of the Republic of Albania, Macedonia, Kosovo, and Serbia.

Academic essays are always coming in our offices from researchers working in European countries but also beyond that. Our magazine is willing to accept articles from everywhere around the world, just as long as they meet our high standards.

I would also like to express my gratitude to all the people who have worked hard and contributed in the making of all the issues. Without them, this magazine wouldn't be what it is today.



Dr. Gëzim MUSTAJ,

Shefi Departamentit të Udhëheqjes Ushtarake në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu” Tiranë

Dr. Edmond BRANESHI

Shefi Seksionit të Udhëheqjes Ushtarake në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, Tiranë

Majlinda CUKALLA

Pedagoge në Departamentin e Udhëheqjes Ushtarake në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, Tiranë

LIDERSHIPI DHE E FOLURA NË PUBLIK

“Bota është e përbërë: gjysma nga njerëz, të cilët kanë për të thënë diçka dhe nuk munden dhe gjysma tjetër nga njerëz, të cilët nuk kanë për të thënë gjë dhe nuk reshtin së foluri”

Lenny Laskowski

Sot ka drejtues, të cilët kanë njohuri shumë të mira profesionale, punojnë me përkushtim, bëjnë plane dhe kanë synime të mira për atë grup njerëzish që dretojnë, por shumë prej tyre nuk kanë aftësi komunikuese, nuk janë në gjendje të shprehin atë bagazh njohurish që zotërojnë, punën, planet apo synimet e tyre.

Komunikimi është një instrument i fuqishëm në dorë të njerëzve për një drejtim të suksesshëm. Çdo drejtues duhet të njohë, të zotërojë dhe të zbatojë rregullat dhe parimet e komunikimit, në mënyrë që të jetë në gjendje të transmetojë mendimet, idetë tek vartësit, bashkëpunëtorët, eprorët e tij si dhe të jetë në gjendje të flasë përpara një auditori.

Udhëheqësit e mëdhenj dretojnë përmes ideve. Ideologjia është jashtëzakonisht e rëndësishme kur drejton një organizatë të madhe. Njerëzit që punojnë për ty, ato që presin përgjigje nga ti, mediat, madje edhe rivalët e tu kanë të drejtë të dinë se si e shikon ti botën¹⁾. Fjala është motori sovran. Motori i së mirës e së keqes. Tërë sekretit qëndron të dish ta adresosh. Fjala ka qenë gjithmonë nxitëse e madhe për të gjitha veprimet e jashtëzakonshme. Të gjithë udhëheqësit e mëdhenj kanë pasur nevojë për fjalën. Çfarë do të kishin qenë ata

1. Rudolph W. Giuliani, “Udhëheqja”, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë 2006, faqe 180.

nëse nuk do të kishin mundur të komunikonin me popullin nëpërmjet oratorisë së tyre? Historia është e mbushur më shumë me diskutime se me veprime.²⁾

Në Greqi dhe në Romë arti i fjalës ishte objekti i mësimin teorik me gjithë kurset e veçanta praktike. Të rinjtë në shkollat e retorikës mësonin të diskutonin me zotësi, me finesë e të mbanin fjalime para popullit me një ndjenjë të vërtetë elegance. Mësuesit i ushtronin për shqiptime korrekte, për diksionë harmonike, për të trajtuar argumentet në mënyrë të përmbledhur, për të gjetur citate të përshtatshme e bindëse e batuta të vlefshme me efekt e të zjarra. Pastaj, nëpër sheshe e podiume, përsosnin më tej mësimet e ndjekura. “Të dish të flasësh” përbënte, si për romakët dhe për grekët, bazën autentike të kulturës dhe armën më të mirë për të përballuar e për të mundur jetën. Një konceptim i tillë ka mbijetuar edhe në Mesjetë në kohën e lulëzimit të shkollave oratorike shumë interesante, por pastaj janë lënë pas dore për t’iu dhënë të rinjve gjëra “më praktike”, të cilat pa një përdorim të përshtatshëm të fjalës në përputhje me realitetin e jetës, tregoheshin në fund të fundit absolutisht jo praktike.

Gjatë një bashkëbisedimi komunikohet nëpërmjet gjuhës verbale dhe gjuhës joverbale. Gjuha verbale është informacioni, është vetë fjala e folur, ndërsa gjuha joverbale është gjuha e trupit, me të cilën do të nënkuptojmë: qëndrimin i trupit, lëvizjet e duarve, shprehjen e fytyrës, refleksat e saj, kontaktin me sy, mënyrën e trajtimit të zërit, mënyrën e të vështuarit si dhe shumë nuanca dhe refleksa të tjera, të cilat përbëjnë një gjuhë mjaft të veçantë të cilësive fizike të personit folës. Sipas Joachim Knappe, *gjuha e trupit është si një orkestër me shumë instrumente, ku secili ka vlerën e tij*.³⁾ Kur njeriu flet, flet dhe mimika, flet dhe gjesti, flet qëndrimi, flet dhe vështimi, duke krijuar tek dëgjuesi një vlerësim, një respekt, një prire për ta besuar apo një prire për të mos e besuar, një refuzim apo një acarim.

Nëse gjuha e folur prek vetëdijen e dëgjuesit, gjuha e trupit krijon tek dëgjuesi ndjenja dhe një të folur të brendshme të sigurt, efekti i të cilave ia arrin qëllimit të përçimit të suksesshëm të lajmit a informacionit shumë herë më tepër se sa gjuha e folur. Vetë gjuha e folur, duke u mbështetur në gjuhën e trupit merr forcë, bëhet më e gjallë dhe më e kuptueshme. Samy Molcho⁴⁾ shkruan: “*Gjuha e trupit është si gjuha e folur; veçse gjuha e trupit nuk mund të gënjejë*”.

2. H. G. Watson, “Të dish të flasësh”, volumni i tetë, Shtëpia Botuese “Shkolla e jetës”, Tiranë 2000, faqe 28.

3. Hebert Genzmer, “Rhetorik die Kunst der Rede”, DuMont Literatur und Kunst Verlag, Köln 2003, faqe 66.

4. Samy Molcho, ekspert i gjuhës së trupit, Profesor i Universitetit të muzikës dhe arteve të bukura në Vjenë.

Sot psikologët rekomandojnë, nëse dyshoni tek fjalët e folësit, vëzhgoni sjelljen e tij, qëndrimin, gjestin, vështrimin e zërin e tij, sepse ato janë rezultat i mendimeve, ideve, ndjenjave. Gjuha e trupit buron nga brenda, ajo nuk mund të sajohet. “Çfarë jemi ne, jemi përmes trupit tonë. Trupi është pasqyra e shpirtit tonë, gjuha e tij janë fjalët e zemrës. Të gjitha lëvizjet e brendshme, ndjenjat, emocionet dhe dëshirat shprehen përmes trupit tonë”.⁵⁾ Të njohësh dhe të mësosh në mënyrë të vetëdijshme sinjalet e gjuhës së trupit do të thotë: të njohësh më mirë vetveten, të paraqitesh bindës, të vlerësosh më mirë kundërshtarin, të kesh më shumë sukses me njëri-tjetrin, të komunikosh më lirshëm dhe më qartë, që situatat në jetën e përditshme dhe në atë profesionale t’i kapërcesh.

Dëgjuesi vlerëson lajmin që merr nëpërmjet gjuhës së folur, duke u bazuar në personalitetin e folësit. Kjo do të thotë që dëgjuesi vlerëson tek folësi një numër shumë të madh ngacmimesh dhe sinjalesh si: sinjalet e trupit, të pamjes, të vështrimit, të zërit etj.

Kur e pyetën Demostenin se cila është pjesa më e rëndësishme e oratorisë, ai u përgjigj “veprimi”; po tjetër pjesë e rëndësishme që duhet t’i kushtojmë vëmendje, ai u përgjigj “veprimi”; po pas këtyre të dyjave, kush e ka radhën, ai përsëri u përgjigj “veprimi”. Njerëzit priren të besojnë veprimet se sa fjalët!⁶⁾ Auditori mban mend më tepër se si flet, si i lëviz duart, si qëndron, çfarë toni ka zëri i folësit, se sa ato që thotë folësi. Ndërsa shekulli XIX ishte shekulli i “fjalëve për fjalë”, ku rektorët, avokatët, oratorët e çdo lloji tipi, në parlament apo në sheshe, fitonin një lloj fame si “folës sallonesh”, në mijëvjeçarin e ri, fjala, ndonëse ka marrë një rëndësi akoma më të madhe, ajo mund të humbë çdo vlerë nëse nuk është e lidhur me faktet. Por është e vërtetë edhe e kundërta se, nëse faktet nuk janë të paraprirë nga një përgatitje e saktë e fjalëve, humbin pothuaj tërë vlerën e tyre⁷⁾ e nuk arrijnë pothuaj kurrë qëllimet e paracaktuara.

“Është e rëndësishme se çfarë do të thuash, por më e rëndësishme është mënyra se si do ta thuash atë”, - thotë Gëte. Pikërisht, mënyra se si folësi e transmeton informacionin është dhe çelësi i krijimit të besueshmërisë së lajmit. Le të përmendim dy parime kryesore të retorikës, që është dhe teknika e të folurës:

- *Folësi depërton te pritësi jo vetëm nëpërmjet përmbajtjes së lajmit, por edhe nëpërmjet personit të tij.*

- *Folësi, përçuesi i lajmit, duhet të vendosë veten e tij në një emërues të përbashkët me lajmin që përçon, që të jetë i besueshëm dhe bindës.*⁸⁾

5. Hebert Genzmer, “Rhetorik die Kunst der Rede”, DuMont Literatur und Kunst Verlag, Köln 2003, faqe 158.

6. Plutarku, “Jetë njerëzish të shquar të lashtësisë”, SHB “Naim Frashëri”, faqe...

7. H. G. Watson, “Të dish të flasësh”, volumni i tetë, Shtëpia Botuese “Shkolla e jetës”, Tiranë 2000, faqe 29.

8. Fuehrungsakademie der Bundeswehr, Redentechnik (Rhetorik), faqe 5-6.

Kur ju jeni i interesuar për atë çfarë thoni, besoni me të vërtetë në atë dhe dëshironi ta ndani mesazhin tuaj me të tjerët, atëherë lëvizjet tuaja fizike do të vijnë nga brenda dhe ju do të jeni në përshtatje me fjalën.

Duke përfshirë vetveten në mesazhin tuaj, ju do të jeni mjaft natyral dhe spontan pa pasur mendime të qëllimshme për atë që jeni duke bërë apo thënë. Për shumë njerëz nuk është aq e lehtë sa duket, sepse ajo kërkon të heqësh maskën që mbulon “të vërtetin” në publik. Në lidhje me këtë, Dr. Ralph C. Smeadly shprehet: “Folësi, i cili flet dhe qëndron i qetë, është ai, i cili mund të dëgjohet pa lodhje. Nëse qëndrimi dhe gjestet e tij janë shumë të hijshme dhe modeste, që askush mos t’i vë re ato, ai mund të quhet me të vërtetë i suksesshëm”.

Kur veprimet tuaja përshtaten me fjalët që thoni, ndikimi i asaj që thoni do të jetë i fortë. Nëse sjellja juaj nuk sinkronizohet me mesazhin e folur, atëherë vëmendja e dëgjuesve do të largohet nga fjalimi. Të bëhesh një folës që ka ndikim tek të tjerët, duhet të çliroheni nga maska dhe të ndani ndjenjat e vërteta me auditorin tuaj. Auditori do të dijë se çfarë ndjeni për atë që thoni. “Një nga përgjegjësitë e drejtuesit, - thekson R. Xhuliani⁹⁾ - është të kuptojë nevojat e atyre që drejton. Qëllimi nuk është të ndryshosh mesazhin sipas atyre që të dëgjojnë, por ta paraqitësh atë në mënyrë të tillë që ai të kuptohet prej të gjithë atyre që u drejtohesh. Qëllimi duhet të jetë që të sigurohesh që mesazhi yt do të mbërrijë i fortë dhe i qartë te sa më shumë njerëz që të jetë i mundur”.¹⁰⁾ Pra, nëse ju dëshironi të bindni të tjerët, ju duhet të përhapni bindjen tuaj, duke folur nga zemra dhe shpirti juaj.

E thënë ndryshe, folësi duhet të shprehet jo vetëm nëpërmjet fjalës, por edhe nëpërmjet përkushtimit të tij shpirtëror, si rezultat, atij do t’i flasin sytë, qëndrimi i trupit, lëvizjet e duarve, madje dhe rrobat e tij.¹¹⁾ Sipas Ciceronit, i mirë është ai orator i cili u jep dëgjuesve mësim e shpirt.¹²⁾ Kur gjuha e trupit është në përputhje, në harmonizim me gjuhën e folur, atëherë folësi bëhet i besueshëm dhe auditori bindet, beson. Lajmi e ka kryer misionin e tij, u besua.

Le të shohim në veçanti elementet e gjuhës së trupit:

- Mimika;

9. Rudolf Giuliani, Kryetar i Bashkisë së Nju-Yorkut, në vitet 1994-2001. Ndër të tjera u dallua në menaxhimin me sukses të pasngjarjeve të 11 shtatorit. Po atë vit përzgjidhet NJERIU I VITIT nga gazeta prestigjioze “TIME” (shënim i autorit).

10. Rudolph W. Giuliani, “Udhëheqja”, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë 2006, faqe 211.

11. Nadine Kmoth, “Koerper Rhetorik”, mvvVerlag, Redline GmbH, Heidelberg 2005, faqe 24-25.

12. H. G. Watson, “Të dish të flasësh”, volumni i tetë, Shtëpia Botuese “Shkolla e jetës”, Tiranë 2000, faqe 113.

- Gjesti;
- Kontakti me sy;
- Qëndrimi i trupit;
- Zëri.

Folësi duhet të ketë një njohje të mirë të elementeve të gjuhës së trupit.

Por më parë se të shqyrtojmë këta elemente është e rëndësishme të njihet një nga parimet e rëndësishme të komunikimit.

Të jesh vetvetja ¹³⁾

Kjo do të thotë: Shmangie e imitimeve, shmangie e qëndrimeve të paramenduar për të paraqitur një pamje në mënyrë standarde apo lëvizje të trupit, të duarve, të mimikës, në mënyrë të stisur, të sajuar, për të arritur artificialisht një efekt maksimal bindjeje. Kjo do të thotë mbi të gjitha se nuk duhet të krijohen korniza të huazuara dhe skematike. “Të jesh vetvetja” do të thotë liri absolute e psikikës, emocioneve, shprehjes së fytyrës, zërit, qëndrimit të trupit dhe lëvizjeve të duarve.

Dhe duke ndodhur kështu, folësi do të ushqehet vetiu, do të mbarset, do të ngarkohet me preokupimin e duhur që i dikton një çast i caktuar, që i dikton komunikimi i brendshëm dhe spontan i momentit. Të gjithë përbërësit e tjerë, si ato psikikë, ashtu edhe ata emocionalë, logjikë, të mimikës, të gjesteve etj., do të marrin formën e tyre dhe paraqitjen e tyre më natyrale, më të përshtatshme, më komunikuese dhe më bindëse.

Le të shohim këshillën e Henry Ford, në lidhje me individualitetin: “Të gjithë makinat e Fordit janë ekzaktësisht njësoj” - thotë krijuesi i tyre, - “por dy njerëz nuk ngjasojnë me njëri-tjetrin. Në këtë botë çdo krijesë është një gjë e re. Asnjëherë nuk ka patur diçka të ngjashme me të më përpara dhe asnjëherë nuk do të përsëritet një gjë e tillë. Secili nga ne duhet të ruajë dhe të zhvillojë plotësisht këtë ide; ne duhet të kërkojmë shkëndijën e veçantë të individualitetit, i cili na bën të ndryshëm nga njerëzit e tjerë”¹⁴⁾.

Nuk ekziston në këtë botë asnjë qenie tjetër njerëzore e njëjtë si ju. Qindra e miliona njerëz kanë dy sy, një hundë dhe një gojë, por asnjëri nga ata nuk është tamam i njëjtë si ju; asnjëri prej tyre nuk ka ekzaktësisht tiparet tuaja, metodat tuaja si dhe mënyrën e të menduarit tuaj. Individualiteti i një folësi është prona më e çmuar. Secili duhet t’i japë gjallëri dhe ta zhvillojë atë. Kjo është shkëndija që do të vendosë forcën dhe sineritetin brenda të folurës suaj.

13. Fuehrungsakademie der Bundeswehr, Redentechnik (Rhetorik), faqe 7.

14. Dale Carnegie, “Public speaking for success”, Penguin Group, New-York 2006, faqe 153.

Debatet më të famshëm që janë mbajtur ndonjëherë në Amerikë kanë ndodhur më 1858 në shtetin e Illinois midis Senatorit Stefan A. Douglas dhe Abraham Linkolnit. Linkoln ishte i madh dhe i rëndë. Douglas ishte i shkurtër dhe i këndshëm. Këta burra ishin të ndryshëm në karakter, në mendim, në personalitet, në natyrë, ashtu sikurse ishin të ndryshëm në fizikun e tyre. Gjestet e Douglas ishin të hijshme, të Linkolnit të ngathta. Douglas ishte krejtësisht i varfër nga humori, Linkoln ishte i famshëm për mënyrën se si i tregonte historitë. Douglas rrallë buzëqeshte. Linkoln vazhdimisht argumentonte me analogji dhe ilustrime. Douglas ishte mendjemadh dhe autoritar. Linkoln ishte modest dhe zemërbutë. Douglas mendonte sa hap e mbyll sytë. Përpunimi i mendimeve të Linkolnit ishte shumë i ngadaltë. Douglas fliste vetëtimthi. Linkoln ishte më i qetë dhe më i matur. Të dy, të ndryshëm sikurse ishin, ishin folës të zotë, sepse ata kishin kurajon dhe sensin e mirë të ishin vetvetja. Nëse ndonjëri nga ata do të imitonte tjetrin, ai mjerisht do të kishte dështuar. Secili prej tyre, duke i qëndruar besnik dhuntive përkatëse, krijuan individualitetin e tyre.

Në fakt kjo është një këshillë e thjeshtë për t'u dhënë. Por, a është po kaq e thjeshtë për t'u zbatuar? Sipas Marshal Foch, arti i luftës *është mjaft i thjeshtë në ide, por për fat të keq i vështirë për t'u zbatuar.*¹⁵⁾

Për të qenë vetvetja përpara një auditori duhet të praktikohesh. Aktorët e famshëm e dinë këtë. Ata, pasi e kanë mësuar tekstin përmendësh dhe e kanë përtypur mirë, e “harrojnë” atë. Atëherë ky tekst do të burojë sipas rrethanës dhe momentit në mënyrë jetësore dhe të vërtetë, të natyrshme dhe bindëse.

Sinqeriteti, entuziazmi dhe serioziteti i madh do të ndihmojnë gjithashtu. Kur njerëzit janë nën ndikimin e ndjenjave të tyre, të vetvetes vijnë në sipërfaqe. Pengesat bien. Kulmi i emocioneve është shuar, të gjitha barrierat kanë rënë. Njerëzit sillen spontanisht, flasin spontanisht dhe veprojnë natyrshëm.

Kur Christopher Reeve, i cili portretizoi Supermenin në filma, u paralizua në një aksident gjatë një gare me kuaj, ai u bë një zëdhënës për njerëzit që kishin të njëjtën sfidë. Kur Kongresi po merrte në shqyrtim një shumë për të financuar studimin që kishte të bënte më këta të sëmurë, Reeve u shfaq përpara Komisionit të Financës së Senatit, nga karroca e tij e invalidit, edhe pse paraliza e kishte dobësuar zërin e tij kumbues të dikurshëm, madje ndonjëherë ishte e vështirë të kuptohej, mesazhi i tij u dha i fuqishëm, sepse ai erdhi nga thellësia e tij. Zemra ishte në fjalët që ai citoi.¹⁶⁾ Zemra ishte në fjalët e tij. Ky është sekret.

Mimika (shprehja e fytyrës)

Kontakti i parë midis folësit dhe dëgjuesit, vendoset nëpërmjet mimikës,

15. Dale Carnegie, “Public speaking for success”, Penguin Group, New-York 2006, faqe 154.

16. Dale Carnegie, “Public speaking for success”, Penguin Group, New-York 2006, faqe 153.

nëpërmjet shprehjes së fytyrës dhe fizionomisë së një personi që shfaq emocionet e ndjenjat e tij të brendshme.

Mimika përcakton fatin e lidhjes që do të vendoset midis folësit dhe dëgjuesit. Ajo përcakton, nëse kjo do të jetë lidhje e një besimi reciprok, e një kundërvënie të brendshme apo mosrespektim. Mimika u tregon atyre që dëgjojnë se me çfarë personi kanë të bëjnë. Mimika është një rezultat i përkushtimit të brendshëm, i kërkesës së vërtetë dhe të pastër. *Mimika nuk mund të sajohet, ajo buron nga brenda. Kështu, folësi i mirë, oratori që njeh mirë rregullat e komunikimit nuk e kontrollon mimikën e tij. Ai kontrollon fillimisht aktin e tij të brendshëm, domethënë përcakton qartë qëllimin e bisedës në vetëdijen e tij: qëllimin dhe përfundimin e lajmit.*¹⁷⁾

Akti i ndërtuar në këtë mënyrë, që buron sinqerisht nga zemra dhe shpirti, pas një kohe të shkurtër do të transmetohet e do të reflektojë në mimikë. Pra, këshilla që i jepet folësit është: Beso fillimisht vetë atë që do të thuash dhe pastaj do të jesh në gjendje të bindësh të tjerët. Mimika dalëngadalë i modulohet, i përshtatet tonalitetit të zërit, logjikës së lajmit që tejçohet dhe kureshtjes e vëmendjes së atyre që dëgjojnë. Kështu, krijohet *uniteti komunikues* midis vëmendjes së atyre që dëgjojnë dhe atij që flet. Një fjalë e urtë nga lindja e largët thotë: *Kush buzëqesh fiton.*

Një fytyrë miqësore që rrezaton një dritë buzëqeshjeje dhe mirësie të sinqertë e që buron nga zemra natyrshëm, i fiton shpejt zemrat e dëgjuesve. Por duhet theksuar, se një lajmës, i cili përpiket të krijojë një mimikë të stisur e gjoja të besueshme në mënyrë artificiale, është i dështuar dhe do të krijojë një shije refuzuese te dëgjuesi.

Nuk ka rregulla në përdorimin e shprehjeve të veçanta. Nëse ju shmangni pengesat tuaja dhe i lejon vetes t'i përshtatesh natyrshëm mendimeve, qëndrimeve dhe emocioneve tuaja, atëherë shprehja e fytyrës suaj do t'i përshtatet mesazhit, duke treguar sinqeritet, besueshmëri dhe bindje.

Kontakti me sy

Kontakti me sy të ndihmon të rregullosh rrjedhjen e komunikimit. Ai sinjalizon interes tek të tjerët dhe rrit besueshmërinë e folësit. Njerëzit të cilët përdorin kontaktin me sy hapin rrjedhën e komunikimit dhe transmetojnë interes, preokupim, ngrohtësi dhe besueshmëri. Nuk ka mënyrë më të sigurtë për të ndërprerë një marrëdhënie komunikimi midis folësit dhe auditorit se sa mungesa e të parit tek dëgjuesi. Fjala e urtë: *“Sytë janë pasqyra e shpirtit”* thekson nevojën tuaj për të bindur dëgjuesit me sytë tuaj, sikurse dhe me fjalët tuaja. Vështrimi duhet të jetë i çiltër dhe krejtësisht i pastër, i

17. Majlinda Cukalla, Retorika (leksion), Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, Tiranë 2004, faqe 13.

vëmendshëm mos ta shqetësojë dëgjuesin, të jetë i drejtpërdrejt dhe të mos nënkuptojë gjendje të pasigurta, dykuptimëshe dhe të mos shprehë prije për të mbuluar apo për të kamufluar diçka.¹⁸⁾ Dëgjuesi në këto raste e pranon folësin brenda vetvetes pa asnjë lloj konflikti. Kjo do të thotë që folësi ka pushtuar zemrat dhe vëmendjen e tyre shumë natyrshëm. Edhe H. G. Watson thekson se *shikimi ka një rëndësi të dorës së parë në artin e të folurit. Ai duhet të konsiderohet si zbulimi më i fortë, më tërheqës, më i parezistueshëm i personalitetit. Vibracionet që shpërthejnë nga syri kanë mbi të tjerët një burim të pallogaritshëm e paraqesin një nga forcat më misterioze që njeriu ka në pushtetin e tij.*¹⁹⁾

Shikimi i folësit nuk duhet të jetë rivalizues me vështirimin e dëgjuesve, sikur t'u thoshte atyre shikoni, jam unë këtu, ju duhet të dëgjoni. Shikimi i folësit duhet të jetë i qetë, i durueshëm dhe tejkalues ndaj vështirimeve acaruese dhe të ngurta të dëgjuesve, kur këto ndodhin herë pas here gjatë bisedës. Në këtë mënyrë, dëgjuesi i nënshtrohet krejtësisht me dëshirë folësit. Nëse mund të bëhen pyetje gjatë bisedës, folësi duhet të shikojë dëgjuesin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ndërkohë të mos shkëpusë vëmendjen nga masa tjetër e dëgjuesve, pra, të mos i mënjanojë ato nga vëmendja e tyre, nga syri i tij i brendshëm, sepse kjo do të krijojë një mendim jo të mirë dhe një gjendje acaruese.

Syri i brendshëm i folësit është ajo që folësi shikon brenda vetvetes, është mënyra e vërtetë se si ai trajton dëgjuesin, është marrëdhënia e vërtetë e tij me dëgjuesin. Ky sy i brendshëm është vendimtar në vendosjen e një komunikimi të drejtë dhe ndikon në krijimin e respektit të ndërsjellët. Këtë gjë dëgjuesi nuk e sheh në mënyrë të drejtpërdrejtë, por e ndjen së brendshmi.

Nuk ka rëndësi se sa i madh është numri i dëgjuesve, çdo dëgjues dëshiron të ndjejë se ju jeni duke iu drejtuar asaj apo atij. Vetëm duke parë dëgjuesit tuaj si individë ju mund t'i bindni ato se ju jeni i sigurt dhe i interesuar për ta.

Kur ju flisni, sytë tuaj punojnë edhe si një pajisje kontrolli, që ju mund ta përdorni për të garantuar vëmendjen dhe përqëndrimin e dëgjuesve.

Duke parë auditorin se si po reagon, ju jepet mundësia të korrigjoni sjelljen tuaj apo dhe përzgjedhjen e fjalëve, duke rregulluar prezantimin tuaj në përshtatje me rrethanat.

Të kontaktosh me sy me auditorin është një element thelbësor i një të folure të bukur përpara publikut. Ky mjet i thjeshtë mrekullon auditorin, duke tërhequr vëmendjen e tij në fillim të fjalimit dhe duke siguruar interesin e tyre dhe respektin.²⁰⁾

18. Nadine Kmoth, "Koerper Rhetorik", mvgVerlag, Redline GmbH, Heidelberg 2005, faqe 57.

19. H. G. Watson, "Të dish të flasësh", volumni i tetë, Shtëpia Botuese "Shkolla e jetës", Tiranë 2000, faqe 136-137.

20. Herman Schluter, "Das Handbuch der Rhetorik", Anaconda Verlag GmbH, Köln 2006, faqe 54.

Gjesti

Gjesti nënkupton tërësinë e lëvizjeve, të vetëdijshme apo jo, të duarve, krahëve, gishtave, të kokës si dhe të pjesëve të ndryshme të trupit siç janë shpatullat, pjesa e gjunjëve etj.²¹⁾ Gjesti flet më shumë se gjuha e folur dhe jo rrallë ai merr fuqi të mëdha shprehëse. Ai mund ta gllabërojë vëmendjen e dëgjuesit, si dhe ta ngazëllejë atë.

Gjesti – thekson Watson - është pas zërit, një nga elementet më të rëndësishëm të artit të folurit. Ai duhet t'i përgjigjet dy kërkesave: së pari, të jetë në harmoni të plotë, në përputhje absolute me tonin e frazës e të diskutimit, të ketë lindur si të thuash, nga vetë fjalët, si një rezultat natyror pa as më të voglën ndjenjë sforcimi; së dyti, ai duhet të jetë i përbërë nga një masë që të mos jetë në kontrast me më të paktën shije të mirë.²²⁾ Të bësh gjeste me kokë dhe duar, është pjesë e komunikimit. Kjo është mënyra në të cilën ne i japim jetë dhe theksojmë fjalën e folur, është normale që ato luajnë një rol të rëndësishëm në të folurën në publik. Gjesti mund të jetë i vlefshëm për të shprehur një pikëpamje të veçantë, por është e rëndësishme që ai të jetë i natyrshëm dhe spontan (jo i paramenduar). Gjestet tepër të ekzagjeruara dhe të detyruara mund të kthehen në disfavorin tuaj, duke hutuar auditorin.

Gjesti është mendimi i brendshëm, i shprehur jo me gjuhën e folur, por me një lëvizje, me shenja trupore. Një lëvizje koke nga lart poshtë shpreh një pohim më të sigurt se sa do të shprehte fjala “po”. Një lëvizje koke nga e majta në të djathtë apo anasjelltas shpreh një refuzim shumë më të fuqishëm se fjala e shprehur me gojë “jo”. Gjesti zëvendëson tërësisht fjalën e folur. Të gjithë kanë përjetuar efektin e jashtëzakonshëm e të padiskutueshëm të filmave të Çarli Çaplini, i cili për të komunikuar me spektatorin vepron me gjeste dhe mimikë, sa askush nuk e ndjen mungesën e fjalës në to.

Gjesti ndihmon së tepërmi aftësinë përçuese dhe komunikuese të folësit. Shpesh ai zëvendëson krejtësisht fjalën e folur, madje ngrihet në nivelin e një komunikimi universal; nëpërmjet gjesteve mund të merren vesh njerëz të kulturave të ndryshme, të cilët nuk kuptojnë gjuhën e njëri-tjetrit. Gjesti ka qenë dhe mbetet gjithmonë një gjuhë universale e natyrës së gjallë, gjuha më e fuqishme shprehëse dhe komunikuese.²³⁾ Nëpërmjet gjesteve, lëvizjeve të trupit apo të këmbëve një kafshë komunikon me njerëzit, duke i vënë në dijeni për kërkesat e veta. Nëpërmjet gjesteve një foshnjë kërkon nga e ëma atë që i duhet.

21. Fuehrungsakademie der Bundeswehr, Redentechnik (Rhetorik), faqe 8

22. H. G. Watson, “Të dish të flasësh”, volumni i tetë, Shtëpia Botuese “Shkolla e jetës”, Tiranë 2000, faqe 133.

23. Nadine Kmoth, “Koerper Rhetorik”, mvgVerlag, Redline GmbH, Heidelberg 2005, faqe 169.

Gjestet janë vetjakë, ato i përshtaten gjithmonë personit, burojnë nga natyra e tij psikofizike. Përgjithësisht, gjesti është pjesë e qëndrueshme, integrale, që nuk mund të ndahet nga gjuha e folur. Që gjesti të jetë një me të folurin dhe kuptimplotë në përçimin e fjalës, duhet patjetër që personi të ketë një fizik dhe një qëndrim trupor të lirshëm, të çliruar si dhe një psikikë të hapur, të pakontraktuar, e cila hap pas hapi gjatë dhënies së një mesazhi të modulohet në mënyrë spontane dhe këtë modulim t'ia transmetojë dhe anës fizike, trupit, duarve, gishtërinjve etj.

Për një folës të talentuar që njeh mirë parimet e komunikimit, gjestet nuk janë të paramenduara, ato janë elementë të frymëzimit dhe të krijimtarisë së momentit të dhënë. Frymëzimi dikton jo vetëm në fjalën e duhur, jo vetëm në kompozimin e duhur të bisedës, por në të njëjtën mënyrë në mimikën dhe gjestin.

Përpikuni të jeni i vetëdijshëm, se çfarë bëni me duart, është mjaft e rëndësishme që t'i mbani ato nën kontroll. Krahët dhe duart duhet të jenë të lirshëm, të natyrshëm dhe jo të duken sikur janë të tepërta dhe kërkojnë një mbështetje apo ndihmë për t'u vendosur diku. Lëvizja e tyre duhet të jetë me vend dhe kuptimplotë, as e tepërt dhe as e ngrirë.

Duart nuk duhen as të fshihen prapa se do të dukeni shumë zyrtar si dhe do të ndiheni jo i natyrshëm. Është më mirë të lëvizin krahët në mënyrë të qetë dhe të kontrolluar.

Qëndrimi i trupit

Një përbërës tjetër i gjuhës së trupit është qëndrimi i tij, pozicioni i bustit, pjesës së sipërme të trupit. Pozicioni dhe vendqëndrimi, duhet të jetë i tillë që të mundësojë një qëndrim të lirshëm e të qetë të trupit dhe të rrokë përpara vetes të gjithë rrethin e dëgjuesve. Qëndrimi të jetë i drejtë në mënyrë të natyrshme dhe jo “sikur ke gëlltitur okllainë”. Pjesa e bustit duhet të jetë e lirshme dhe përballë dëgjuesit. Nëse ka një podium, mos e përdor atë të mbështetesh përpara apo prapa, sepse reflekton përshtypjen e një plogështie shpirtërore dhe fizike që largon vëmendjen e dëgjuesve. Është e rëndësishme të kesh një qëndrim trupi të qetë dhe të drejtë. Këmbët të jenë të hapura sa është gjerësia e shpatullave, kjo do t'u ndihmojë të ruani ekuilibrin e trupit. E rëndësishme është edhe mënyra e mbajtjes së supeve; nuk duhen të jenë as të ngritura që të tregojnë mendjemadhësi dhe arrogancë, por as të varura që të tregojnë mosbesim dhe plogështi.

Stilet e të ecurit

Kur lëviz, detyron njerëzit të fokusohen tek ju. Rruga që bëni nga vendi juaj deri tek pozicioni që do të flisni është shumë e rëndësishme. Kur ju

prezantoheni, ju duhet të shfaqeni i etur për të folur. Lëvizjet, ecejaket duhet të jenë gjithmonë funksionale, përndryshe ato krijojnë tension të brendshëm dhe i heqin vëmendjen dëgjuesit.²⁴⁾

Mjaft folës duken sikur po i çojnë drejt ekzekutimit. Ec me besim nga karrigia juaj tek foltorja. Hesht për disa sekonda, pastaj largohu nga pas foltores. Është mençuri të përdorësh foltoren si një pikë nisjeje dhe jo si një barrierë për t'u fshehur pas saj. Buzëqesh përpara se ju të thoni fjalën e parë. Kij kujdes, mos qëndro shumë pranë reshtit të parë, por dhe mos kalo përtej tyre. Mos bëni shumë ecejake, por dhe mos qëndroni pa lëvizur. Ecja mund të jetë një mënyrë efektive për të theksuar një ide të rëndësishme. Është thelbësore që ecja juaj të jetë e qëllimshme, jo një ndryshim pozicioni i rastësishëm. Përdor rreth tri hapa dhe lëviz në një kënd të ngushtë, zakonisht funksionon mjaft mirë. Një pozicion është pozicioni juaj “shtëpi” që duhet të jetë përpara dhe në qendër. Dy pozicionet e tjera duhet të jenë relativisht pranë pozicionit “shtëpi”. Asnjëherë mos qëndro përpara ndonjë pajisjeje vizuale. Kur ju të praktikoni fjalimin tuaj, sigurohu që jeni duke praktikuar dhe të ecurën përpara publikut, ndërsa kur qëndroni pa lëvizur, kujtohu të mbash një pozicion të mirë.

Stili i të folurit

Stili i të folurit përbëhet nga: artikulimi, modulimi, toni, volumi, ritmi, pauza dhe teknika e frymëmarrjes.

Siç është përmendur edhe më lart, është e rëndësishme mënyra si të thuash diçka se sa ajo që thua. Nëse dëshironi të jeni një folës tërheqës, mëso të përdorësh ndryshimin e zërit, të shtosh gjallërinë në dhënien e mesazhit. Ndoshta gjëja më e mirë që mund të bëni për të përmirësuar përçimin e mesazhit është të përdorni modulimin e zërit, të ndryshoni ritmin dhe volumen e tij, si dhe t'i jepni rëndësinë e duhur pushimeve gjatë të folurit. Ndryshimi i zërit duhet të kombinohet me logjikën dhe gjuhën e trupit për të përmirësuar të gjithë dhënien e mesazhit.

Kur ju bëni një prezantim, mos rri i heshtur gjithë frikë – flit në mënyrë miqësore, sikur të jini i njohur me auditorin. Flit qartë, në mënyrë të përmbledhur thekso aty ku ju doni të tërhiqni vëmendjen. Përdor zërin për të vënë në pah emocionet, por ki kujdes nga bisedat vazhdimisht në mënyrë pasionante. Pasioni i vazhdueshëm është po aq i keq sa dhe në rastin kur nuk ke aspak.

Një mënyrë e mirë për të përmirësuar ndryshimin e zërit është të praktikohesh duke lexuar me zë të lartë fragmente të autorëve të ndryshëm,

24. James C. Humes, “Speak like Churchill stand like Lincoln”, Three Rivers Press, New York 2002, faqe 97

duke përçaruar emocione të ndryshme. Praktikohu duke përsëritur të njëjtat fjalë, ndrysho ritmin, ndrysho regjistrin, ndrysho mënyrën e trajtimit të zërit, deri aty ku ju duket se është në nivelin e duhur.

Artikulimi është shqiptimi i qartë, me theksin e duhur, i kuptueshëm i fjalëve dhe i fjalive. Një artikulum i mirë u jep rëndësinë e duhur të gjitha rrokjeve, si zanoreve, ashtu edhe bashkëtingëlloreve dhe sidomos mbaresave të fjalëve, që shpesh neglizhohen prej folësit. Për këtë Watson sugjeron që, një nga ushtrimet më të para që duhet kryer për të “lëmuar” fjalën është zgjidhja e gjuhës, e cila është një kompleks i vogël fjalësh të studiuar apostafat për të detyruar gjuhën në një ushtrim të përcaktuar që nuk është as i lehtë, as i zakonshëm. Ajo është një nga sekretet e artikulimit.²⁵⁾ Folësi duhet të artikulojë qartë të gjitha gerrat gjatë të folurit, në mënyrë që të kapen nga veshi i dëgjuesit. Ashtu sikundër do të ndahen në mënyrë të qartë e të dukshme kokrrat nga kalliri i misrit kur ai shkërmoqet, në të njëjtën mënyrë duhet të burojnë rrokjet dhe gerrat prej gojës së atij që flet. Duhet shmangur e folura nën buzë, nëpër dhëmbë si dhe mërmërimat.

Dobësitë e të folurit mund të shmangen nëpërmjet praktikave, si të lexuarit e ngadalshëm e me zë të lartë dhe ushtrime të ndryshme, të cilat zbatohen në mënyrë individuale, sipas dobësive që ka personi. Duhet të kujtojmë këtu, rastin e shumë oratorëve, të cilët në fëmijërinë e tyre shfaqnin defekte në të folur, por të shtyrë nga një vullnet i habitshëm i kanë kapërcyer këto “mangësi”. Shembulli ideal për të ilustruar këtë praktikë është Demosteni, i cili kur fliste ngatërrohej, emocionohej dhe i merrej goja nën ndikimin e të tjerëve. Për të ndrequr këtë defekt ai dilte në breg të detit dhe recitonte përmendësh ligjërata të tëra përpara detit që zhurmonte nga dallgët e fuqishme.²⁶⁾ Kështu ai mësohej të fliste rrjedhshëm, qartë dhe në mënyrë të qetë përpara zhurmës së dallgëve. Dalëngadalë ai i eliminoi mangësitë e veta dhe u bë një nga oratorët më të mëdhenj të lashtësisë.

Modulimi është ndryshimi i tonit të zërit në fjalë të veçanta brenda një fjalie ose ndryshimi i tonit të zërit në rrokje të caktuara brenda një fjale. Modulimi na lejon të transmetojmë më shumë informacion se sa do të ishte e mundur në mungesë të tij. Kjo është në interes të folësit për të forcuar kuptimin e fjalisë ose të një fjale të vetme gjatë të shprehurit. Një folës i mirë nuk e paraqet fjalinë në mënyrë të njëtrajtshme, monotone, me shpejtësi të njëjtë nga fillimi në fund, por ai përdor tone të ndryshme, shtrirje të ndryshme të gjatësisë së rrokjeve, shpejtësi të ndryshme të thënies së një

25. H. G. Watson, “Të dish të flasësh”, volumni i tetë, Shtëpia Botuese “Shkolla e jetës”, Tiranë 2000, faqe 64.

26. Plutarku, “Jetë njerëzish të shquar të lashtësisë”, SHB “Naim Frashëri”, Tiranë 1980, faqe 170.

fjalie, gjithmonë sipas interesit që ai ka për të përçarur tek dëgjuesi më qartë dhe më me shumë ngjyrimë idenë, logjikën dhe përmbajtjen e një fjalie. Nuk e bën folësin më të besueshëm e folura e shpejtë dhe me zë të lartë, çjerrës apo të egër. Përkundrazi, një ton i ulët ka vlerë shumë më të madhe kur i përshtatet momentit të duhur gjatë shprehjes së mendimit, si dhe kur merret në konsideratë vëmendja e dëgjuesit. Në të njëjtën mënyrë, toni i lartë nuk nënkupton të jetë i lartë në vetvete, por gjithmonë në harmoni me momentin e dhënë dhe me tonalitetin e përgjithshëm të fjalisë, jo si qëllim në vetvete.

Është e rëndësishme të theksohet se modulimi hyn në aftësitë vetjake, ai është shumë individual dhe lidhet ngushtë me karakteristikat e tjera të folësit si me forcën e zërit, me diapazonin e brendshëm të tingullit të tij, me gjatësinë e shtatit, pra, me vetitë e paraqitjes dhe shumë të dhëna të tjera psikofizike. Çfarë përshtypje do të linte një folës shtatlartë e trupmadh me një zë të hollë? Modulimi është një art më vete i të folurit, shumë i rëndësishëm në paraqitjen e mendimeve. Përveç atyre që përmendëm më lart, ai lidhet edhe me impulsin e natyrshëm dhe të vërtetë që krijohet te folësi, me situatën për të cilën bëhet fjalë, me botën emocionale dhe vëmendjen e dëgjuesve. Për shembull, një folës i cili nuk ndjen dhe nuk kap në mënyrë intuitive gjendjen shpirtërore të dëgjuesve, nuk do të pikasë çastin kur dëgjuesit të jenë krejtësisht të pavëmendshëm ndaj tij. Ai do të vazhdojë të flasë me tone të qeta, me një modulim monoton, duke qenë i sigurt se të tjerët po e dëgjojnë.

Toni nuk mund të jepet me formulë të përcaktuar. Ai buron përherë prej momentit të dhënë dhe interesit që folësi ka për të theksuar një ide a mendim. Kur jeni duke dhënë një informacion, mënyra se si e thoni atë është po aq e rëndësishme me atë që ju thoni. Nuk ka rëndësi se sa interesante është fjala që ju thoni, por mënyra monotone e interpretimit të saj është një rrugë e sigurt për të vënë në gjumë auditorin, njëkohësisht, mund të merret nga dëgjuesi si një përgatitje e dobët nga ana juaj ose si një temë pa rëndësi të veçantë.²⁷⁾ Por, edhe të folurit e shpejtë dhe pa kriter nuk e ndihmon dëgjuesin në përvetësimin e mendimeve të folësit. Duke pasur parasysh këtë, është mjaft e rëndësishme që ju të ndryshoni ritmin dhe natyrën e zërit tuaj, kjo plotëson dhe thekson atë që ju jeni duke u përpjekur të thoni.

Volumi është një mjet tjetër për një fjalim bindës, por duhet ta përdorni atë me maturi. E folura me një timbër të mirë është faktor i rëndësishëm. Zëri duhet të jetë në lartësinë e duhur, në mënyrë që ta dëgjojë qartë dhe rreshti i fundit, por jo aq i lartë sa të lërë përshtypjen se po i ulërin auditorit. Por nga ana tjetër, një e folur me zë të lartë, e llogaritur në kohën e duhur, mund të gjallërojë fjalimin. Të njëjtin efekt ka edhe e folura me zë të ulët, kjo mund të

27. Dale Carnegie, "Public speaking for success", Penguin Group, New-York 2006, faqe 159.

shkaktojë largimin e vëmendjes së auditorit si dhe të paraqet të pasigurt për ato që jeni duke thënë.

Ritmi juaj është një variabël i rëndësishëm për kontroll. 125-160 fjalë në minutë është ritmi normal për një fjalim bindës. Ky ritëm u lehtëson dëgjuesve përpunimin e mendimit, u nxit interesin për të dëgjuar më tej dhe siguron vëmendjen e tyre. Folësi duhet të marrë parasysh vazhdimisht kohën e dhënies së fjalëve në funksion të përkushtimit që kanë dëgjuesit, gjendjen e gjallërinë e tyre. Çdo shpejtësi tjetër do të bëjë që të dukeni brisk nga goja dhe çdo ngadalësim do të bëjë që të dukeni sikur jeni duke dhënë udhëzime. Nëse ju nuk jeni i sigurt për shpejtësinë tuaj, shkruani fjalët që thua për një minutë dhe përsëri numëro fjalët për një minutë! Truri dhe veshi njerëzor grumbullon dhe deshifron mbi 400 fjalë në minutë, kështu, nëse ju do të ngadalësoni shumë të folurën, atëherë mendja e dëgjuesve tuaj do të fillojë të endet dhe do të gjejë mënyra të tjera për të mbajtur veten të përkushtuar.

Nëse jeni duke paraqitur një informacion, bëni një përpjekje të vetëdijshme, për të folur ngadalë dhe qartë.

Pauza është një mjet kritik i bindës. Kur doni të theksoni një fjalë, ndalo më parë për disa sekonda. Pikërisht kjo e nxjerr në pah fjalën dhe, nëse ju dëshironi me të vërtetë që ajo fjalë të ketë efekt, bëni një pauzë para dhe pas fjalës. Uilliam Shekspir thekson: *“Unë bëj një pauzë, kur filloj rishtaz”*²⁸⁾.

Vlera e pauzës njihet mirë nga oratorët më të mirë të gjithë kohërave. Seneka²⁹⁾, thoshte se *ai që nuk di të pushojë, nuk di as të flasë*. Pauza lejon një kuptim dhe perceptim më të mirë të mesazhit ose informacionit që duhet dhënë. Në këtë hapësirë kohe “të lirë” truri deshifron me shpejtësi, krahason, kundërvihet e miraton. Ndodh që oratorë, pedagogë a instruktorë të ndryshëm deklarojnë që në fillim se nuk kanë shumë kohë në dispozicion dhe përpiqen të japin sa më shumë informacion në një kohë sa më të shkurtër dhe këtë e bëjnë duke vështruar pareshtur orën e tyre. Në të vërtetë, kjo ngjall një ndjenjë çoroditjeje te dëgjuesit dhe mbi të gjitha atij nuk i lihet mundësia që të memorizojë informacionin që merr. Pauza ndihmon edhe për një lloj shkëmbimi a ndarje emocionesh. Për përdorimin e saj nuk mund të vendosen rregulla fikse, por në përgjithësi mund të thuhet se ajo përdoret para dhe pas një ideje të rëndësishme. Në rastin e parë ajo do të synojë të tërheqë vëmendjen dhe në rastin e dytë ajo nënvizon rëndësinë e fjalëve të fundit dhe lejon perceptimin më të plotë të informacionit.

Kur vëren shkëputje të vëmendjes së auditorit, folësi duhet të flasë më ngadalë, duhet të bëjë më shumë pushime gjatë fjalisë, duhet t’i shtrijë më

28. James C. Humes, “Speak like Churchill stand like Lincoln”, Three Rivers Press, New York 2002, faqe 1.

29. Filozof dhe shkrimtar romak, shekulli 4 para Krishtit - 65pas Krishtit

shumë fundet e fjalëve, të përdorë tone më të buta. Këto teknika do të lejojnë dëgjuesin të përqendrohet më mirë, të rimarrë dhe të freskojë vëmendjen dhe t'i kuptojë më qartë ato që thuhën.

Linkoln shpesh përdorte pauzën kur fliste. Kur ishte duke përcjellë një ide të rëndësishme dhe dëshironte që kjo ide të bënte një përshtypje të thellë tek dëgjuesit e tij, ai përkulej përpara, i shikonte ata drejtpërsëdrejti në sy për një moment dhe nuk fliste. Kjo qetësi e papritur kishte të njëjtin efekt, ashtu sikurse dhe zëri i vullshëm. Kjo tërheq vëmendje. Kjo bën çdonjërin të vëmendshëm, vigjilent, syçelur për atë që po ndodh. Për shembull, kur debati i tij i famshëm me Douglas ishte duke u mbyllur dhe të gjitha gjasat tregonin për disfatën e tij, ai u stresua, melankolia e zakonshme e tij u largua nga ai në kohën kur po thoshte fjalët e tij me një ndjenjë të fuqishme dhe prekëse, ku, papritmas, ai “ndaloi” dhe qëndroi i qetë për një moment, shikoi përreth turmës që qëndronte përpara tij, gjysma indiferente dhe gjysma miqësore, me ata sy të zhytur thellë në mërztitje që gjithmonë dukeshin të mbushur me lot të paderdhur. Përkuli duart e tij, ashtu sikurse dhe ata, i lodhur nga kjo betejë pa përkrahje, ai tha me një monotoni të pazakontë: “Miq të mi, është një ndryshim i vogël, një ndryshim tepër i vogël, nëse Douglas ose unë zgjidhemi në Senat të Shteteve të Bashkuara; por çështja madhore që ne kemi paraqitur sot përpara jush është mjaft larg dhe përtej çdo interesi vetjak apo fati politik të ndonjë personi. Miqtë e mi...,” ai përsëri bëri një pauzë, dëgjuesit ishin të përqendruar në çdo fjalë, “kjo çështje do të jetojë, do të marrë frymë dhe do të digjet kur gojët e mjera, të pafuqishme të Douglas dhe e imja që belbëzojnë do të jenë të qeta në varr”.³⁰ Këto fjalë të thjeshta dhe mënyra në të cilën ato u thanë, prekën çdo zemër deri në palcë.

Linkoln bënte pauza edhe pas frazave të cilat ai dëshironte t'i theksonte. Ai i shtonte fuqinë fjalëve, duke qëndruar i qetë, ndërkohë kuptimi përthithej dhe ndikonte në misionin e tij. Heshtja është më e vlefshme se floriri, kur ajo përdoret me mençuri gjatë të folurit. Pauza është mjet i fuqishëm, mjaft i rëndësishëm, por në përgjithësi, folësit fillestarë e anashkalojnë atë.

Le të shohim fuqinë e pauzës në fjalimin e Benito Juarez³¹). Juarez ishte i pari president që nuk ishte spanjoll, ai ishte një indian, ishte më pak se 162 cm i gjatë dhe mjaft i shëmtuar. “I mjeri Jaurez, duket si një zhabë”, thonin njerëzit e pasur për të. Në moshën 26 vjeçare Juarez drejtonte parlamentin e Meksikës, kur ky indian i rëndomtë u ngrit për të folur, shumica nga auditori e përçmuan, por ai shpiku modelin e tij të prezantimit. Ai nuk foli menjëherë, i hodhi një sy fytyrave të ndryshme në auditor dhe detyroi çdo dëgjues të

30. Dale Carnegie, “Public speaking for success”, Penguin Group, New-York 2006, faqe 162.

31. Presidenti i parë meksikan i zgjedhur në mënyrë demokratike, (i pari që nuk ishte diktator).

drejtonin shikimin nga ai. Heshtja pushtoi menjëherë sallën, ai vazhdoi të qëndronte pa folur dhe duke parë me vëmendje parlamentarët, të cilët, sipas Juarez, mund të mendonin për moszotërimin e spanjishtes së tij. Pikërisht për të përforcuar edhe më tepër parashikimin e tyre Juarez përdori një pauzë të gjatë. Përfundimisht pas kësaj qetësie që zgjati, Benito Juarez filloi fjalimin. Fjalët e tij imponuese oshëtinë, nga zëri i tij i lartë, të qarta për auditorin tashmë të vëmendshëm.³²⁾

Një mjeshtër tjetër që e njihte fuqinë e pauzës ishte Napoleoni. Ashtu sikurse Benito Juarez edhe Napoleoni kishte “një gjatësi trupi sfidues”. Napoleoni u fliste trupave francezë me një zë që e tregonte dialektin e tij të një italianit të vrazhdë prej Korsike, ishulli i vendlindjes së tij. Përpara fillimit të fjalimit të betejës, ai do të qëndronte i heshtur nga dyzet në pesëdhjetë sekonda dhe dukej sikur për çdo sekondë që ai priste, rritej në sytë e trupave të tij. Napoleoni i njihte çelsat e karizmës. Metoda e pauzës së fuqishme ishte çelësi për të lartësuar mesazhin e tij³³⁾.

Në vitin 1991 mbretëresha e Anglisë Elisabeta e dytë, jo më e gjatë se 160 cm, shkoi në Uashington për një vizitë zyrtare, podiumi ku ajo do të mbante fjalimin e saj ceremonial ishte parashikuar për lartësinë e presidentit Bush, kështu menjëherë u vendos një stol, në mënyrë që podiumi të bëhej i përshtatshëm edhe për të, përpara se ajo të fliste bëri një pauzë, me qëllim që auditori të reagoonte ndaj heshtjes së saj. Po kështu, edhe në 1957, përpara se ajo të fillonte fjalimin e saj në pallatin qeveritar Williamsburg, në Virginia, Mbretëresha Elisabetë bëri një pushim aktoresk, i cili rrëmbeu zemrat e auditorit tashmë të përqendruar, përshëndetja e saj ceremoniale tingëlloi mjaft e ngrohtë dhe e çiltër³⁴⁾. Kur fjalët e saj u shfaqen në faqet e gazetës ditën tjetër, ato u duken mjaft të thata. Pauza e saj e fuqishme kishte siguruar vëmendjen e dëgjuesve dhe lartësimin e forcës së fjalëve.

Burrat si dhe gratë, qofshin të gjatë apo të shkurtër, marrin gjatësinë e duhur në sytë e auditorit të tyre përmes heshtjes strategjike.

Pauza është e rëndësishme edhe kur dikush në auditorin tuaj ju bën një pyetje. Para se të jepni një përgjigje të shpejtë dhe të pamenduar, bëni një pauzë, gjatë të cilës ju mund të përgatiteni për t'u përgjigjur pyetjes duke i shprehur mendimet në fjalë. Hartoni përgjigjen në mendjen tuaj – në një fjali me një kryefjalë dhe një kallëzues. Një përgjigje e shpejtë, pa u menduar mirë, tregon që ju nuk e keni dëgjuar me vëmendje pyetjen. Një pauzë e bërë me

32. James C. Humes, “Speak like Churchill stand like Lincoln”, Three Rivers Press, New York 2002, fq. 1-2.

33. Po aty.

34. Po aty, faqe 5-6.

qëllim përpara se ju të flisni i shton peshë dhe mençuri si përgjigjes suaj, ashtu edhe perceptimit të saj nga auditori. Në këtë mënyrë dëgjuesi mendon se ju keni dëgjuar me të vërtetë atë që ju bëri pyetjen, në vend që të përgjigjeni me nxitim.

Kur ju jeni duke u përgjigjur, mendoni për pauzën e fuqishme, sikurse ju vendosni rripin e sigurimit përpara se të ngisni makinën, si një masë sigurie për të parandaluar ndonjë aksident. Prandaj, përpara se ju të përgjigjeni, ju duhet të shihni drejt e në sy bashkëbiseduesin tuaj që pret përgjigje nga ju.

Njeriu nuk mund ta arrijë qëllimin e tij i vetëm, ai nuk mund të fitojë garën pa ndihmë. Përderisa, veprat e gjenive të pikturës të Rafaelos apo Rembrandit u nevojiten kornizat e duhura, po ashtu edhe një fjalimi i nevojiten pauzat e duhura. Një pauzë e fuqishme është si një kornizë, e cila i sjell hijeshi pikturës.

Përfundime

Të dish të flasësh nuk është një art aq i lehtë, siç do të mund të dukej në shikim të parë. Nuk mjafton të hapësh gojën, të njohësh një koleksion historish të ndodhura, të përdorësh argumente, citime e fraza të famshme. Të dish të flasësh do të thotë, mbi të gjitha, të dish t'i bësh të tjerët që të dëgjojnë. Prandaj drejtuesi duhet të jetë orator i mirë. Në qoftë se është i tillë, ai mund t'i bëjë njerëzit të ndjehen optimistë dhe të krenohen për punën e tyre. Gjatë veprimtarisë së tij drejtuesi do të ketë përballje të shpeshta me median, diskutime apo debate me eprorët, kolegët dhe me vartësit. Për të zotëruar këto ngjarje ai duhet të ndjekë disa rregulla:

- Të mendojë mirë me vëmendje, në qetësinë e vetminë e zyrës së tij, duke analizuar argumentin kryesor, duke qartësuar qëllimin të cilit duhet t'i shërbejë materiali që përgatit (diskutimi, debati), duke marrë parasysh mjedisin dhe mentalitetin e publikut.

- Të përpilojë një skemë mendore të diskutimit, duke fiksuar pikat me rëndësi më të madhe, me fjalë të tjera, të krijojë shtyllën kurrizore. Pikat e ndryshme duhet të jenë të lidhura ngushtë ndërmjet tyre nga një koordinim i fortë logjik.

- Të pasurojë, gjithmonë mendërisht, këto pika me linja të dyta, pasoja, argumentime, dokumentacione në bazë të nismave lirike, ironike, patetike sipas rasteve.

- Të shkojë në një vend ku askush nuk mund ta dëgjojë apo ta shqetësojë e të fillojë të ndërtojë gojariisht diskutimin e tij, duke zhvilluar një nga një pikat e fiksuara në kujtesë, duke llogaritur të gjitha materialet e grumbulluara për këto pika thelbësore e duke u përpjekur t'i shprehë në mënyrën më të mirë.

- Të vazhdojë të recitojë diskutimin derisa të ketë krijuar përshtypjen se e zotëron plotësisht. Në këtë pikë do të mundë të përballojë auditorin.
- Të jetë një orator i kohës së vet. Sot maten fjalët siç maten gjestet e mendohen frazat. Kur të flasë në publik, të thotë vetëm atë që ka për të thënë e asnjë fjalë më shumë, si dhe të përpiket ta thotë si “thuhet në jetë”, pa zbulurime retorike apo akrobacira stilistike.
- Por dhe nëse arrin të bëhet një orator i mirë, të ruhet nga defekti për të marrë fjalën në çdo rast. Ai duhet të ruhet nga mikrobi i fjalomanisë. Nuk do të bëjë gjë tjetër, veçse do të shkatërrojë reputacionin e tij. Të flasë vetëm kur të jetë e nevojshme. Metalet më të rralla janë më të çmueshmet.

Literatura:

- Harry Box, “*Arti i imponimit*”, volumni i gjashtë, Shtëpia Botuese “Shkolla e jetës”, Tiranë 1999.
- Dale Carnegie, “*Public speaking for success*”, Penguin Group, New-York 2006.
- Majlinda Cukalla, *Retorika (leksion)*, Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, Tiranë 2004.
- Hebert Genzmer, “*Rhetorik die Kunst der Rede*”, DuMont Literatur und Kunst Verlag, Köln 2003.
- Rudolph W. Giuliani, “*Udhëheqja*”, Shtëpia Botuese “Dudaj”, Tiranë 2006.
- James C. Humes, “*Speak like Churchill stand like Lincoln*”, Three Rivers Press, New York 2002.
- Nadine Kmoth, “*Koerper Rhetorik*”, mvgVerlag, Redline GmbH, Heidelberg 2005.
- Plutarku, “*Jetë njerëzish të shquar të lashtësisë*”, SHB “Naim Frashëri”, Tiranë 1980.
- Herman Schluter, “*Das Handbuch der Rhetorik*”, Anaconda Verlag GmbH, Köln 2006.
- H. G. Watson, “*Të dish të flasësh*”, volumni i tetë, Shtëpia Botuese “Shkolla e jetës”, Tiranë 2000.
- Fuehrungsakademie der Bundeswehr, Redentechnik (Rhetorik).

Doc. dr. Flora SELA (KASTRATI)

EUROPA NËN PETKUN E DEMOKRACISË

“Jam demokrat dhe nuk mund t’ia mendoj askujt të keqen. Me politikë dhe prapaskena le të merrret kush të dojë. Unë aty nuk jam.”

(L. Gurakuqi)

Thonë se njeriu vazhdimisht është në gjurmim të vetvetes, me qëllim që pas vetes së tij të lë gjurmë të pashlyer në kohë dhe hapësirë, të japë maksimumin që rrjedh nga potenciali i tij intelektual edhe pse në këtë përpjekje të parreshtur ai ballafaqohet shpesh me vështirësi të natyrave të ndryshme, që pengojnë që ai të shprehet në tërësi. Por, megjithatë, ai shkon përpara, ec me kohën, dëshiron ta ndryshojë këtë botë ose së paku ta bëjë më të mirë dhe më njerëzore e kjo është pa mëdyshje, në radhë të parë, detyrë dhe misioni i intelektualit.

Detyra dhe misioni i intelektualit shqiptar në këtë kohë të lulëzimit dhe zhvillimit të demokracisë së njëmendtë në Europë është që vlerat e kësaj demokracie t’i bartë e t’i kultivojë në trojet ku jetojnë shqiptarët, të cilët historikisht i takojnë Europës së civilizuar, si popull me një kulturë dhe civilizim të lashtë.

(Flora Sela Kastrati)

Nocioni dhe përkufizimi

Ekzistojnë përkufizime të cilat vetvetiu ndikojnë pozitivisht ose po ashtu me një dozë të madhe kthjelltësie. Domethënia e tyre, respektivisht vetë kuptimi i tyre, duken se janë aq të qartë, saqë nuk nevojitet një përpjekje për përcaktimin e tyre.

Nocione të tilla janë liria, demokracia, progresi dhe toleranca. Ndër të parat, natyrisht, është dhe nocioni demokraci, i cili në përpjekjet e shoqërisë sonë luan një rol mjaft të rëndësishëm, pse jo edhe rolin më të rëndësishëm edhe sot. Ky nocion, në raport me përpjekjet që bëhen në rregullimin e proceseve politike, ekonomike ose qofshin ato mbi marrëdhëniet ndëretnike në plan të brendshëm, por edhe ato ndërkombëtare, proceset e globalizimit dhe integritit në to, duket sikur shumë rëndë mund të implementohen dhe për këtë shkak mendohet se është shumë e lehtë që të kuptohet. Ndaj, përmbajtja e saj nuk duket vetëm si evidente, por e thjeshtë dhe e qartë.

Në aspektin etimologjik, nocioni demokraci rrjedh nga fjalët e vjetra greke ‘demos’, që domethënë popull dhe folja ‘krateo’, që ka kuptimin e fjalës sundim ose ndryshe ‘sundimi i popullit’. Megjithatë, definicioni etimologjik si fjalë kënaqet vetëm me përkufizimet terminologjike nga nocionet tjera. Që të përcaktohet përmbajtja e këtij nocioni, gjithsesi është e nevojshme të definohen karakteristikat thelbësore të saj. Për këtë arsye do të shërbehemi me përkufizimet e nocionit demokraci në enciklopedi dhe fjalorë të ndryshëm.

Në botimin më të ri në Fjalorin Enciklopedik të Britanisë nocioni demokraci përdoret për të shprehur njërën nga format e udhëheqjes, ku fuqia kulmore e udhëheqjes u besohet njerëzve ta zbatojnë dhe t’i gëzojnë frytet e saj në mënyrë direkte ose indirekte përmes sistemit të zgjedhjeve të lira.

Nuk do të kishim kuptuar nocionin demokraci nëse në vazhdim nuk do të flisnim për llojet më të rëndësishme të rregullimeve demokratike edhe atë “Në demokracinë direkte, publiku në mënyrë të drejtpërdrejtë merr pjesë në vendimmarrje (si në disa qytet-shtete në Greqinë e vjetër, disa sisteme parlamentare në Anglinë e re, si dhe në disa kantone moderne të Zvicrës).

Pjesa dërmuese e demokracive në kohën e sotme janë të llojit përfaqësues (demokraci indirekte).

Koncepti i demokracisë përfaqësuese u paraqit si rezultat i ideve të institucioneve të cilat janë zhvilluar në periudhën e shekullit të mesëm dhe iluminizmit në Europë, si dhe në kohën e Revolucionit Amerikan dhe Francez. Në fund të tekstit tregohet për vlerat e demokracisë, e cila u ngrit deri në një instrument universal për shprehjen e së drejtës së votimit në kohën e zgjedhjeve, garë për funksione të mandatit, liria e shtypit dhe ajo e të shprehurit si dhe zbatimi i ligjit”.¹⁾

Në përcaktimin e demokracisë si mënyrë e udhëheqjes, në mënyrë të qartë kufizohet praktikimi i llojit direkt nga ai indirekt, si të afërt dhe të përfaqësues, aplikimi i saj në nivel qendror (në nivel të shtetit) ose lokal (kantone dhe qytet-shtete), fuqia e instrumentit universal për arritjen dhe kontrollin

1) Британика Энциклопедически Речник, (2005), Libri i Tretë, G-Z, Toper MPM, Shkup, fq.59.

e të drejtave dhe lirive bazë dhe për sundimin e së drejtës. Ky përcaktim i vlerave të demokracisë sot paraqet bazën për proceset e globalizimit, të cilat zhvillohen në një ritëm të shpejtë në të gjitha pjesët e botës.

Është e vlefshme ndarja e këtij kuptimi në librin kushtuar Enciklopedisë–Mozaik. Atje demokracia është caktuar si udhëheqja e popullit, e krijuar kundër sundimeve aristokratike, të cilat kanë qeverisur me fiset fillestare. Në tekst më vonë tregohet për fazat të cilat kanë kaluar në zhvillimin personal, “shkalla e saj e parë ishte demokracia gjinore, e cila është themeluar në mënyrën e krijimit dhe rregullimit të fiseve shoqërore“. Në takimet e përbashkëta vendosej në prani të të gjithë anëtarëve të fisit. Kryeplaku i fisit të zgjedhur nuk ka pasur në takime më shumë të drejta se anëtarët e tjerë. Ishin të parët midis të barabartëve, ndërsa detyra e tyre ishte angazhimi për sjelljen e vendimeve të arrituara në takimin e përbashkët.

Lloj tjetër i demokracisë ishte ajo ushtarake, në të cilën “klasa sunduese tashmë kishte arritur që të marrë në duart e veta funksionet më të rëndësishme të fisit”, megjithatë në mbledhjet e anëtarëve të lirë të komunave fshatare kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët, të cilët tani janë me të drejta të barabarta. Këto të drejta kanë qenë të lidhura për së afërmi me gjendjen e pasurisë së anëtarëve të fisit. Për shembull, tipik i demokracisë ushtarake jepet rregullimi i Greqisë Antike, e cila bazohet në punën e një numri të madh të robërve. Në tekst citohen dhe tregues numerik për gërshtimin e caktimit të këtij lloji të demokracisë. Në shumë shtete antike shtet-poliset janë sjellë në demokracinë e njëjtë, në të cilën të drejtat politike të cilat i kanë gëzuar njerëzit e rritur si qytetarë të barabartë. Ato kanë arritur 20% të popullatës së përgjithshme. Kjo formë e demokracisë nuk është demokraci në kuptimin e plotë të fjalës, duke marrë parasysh faktin se një numër i madh i popullatës në këto polise (gratë, pleqtë, zejtarët, tregtarët etj). Gjithsesi, demokracia e këtillë, me shekuj është përçarur në teorinë dhe praktikën politike. Po ashtu, merret parasysh dhe shembulli i Perandorisë Romake, në të cilën është aplikuar rregullimi republikan, por, gjithashtu, ceket se në të asnjëherë nuk ka qenë e aplikuar ajo demokraci që u aplikua në Greqinë Antike. Fillimin e demokracisë redaktorët e librit e lidhin me paraqitjen e klasës së re qytetare, në garën për absolutizmin feudal. Ajo ishte fillimi i demokracisë qytetare, e cila ishte e vendosur me Revolucionet Borgjeze në disa shtete europiane, edhe pse në fillim, siç theksohet në vazhdimin e librit, shumë rrjedha demokratike kishin vetëm karakter deklarativ, ndoshta disa kritikë kanë konstatuar se demokracia “si e drejtë bazë e çdo njeriu” mund të flitet në demokracitë socialiste.²⁾

2) Энциклопедиски лексикон-Мозаик знања, (1970), Histori, Interpres, Beograd, fq.140-141.

Ndarje të këtilla hasim edhe në disa publikime të ndryshme në vendet e ish Jugosllavisë. Për shembull, në një nga botimet më të shitura siç është leksikoni i Vujaklisë, aty demokracia përkufizohet si “pushtet” i popullit dhe këtu bëhet krahasimi ndërmjet mendimit formalistik qytetar me atë marksist. Botëkuptimi “Qytetaro-formalist” demokracinë e përkufizon si regjim të një barabartësie formale dhe të drejtën e çdo qytetari të marrë pjesë në zgjidhjen e të gjithë punëve brenda shtetit. Ky botëkuptim dallon vetëm dy tipe të demokracisë: atë të drejtëpërdrejtë dhe atë indirekten. Për dallim nga kjo, autori e sqaron se mendimi marksist demokracinë e definon si një qeverisje të klasave.³⁾

Një ndarje të tillë ose të ngjashme hasim pothuajse tek të gjithë leksikonet e botuara deri në vitet 90-të të shekullit të kaluar. Kështu që në një nga leksikonet moderne të gjuhëve të huaja dhe shprehje të autorit Lubo Mikunoviq, termi demokraci është i definuar nga aspekte të ndryshme rreth përmbajtjes së tij, si psh: 1. “Qeverisja e shumicës së popullit, rregullimi shoqëror në të cilin pushteti i takon shtresave të gjëra të popullit, të cilat i zgjedh përfaqësuesi i tyre në të gjithë organet e qeverisë, prej udhëheqësve me të ulët shtetëror deri tek ato më të lartët; 2. Liri për të gjithë njerëzit përparimtarë, progresivë, barazi në jetën shoqërore; 3. Mungesë të detyrimit ose kufizimeve të ndryshme.”⁴⁾

Në definicionet e cituara më lart të nocionit demokraci hasim disa përcaktime: E para, ky nocion kuptohet si formë e rregullimit shoqëror, ku pushteti ka shumicën e popullit, i cili me të drejtë i kërkon bartësit të funksioneve udhëheqëse; e dyta, si qeverisje e shumicës si në nivel lokal, ashtu dhe në atë qendror; e treta, ajo vlerësohet që në mënyrë direkte është e lidhur me lirinë si një ndër vlerat më të mëdha të jetës së njeriut, në të njëjtën kohë duke e lidhur me idetë e njerëzve përparimtarë, progresivë, por edhe me barazinë e të gjithëve në praktikimin e jetës shoqërore; e katërta, si diçka e kundërt e vlerave negative, siç janë detyrimi me dhunë, shtrëngimi dhe kufizimi.

Nëse i kthehemi të kaluarës nga Antikiteti e deri sot, do të shohim se ky nocion dhe në të kaluarën, si edhe sot përcaktohet në kontekst të formave të pushtetit në nivel lokal si formë direkte, por edhe në nivel qendror, si formë indirekte e demokracisë. Në këtë aspekt, qytet-shtetet (poliset) antike sikur të ishin ai vendkalim në kalimin e praktikimit të pushtetit nga niveli lokal në atë qendror, që është me një domethënie të veçantë për të dy llojet e qeverisjes shoqërore sot.

3. Vujaklija, M (1980), Лексикон страних речи и изрази, Prosveta, Beograd, fq.200-201.

4. Mikunoviq, L (1990), Современ лексикјон на странски зборови и изрази, 'Libri jonë', Shkup, fq.150-151

Në njërën nga studimet më të rëndësishme për rregullimin shtetëror në Antikitët në veprën “Shteti” të Platonit, nocioni “demokraci” përdoret vetëm për të emëruar njërën nga llojet e rregullimit shtetëror, që ishte i njohur në Greqinë e antike. Kreun e tetë në veprës “Shteti” Platoni ia kushton kësaj çështjeje dhe atë përmes bisedës me shokun e tij Glaukon, ku mundohen që të gjejnë një rregullimin shtetëror, që do të ishte ideale për “sofokratinë” e tij e të cilën do ta realizonin në “kalipolisin” ideal. Kjo për të, për çdo rast nuk ka qenë demokraci. Si forma më të njohura të rregullimeve shoqërore në Antikitët Platoni i konsideron; “Në radhë të parë ajo është formë krite ose lakonike e shtetit; e dyta, oligarkia, e cila është e dyta në radhë edhe sipas rregullit edhe sipas meritave; kjo është formë e shtetit përplot gabime; pastaj vjen demokracia, forma e kundërt e oligarkisë dhe që vjen pas saj, madje, sëmundja e katërt dhe e fundit e shtetit është tirania e vërtetë, e cila dallohet nga të gjitha të tjerat.

A njohim edhe ndonjë formë tjetër që do të jetë aq e theksuar dhe e qartë?

Dinastitë dhe mbretëritë, të cilat mund të blihen dhe forma të tjera të ngjajshme me ta, bëjnë pjesë në mesin e tyre që tanimë i numërova, forma të tilla mund të gjinden si tek barbarët, ashtu edhe tek helenët.⁵⁾

Në diskurin dhe dialogun e metejshëm mes shokëve, Platoni jep një lloj definicioni të pushtetit demokratik kur thotë që: “Ajo formë krijohet kur të varfërit do të fitojnë dhe një pjesë të kundërshtarëve do t’i vrasin, ndërsa pjesën tjetër do ta dëbojnë, dhe me të tjerët do të mundohen që në mënyrë të barabartë të ndajnë pushtetin dhe të drejtat qytetare edhe atëherë kur pushteti rëndom zgjidhet me anë të shortit.” Nga ky definicion shihen qartë disa nga karakteristikat thelbësore bazë të demokracisë siç janë: barazia në ndarjen e pushtetit, të drejtat qytetare, vlerat e demokracisë dhe çka është mjaft interesante, zgjedhja e qytetarëve në pushtet është vendosur edhe me anë të shortit, i cili, si veprim, ishte zëvendësim ose paralelisht përdorej me veprimin e zgjedhjes direkte dhe indirekte të bartësve të pushtetit. Ky veprim më vonë me praktikimin e demokracisë pothuajse në tërësi është braktisur.

Cila është vlera më e madhe ose siç thotë e mira më e madhe e demokracisë sipas Platonit? (*Filozofia e Antikitetit*)

Cila është vlera më e madhe ose siç thotë e mira më e madhe e demokracisë sipas Platonit?

Në këtë pyetje Platoni përgjigjet se ajo është liria (elefteria) “mund të

5. Platon (1969), Shteti, 'Kultura', Beograd, fq.264.

dëgjosh se ajo është më e bukura në shtetin demokratik dhe për atë, i cili për nga natyra është i lirë, vetëm për atë ia vlen të jetohet” në këtë lloj të shtetit. Megjithatë, Platoni na jep një përgjigje të padyshimtë në pyetjen se cilat janë shkaqet për rënien e demokracisë?

Natyrisht, ai arsyet ose shkaqet i sheh në pangopësinë e orekseve të njerëzve të pushtetit për të mira materiale dhe epshtet si vlera negative në demokraci. *“Unë mendoj se shteti demokratik është i etur për liri”*.

Është mjaft interesant qëndrimi i Platonit në raport me vlerën më të bukur të demokracisë - liria, duke pasur parasysh se ai në mënyrë konsekuente, konkludon se kjo është arsyeja për rënien e saj. Në formën e sotme të demokracisë kjo gjë është tejkaluar me qëndrimin për funksionimin e sistemit juridik si pushteti i tretë në shtet.

Pyetja mbi demokracinë si formë e rregullimit shtetëror nuk është e përpunuar në mënyrë eksplicite nga ana e njëres nga mendjet më të ndritura të Antikës, që ka qenë pikërisht nxënësi i Platonit, i cili ka qenë edhe sistematizues i madh, logjicent dhe themelues i shumë shkencave, Aristoteli. Për njohësit e mirë të rrethanave shoqërore-politike në Eladë dhe lidhjen e Aristotelit me sundimtarët e Mbretërisë Maqedone (babai i tij Nikomah ka qenë mjeku personal i familjes mbretërore të Amintës, babait të Filipit të Maqedonisë, ndërsa ai vetë ka qenë mësues i Lekës së madh), evidente është se në kushtet e ekspeditave ushtarake-pushtuese në tërë ekumenën e njohur është logjike se nuk mund të lidhet demokracia për emrin e tij.

Megjithatë, Aristoteli i ka njohur dhe pranuar vlerat e demokracisë, duke folur për të si për liri (elefteri). Gjithashtu, duhet të theksohet se Aristoteli nuk e ka përdorur termin liri në kuptimin e sotëm të fjalës (elefteri), por vetëm termin vlerë (atia), nga i cili më vonë është krijuar dhe termi etikë (etos, ejnos), dhe atë në mënyrë eksplicite e shfrytëzon në domethënien e sotme kur flet për zhvillimin e jetës politike-polis-ia nga pozita e udhëheqësit në botën antike nga raporti skllav-skllavopronar.

Lirinë, Aristoteli, e cilëson si vlerë (atia), të cilën e kanë praktikuar “forma e caktuar politike-demokracia” për dallim nga vlerat udhëheqëse në ‘forma të tjera politike’.

Në lidhje me lirinë, Aristoteli zhvilloi një sistem të tërë të një jete morale, siç janë vlerat etike si psh: e mira, vullnetarizmi, antivullnetarizimi, virtyti etj., por, gjatë kësaj, asnjëherë nuk e ka përdorur termin liri.

Në periudhën e helenizmit të Antikitetit dhe hegjemonisë të perandorive të mëdha aristokratike (Maqedoni dhe Romë), nuk ka pasur as kushte sociologjike, as edhe mundësi që demokracia të mendohet si një formë e qeverisjes së popullit. Edhe në Romë, ku në një periudhë të caktuar kohore u fut mënyra republikane e qeverisjes si një formë e rregullimit shtetëror,

nuk mund të gjindet diçka më domethënëse se vetë tiparet e demokracisë, përveç tentimeve për t'u konstituuar sistemi i së drejtës në vetë të Drejtën Romake, si bazë ë shkencave juridike dhe njëkohësisht njëra nga përfitimet më të rëndësishme të demokracisë moderne.

Mesjeta me aristokracinë laike dhe kleri me pushtetin e tij shpirtëror nuk kanë lënë hapësirë për zhvillim të demokracisë në kushte reale. Deri para përfundimit të Mesjetës, gjatë periudhës së humanizmit dhe renesansës, periudhë e cila dallohej me idetë e saj për ngritje të nivelit për liri tek njerëzit në të gjitha sferat e jetës, si në atë shpirtëror, moral, social, politik, në këtë periudhë, gjithashtu, u paraqitën dhe kuptime të ndryshme mbi zhvillimin e shtetit, si psh: Hugo Grocius me veprën e tij të njohur “Për të drejtën e luftës dhe paqes”, në të cilën e ndërtoi teorinë e parë mbi të drejtën ndërkombëtare bazuar mbi të drejtën natyrore, ndërsa të drejtën ai e ka konsideruar si pjesë të natyrës së njeriut dhe për këtë shkak ndjenjën mbi shtetin ai e shikonte si të pashmangshme. Janë dhënë dhe ide të tjera utopike në ëndrrat e njerëzve të mençur, të cilët e shohin si një largim virtual nga tirania dhe gjithë ajo që është e pamoralshme, në formë të rregullimeve shtetërore të paramenduara nga tripi i ishullit “Utopia” e Tomas Mor-it, “Qyteti i diellit” i Tomazo Kampanelës ose “Atlantida e Re” e Frensis Bekonit.

Idetë e vetive utopike

Ëndrrat e këtyre mendimtarëve ishin të drejtuara përpara dhe dukej sikur po e braktisnin mendimin real ose po dukej sikur nuk kishin asgjë të përbashkët me të. Por, në qoftë se analizohen këto ide, do të shihet se bëhet fjalë për dy natyra të diferencuara ndërmjet veti: utopike dhe utopiste.

Natyra utopiste lëshohet në përpunimin e mundësive abstrakte nga mendja personale (në shembujt që i përmendëm më lart), ndërsa natyra utopike, këto mendime i lidh me realitetin (Robert Oven dhe Sharl Furie me orientimin e tyre federal dhe Shën Simoni me orientimin e tij centrist, ose të parët, themelet e ndërtesave të reja i kanë vendosur vetëm në mendjet e tyre, për shkak se nuk kanë mundur të përballen me realitetin e atëhershëm, ndërsa të dytët me fillimet e tyre gjeniale paraqiten gjithandej nën luspën fantastike. Edhe përkrah të tejkalimit të një kohe të gjatë, utopitë e tilla në masë të madhe janë të ndikuara nga koha kur kanë ekzistuar (p.sh: Furie me kritikën e mundësive ekzistuese, Shën Simoni me gjenialitetin e zgjeruar të pamjes me ndihmë, i cili ka përfshirë pothuajse të gjitha mendimet e mëtejme socialiste, të cilat rreptësisht nuk kanë pasur karakter ekonomik).*

* Shif më gjërësisht; Ernest, B, (1966),Tubingenski uvod u filozofii, Beograd, fq.115-116.

Për demokracinë, si një rregullim shtetëror në aspektin modern të fjalës, mund të flitet që nga paraqitja e klasës së re qytetare në fillimin e shekullit të ri, në qytetet e disa vendeve europiane. Bartës së ideve të demokracisë, lirisë, barabarësisë, drejtësisë e të ngjashme janë empiristët, arsimuesit, enciklopedistët, liberalistët ekonomikë, kritika sociale etj. Ato me të vërtetë ishin ideologët e revolucioneve të mëdha burzhiste në Holandë, Francë dhe Angli, ndërsa idetë e tyre ishin të shënuara në shumë dokumente, të cilat shërbejnë si bazë për demokracinë e sotme.

Në mes tyre më domethënëse është Deklarata për pavarësimin e SHBA-ve, Deklarata për të drejtat e njeriut dhe qytetarit nga viti 1789 si një nga dokumentet më të rëndësishme, i cili doli nga Revolucioni Francez dhe dokumente të tjera më të reja, të cilat janë themeli i mendimit të sotëm mbi demokracinë (më domethënëse për demokracinë sot, është Deklarata Universale për të drejtat e njeriut të OKB-së, e miratuar në vitin 1948).

Idetë e teoricienëve të kontratës shoqërore

Kontribut mjaft interesant dhe domethënës në zhvillimin e demokracisë në vendet e Europës veriore dhe atyre anglo-saksone kanë dhënë empiristët, para së gjithash: Tomas Hobsi dhe Xhon Loku.

Tomas Hobsi në veprën e tij të madhe “Levijatan”, demokracinë e definon si një nga format e rregullimit shtetëror, por interesin e tij ai e drejton drejt monarkisë si një formë e rregullimit shtetëror kryesisht në të drejtën natyrore dhe marrëveshjen shoqërore. Megjithatë, ajo që me të vërtetë është rëndësishme për Hobsin, si dhe për sistemin anglo-sakson të demokracisë, sidomos në pjesën për të drejtat e njeriut, është fakti që një koncept të një monarkie mjaft të ashpër, të drejtat e njeriut janë të pranura në një mënyrë mjaft liberale, sidomos në aspektin e të drejtës së jetesës. Në veprën “Leviathan”, Hobsi mendon se ekzistojnë tre lloje të suverenitetit, në atë që monarkia në të cilën suvereniteti i takon një njeriu ose po demokracia në të cilën ajo i takon në bashkësinë e përgjithshme, ose aristokracia në të cilën ajo bën pjesë në një bashkësi e përbërë nga një numër i caktuar i personave të emëruar ose persona që në njëfarë mënyre tjetër dallojnë nga të tjerët.⁶⁾

Hobsi, në vlerat e monarkisë, të cilën e definon në veprën e tij, në veçanti e tregon korrelacionin e lirisë dhe nevojës, por edhe rëndësinë e saj për njeriun dhe me këtë vjen në përfundim se e gjithë ajo që thamë më lart do të ishte e mjaftueshme për realizimin e demokracisë.⁷⁾

6. Hobs, T (1961), *Levijatan ose materia, oblik i vlast drzave crkvene i gradjanske*, Kultura, Beograd, fq.169.

7. Po aty, fq.187.

Xhon Loku mendon se shoqëria duhet të jetë e ndërtuar me kujdes dhe me qëllim që të zhvillojë lirinë njerëzore dhe të drejtat e njeriut, përderisa pushteti duhet të jetë nën udhëheqjen e vetë njerëzve. Koncepti i tij për shoqërinë është i përshkruar në veprën. Dy mosmarrëveshjet për pushtetin janë themelet e të drejtave të përealizuara të njeriut dhe pikërisht këto mendime liberale kanë qenë ato që sollën sjelljen e Kushtetutave të SHBA-ve (në vitin 1787 nga juristi Tomas Xheferson, i cili ishte i lidhur ngushtë me Lokun), por edhe të shteteve të tjera moderne. Në veprën e tij ai shfaq vlerat të cilat sot paraqesin bazë për definimin e demokracisë: qëllimi kryesor i njerëzve të cilët janë pjesë e shoqërisë dhe dhe jetojnë të pavarur në pronat e tyre personale, ligji i parë dhe më i rëndësishëm i të gjithë shteteve është vendosja e pushtetit ligjor; ligji i parë dhe bazë është ruajtja e shoqërisë,* dhe këto janë shteti i së drejtës dhe liritë e njeriut.

Arsimimi si kulturë e veçantë, aktivitet kritik dhe pedagogjik në Europë si dhe shprehje e ndryshimeve të shumta në jetesë dhe marrëdhënieve në mes njerëzve në fillim të shekullit të ri. Arsimimi paraqet një hap mjaft të rëndësishëm për ngritjen e mentalitetit tek njerëzit, për angazhimin e filozofëve, shkencëtarëve dhe pedagogëve në ndryshimet që ndodhin në botë. Me ide të tilla ishte e përfshirë si Europa kontinentale, ashtu edhe ajo ishullore.

Arsimuesit ishin mendimtarët më të denjë në vendet e tyre, të nacionalitetit të tyre, disa herë dhe shkencëtarë të mëdhej, të cilët dijen e tyre e përçonin tek populli. Disa nga ato ndikuan në zhvillimin e mendimit demokratik politik, ndërsa disa nga ato praktikoni kritikën bashkëkohore ndaj disa dukurive negative të asaj kohe. Të tillë ishin: Tomas Hobsi në Angli, Sharl Monteskiye, Volteri dhe Zhan Zhak Ruso në Francë, Lesing, Gete dhe Shileri në Gjermani dhe të ngjashme.

Sharl Monteskiye në veprën e tij për Frymën e ligjit, si jurist dhe filozof, është munduar të paraqesë nevojën e ndarjes së pushtetit në atë gjyqësor dhe ekzekutiv dhe secili nga ato të ketë ingerencat e veta, mirëpo ato vazhdimisht të kontrollohen ndërmjet veti. Kjo është kusht për Monteskijen për arritjen e një shkalle të caktuar të lirisë së qytetarit dhe një koncept i tillë i rregullimit kushtetues të shtetit është përgjithësisht i pranuar dhe sot, pothuajse në të gjitha shtetet të cilat pretendojnë që të jenë demokratike.

Në veprën “Marrëveshje për tolerance”, Volteri, përsëri paraqitet si mbrojtës i të drejtave të njeriut. Këtë mendim të tij ai më së miri e ka paraqitur në qëndrimin e tij: “Zotëri, unë nuk dakordohem me mendimin tuaj, por me të gjitha fuqitë e mia do ta mbroj të drejtën tuaj me qëllim që të dalë në pah mendimi juaj”. Ja dhe një lepezë tjetër e vlerave të demokracisë moderne dhe tolerancës.

*Shif më gjërësisht në veprën “Две расправи за власта”, të Xhon Lokut.

Bashkatdhetari i tij, po ashtu dhe miku i tij Zhan Zhak Ruso, të cilin në aspektet filozofike dhe shkencore e marrin parasysh si njëri nga mendimtarët më të rëndësishëm dhe më modernë, përmes kritikave për përparim ai dha disa shembuj se progresi i njerëzimit nuk ka sjellë deri në zhvillimin e duhur, por deri në anashkalimin e disave nga elementet më humane tek njerëzit dhe, për këtë shkak, bëri thirrje për kthim mbrapa dhe analizim më të detajuar të situatës.

Në veprën e tij “Marrëveshja shoqërore”^{*} Ruso promovoi idenë e thelbit të marrëveshjeve politike në shoqërinë bashkëkohore: Njeriu lind i lirë, por gati në çdo vend është nën pranga. Dikush mendon se është Zot mbi të tjerët, a faktikisht është rob më i madh se to.

Idetë e arsimimit ishin të përafërta me një plejadë mendimtarësh me përcaktime materialiste, të cilët me këmbëngulje të madhe krijuan Enciklopedinë (fjalor i zgjeruar i shkencave, prirejeve dhe aftësive). Në përgatitjen e saj ato arritën t’i mbledhin mendimtarët më të mëdhenj, filozofët, ekspertë nga lëme të ndryshme dhe në bazë të mundësisë së shkencëtarëve nga Likeji i Aristotelit dhe Librarisë dhe Muzejit të Aleksandrit ato përpunuan, së pari, një mjet të koncentruar me domethënie universale për njerëzimin. Aktivitetet e arsimuesve dhe enciklopedistëve të udhëhequr nga Ruso, Volteri, Didro, Dalamber në drejtim të afirmimit të lirisë në të gjitha fushat e jetës dhe shoqërisë, nga njëra anë, dhe kritikën dhe aristokratizmin në anën tjetër, sollën deri në një përgatitje direkte të demokracisë qytetare, por një kohë ishin dhe pikënisje për futjen drejt Revolucionit Francez të vitit 1789, kulmi i të cilit ishte :Deklarata për të drejtat e njeriut dhe qytetarit.”⁸⁾

Këto ide të mendimtarëve dhe enciklopedistëve dolën nga shpirtërat e mëdhenj të asaj kohe, por para së gjithash edhe nga ndryshimet sociale, të cilat janë bazë e demokracisë moderne.

Pikpamjet e liberalizmit ekonomik dhe atij social, më pas dhe të mësimëve socialiste të anarkizmit, gjithashtu kontribuan për mirëkuptim të plotë të bazave të demokracisë, edhe pse disa nga studimet në praktikimin e pushtetit gjatë shekullit të XX rilindën në kundërshtim me mendimet e mëparshme dhe u treguan si sisteme totalitare, e gjithë kjo ishte kundër një shteti demokratik si kundër synojë që të arrihej.

* Vepra “Општествен договор” nga Ruso, në gjuhën maqedone e përktheu dekan i fakultetit në Shkup, profesori Jovan Takovski.

8. Neni 1.Njerëzit lindin dhe jetojnë të lirë dhe janë të barabartë në gëzimin e të drejtave të tyre...,Neni 2...Ato të drejta janë: liria, privatësia, siguria dhe ballafaqimi me realitetin, Neni 3. Liria përbëhet nga mundësia që të bëhet e gjithë ajo që nuk i shkakton dëm tjetrit;(nga Deklarata).

Përfundimi

Këtu le të na lejohej që të përfundojmë me definimin e termit të demokracisë dhe kuptimeve të ndryshme rreth këtij sistemi nga mendimtarë dhe shkolla të ndryshme, por në të njëjtën kohë edhe të mundohemi të gjeneralizojmë gjërat në kuadër të pushtetit ekzistues në kushte të demokracisë në nivel lokal dhe qendror, por gjithashtu me një rëndësi të veçantë të arrijmë të nxjerrim në pah vlerat në kuadër të cilave zhvillohet dhe ekziston demokracia, të cilat janë liritë dhe të drejtat e njeriut.

Demokracia dhe të drejtat e njeriut historikisht (e pamë që nga Platoni dhe më tej) janë të lidhura me dy dukuri të ndryshme, duke përfshirë fusha të ndryshme nga lëmia e politikës – e para është e lidhur me pyetjen rreth organizimit të pushtetit, ndërsa tjetra me të drejtat personale të njerëzve dhe mbrojtjen e tyre. Tek qytetari i thjeshtë, kur bëhet fjalë për demokracinë, mendohet pikërisht për një organizatë të institucionalizuar, siç janë zgjedhjet, sistemet shumëpartiake, ndarja e pushtetit e të tjera. Me të vërtetë, këto janë pyetjet kyçe të përparimit kushtetues të organizatës dhe pushtetit shtetëror. Por, të drejtat e njeriut, nga ana tjetër, përjetohen personalisht dhe kanë për detyrë që t’ju sigurojnë qytetarëve të paktën kushtet minimale për jetesë. Këtu duhet të përmendim atë se kur përdoret termi njerëzore, ato të drejta menjëherë kuptohen si të përgjithshme për nga përmbajtja dhe janë të përfshira në kontrollin ndërkombëtar, përderisa kur bëjmë fjalë për organizimin kushtetues të pushtetit, kryesisht mendohet se e gjithë kjo paraqet një pyetje përgjithësisht të brendshme në kuadër të detyrave të shtetit, sepse shumë ngushtë janë të lidhura me termin e suverenitetit.

Duke u nisur nga përvoja e deritanishme nga praktikimi i demokracisë në disa sisteme shoqërore, në një pjesë të literaturës politiko-sociologjike hasim dy disiplina, të cilat i studiojnë pyetjet e lidhura ngushtë me demokracinë dhe si rezultat i kësaj ndarjeje akademike, na del se pyetja e parë ishte e objekt i studimit të shkencave politike, ndërsa e dyta, ishte pyetja mbi të drejtat e njeriut, të shkencës mbi të drejtën dhe legjitimitetit. Megjithatë, në qoftë se kjo ndarje e tillë do të ishte prezente në vendet e Europës Lindore ose në vendet anglosaksone, atëherë ato me të vërtetë do të ishin larg njëra-tjetrës.*

Sot kjo ndarje e tillë, për fat të mirë nuk vlen, edhe pse shumë pak ka qenë valide në kuptimin e plotë të fjalës. Me rënien e regjimeve totalitare nën presion të popullit, u afirmua demokracia, së bashku me të drejtat e njeriut si një nga vlerat kryesore.

* Kësaj pyetje vëmendje të veçantë i ka kushtuar Beetham, D, (1995), në veprën e tij “Politics and Human Rights”, Oxford, Blakwell.

Kufizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut në të gjitha qëndrimet, pa marrë parasysh a i takon së majtës ose të djathtës, tregoi se janë pengesë për t'u realizuar sistemi politik në një shtet e cili nuk i ka të plotësuara standardet të cilat i kërkon popullata, e cila jeton brenda atij territori. Demokracia dhe të drejtat e njeriut në ditët e sotme llogariten të lidhura ngushtë me realitetin dhe studimin.

Problemi kryesor është pyetja rreth asaj se si do të definohet kuptimi i demokracisë, duke marrë parasysh përcaktimet gjatë gjithë procesit historik, por edhe përcaktimet e sotme rreth përmbajtjes së saj. Dobësia e të gjithë definicioneve institucionale në ditët e sotme shihet në faktin se ato akoma nuk mund të përcaktohen se cila është ajo që i bën institucionet të llogariten si demokratike dhe të mos themi liberale, pluraliste dhe të ngjashme. Në qoftë se përgjigjemi se ato janë vetë institucionet, menjëherë duhet të pyesim se pse ato shtete me institucione të tilla janë demokratike? Kështu që do të biem në konkludim të një gabimi logjik gjatë definimit të të ashtuquajturit cirkulus visiosis (rrethi magjik). Formë e mundshme për t'i ikur kësaj situatë është përcaktimi i principeve bazë nëpërmes të cilave këto institucione dhe shteti ndihmojnë në realizimin e sistemit demokratik.

Qëllimi i demokracisë është rregullimi shoqëror ose kontrolli shoqëror gjatë sjelljes së vendimeve të ndryshme. Pikë kyçe është qytetari dhe jo institucionet. Principi bazë është se secili qytetar ka të drejtë në votë në lidhje me punët shoqërore. Është shumë me rëndësi që kjo e drejtë të jetë e vlefshme për të gjithë. Me fjalë të tjera, kontrolli mbi qytetarët në lidhje me punët e tyre shoqërore janë principet bazë të demokracisë. Në to është e përfshirë edhe perspektiva e demokracisë, e cila është vlera më e madhe e të gjithë procesit të globalizimit në ditët e sotme.

Mark MOLLA,
Magjistër i Shkencave juridike

SISTEMI ZGJEDHOR NË SHQIPËRI: REFORMAT, ARRITJET DHE SFIDAT E SË ARDHMES

Abstrakt

Në këtë studim, duke iu shmangur një analize faktike të shkaqeve, aktorëve dhe sjelljeve të tyre, do të trajtohen sistemet zgjedhore të Shqipërisë, duke u fokusuar sidomos në sistemin e fundit zgjedhor, kuadrin ligjor kushtetues, Kodin zgjedhor si dhe praktikën e krijuar së bashku me fenomenet e reja që u shfaqën. Pa përpjashtuar konsideratat juridike, doktrinare apo vlerësimet e institucioneve relevante ndërkombëtare, trajtimi i një teme të tillë është sa aktual, aq edhe i rëndësishëm në morinë e studimeve juridike të fushës, pasi paraqet interes të veçantë studimor dhe praktik në doktrinën e së drejtës dhe debatin juridik në Shqipëri dhe më gjerë.

Çështjet që do të trajtohen në këtë punim shkencor shihen në dy këndvështrime: në këndvështrimin e evolucionit historik të sistemit zgjedhor në Shqipëri dhe në trajtimin e sistemit aktual, që është në fuqi. Konkretisht, në këtë punim do të gjejnë trajtim çështje të tilla si:

1. Sistemi zgjedhor i zgjedhjeve të para pas rënies së diktaturës komuniste në vitin 1991.
2. Kuadri kushtetues dhe ligjor në zgjedhjet e vitit 1991, 1992, 1996, 1997.
3. Modeli i sistemit zgjedhor në Kushtetutës e vitit 1998, kuadri ligjor me ndryshimet që pësoi. Problemet që u ndeshën gjatë aplikimit të tij në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore të vitit 2000, 2001, 2003 e 2005.
4. Ndryshimet kushtetuese të 21 prillit 2008. Sistemi zgjedhor propocional rajonal për zgjedhjet parlamentare. Kodi Zgjedhor i vitit 2008 si instrument rregullues i këtij sistemi. Organet e administrimit

zgjedhor. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, arritjet që sollën dhe problemet që u indentifikuan. Një sipërmarrje e tillë do të ishte krejtësisht e mangët nëse nuk do të përmbante studimin e modeleve të sistemeve zgjedhore të njohura në botë me karakteristikat e tyre.

Punimi shkencor mbyllet me sfidat që e presin sistemin zgjedhor në Shqipëri, si një rrjedhë logjike e analizës të të gjitha çështjeve të trajtuara dhe problemeve të ngritura. Kjo pjesë shënon nxjerrjen e konkluzioneve, si dhe rekomandimet e bëra për zgjidhjen e problemeve që kanë dalë gjatë trajtimit të çështjeve në këtë punim shkencor.

Në këtë punim shkencor do të përdoren metodat shkencore të analizës shkencore, deduksionit logjik dhe ajo krahasimore. Të dhënat empirike dhe fakte të tjera shkencore do të shërbejnë si mbështetje për tezat shkencore të ngritura si dhe për propozimet dhe sugjerimet konkrete që do të pasqyrohen në këtë punim shkencor. Metoda të tjera shkencore do të përdoren në varësi të kompleksitetit të çështjeve që do të trajtohen dhe rezultateteve që synohen të arrihen.

Literatura që do të përdoret lidhet me mendimin shkencor teorik doktrinar shqiptar dhe të huaj, si dhe me të dhëna empirike dhe faktike nga burime zyrtare dhe të besueshme, si dhe literaturë tjetër e nevojshme. Burimet e saj do të jenë autorë vendas dhe të huaj, produkte studimore dhe studime e raporte faktike e monitoruese, debate shkencore dhe institucionale për çështje të caktuara, literaturë thellësisht juridike si dhe literaturë tjetër në varësi të çështjeve që do të trajtohen.

Në këtë punim shkencor do të respektohen rigorozisht kriteret akademike dhe autenticiteti i burimeve bibliografike, duke shmangur çdo keqpërdorim qoftë edhe në mënyrë koicidenciale shkelje të së drejtës së autorit apo akte të tjera të plagjaturës.

Vështrim krahasues i sistemit zgjedhor shqiptar përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008 me sistemet zgjedhore të vendeve të tjera të sistemit elektoral miks

Nëse do të krahasonim elementët kryesorë të sistemit zgjedhor të Shqipërisë (kuadrin ligjor, raportin mes mandateve të zgjedhura me sistem mazhoritar dhe sistem proporcional, pragun elektoral, formulën matematike, zonat zgjedhore, numrin e votave që disponon zgjedhësi dhe raundet e votimit) me sistemet zgjedhore të vendeve të tjera, të cilat i përkasin sistemit elektoral miks, variantit ‘Proporcional me Mandate të Përziera’ (PMP), krahasimi do të bëhej duke evidentuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që sistemi zgjedhor shqiptar ka me tetë vendet e tjera si: Bolivia, Gjermania, Hungaria, Italia,

Lezoto, Meksika, Zelanda e Re dhe Venezuela, të cilat i përkasin të njëjtit sistem elektoral të adoptuar nga Shqipëria. Nga krahasimi i sistemin elektoral shqiptar me sistemet elektorale të vendeve në fjalë rezultojnë këto ngjashmëri dhe ndryshime:

Parlamenti shqiptar (Kuvendi) përbëhet nga një Dhomë e vetme, ashtu si dhe Parlamenti i Hungarisë dhe i Venezuelës, kurse parlamentet e 6 vendeve të tjera, (Bolivisë, Gjermanisë, Italisë, Lezotos¹), Meksikës, dhe Zelandës së Re) përbëhen nga dy Dhoma:

- (Dhoma e Ulët
- Dhoma e Lartë/Senati).

Sistemi zgjedhor në vende të ndryshme rregullohet me Kushtetutë ose me Ligj Elektoral. Rregullimi i sistemit zgjedhor me Kushtetutë apo vetëm me Ligj Zgjedhor ka rëndësi, sepse ka të bëjë me natyrën fikse apo jo të sistemeve elektorale. Nëse kjo përbën përparësi apo mangësi, varet nga konteksti politik i vendit në fjalë, por rregulli i përgjithshëm është që sistemet elektorale kanë natyrë statike dhe pas vendosjes së tyre karakterizohen nga pak ndryshime. Shqipëria ka adoptuar pikërisht këtë përjasje: sistemi elektoral ka natyrë fikse dhe është i parashikuar në Kushtetutë. Po kështu, të parashikuar me Kushtetutë e kanë edhe katër vende të tjera Bolivia, Hungaria, Lezoto dhe Gjermania. Si vende të tjera, të cilat i përkasin sistemeve të tjera elektorale dhe që sistemin elektoral e kanë të rregulluar me Kushtetutë janë Irlanda (Votë e vetme e transferueshme, variant i proporcionalit), Portugalia dhe Spanja (sistem zgjedhor proporcional). Kurse vendet e tjera si: Italia, Meksika, Venezuela dhe Zelanda e Re sistemin elektoral e kanë të rregulluar vetëm me ligj zgjedhor.

Në 8 shtete, duke përfshirë edhe Shqipërinë, sistemi zgjedhor përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008, për pjesën e mazhoritarit, bëhej me një raund të vetëm votimi, pra, me shumicë të thjeshtë sipas parimit Fiton-kush-del-i-pari (First-Past-the-Post). Përjashtim bën vetëm Hungaria, e cila përdor dy raunde për zgjedhjen e deputetëve të pjesës së mazhoritarit. Në Shqipëri dhe në 8 vendet e tjera të sistemit PMP, mandatet plotësuese kompensojnë për disproportionalitetin e shkaktuar nga pjesa e sistemin mazhoritar. Numri i Zonave Zgjedhore për Pjesën e Proporcionalit: varion nga 1 zonë e vetme zgjedhore në nivel kombëtar Shqipëria, Lezoto, Zelanda e Re, Gjermania (pjesërisht), në 5 zona zgjedhore Meksika dhe në 20 zona zgjedhore Hungaria. Sipas sistemit zgjedhor para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008 zgjedhësit kishin dy vota dhe votonin me dy fletë votimi, një për të zgjedhur deputetët nga listat në zonat zgjedhore njëemërore dhe një për

1. Senati është formal dhe nuk zgjidhet por emërohet nga Mbreti dhe Kryeministri.

listat partiake të proporcionalit. Edhe në vende të tjera si Gjermani, Hungari, Itali dhe Zelandë e Re votuesit kanë dy vota, por në disa nga këto vende p.sh. Gjermani dhe në Zelandën e Re zgjedhësit kanë një fletë të vetme votimi, e cila është e ndarë në dy pjesë, njëra për të votuar për proporcionalin dhe tjetra për mazhoritarin. Përfshirë bën vetëm Meksika, ku zgjedhësit disponojnë vetëm një votë të vetme, e cila vlen për të zgjedhur deputetët sipas sistemit mazhoritar dhe pastaj për të llogaritur mandatet sipas sistemit proporcional (IDEA, 2005, 97).

Megjithatë formula zgjedhore e parashikuar nga Sistemi Elektoral i Shqipërisë ishte mjaft kompleks (neni 67 i Kodit Zgjedhori vitit 2003), formula e përdorur është ajo e “Mbetjes më të madhe” (*largest remainder*), konkretisht formula Le Hare. Formulën e “Mbetjes më të madhe” e përdorin edhe tre vende të tjera të sistemit PMP si Italia, Gjermania dhe Meksika. Konkretisht, Italia dhe Meksika përdorin Le Hare (votat e vlefshme pjesëtohen me numrin e mandateve që do të shpërndahen), ndërsa Gjermania përdor variantin Le Hare/ Niemeyer, që prodhon të njëjtin efekt si dhe formula Le Hare, por që aplikohet ndryshe (numri i votave të partisë shumëzohet me numrin e mandateve, që do të shpërndahen dhe rezultati pjesëtohet me numrin total të votave të vlefshme të partive). Bolivia, Hungaria, Venezuela dhe Zelanda e Re përdorin formulën e “Mesatares më të lartë”, (*highest average*). Konkretisht, Bolivia, Hungaria dhe Venezuela përdorin formulën D’Hondt (Votat e vlefshme të marra nga partitë pjesëtohen me 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7...), kurse Zelanda e Re formulën Sainte-Laguë (Votat e vlefshme të partisë pjesëtohen me 1, 3, 5, 7...). Ndërsa, Lezoto nuk aplikon formulë për shpërndarjen e mandateve plotësuese.

Balanca/raporti mes numrit të mandateve të mazhoritarit dhe numrit të mandateve të proporcionalit (mandateve kompensuese), varion gjerësisht: Në Shqipëri sipas sistemit zgjedhor përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008, numri i deputetëve të zgjedhur me sistem mazhoritar ishte 100 deputetë ose 71 %, dhe me sistem proporcional 40 deputetë ose 29%. Krahasuar me 8 vendet e tjera të variantit PMP, me përfshirë të Italisë ku 25% e mandateve shpërndahen me proporcional, Shqipëria kishte përqindjen më të ulët të mandateve plotësuese që përdoret për të kompensuar disproporcionalitetin e shkaktuar nga mazhoritari. Për më tepër, e krahasuar edhe me 21 shtetet e variantit tjetër ‘Sistemi paralel’ vetëm 7 shtete Azerbajxhani 20 %, Kazakistani 13 %, Koreja 19 %, Pakistani 20 %, Filipinet 20 %, Taivani 22 % dhe Tailanda 20% kanë përqindje më të vogël të mandateve kompensuese se Shqipëria. Sipas sistemit elektoral gjerman, (që, siç e kemi theksuar, më lart është modeli klasik i sistemit elektoral PMP), ky raport është 50 % me 50 %.

Pragu elektoral për pjesën e proporcionalit varion gjerësisht: Në Shqipëri pragu elektoral ishte 2.5 %. E krahasuar me pragu që aplikohet në 8 vendet

e tjera të Sistemit PMP, 4 vende si Hungaria 4 %, Italia 4%, Gjermania dhe Zelanda e Re 5% e kanë prapun elektoral më të lartë se Shqipëria, 4 vende të tjera ose nuk aplikojnë prag elektoral Venezuela, Lezoto dhe Bolivia ose e kanë prapun më të ulët se Shqipëria, si p.sh Meksika me 2 %.

Veçoritë kryesore të Sistemit zgjedhor shqiptar²⁾ përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008 mund të renditeshin si më poshtë: Sistemi zgjedhor ishte i parashikuar në Kushtetutë Neni, 64 dhe në Kodin Zgjedhor nenet 65-78. i përkiste familjes së sistemit të përzier (miks ose gjysmëproporcional, i cili kombinon elementë qoftë të sistemit proporcional, qoftë të sistemit mazhoritar³⁾. Argumenti, nëse ky sistem zgjedhor i përket ose jo variantit “Proporcional me mandate të përziera” është i diskutueshëm. Por si argumente në favor të këtij interpretimi janë:

Së pari, literatura botërore mbi sistemet elektorale që e ka klasifikuar si Proporcional me mandate të përziera, (IDEA, 2005, 91; Bochslers, 2007).

Së dyti, kjo rezulton edhe nga një interpretim i nenit 65 të Kodit Zgjedhor. Kodi Zgjedhor i vitit 2003 nuk parashikonte një “sistem zgjedhor paralel”, sepse ky sistem kërkon që rezultatet e dy tipeve të votimit (me proporcional dhe mazhoritar) të jenë të shpërndarë ose të pavarur nga njëri-tjetri. Por, sipas sistemit zgjedhor shqiptar, shpërndarja e 40 “mandateve plotësuese” ishte e lidhur pazgjidhshmërisht me numrin e mandateve njëëmërore të fituara nga kandidatët e çdo partie apo koalicioni. Sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor 2003, nëse numri i mandateve njëëmërore të fituara nga çdo parti/koalicion është më i madh sesa numri i përgjithshëm i mandateve që u takon, nëse 140 mandatet do të shpërndaheshin nëpërmjet një sistemi të pastër proporcional, (neni 67.1.b i Kodit Zgjedhor), atëherë partia/koalicioni nuk do të përfitonte asnjë prej 40 mandateve plotësuese. Prandaj duke qenë se rezultatet e dala nga dy tipet e zgjedhjeve mazhoritar dhe proporcional janë të lidhura, rezulton se sistemi zgjedhor shqiptar nuk ishte “sistem paralel”, por kishte më tepër veçoritë e variantit “Proporcional me Mandate të Përziera”.

Në një përjasje krahasuese të aspekteve kryesore të sistemit zgjedhor shqiptar me përvojat e sistemeve zgjedhore të disa vendeve të tjera, do të

2. 100 deputetë ose 71% zgjidhen me Sistem Mazhoritar me një raund First Past the Post dhe 40 ose 29 % e deputetëve zgjidhen sipas Sistemit të Listës së Përfaqësimit Proporcional. Sistemi i përzier u vendos në Shqipëri pas viteve '90 me idenë që të kombinohen përparësitë e sistemit mazhoritar dhe atij proporcional, por edhe ky sistem si çdo sistem tjetër zgjedhor ka mangësitë e tij. Sistemi i përzier elektoral përdoret në 30 vende, nga të cilat 21 vende përdorin Sistemin Paralel dhe 9 shtete sistemin Proporcional me Mandate të Përziera. Në rajonin Ballkanik dominon kryesisht sistemi proporcional, (IDEA, 2005).

3. Nga viti 1991 deri në vitin 2000 ishte varianti “Sistem Paralel” (Parallel System), dhe me reformën e vitit 2000 sistemi elektoral i vendit tonë mori më tepër veçoritë e variantit “Proporcional me Mandate të Përziera”, (Mixed Member Proportional). (shenim i autorit)

duhej të kishim në konsideratë faktin që përvoja e një vendi me një sistem elektoral të caktuar nuk mund të aplikohet në mënyrë identike edhe në një vend tjetër (MacIvor, 1999). Prandaj, “hartuesit institucionalë” mund të informohen, nxjerrin mesime nga përvoja e një vendi tjetër, por nuk mund të kufizohen prej tyre., Për më tepër vetë metodologjia ka në vetvete kufizime, pasi disa prej vendeve të tjera të marra si model krahasimi kanë forma të ndryshme qeverisjeje në krahasim me Shqipërinë, e cila bën që sistemet zgjedhore respektive nuk mund të konsiderohen mekanikisht të krahasueshme. Pavarësisht se përvoja e sistemit elektoral të një vendi nuk mund të importohet në mënyrë identike në një vend tjetër, përsëri shumë mësimë mund të nxirren nga përvoja e të tjerëve në këtë fushë, (IDEA, 2005, 159).

Duke krahasuar në mënyrë të përgjithshme disa nga aspektet kryesore të sistemit zgjedhor shqiptar me ato të vendeve të tjera, këto aspekte kanë qenë objekt i diskutimit të gjerë në Shqipëri për të mundësuar reformën kushtetuese dhe zgjedhore në vitin 2008.

Vendosja në Kushtetutë e sistemit zgjedhor dhe e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendosja ose jo në Kushtetutë e sistemit zgjedhor ka të bëjë me natyrën fikse ose jo të sistemeve zgjedhore. Rregulli i përgjithshëm është që sistemet zgjedhore, pas vendosjes se tyre karakterizohen nga pak ndryshime dhe përgjithësisht janë statike. Për ta bërë edhe më të qëndrueshëm këtë parim, disa shtete duke përfshirë edhe Shqipërinë, e parashikojnë sistemin zgjedhor në Kushtetutë.

Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 64 ka parashikuar sistemin zgjedhor. Si përvoja të vendeve të tjera të cilat sistemin zgjedhor e kanë të parashikuar në Kushtetutë (vetë një vendesh) mund të përmenden Irlanda, Portugalia ose në Kushtetuten e Spanjës. Kushtetuta e Irlandës e adoptuar më 1937, në nenin 16, pika 2.5, parashikon shprehimisht se anëtarët për në dhomën e ulët do të zgjidhen me *sistem përfaqësimi proporcional përmes votës së vetme të transferueshme, STV* (Single Transferable Vote).

Kushtetuta Portugeze, në nenin 155, pika 1, parashikon se *anëtarët e Asamblesë do të zgjidhen me sistem përfaqësimi proporcional sipas Metodes së Hondt të mesatares më të lartë*”. Pra, Kushtetuta portugeze përcakton jo vetëm sistemin elektoral përkatës (proporcional), por edhe formulën matematike për llogaritjen e mandateve, pra metodën d’Hont.

Kushtetuta Spanjolle, Neni 68, pika 2, parashikohen se *Zonë Zgjedhore do të jetë provinca. (...) Ligji do të shpërndajë numrin total të deputetëve, duke i caktuar fillimisht çdo zonë zgjedhore një numër minimal përfaqësuesish dhe mandatet që mbeten do të shpërndahen në përpjestim me numrin e popullsisë*”, (Neni 68, pika 2). *Zgjedhjet në çdo zonë zgjedhore do të zhvillohen në përputhje me kriteret e përfaqësimit proporcional*, (kemi ligj të zhdrejtë) (Neni, 68, pika 3).

Siç u theksua me lart shumica e vendeve të tjera nuk e kanë të parashikuar në kushtetutë sistemin zgjedhor, (p.sh. Italia), por e kanë të rregulluar me ligj elektoral.

Kushtetuta e Italisë e trajton sistemin elektoral të Dhomës së Deputetëve, në nenin 56 dhe të Senatit në nenin 57, pa specifikuar se cila duhet të jetë formula elektorale për t'u adoptuar, prandaj mund të vendosen qoftë formula elektorale proporcionale, mazhoritare apo mikse, (Manuali Elektoral, 2006). Prandaj duke qenë se në sistemin italian disiplina elektorale nuk është e parashikuar në kushtetutë, ajo rregullohet me Ligj Elektoral, (i cili mund të miratohet me shumicë të thjeshtë), dhe në raste të jashtëzakonshme edhe me Referendum shfuqizues.

Nëse parashikimi në Kushtetute i sistemit zgjedhor konsiderohet përparësi apo e metë, kjo varet nga konteksti politik i vendit. Sipas doktrinës mbi sistemin zgjedhor italian, fakti që sistemi zgjedhor nuk është i parashikuar në kushtetutë, konsiderohet më tepër si një përparësi sesa një e metë, duke qenë se ky rregullim ka lejuar që në shumë raste të bëhen ato modifikime që vetë shoqëria kërkon. Në vende të tjera si në Irlandë, sanksionimi me kushtetutë i sistemit zgjedhor ka rezultuar një përparësi, për vetë faktin se një parti e vetme nuk mund ta ndryshojë atë. Që nga viti 1937 Partia *Fianna Fail* kur ishte në pushtet, ka tentuar dy herë, në 1959 dhe 1969 për të ndryshuar sistemin zgjedhor dhe për ta zëvendësuar Sistemin e Votës së Vetme të Transferueshme STV me sistem mazhoritar, (Benoit, 2004, 377).

Në kontekstin politik shqiptar parashikimi me kushtetutë i sistemit elektoral mund të konsiderohet më tepër si një avantazh, sepse e bën të pamundur që një parti e vetme të ndryshojë një institucion kaq të rëndësishëm siç është sistemi zgjedhor. Ndryshimi i sistemit zgjedhor kërkon një konsensus të gjerë të aktorëve politike (partitë politike), gjë e cila e bën procesin dhe rezultatin nëse arrihet të legjitimuar dhe të pranuar nga të gjithë.

Vendosja në Kushtetutë e KQZ-së

Kushtetuta e vendit tonë, në nenet 153 dhe 154⁵⁾ kishte parashikuar shprehimisht KQZ-në si një Organ Kushtetues të përhershëm që përgatit, mbikqyr dhe drejton të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Vendet e tjera si Gjermania dhe Italia nuk e kanë të parashikuar në kushtetutë, Organin Zgjedhor, por e rregullojnë me Ligj Zgjedhor. Për më tepër sipas ligjit zgjedhor gjerman, ky organ varet nga ekzekutivi. Kështu, në sistemin elektoral gjerman është Ministria Federative e Punëve të Brendshme ajo që emëron Kryetarin e Komitetit Zgjedhor Federal, i cili pastaj emëron 8 anëtarët e tjerë të këtij komiteti.

5. Me ndryshimet kushtetuese të 21 prillit 2008 këto parashikime kushtetuese u shfuqizuan.

Parashikimi me kushtetutë i Organit Zgjedhor që administron zgjedhjet KQZ-së përbën një avantazh në vendet me demokraci jo të zhvilluar, sepse e bën atë organ të pavarur nga pushtetet e tjera. Në Meksikë një nga elementët më të rëndësishëm të refomës zgjedhore ka qenë krijimi i një Organi Zgjedhor të pavarur.

Pragu elektoral, ndarja e zonave dhe formula matematike

Të gjitha sistemet elektorale kanë *prag elektoral të përfaqësimit*: d.m.th. niveli minimal i mbështetjes që një parti ose koalicion duhet të arrijë për t'u përfaqësuar në parlament. Ka dy tipe bazë të pragut elektoral: *Pragu ligjor*, (i njohur ndryshe edhe si *formal* apo *artificial*) dhe *pragu informal* (i njohur ndryshe edhe si *natyror* apo *matematik*), (Norris, 2004). Pragu ligjor (formal) zakonisht është i sanksionuar në kushtetutë dhe në ligjet elektorale që përkufizojnë Sistemin Proporcional (IDEA, 2005). Partitë që marrin më pak sesa ky prag përjashtohen automatikisht nga marrja e mandateve. Qëllimi kryesor i këtij pragu është të korrigjojë mangësitë e sistemit proporcional duke reduktuar fragmentarizimin e partive si dhe për të përjashtuar partitë ekstremiste nga legjislativi (Norris, 2004). Në sistemet mikse të Gjermanisë, Zelandës së Re dhe të Rusisë, ky prag është 5 % e pjesës së proporcionalit. Në vende të ndryshme pragu ligjor varion nga 0.67 në Hollandë deri në 10 % në Turqi. Pragu zgjedhor (formal) ka qenë parashikuar edhe në kushtetutën e vendit tonë (në nenin 64, pika 3)⁶, në 2.5 % për partitë dhe në 4 % për koalicionet e partive. Pragu *informal ose efektiv* (Lijphart, 1996) është i fshehur dhe është një variabël që varet nga *madhësia mesatare* e zonës zgjedhore (d.m.th. numri mesatar i deputetëve të zgjedhur në një zonë zgjedhore që varion nga një anëtar parlamenti për një zone elektorale në Dhomën e Komunëve në Angli deri në 150 anëtarë në Hollandë) nga *numri i partive politike* dhe nga *madhësia e Parlamentit*. Efekti i këtij pragu varet shumë nga formula elektorale me të cilën votat kthehen në mandate (d'Hont, Saint-Laguë etj). Sipas Nadar (2003) të gjitha sistemet mazhoritare imponojnë automatikisht një prag efektiv rreth 35 %.

Formula matematike përdoret për të shpërndarë mandatet mes listave të proporcionalit dhe ka një efekt të rëndësishëm në rezultatin e votimit proporcional. Dy janë formulat matematike: Sistemi i “mbetjes më të madhe” (*largest remainder*) ose “herësit elektoral” dhe ai i “mesatares më të lartë” (*highest average*) ose “pjestuesit elektoral”.

Sistemi i mesatares më të lartë...

Sipas formulës sistemi i ‘mbetjes më të madhe’, metoda e llogaritjes së rezultatit bëhet në tre kohë.

6. Ky nen është ndryshuar në vitin 2008.

Së pari llogaritet *kuota*. Kuota llogaritet në mënyra të ndryshme: *Le Hare Quota*: V/S , ku V =numri përgjithshëm i votave dhe S =vendet për t'u plotësuar. Kjo është metoda më e vjetër, më e thjeshtë dhe përdoret nga shumica e vendeve si p.sh., (Danimarka, Kosta Rika, Taivani, Lituania dhe nga Italia për të zgjedhur 25 % të deputetëve për në Dhomën e Deputetëve). *Hagenbach-Bischoff quota*: $V/(S+1)$, *Droop Quota*: $V/(S+1)+1$. Përdoret në Afrikën e Jugut, Çeki dhe Greqi. *Quota Imperiali*: $V/(S+2)$. Siç rezulton më sipër diferenca mes kuotës Le Haire dhe tre kuotave të tjera është se në rastin e kuotës *Hagenbach*, *Droop* dhe *Imperiali*, pjesëtuesi, pra, numri i mandateve përt'u shpërndarë rritet me 1 ose me 2, duke dhënë një rezultat lehtësisht më proporcional dhe duke favorizuar partitë e vogla.

Se dyti, numri i votave të çdo partie pjesëtohet me kuotën që del nga llogaritja e mësipërme. Numri i plotë i herësit përbën numrin e plotë të vendeve që fiton direkt partia. *Se treti*, vendet e mbetura për t'u plotësuar u shpërndahen partive me mbetjen më të madhe.

Dy janë mangesitë e metodës së mësipërme:

Mangësia e parë e këtij sistemi, qëndron në faktin se në pak raste, Le Hare Quota, lejon shpërndarjen e të gjitha mandateve. Për të zgjidhur këtë problem bëhet korrigjimi i vetë kuotës. Për këtë qëllim metodat më të përdorura janë ato të përmendura më sipër, Hagenbach-Bischoff, Droop dhe Imperiali, të cilat konsistojnë në rritjen e emëruesit me 1 ose me 2 njësi, me qëllim që të zvogëlojë kuotën dhe numrin e votave të mjaftueshme për të fituar një mandat. Në këtë rast vlen të përmendet fakti se sa më i madh të jetë korrigjimi, aq më tepër favorizohen partitë e vogla.

Mangësia e dytë është se përgjithësisht shpërndarja e plotë e të gjitha mandateve kërkon adoptimin e një formule për të shpërndarë mbetjet dhe në këtë rast përdoret ajo e 'mbetjes më të madhe'.

Zonat zgjedhore dhe ndarja e tyre.

Në literaturën e sistemeve zgjedhore pranohet universalisht se përcaktuesi kryesor i proporcionalitetit është Madhësia e Zonës Zgjedhore, pra numri i deputetëve që do të zgjidhen në secilën zonë zgjedhore. (*IDEA, 2005; Bowler et al., 2001; Kats, 1997*).

Kjo do të thotë se sa më e madhe të jetë zona zgjedhore, aq më e lartë është shkalla e proporcionalitetit, p.sh rasti i Hollandës ose i Izraelit ku i gjithë vendi është një zonë e vetme elektorale që ka 150 mandate. Në këtë rast më të favorizuara janë partitë e vogla. Rasti i kundërt janë zonat zgjedhore njëëmërore të sistemit mazhoritar.

Kushtetuta e Shqipërise (neni 64.1) dhe Kodi Zgjedhor (Nenet 65, 66 dhe 69), për pjesën e deputetëve që zgjidhen me sistem mazhoritar, kishte

parashikuar zgjedhjen e 100 deputetëve nga zonat zgjedhore njëmërore me numër të përafërt zgjedhësish. Pra numri i zonave ishte i përcaktuar me Kushtetutë dhe mbetej vetëm të respektohej kërkesa e Kushtetutës (Neni, 64.1)⁷⁾ dhe e Kodit Zgjedhor (Neni 69. 1)⁸⁾, që kërkonin që zonat zgjedhore të kishin “numër të përafërt zgjedhësish”. Kjo ndarje duhej të bëhej sa herë që kishte zgjedhje për të reflektuar lëvizjet e popullsisë, (IDEA, 2005, 153).

Madhësia e zonës elektorale merrte rëndësi sidomos, kur bëhej fjalë për shpërndarjen e 40 mandateve nga ‘listat shumëëmërore të partive’, pasi kjo mund të cënonte shkallën e proporcionalitetit. Kur i gjithë vendi përbën një zonë të vetme elektorale nga ku zgjidhen 40 deputetë, (për efekt të proporcionalit), ky do të ishte shumë proporcional. Nga ana tjetër, kur zonat zgjedhore të proporcionalit përcaktohen jo në nivel kombëtar por në nivel rajonal, duke e ndarë vendin në zona zgjedhore më të vogla, kjo do të ketë këto dy efekte: *Së pari* do të sillte uljen e shkallës së proporcionalit për partitë politike që konkurojnë për këto mandate, pavarësisht formulës matematike apo pragut elektorale që mund të përdorej, dhe *Së dyti*, përsëri edhe këtu do të kërkohej përcaktimi i kufijve të zonave elektorale edhe për proporcionalin si në rastin e mazhoritarit.

Prania e kuotave në Parlament për gratë

Sipas statistikave të janarit 2007 përqindja mesatare botërore e grave si deputete në Parlamentet Kombëtare ishte 17.2%. Kjo e dhënë është larg objektivit të përcaktuar nga Procesi i Pekinit, i iniciuar në vitin 1995, i cili synon rritjen e përqindjes së grave në Parlamentet Kombëtare në 30 %. Në legjislaturën e kaluar në Kuvendin e Shqipërisë, nga 140 deputetë vetëm 10 ishin gra (ose 7.1%) që do të thotë se Shqipëria ishte ende shumë larg jo vetëm objektivit të Pekinit, por edhe larg mesatares botërore.

Për rastin e përfaqësimit të gruas në parlament, shumica e literaturës dhe e studiuesve e konsideron sistemin elektorale si faktorin më të rëndësishëm për të rritur pjesëmarrjen e grave në parlament (krahas faktorëve të tjere socialë-ekonomikë, politikë dhe kulturorë, si shkollimi, të ardhurat, preferenca e votuesve, aspirata që kanë vetë gratë etj), (Lekberg, 2000; IDEA, 2007). Gjithashtu theksohet se mospërfaqësimi i grave në politikë nuk është vetëm çështje e barazisë formale, por nënpërfaqësimi i tyre në elitën politike të një vendi e deprivon politikën e atij vendi nga persona energjikë dhe të talentuar, gjë e cila mund të dekurajojë inovacionin politik nga i cili mund të pëfitonin vetë gratë dhe fëmijët, (MacIvor, 1999).

7. Ndryshuar me ligjin për ndryshimet kushtetuese 21 prill 2008.

8. Shfuqizuar me ligjin nr.10 019, datë 29.12.2008”Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”

Për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë, literatura rekomandon kuotat apo mandatet e rezervuara për gratë. Kuotat për gratë janë një formë e diskriminimit pozitiv (*affirmative action*) që synon t'i ndihmojë ato për të kapërcyer vështirësitë që i pengojnë për të hyrë në politikë në të njëjtën mënyrë si dhe kolegët e tyre meshkuj.

Ka disa instrumente apo strategji për përfshirjen e këtyre kuotave për gratë:

Së pari, është parashikimi nga vetë sistemi elektoral (Kushtetutë apo ligj elektoral) i kuotave ose mandateve të rezervuara për gratë. 14 vende i parashikojnë në kushtetutë mandatet e rezervuara për gratë, si në Afganistan, (25% e mandateve), Uganda dhe Ruanda., kurse me ligj elektoral, kuotat për gratë janë të parashikuara nga 32 vende.

Sipas studimeve në këtë fushë (Norris 1993), kuotat për gratë në sistemin proporcional ofrojnë mundësinë më të mirë politike që gratë të zënë vend në parlament. Konkretisht, kuotat për gratë janë të parashikuara në sistemet elektorale proporcionale të 45 vendeve, (IDEA, 1997). Mandate të rezervuara për gratë: janë një formë tipike që përdoren në sistemet mazhoritare (aktualisht përdoret në 17 vende), kurse në sistemet mikse kuotat për gratë parashikohen në 15 vende.

Ligji elektoral mund t'u kërkojë partive politike për të përcaktuar një numër kandidatesh femra për në zgjedhje, duke parashikuar edhe sanksione për këtë qëllim. Partitë politike mund të adoptojnë vetë vullnetarisht kuota për gratë si kandidate për në parlament. 124 Parti në 61 vende të ndryshme kanë adoptuar kuota vullnetare. Kjo përdoret në të gjithë botën, duke përfshirë dhe Partitë Laburiste në Angli dhe Australi.

Pasojat administrative të sistemeve elektorale

Listat e zgjedhësve, fletët e votimit dhe numërimi i votave kanë të bëjnë me aspektet administrative të zgjedhjeve. Regjistrimi i votuesve është pjesa më komplekse, më e kundërshtuar dhe shpesh më pak e suksesshme në administrimin e zgjedhjeve (IDEA, 2005). Nga vetë natyra ajo përfshin mbledhjen në një format të standardizuar të informacioneve të veçanta për një numër të madh votuesish dhe pastaj për t'i renditur dhe shpërndarë këto të dhëna, që të përdoren për zgjedhje dhe që të shmangën votimin e shumëfishtë nga një person i vetëm. Kjo çështje ka ndjeshmëri të lartë politike dhe për vetë natyrën e saj konsiderohet si një nga pjesët më të kushtueshme të të gjithë procesit elektoral (IDEA, 2005). Sistemi zgjedhor edhe këtu ndikon në regjistrimin e votuesve, sepse zonat zgjedhore njëemërore, pra mazhoritari, është më i kushtueshëm dhe kërkon që votuesi të regjistrohet brenda kufijve të një zone të caktuar zgjedhore, kurse listat e proporcionalit janë më pak komplekse.

Fleta e votimit duhet të jetë sa më e thjeshtë dhe e kuptueshme për votuesin, më qëllim që të rrisë numrin e pjesëmarrjes në votime dhe të pakësojë numrin e fletëve të pavlefshme. Në këtë rast mazhoritari ka më tepër përparësi, pasi fleta është më e thjeshtë, kurse proporcionali dhe akoma me tepër sistemi miks është më i komplikuari, (IDEA, 2005, 154).

Numërimi në sistemin mazhoritar dhe me listë të mbyllur (ose bllokuar) në sistemin proporcional janë më të thjeshtë, kurse sistemi i përzier është më i vështirë, pasi kërkon numërimin e dy fletëve të votimit.

Përfundime dhe rekomandime

Zgjedhjet janë kurorëzim i ndërgjegjes dhe vullnetit personal të çdo njeriu. Ndërgjegjësimi personal i çdo njeriu kurorëzohet me votën, e cila është universale, absolute, e pavarur, e lirë, e fshehtë dhe e padiskutueshme nga askush, cilidoqoftë ai. Sistemi zgjedhor është instrumenti për të arritur një gjë të tillë.

Sistemi zgjedhor, si mënyrë me të cilën votat kthehen në mandate, nuk është *neutral*, pra, ai ndikon në përfshirjen ose jo të partive politike apo të grupeve të tjera në procesin e vendimmarrjes politike. Nuk ekziston një sistem perfekt elektoral, pasi çdo sistem ka përparësitë dhe mangësitë e tij.

Në më pak se njëzet vjet Shqipëria aplikoi pothuajse të gjitha sistemet zgjedhore të njohura në botë, duke filluar nga sistemi i pastër mazhoritar në vitin 1991, duke pasuar sistemin mazhoritar të përzier të modelit gjerman në vitin 1992 dhe në vitet 1996, 1997, 2001 e 2005 me të njëjtin sistem (me ndryshime të vogla). Në vitin 2009, pas një reforme të thellë kushtetuese e ligjore aplikohet për herë të parë sistemi zgjedhor proporcional rajonal.

Deri në vitin 2005 u përdor sistemi më dy raunde votimi, por që nuk rezultoi shumë efikas dhe solli mjaft probleme. Përparësia e sistemit me një raund është se u lejon zgjedhësve që të shprehin një preferencë për një kandidat në raundin e parë. Sistemi i përzier, i zbatuar në vendin tonë, sidomos në zgjedhjet e vitit 1992, ka pasur një përvojë pozitive, duke kombinuar anët e mira të mazhoritarit dhe të proporcionalit, por formulat e përdorura jo vetëm që nuk jepnin efektet e kërkuara, por deformonin rezultatet zgjedhore.

Në këtë rrugë të gjatë, dihet se nuk ekziston një sistem zgjedhor perfekt. Përsëri u tentua për të zgjedhur një sistem, i cili të reflektonte sa më shumë vlerat bazë të sistemit elektoral: paanshmërinë, përfaqësimin, barazinë, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe legjitimitimin. Një sistem i tillë nuk do të mund të përfshinte njëherazi vlera të tilla.

Përmirësimi i sistemit zgjedhor u bë përmes një reforme të përgjithshme, duke pasur në konsideratë këshillat dhe sugjerimet e faktorëve ndërkombëtare.

Ata sugjerorin se çdo ndryshim i mundshëm në sistemin elektoral duhet të analizohej dhe mendohej mirë, (IDEA, 2007), që do të thotë se duhej të ndërmerreshin kërkime të thelluara, kombinuar me debate dhe me konsultime publike⁹.

Në këtë reformë zgjedhore u mbajtën parasysh elementë të tillë si familja dhe varianti (tipi) i sistemit elektoral, madhësia e zonës zgjedhore, roli përkatës i partive dhe i kandidatëve, forma e fletës së votimit, mekanizmat e regjistrimit elektoral etj.

Sistemi zgjedhor duhet të ishte i thjeshtë dhe i qartë për t'u kuptuar si nga politikanët dhe votuesit, në të kundërtën mund të shkaktonte keqkuptime, efekte anësore dhe mosbesim të votuesve ndaj rezultateve të votimit.

Duke pasur parasysh se sistemet elektorale nuk funksionojnë në një *vakuum*, por ndërveprojnë e harmonizohen me institucionet politike, traditën kulturore dhe politike, sistemi i përzgjedhur duhej të ishte i përhershëm dhe jo një sistem, i cili do të duhej të përdorej në një periudhë tranzitore.

Pavarësisht se jo të gjithë faktorët politikë e pranuan një sistem të tillë, ai gëzoi konsensusin më të gjerë dhe në vetvete ishte i drejtë, pasi u jep atyre të njëjtën mundësi për sukses elektoral, ashtu si gjithë të tjerëve.

Avantazhet afatshkurtra elektorale dhe stabiliteti afatgjatë nuk janë gjithmonë të pajtueshëm me njëri-tjetrin. Asnjë sistem elektoral nuk është një 'ilaç gjithëshërues' (panacea) për të gjitha sëmundjet 'politike' të një vendi. Pa mohuar rëndësinë e tij, përsëri, sistemi elektoral nuk mund të jetë një ilaç që shëron të gjitha 'sëmundjet politike' e një vendi. Efekti i përgjithshëm i faktoreve të tjerë, veçanërisht kultura politike e një vendi, ka një ndikim më të madh në perspektivën e tij demokratike sesa *faktorët institucionalë* si p.sh. sistemi elektoral. Për më tepër edhe efektet pozitive të një sistemi elektoral të projektuar mirë, lehtësisht mund të përmbysen nga një rregullim Kushtetues i papërshtatshëm ose kur dominojnë forcat e mosmarrëveshjeve të brendshme¹⁰.

Në më të shumën e rasteve sistemet zgjedhore janë hartuar për të shmangur gabimet e të shkuarës, veçanërisht të shkuarës së afërt. Një gjë e tillë ka ndodhur ekzaktësisht në Shqipëri. Duke kërkuar këtë "ilaç çudibërës" për të shëruar "sëmundjen politike" nuk është treguar kujdes në këto raste për të mos reaguar më tepër sesa duhet duke krijuar një sistem që shkon shumë larg, duke tentuar për të korrigjuar problemet e mëparshme.

9. Në këtë drejtim të gjithë studiuesit e Shkencave Politike janë dakort se Zelanda e Re (Raporti Drejt Një Demokracie më të Mirë (1986), Komisioni Mbretëror mbi Sistemin Elektoral) është një shembull i mirë në këtë drejtim.

10. (IDEA, 2005, 162).

Sistemi propocional rajonal, pas aplikimit për herë të parë në Shqipëri, zgjidhi disa probleme jo të vogla që trashëgoheshin nga një sistem në tjetrin, duke krijuar një sistem të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshëm për njerëzit dhe i përshatshëm për kohën. Ky sistem rezultoi gjithëpërfshirës, duke u pranuar gjerësisht nga votuesit me një pjesëmarrje të madhe në zgjedhje.

Ky sistem solli një konfigurim të balancuar në përfaqësimin politik të partive, nga njëra anë duke “eliminuar” partitë që nuk kishin mbështetje të mjaftueshme dhe nga ana tjetër krijoi një mazhorancë dhe opozitë të qartë. Sistemi propocional rajonal korrigjoi shproporcionimin e përfaqësimit në Shqipëri. Duke eliminuar fenomene elektorale (Dushkun) apo çdo lloj forme të transferimit të votave. Është e qartë që aplikimi i këtij sistemi solli një ulje të tensionit politik, përse i përket administrimit të votave dhe uljen e rolit aktiv të kandidatëve. Ky sistem solli një përfaqësim rajonal duke ruajtur një lidhje direkte me zgjedhësit.

Zgjedhjet e fundit, ndonëse ishin të kushtueshme, kjo nuk erdhi nga sistemi zgjedhor, por nga kërkesa për transparencë maksimale dhe përdorimi i teknologjisë së lartë gjatë procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultateve zgjedhore. Sistemi në vetvete uli shpenzimet dhe administrativisht ishte shumë më i thjeshtë për t’u zbatuar nga administrata zgjedhore.

Votuesit, duke pasur besim të plotë te ky sistem, morën pjesë masivisht në zgjedhje, duke u ndjerë me të vërtetë të pushtetshëm. Subjektet zgjedhore u ndjenë në një garë të fortë konkurruese ndërmjet tyre.

Duke inicuar një reformë kushtetuese dhe më pas hartimi i Kodit Zgjedhor “rregullave të lojës” u realizua një përjasje holistike, ku çdo element i reformës plotëson tjetrin dhe nuk ka kontradikta mes tyre.

Fatkeqësisht periudha paszgjedhore u shoqërua me një klimë të nxehtë politike, por kjo nuk ishte pasojë e sistemit zgjedhor. Sistemi Zgjedhor u propozua nga opozita. Administrimi i zgjedhjeve ishte kolegjal dhe kaloi me një numër minimal ankimesh. Kjo do të thotë që sistemi zgjedhor eliminoi konfliktet ndërmjet subjekteve zgjedhore.

Sikurse kemi theksuar në këtë punim shkencor, sistemi zgjedhor aktual duket që, përveç rezultateve pozitive, nuk ishte “çelësi magjik” për të zgjidhur problemet që kanë dalë gjatë këtyre njëzet vjetëve. Opinioni i përgjithshëm është se ky sistem është i përshatshëm për kushtet dhe rrethanat e Shqipërisë.

Sfidat që dalin pas aplikimit për herë të parë qëndrojnë në përmirësimin e mëtejshëm të disa neneve të Kodit Zgjedhor, që të përshpejtojnë numërimin e votave dhe duke rritur numrin e vendeve të numërimit të votave.

Ulja e tensioneve dhe ndikimit politik në aspektet teknike gjatë numërimit të votave do të mund të zgjidhej nëse arrihet një marrëveshje politike ndërmjet pozitës dhe opozitës në Parlament dhe nëse administrimi i zgjedhjeve të kryhet nga trupë administrimi jo e propozuar nga partitë politike, por të pavarur. Një gjë e tillë nuk duhet e lehtë për shkak të mosbesimit të thellë që është manifestuar në mes të aktorëve të skenës politike në Shqipëri.

Duke marrë në konsideratë situatën paszgjedhore dhe këmbënguljen e opozitës për të kërkuar rihetim të zgjedhjeve dhe rinumërim të votave, kjo çështje sigurisht do të jetë një objekt rregullimesh ligjore në ligjin zgjedhor. Megjithatë është ende herët për të pasur një ide sado të përgjithshme se në çfarë pikash do të konsistojnë këto ndryshime dhe amendime.

Një ndër çështjet që do të përbëjë sfidë për të ardhmen është parashikimi në ligjin zgjedhor shqiptar e votimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë, në vendbanimin e tyre. Kuadri ligjor aktual nuk ka mundur një gjë të tillë, por vetëm votimin në territorin e Shqipërisë. Një sfidë e tillë në fakt nuk lidhet me ndonjë pikëpamje të ndryshme politike të subjekteve politike në Shqipëri, por me vështirësi të karakterit teknik, logjistik dhe faktin se një pjesë e shtetasve shqiptarë jetojnë në vende të tjera pa pasur një rezidencë të saktë. Mundësimi i votimit edhe për këtë kategori të shtetasve është e mundur të realizohet në zgjedhjet e ardhshme. Një gjë e tillë do të duhej të mundësonte krijimin e qendrave të votimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (përfaqësitë diplomatike) ose mundësimin e formave alternative të votimit me anë të postës ose mënyrën elektronike të votimit.

Përveç sfidave të njohura përpara Shqipërisë do të shtrohet çështja e përfshirjes në legjislacion, në momentin e anëtarësimit në Bashkimin Europian të kuadrit ligjor dhe kushtetues për zgjedhjet për Parlamentin Europian dhe të drejtës së qytetarëve të Bashkimit Europian, rezidentë në Shqipëri, të kenë të drejtë të marrin pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Sigurisht, për një gjë të tillë do të duhet të analizohet kuadri kushtetues dhe ligjor nacional. Në një shqyrtim paraprak për një gjë të tillë duket se ndryshimi i Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor dotë ishte i nevojshëm. Përsa kohë sistemin zgjedhor e kemi të parashikuar në nivel kushtetues, atëherë dhe ushtrimi i të drejtës aktive të votës edhe për zgjedhjet vendore lidhet me pasjen e shtetësisë shqiptare.

Të gjitha sa thamë nuk lidhen ngushtësisht me ndryshimin e sistemit zgjedhor në kuptimin e tij të ngushtë, por janë pjesë e gjithë korpusit ligjor dhe administrativ që lidhet me procesin zgjedhor, i cili në kuptimin e gjerë mund të identifikohet me sistemin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Literatura:

1. Ligji nr. 7423, datë 13.11.1990 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”
2. Ligji nr. 7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”
3. Ligjin nr.8055, datë 1.2.1996 “Për ndryshimet në ligjin nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”
4. Ligji nr. 8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”
5. Ligji nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”
6. Ligji nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”
7. Ligji 7491, datë 27.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”
8. Kushtetuta e vitit 1998
9. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.04.2008
10. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor i Gjykatës së Apelit, Tiranë nr.68, date 27.7.2009.
11. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nr.18, date 18.5.2003)
12. Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aziz kundër Qipros, Nr. 69949/01 (2004).
13. Vendim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 24833/94, (1999);
14. Vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Labita kundër Italisë Nr. 26772/95, (2000).
15. Reynolds, A., Reilly, B., Ellis, A., (2005) “Electoral System Design”, IDEA-International Institute for Democracy and Electoral Assistance.
16. Raport i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, 2005, Varshavë, 7 Nëntor 2005.
17. Raporti përfundimtar zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, ODIHR për zgjedhjet parlamentare të 28 qershorit 2009, I publikuar më 14 shtator 2009.
18. Luan Omari, Sistemi Parlamentar, Tiranë 2000
19. Blendi Kajsii: Problematika e Sistemit Proporcional ne Raport me Realitetin Shqiptar Konferenca shkencore “Sistemi zgjedhor ne kontekstin shqiptar” http://www.fes.org.al/al/ProjectsAndPartners/DemocracyAndInstitutionBuilding/Prog_Election.html
20. Ermal Hasimja Sfidat reale të përfaqësimit politik në Shqipëri Konferenca e parë të Institutit Shqiptar të Sociologjisë, Qershor 2007
21. Blendi Kajsii: Problematika e Sistemit Proporcional ne Raport me Realitetin Shqiptar Konferenca shkencore “Sistemi zgjedhor ne kontekstin shqiptar” http://www.fes.org.al/al/ProjectsAndPartners/DemocracyAndInstitutionBuilding/Prog_Election.html
22. Gent Ibrahimii LL.M Sistemi Zgjedhor dhe Stabiliteti në Qeverisje Konferenca shkencore “Sistemi zgjedhor ne kontekstin shqiptar” http://www.fes.org.al/al/ProjectsAndPartners/DemocracyAndInstitutionBuilding/Prog_Election.html
23. Roland Sturm: Politische Willensbildung; në: Informationen zur politischen Bildung 262, “Großbritannien”, Bonn BpB 1999
24. Giddens, Anthony (1997)
25. Giesecke, Hermann (1976)
26. Nohlen, Dieter (1995), f. 846
27. Fjalori politik i Oxfordit , Tiranë 2001
28. (http://dardania.de/vb/upload/newthread.php?downthread&fw114#_ftnref1) Agjensia e Informacionit e Shteteve të Bashkuara (USIA). Dhjetor.1991. Çfarë është demokracia?, fq.16

Flamur HOXHA,
Magjistër i Shkencave Juridike

ARBITRAZHI NDËRKOMBËTAR TREGTAR

Hyrje

Në këtë punim jam përpjekur që të trajtoj temën “Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar”, përparësitë dhe të metat që ai ka, format e realizimit të arbitrazhit, procedurën, zbatimin e vendimeve etj. Zgjidha këtë temë “Arbitrazhi Ndërkombëtar”, duke ditur që trajtimi i kësaj teme nuk është bërë më përpara nga studentët paraardhës të mi, si dhe duke ditur rëndësinë dhe rolin e veçantë që luan arbitrazhi në zgjidhjen e konflikteve në fushën tregtare. Do të shprehja mendimin që trajtime mbi arbitrazhin ndërkombëtar tregtar janë të pakta, sidomos në gjuhën shqipe, qoftë për sa i përket doktrinës, por edhe nga institucione të ndryshme shtetërore apo OJF. Natyrisht, ky punim nuk zëvendëson “boshllëkun” që mund të ekzistojë në trajtimin e kësaj fushe. Duke u bazuar në literaturën e shfrytëzuar, (kryesisht materiale në gjuhën e huaj dhe materiale të marra nga interneti), do të përpiqem që të trajtoj nocionin e arbitrazhit ndërkombëtar si dhe të gjithë problematikën lidhur me këtë të fundit. Për arbitrazhin ndërkombëtar ka shumë përkufizime, por më i pranuari është ai që e përcakton arbitrazhin ndërkombëtar si një proces privat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me një vendim të detyrueshëm për palët, vendim i cili merret nga një apo disa individë të përzgjedhur nga palët konfliktuese. Arbitrazhi është një procedurë më pak formale se procesi gjyqësor. Përbën një formë private gjykimi. Pasi i gjithë procesi bazohet në një marrëveshje private, palët “ndërgjyqëse” janë individë ose persona juridikë privatë, procesi zhvillohet në një ambient të përcaktuar nga palët, privat

dhe marrja e vendimit i besohet përsëri një “arbitri” privat. E rëndësishme është arritja e marrëveshjes së arbitrazhit, marrëveshjes midis palëve, për t’iu nënshtruar të gjitha mosmarrëveshjeve të veçanta që kanë lindur ose mund të lindin në të ardhmen ndërmjet tyre si rezultat i një marrëdhënieje juridike të natyrës kontraktuale. Tipare të rëndësishme që karakterizojnë arbitrimin janë fleksibiliteti dhe kontrolli i palëve, të cilat rrjedhin drejtpërdrejt nga natyra konsensuale e tij. Si një proces ndërkombëtar arbitrazhi favorizohet nga disa faktorë siç janë: përvoja vendimmarrëse, natyra e formës së prerë të vendimit, natyra private e procedurave, shpenzimet më të vogla dhe shpejtësia e madhe e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, faktorë të cilët ndikojnë fuqishëm duke e bërë arbitrazhin një proces tërheqës për palët, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Natyrisht që avantazhet e sipërpërmendura, jo detyrimisht i ndeshim në çdo proces të veçantë arbitrazhi që zhvillohet, por kuadri ligjor i arbitrazhit ndërkombëtar tregtar bën të mundur dhe siguron një shkallë të lartë probabiliteti, që arbitrazhi të përcaktohet nga këto faktorë të mësipërm. Gjithashtu, nga trajtimi i temës, jam përpjekur të theksoj se arbitrazhi ndërkombëtar lejon të arrihen rezultate përfundimtare dhe të ekzekutueshme në shkallë globale, ku ekzekutueshmëria e vendimeve të arbitrazhit ka efektin indirekt të nxitjes së ekzekutimit vullnetar apo të arritjes së një zgjidhjeje miqësore, e cila në fund të fundit shmang nevojën e marrjes së një vendimi nga gjykata e arbitrazhit.

Ky punim paraqitet në një formë të përmbledhur dhe pjesët paraqiten në harmoni me njëra-tjetrën. I gjithë punimi është i ndarë në VI kapituj. Fillimisht është trajtuar kuptimi dhe karakteristikat e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar, parë kjo edhe në vështrimin historik. Më pas llojet e arbitrazhit ndërkombëtar, marrëveshja e arbitrazhit, efekti i saj dhe projektligji i arbitrazhit në Shqipëri.

Së fundi, është me vend të pasqyrohet ajo çka reflektohet në të gjitha çështjet e këtij punimi, konkluzionet, ku arbitrazhi ndërkombëtar, në ditët e sotme përbën mënyrën më të parapëlqyer për trajtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia ndërkombëtare. Mbetet problem aktual dhe madhor mbështetja e vendimeve të dhëna, zbatimi i tyre.

Duke shpresuar që ky punim të ketë paraqitur problematikën aktuale (avantazhet dhe disavantazhet) e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar dhe të ketë arritur qëllimin e zgjedhjes së kësaj teme, kemi paraqitur disa konkluzione të cilat do të ndihmojnë për t’u njohur më shumë me “arbitrazhin ndërkombëtar”, mënyrën e zhvillimit të tij.

Kuptimi dhe karakteristikat e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar

Arbitrimi është një proces privat për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me një vendim të detyrueshëm për palët, i cili merret nga një apo disa individë të përzgjedhur nga palët konfliktuese. Në krahasim me metodat e tjera që parashikojnë ndërhyrjen e palëve të treta, kjo formë dallohet nga procesi gjyqësor nga natyra e saj private, ndërkohë që dallohet nga ndërmjetësimi apo pajtimi nga karakteri i detyrueshëm i vendimeve të saj. Arbitrazhi është një procedurë më pak formale se procesi gjyqësor.

Dy janë format e gjykimit: procesi gjyqësor në gjykatë (gjykim publik) dhe arbitrimi (gjykim privat).

Arbitrimi është një *formë private gjykimi* sepse:

- bazohet në marrëveshjen private,
- rregullohet nga këto lloj marrëveshjesh,
- zhvillohet në një ambient privat,
- marrja e vendimit i besohet një pale private,
- palët janë individë ose persona juridikë privatë ose persona juridikë publikë, që veprojnë në mënyrë tipike në cilësinë e tyre si sipërmarrës tregtar.

Në një këndvështrim strikt, arbitrimi ka një *karakter hibrid* për arsye se është një proces privat që varet nga mbështetja që jep atij sistemi publik ligjor, për sa i përket efektivitetit dhe vlefshmërisë, për arsye se ky proces ka efekte publike të krahasueshme me vendimet që merren në proceset gjyqësore (gjykimi publik).

Arbitrimi ka natyrë hibride edhe për një arsye tjetër: ai varet nga *marrëveshja e palëve*, por në momentin që ky *konsensus* është dhënë, palët janë të detyruara të zbatojnë vendimet e marra nga arbitri pavarësisht nëse janë dakord me to apo jo. Marrëveshja e arbitrazhit gjithashtu shërben edhe për të përcaktuar rregullat procedurale deri në atë masë që lejohen nga ligji i shtetit në të cilin do të zhvillohet procesi i arbitrit.

Ekzistojnë dy lloje marrëveshjesh arbitrazhi:

- paraqitja përpara gjykatës së arbitrazhit e të gjitha mosmarrëveshjeve që mund të lindin në të ardhmen, nëpërmjet përfshirjes në tekstin e kontratës të një *klauzole arbitrazhi* ose vendosjes së saj si aneks të kontratës kryesore,
- paraqitja e një mosmarrëveshjeje ekzistuese përpara gjykatës së arbitrazhit nëpërmjet *një marrëveshjeje arbitrazhi*.

Shumica e arbitimeve ndërkombëtare sot zhvillohen mbi bazën e klauzolave kontraktuale të arbitrazhit.

Nuk ekziston ndonjë përkufizim universal për transaksionet, mosmarrëveshjet apo arbitrazhin “*tregtar*”. Ky term ka kuptim për arbitrazhin

ndërkombëtar për arsye se, në baze të legjislacionit të disa shteteve, vetëm mosmarrëveshjet “tregtare” mund të gjykohen nga një gjykatë arbitrazhi, një fakt i cili njihet edhe nga konventat ndërkombëtare (si p.sh. Konventa e Nju Jorkut, e cila lejon shtetet të përjashtojë nga gjykimi në arbitrazh ato mosmarrëveshje që nuk konsiderohen nga legjislacioni i tyre si mosmarrëveshje të fushës tregtare). Përveç kësaj, termi tregtar përdoret për të treguar veprimet e shteteve sovrane, që nuk mbulohen nga imuniteti sovran dhe për të bërë dallimin midis “arbitrazhit ndërkombëtar tregtar” (i cili rregullohet nga e drejta private) dhe “arbitrazhit ndërkombëtar” të mosmarrëveshjeve midis shteteve, që rregullohet nga e drejta ndërkombëtare publike.

Arbitrazhi ndërkombëtar duhet të dallohet dhe të mos konsiderohet i njëjtë me atë kombëtar. “*Ndërkombëtar*” mund të përkufizohet për arsye të natyrës së mosmarrëveshjes ose shtetësisë apo vendbanimit të palëve.

Vështrim historik

Arbitrimi është mjeti më i vjetër që njeh njerëzimi për zgjidhjen e konflikteve në mënyrë paqësore. Ai i paraprin procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat shtetërore dhe në të gjitha format e mundshme arkaike të tij, arbitrimi i ka paraprirë edhe vetë ekzistencës së shtetit.

Arbitrazhi është një institucion që ndeshet që në lashtësi. Njihen mjaft raste të përdorimit të tij, si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në marrëdhëniet midis poliseve greke. Platoni, Tukidi, Ciceroni dhe Seneka i kanë kushtuar vëmendje të veçantë në veprat e tyre.

E njëjta gjë ndodh në Mesjetë. Në shek e XII-XIII arbitrazhin e përdorin sidomos republikat tregtare italiane dhe kantonet zvicerane.

Në periudhën e absolutizmit arbitrazhi pëson rënie (shek XVI-XVIII). Nga fundi i shek. XVIII është përsëri në ngritje.

Arbitrimi tregtar është ndoshta po aq i vjetër sa edhe vetë tregtia.

Institucioni i parë i arbitrazhit ndërkombëtar që shqyrtonte nga të katër anët e globit ishte Gjykata e Arbitrazhit e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC).

Sipas një juristi dhe akademiku mund të dallohen katër breza të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar midis periudhës që nga krijimi i ICC e deri në ditët tona:

Deri pak pas Luftës së II Botërore kishte vetëm disa raste të rralla të arbitrimit ndërkombëtar tregtar. Roli i juristëve ishte i kufizuar dhe procesi i arbitrimit nuk kërkonte shumë shpenzime, ishte informal, miqësor dhe i shpejtë, përfshinte thjesht përcaktimin e cilësisë së mallrave.

Pas Luftës së II Botërore, shoqëritë multinacionale të naftës u hodhën kundër qeverive të vendeve të ndryshme në mosmarrëveshje që kishin të bënin me shtetëzimin e koncesioneve të naftës nga qeveritë e këtyre vendeve.

Në këto arbitime njëra nga palët ishte një qeveri sovrane dhe parimet mbi të cilat bazoheshin vendimet e tyre ndesheshin me të drejtën ndërkombëtare private. Secili mund të zgjidhte procedurën që donte. Ato filluan të kërkonin shumë kohë dhe u bënë të shtrenjta.

Në vitet '60 dhe '70 arbitrazhi filloi të bëhej gjithnjë e më i përdorshëm. Në këtë kohë u zhvillua avokatia dhe gjyqtaria e arbitrazhit. Numri i çështjeve të gjykuara në arbitrazh ICC arriti në rreth 50-80 çështje në vit.

Në fazën e fundit, pra në gjendjen e tij aktuale, arbitrazhi është kthyer në një “industri” dhe klauzolat e arbitrazhit kanë filluar të bëhen gjithnjë e më standarde në kontratat ndërkombëtare.

Personat të tjerë kanë identifikuar vetëm dy breza të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar:

Brezi i parë i arbitrazhit. Palët ia paraqisnin mosmarrëveshjet e tyre një arbitri të respektuar dhe me reputacion dhe ia linin atij në dorë me besim të plotë zgjidhjen e tyre pa ndonjë formalitet, duke rënë dakord që më parë, që të pranonin dhe të ekzekutonin pa vonesë çdo vendim që do të merrte ai.

Brezi i dytë i arbitrazhit. Procesi është bërë shumë më i shpeshtë dhe më përfshirës, dispozitat e tij janë bërë më komplekse dhe vendimet që merren në arbitrazh shpesh ankimohen nga palët.

Pavarësisht sesa breza identifikohen, çështja mbetet e njëjtë: *Arbitrazhi ka kaluar në një proces transformimi dhe ka arritur një nivel proceduralizmi dhe kompleksiteti që përbën me të vërtetë një burim shqetësimi.*

Kuadri ligjor i Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar

Arbitrazhi ndërkombëtar tregtar rregullohet nga regjimi privat i marrëveshjes së arbitrazhit midis palëve, në të cilën përfshihen të gjitha rregullat e arbitrit të inkorporuara me referim, kompetencat që jepen gjykatës së arbitrazhit dhe çdo kompetence tjetër që i jepet institucionit të arbitrazhit, si dhe nga regjimi publik i sistemeve ligjore kombëtare dhe konventave ndërkombëtare. Nëpërmjet një ndërveprimi shumë kompleks, sistemet ligjore kombëtare dhe konventat ndërkombëtare kombinojnë dispozitat e njëra-tjetrës për të siguruar një kuadër ligjor brenda të cilit të zhvillohet arbitrazhi ndërkombëtar.

Sistemet ligjore kombëtare

Ka tre nivele të regjimeve ligjore që rregullojnë arbitrazhin ndërkombëtar tregtar:

- marrëveshja kontraktuale (kontrata) midis palëve;
- sistemet e ndryshme ligjore kombëtare që kanë efekte mbi arbitrazhin;
- marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare midis shteteve

Sistemet ligjore kombëtare kanë rendësi të konsiderueshme për arsye se, është sistemi ligjor kombëtar ai që përcakton vlefshmërinë dhe efektet e marrëveshjes së arbitrazhit dhe, përveç kësaj, është po ky sistem që inkorporon dhe implementon çdo konventë përkatëse për këtë qëllim. Me fjalë të tjera, marrëveshja private e arbitrazhit si dhe konventat ndërkombëtare sjellin vetëm ato efekte, të cilat legjislacioni kombëtar jua lejon të sjellin.

Kufijtë e “De-lokalizimit”

Dy dhjetëvjeçarët e fundit është vënë re një debat akademik rreth nocionit të një sistemi të vërtetë ndërkombëtar dhe të de-lokalizuar të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar, i cili të funksionojë në mënyrë të pavarur nga të gjitha sistemet ligjore kombëtare, apo të paktën i pavarur nga legjislacioni kombëtar i vendit ku zhvillohet procesi i arbitrit. Do të duhet një kohë e konsiderueshme për të arritur të kemi një sistem me të vërtetë të de-nacionalizuar për zgjidhjen e konflikteve në fushën e biznesit ndërkombëtar.

Palët kanë të drejtë që në një farë mase të de-lokalizojnë arbitrazhin nëpërmjet përzgjedhjes së ligjit të aplikueshëm për këtë procedurë. Në përgjithësi, ligji i aplikueshëm për procedurën e arbitrit është ligji i vendit ku do zhvillohet procesi i arbitrit dhe në atë masë që lejohet nga ai ligj, rregullat procedurale të përcaktuara me marrëveshje nga palët dhe, në mungesë të një marrëveshje të tillë, rregullat e përcaktuara nga gjykata e arbitrazhit. Një pjesë e zgjedhjes që i është lënë palëve (por jo arbitrave në rast se palët nuk bien dakord) është mundësia për të de-lokalizuar arbitrazhin nëpërmjet rregullimit të procedurave (procesit të arbitrazhit) nga ligji kombëtar i një vendi tjetër të ndryshëm nga vendi ku do të zhvillohet procesi i arbitrit.

Një zgjedhje e tillë krijon avantazhe se, lejon të zgjidhet një ligj procedural, i cili të jetë i përshtatshëm në përmbajtje me nevojat e parashikuara të procesit të arbitrazhit (çështjes) në fjalë.

Por, nga ana tjetër, zgjedhja e një ligji procedural të huaj (të ndryshëm nga ai i vendit ku zhvillohet arbitrazhi) mund ta bëjë të vështirë procesin, sepse mund të mungojë asistencë nga gjykatat lokale (vendore) p.sh. për masat (veprimet) paraprake të mbrojtjes (sigurimin e padisë). Influenca e gjykatave lokale në procesin e arbitrit mund të kufizohet vetëm në atë masë që e lejon legjislacioni i vendit.

Bashkërendimi i ligjeve kombëtare

Mbi çdo arbitrazh ndërkombëtar ndikojnë të paktën dy dhe nganjëherë edhe më shumë sisteme ligjore kombëtare. Këto janë:

- ligji që rregullon zotësinë e palëve për të lidhur marrëveshje arbitrazhi,
- ligji që rregullon marrëveshjen e arbitrazhit,
- ligji i vendit ku zhvillohet procesi i arbitrit,

- ligji procedural, në rast se ka, i zgjedhur për të rregulluar procesin e arbitrit (i cili nuk i përjashton në mënyrë të plotë efektet e ligjit të vendit ku zhvillohet procesi i arbitrit),

- ligji material i aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (i cili mund të jetë ose jo një legjislacion kombëtar, meqë palët nganjëherë parashikojnë që marrëdhëniet midis tyre do të rregullohen p.sh nga “parimet e ligjit të tregtisë ndërkombëtare”),

- ligji i cilitdo vendi ku kërkohet marrja e masave paraprake (sigurimin e padisë) ose asistencë gjyqësore për mbledhjen e provave,

- ligji i vendit ku do të bëhet njohja dhe ekzekutimi i vendimit të gjykatës së arbitrazhit

- ligji i vendit ku nga palët mund të jetë filluar një proces gjyqësor paralel.

Në përgjithësi, kuadri ligjor i arbitrazhit ndërkombëtar është superior ndaj atij që rregullon proceset gjyqësore transnacionale, për arsye se disa zhvillime të caktuara të vëna re këto kohë kanë ndihmuar për të reduktuar, bile nganjëherë edhe për të eliminuar shumë nga rreziqet që lidhen me kontekstin multi-juridiksional të këtij procesi.

Liberalizimi i ligjeve kombëtare mbi arbitrazhin

Gjatë 10-15 vjetëve të fundit në mjaft vende janë aprovuar ligje mjaft liberale për arbitrazhin. Tendencia për t’i dhënë procesit të arbitrit një masë më të madhe autonomie është forcuar edhe nga publikimi nga Kombet e Bashkuara i Ligjit Model UNCITRAL të vitit 1985 mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar. Ligji Model, i cili lehtëson zhvillimin e procesit të arbitrit brenda sferës së tij dhe rrit masën e ekzekutueshmërisë së vendimeve të gjykatave të huaja të arbitrazhit, është aprovuar pjesërisht apo tërësisht nga një numër shtetesh dhe është duke u diskutuar aprovimi i tij në një numër po aq të madh shtetesh të tjera.

Përveç kësaj, gjykatat kombëtare kanë pasur një sjellje gjithmonë e më inkurajuese ndaj arbitrazhit ndërkombëtar.

Efektet e Sistemeve Ligjore Kombëtare mbi Arbitrazhin

Efektet e sistemeve të ndryshme ligjore kombëtare janë manifestuar në aspekte të ndryshme:

- *juridiksioni* i gjykatave të arbitrazhit përcakton nëse procesi mund të zhvillohet në mënyrë të vlefshme duke përjashtuar proceset e tjera

- *çështjet procedurale* kontrollojnë mënyrën e zhvillimit të procesit të arbitrit

- në pjesën me të madhe të rasteve është legjislacioni kombëtar ai që aplikohet nga ana *materiale* për zgjidhjen e mosmarrëveshjes

-trajtimi që i bëhet vendimit të gjykatës së arbitrazhit përcakton se cilat do të jenë efektet që do të sjellë ky proces.

Konventat ndërkombëtare

Hapat më të rëndësishëm që janë ndërmarrë në drejtim të një “sistemi uniform të arbitrazhit ndërkombëtar” janë arritur nëpërmjet krijimit të një numri konventash ndërkombëtare që rregullojnë arbitrazhin tregtar.

Konventa e Nju Jorkut mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të huaja të arbitrazhit

Kjo konventë mbulon si aspektet e ekzekutimit ashtu edhe ato të juridiksionit të arbitrazheve ndërkombëtare tregtare. Konventa përcakton disa standarde minimum për mënyrën e trajtimit nga ana e gjykatave kombëtare të shteteve anëtare të saj, të marrëveshjeve të huaja të arbitrazhit dhe të vendimeve të dhëna nga gjykatat e arbitrazhit të vendeve të tjera, por ja lë vetë shteteve anëtare të saj në dorë të nxjerri rregulloret përkatëse për përcaktimin e procedurave të zhvillimit të procesit të arbitrit.

Konventa e Nju Jorkut përbën një sukses në përpjekjet për arritjen e një sistemi universal për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare. Megjithatë, ky sukses ka edhe kufizimet e tij.

Harmonizimi i arritur nga Konventa e Nju Jorkut nuk është i plotë, po të kemi parasysh faktin se konventa i lë hapësira të rëndësishme vendimmarrëse gjykatave kombëtare, të cilat kanë të drejtë të vendosin në lidhje me vlefshmërinë e marrëveshjeve dhe vendimeve të arbitrazhit.

Ajo përcakton standarde uniform për vendimet e gjykatave të arbitrazhit, por e lë interpretimin dhe aplikimin e Konventës në dorë të gjykatave kombëtare.

Përveç kësaj, ajo nuk siguron një mekanizëm për zgjidhjen e konflikteve midis juridiksioneve kombëtare mbi çështjet që kanë të bëjnë me arbitrazhin.

Konventa e Nju Jorkut ka krijuar një sistem me të vërtetë global, jo vetëm për sa i përket numrit të shteteve kontraktuese, por edhe për sa i përket diversitetit të tyre gjeografik, politik dhe ekonomik.

Konventa ICSID (Konventa e Uashingtonit)

Konventa e Uashingtonit për Zgjidhjen e Konflikteve të Investimeve Midis Shteteve dhe Qytetarëve të Shteteve të Tjerë, është ratifikuar nga një numër më i madh shtetesh se i çdo konvente tjetër mbi arbitrazhin.

Sistemi ICSID mbështet zgjidhjen e konflikteve në tre mënyra:

1. Nëpërmjet krijimit të një institucioni arbitrazhi për të administruar procedurat e këtij procesi.

2. Nëpërmjet krijimit të një kompleti rregullash ndërmjetësimi dhe arbitrimi të hartuara qëllimisht për këtë lloj mosmarrëveshjes (që zgjidhen me arbitrim dhe me ndërmjetësim).

3. Nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor të de-nacionalizuar, i cili i ndan në mënyrë të qartë procedurat e ICSID nga sistemet ligjore kombëtare dhe siguron ekzekutimin e vendimeve të dhëna në bazë të sistemit ICSID në shtetet që janë palë të kësaj konvente, shumë nga të cilat nuk janë palë të Konventës së Nju Jorkut.

Kjo konventë përcakton dy kushte të nevojshme për aplikimin e saj:

Si shteti në të cilin janë bërë investimet, ashtu edhe shteti, qytetari i të cilit është investitori, duhet të jenë palë të Konventës.

Mosmarrëveshja midis tyre duhet të ketë lindur duke pasur për shkak direkt të saj një investim të kryer.

Në momentin që marrin formë të prerë, vendimet e arbitrazhit ICSID janë direkt të ekzekutueshme në çdo shtet kontraktues, pa pasur nevojë të kërkojnë një urdhër ekzekutimi dhe pa mundësi rishikimi nga gjykata.

Konventat rajonale

Konventa Evropiane e vitit 1961 mbi Arbitrimin Ndërkombëtar Tregtar (Konventa e Gjenevës e vitit 1961).

Është ratifikuar nga 19 shtete. Rëndësia e saj praktike është e kufizuar për sa i përket njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit, për arsye se shumica e shteteve kontraktuese të saj janë, gjithashtu, palë të Konventës së Nju Jorkut. Në nenin IV të saj përmban një dispozitë të detajuar për procedura standard që ndiqen në rastet kur palët nuk kanë përcaktuar numrin e arbitrave dhe metodën e emërimit të tyre, vendin e arbitrazhit dhe ligjin e aplikueshëm për procedurat e procesit të arbitrimit.

Konventa Inter-Amerikane e vitit 1975 mbi Arbitrimin Ndërkombëtar Tregtar (Konventa e Panamasë).

Ajo trajton si aspektet e juridiksionit, ashtu edhe ato të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit. Për sa i përket aspektit të dytë, ajo vetëm parashikon që një marrëveshje para-konfliktuale arbitrazhi është e “vlefshme”, por pa thënë ndonjë gjë për mënyrën e ekzekutimit të saj. Nuk parashikohet ndonjë detyrim i gjykatave kombëtare për të pezulluar procesin gjyqësor të nisur përpara tyre, në rastet kur ndeshen me ekzistencën e një marrëveshjeje arbitrazhi.

Një të re që sjell kjo konventë parashikohet në nenin 3; në mungesë të një

përzgjedhjeje të shprehur nga palët, procesi i arbitrit do të rregullohet nga rregullat e arbitrazhit të përcaktuara nga Komisioni Inter-Amerikan i Arbitrit Tregtar (IACAC), të cilat janë hartuar në bazë të Rregullave UNCITRAL.

Çështje të arbitrazhit, ku shteti shqiptar ka qenë palë.

Në disa raste shteti ynë ka qenë palë e paditur në një proces ndërkombëtar arbitrazhi. Një nga çështjet e para është ajo e shqyrtuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit e DHNT-së, ku shteti ynë ishte i paditur nga Projekti për zhvillimin e arsimit në Shqipëri.

AEDP ose Projekti për Zhvillimin e Arsimit në Shqipëri u themelua në vitin 1994 si një iniciativë e OSFA për rindërtimin dhe modernizimin e sistemit arsimor në Shqipëri. OSFA hyri në Marrëveshje Bashkëpunimi me shtetin shqiptar të përfaqësuar në Shqipëri nga Ministria e Arsimit. Angazhimi i AEDP ishte rinovimi i shkollave në Shqipëri. Për realizimin e aktiviteteve të saj AEDP ka shpenzuar më shumë se 57 milionë dollarë. Pra, 1996 Shqipëria nuk e aplikonte Taksën mbi Vlerën e Shtuar në blerjen e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve dhe, si rrjedhim, AEDP nuk ka paguar ndonjë shumë për efekt të TVSH. Me efekt prapaveprues, që nga data 1 korrik 1996 Shqipëria aprovoi një ligj që prezantonte TVSH në masën 20%. Ligji përcaktonte përjashtime për organizatat jofitimprurëse si AEDP, mbi bazën e marrëveshjeve të ratifikuara nga Parlamenti ynë.

Marrëveshja u nënshkrua në qershor të vitit 1997 dhe parashikonte financime projektsh të përbashkëta si dhe klauzola se TVSH dhe çdo taksë tjetër do të mbulohej tërësisht nga Buxheti i Shtetit. Me realizimin e bashkëpunimit AEDP pagoi vetë TVSH në nivelin 20% mbi shpenzimet për realizimin e projekteve në Shqipëri dhe kërkoi nga shteti shqiptar rimbursimin. Deri në shkurt të vitit 1999 rimbursimi u bë sipas parashikimit të marrëveshjes. Më tej, pas kësaj periudhe pati vonesa në përmbushjen e rimbursimit.

Gjykata e Arbitrazhit në këtë rast shqyrtoi çështjen referuar parimeve të UNIDROIT në interpretim të marrëveshje skuadër në mes të AEDP dhe shtetit shqiptar. Gjykata e Arbitrazhit vendosi që shteti shqiptar ishte i detyruar të paguante rimbursimin e mbetur AEDP si dhe e konsideroi kërkesën e AEDP për interesin si të justifikueshëm dhe për shumën e kërkuar 41, 286, 462 lekë.

Në kushtet e reja të viteve të fundit Shqipëria ka qenë disa herë para Gjykatave të Arbitrazhit. Tashmë shteti shqiptar përfaqësohet në këto gjykime nga Avokatura e Shtetit. Avokatura e Shtetit në Shqipëri ka si detyrë të saj funksionale krahas përfaqësimit të shtetit në gjyq kundër të tretëve dhe përfaqësimit të shtetit tonë në Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar.

Në një rast Kompania Italo-Amerikane, “General Electric”, ka paditur shtetin shqiptar në Arbitrazhin Ndërkombëtar për një dëm ekonomik prej 21 milionë dollarësh. Firma paditëse pretendon se shteti i detyrohet për shkeljen e kontratës për ndërtimin e trenit elektrik nga firma ndërtuese Italo-Amerikane.

Çështjet që po gjykohen në Arbitrazhin Ndërkombëtar, në të cilat është palë dhe shteti i përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, janë gjithsej katër procese gjyqësore, në të cilat Avokatura e Shtetit do të përfaqësojë interesat shtetit shqiptar. Të gjitha këto çështje janë drejt përfundimit. Kështu është drejt përfundimit procesi gjyqësor me “Soros-in”, ku pritet vendimi këto ditë. Në këtë dosje bëhet fjalë për një shumë rreth 3 milionë dollarë. Sipas palës paditëse, Fondacionit “Soros”, shteti shqiptar i detyrohet këtij institucioni për shumën 3 milionë dollarë. Prosesi është në fazat e fundit dhe përfaqësuesit e Avokaturës së Shtetit janë drejt mbylljes me sukses të kësaj çështjeje, ku shumën e pretenduar nga pala paditëse të mos paguhet nga buxheti i shtetit.

Është në proces shqyrtimi nga Arbitrazhi Ndërkombëtar dhe çështja me kompaninë Italo-Amerikane, “General Electric”, ku kjo kompani kërkon nga shteti shqiptar shumën 21 milionë dollarë për moszbatimin e kontratës për ndërtimin e trenit elektrik në Shqipëri. Ndërkohë, nuk ekziston asnjë kontratë e nënshkruar nga shteti shqiptar me kompaninë paditëse. Arbitrazhi ndërkombëtar po gjykon çështjen me kompaninë “Petrol Infera”, me të cilën nuk është ratifikuar nga Parlamenti kontrata. Paditësi pretendon se shteti shqiptar duhet të lejojë zbatimin e kontratës për një ndërtim në portin e Vlorës ose në rast të kundërt duhet të paguajë dëmin që i është shkaktuar firmës. Shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, është palë në Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe në një proces gjyqësor me një kompani daneze, “Rode Nilsen”, e cila pretendon se shteti shqiptar i detyrohet 6 milionë dollarë amerikanë. Ky proces sapo ka filluar dhe ende nuk mund të flasim për ecurinë e tij. Gjithashtu, është dhe në proces gjyqësor me një kompani gjermane, ku Avokatura e Shtetit i jep asistencën e saj gjyqësorit të shtetit gjerman për legjislacionin e shtetit shqiptar. Ky bashkëpunim ka lindur pasi kompanisë gjermane që është në proces i janë sekuestruar nga shteti shqiptar disa pajisje gjatë procesit gjyqësor që ka pasur në Shqipëri në vitin 2002.

Në Arbitrazhin Ndërkombëtar institucioni i Avokaturës së Shtetit aktualisht përfaqëson tre çështje: çështjen me Fondacionin SOROS ose programin Tirana 2000, është një program që ka qenë për riparimin e shkollave, ku nga ana e SOROS-it kërkohet t’i dëmshpërblehet një dëm nga ana e shtetit në një shumë prej 2 milionë dollarë. Kjo shumë pretendohet nga fondacioni për mos shlyerje të TVSh-së. Kjo çështje është akoma në proces. Ne e kemi mbaruar mbrojtjen dhe pritet vetëm vendimi nga Arbitrazhi.

Janë disa kompani dhe firma të huaja, ato të cilat kanë trokitur tashmë në dyert e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, duke paditur shtetin tonë për moszbatim kontratash të ndryshme. Pretendimet e tyre ato i kanë shoqëruar edhe me një faturë të majme financiare në dëm të Shqipërisë.

Rreth 40 milionë euro është shifra totale e dëmshpërblimit që këto kompani të huaja amerikane, italiane, daneze apo turke pretendojnë. Probleme pronësie, kaos hipotekash, anulim kredie, mungesë studimesh profesionale nga pala shqiptare, zvarritje punimesh nga vetë firmat etj., janë disa prej problemeve që kanë detyruar palët t'i drejtohen Gjykatës. Por përtej telajos së këtyre problemeve dhe faturës financiare, shfaqet edhe një hartë gjeopolitike me mjaft ndërlikime në rrafshin e marrëdhënieve tona ndërkombëtare.

E parë nga aspekti diplomatik, Shqipëria në linjat e saj të politikës së jashtme e ka cilësuar prej kohësh SHBA, Italinë dhe Turqinë si partnerë strategjikë të saj. Këto tre vende politika zyrtare e Tiranës i shikon si porta për anëtarësim në NATO dhe në BE, por edhe si një mundësi për një promovim më të madh të rolit të Shqipërisë në politikën rajonale dhe më gjerë. Jo pak rëndësi për vendin tonë ka edhe Danimarka, sidomos sa i përket integritimit në BE.

Siç vihet re, vija mes interesave ekonomike dhe atyre politike të vendit tonë me këto vende është mjaft e hollë. Kjo sepse shumë shpesh pas këtyre bizneseve me peshë globale, kanë qëndruar qeveritë përkatëse, të cilat kanë reaguar sa herë që kontratat me vendin tonë janë prekur, shtyrë, apo edhe anuluar. Historia e vonë e dosjes gjyqësore në fjalë shënon reagime të hapura dhe të mbyllura të Uashingtonit dhe Ankarasë, Romës dhe Kopenhagenit.

Dosja e gjyqeve në të cilat shteti ynë është palë, përfshin kompani të ndryshme.

Në krye të listës, si nga pesha politike, por dhe ajo financiare, spikat "General Electric" (GE). Kjo kompani kërkon 20 milion dollarë amerikanë dëmshpërblim nga shteti shqiptar, për kontratën e prishur nga ana e qeverisë shqiptare, për modernizimin e segmentit hekurudhor Tiranë-Durrës në vlerën 95 milionë USD. "GE" është një kompani mjaft e njohur e prestigjioze në SHBA. Ajo ka lidhje mjaft të fuqishme me politikën amerikane, pasi ka dhe nivelet më të larta të kontraktimeve me qeverinë amerikane.

Nisur nga pesha dhe rëndësia e "GE", por dhe nga përftimi ekonomik i projektit, ish- ambasadori amerikan në Tiranë, Xhejms Xhefri, e mbështeti publikisht kontratën për modernizimin e segmentit hekurudhor Tiranë-Durrës. Ai, përpos leverdisë ekonomike, nënvizonte dhe faktin se operimi i "GE" në Shqipëri do të shërbente edhe si një sinjal pozitiv për investitorët amerikanë, por edhe ata europianë, për të investuar, si dëshmi e stabilitetit politik dhe e sigurisë në vend.

Brenda këtij konteksti duket se ishte edhe përzgjedhja që qeveria shqiptare në vitin 2004 bëri ndaj kompanisë amerikane “GE”, duke ju kundërvënë edhe institucioneve financiare të huaja që operojnë në Tiranë si Banka Botërore dhe FMN, të cilat u shprehën kundër marrjes nga qeveria të kredisë me terma tregtarë, që do të financonte projektin. Me qeverinë e re të krijuar pas zgjedhjeve të vitit 2005 kontrata në fjalë u anulua, me argumentin se ky segment hekurudhor nuk përbënte përparësi për vendin dhe se kredia ishte me interesa mjaft të larta.

Jo pak e ndërlikuar nga pikëpamja financiare dhe ajo politike shfaqet edhe përballja në Gjykatë e qeverisë shqiptare me kompaninë e njohur italiane “Petrolifera”.

Ajo do të investonte 12 milionë euro në infrastrukturën e Portit të Vlorës. Politika më e lartë italiane nuk ka ngurrar të shprehë haptazi pakënaqësinë ndaj zyrtarëve më të lartë të shtetit shqiptar, si dhe qeverisë, lidhur me mungesën e seriozitetit për zbatimin e kontratave me firmat italiane.

Qeveria shqiptare deri në këto momente nuk ka bërë asgjë për zbatimin e kontratës, duke lëshuar në këtë mënyrë jo vetëm një mesazh negativ në drejtim të investitorëve përtej Adriatikut, por edhe një shpërfillje ndaj qëndrimit të politikës italiane.

Dëmshpërblim prej 20 milionë eurosh kërkon edhe kompania turke “BeHaShe”. Kjo kompani do të ndërtonte segmentin Elbasan-Rrogzhiinë, si pjesë e Korridorit të 8-të. Më e kursyer në kërkesën për dëmshpërblim shfaqet kompania daneze “Rhade Nielsen”. Kjo kompani, e cila do të merrej me zgjerimin e një pjese të Portit të Durrësit, kërkon 6 milionë euro dëm.

a) Cilat janë arsyet që kompania amerikane “GE” kërkon 20 milionë USD dëmshpërblim nga shteti shqiptar?

Sipas pretendimit të kësaj kompanie, e cila ka nisur proces gjyqësor në qershor 2006, qeveria shqiptare ka penguar angazhimin e mëtijshëm të kompanisë amerikane për të marrë pjesë në projekte të tjera në vendet e rajonit, pasi ajo priste të fillonte projektin në Shqipëri, për modernizimin e segmentit hekurudhor Tiranë - Durrës në vlerën 95 milionë USD. Projekti për modernizimin e segmentit hekurudhor Tiranë - Durrës, është miratuar nga ish - qeveria socialiste, por është anuluar nga qeveria.

Si pasojë e këtij mosangazhimi, kompania pretendon se i është shkaktuar një dëm prej afro 20 milionë USD. Përkthyer në terma tregtar pretendimi për një dëmshpërblim prej 20 milionë USD, sipas kompanisë, përllogaritet si fitim i munguar. Shteti shqiptar, nëpërmjet Avokatisë së Shtetit, ka mbajtur qëndrimin se nga pala shqiptare nuk është bërë asnjë shkelje, sepse Kuvendi nuk e ka miratuar marrëveshjen për modernizimin e këtij segmenti hekurudhor.

Ndonëse vendimi është marrë në qeveri, kontrata nuk është ratifikuar në Kuvend dhe, për rrjedhim, ajo nuk është e vlefshme.

Kuvendi i Shqipërisë ka mbajtur qëndrimin se p/ligji mbi të ashtuquajturin “tren elektrik”, rreth një vit e gjysmë më parë ka ardhur deri në Kryesinë e Kuvendit për t’iu nënshtuar gjykimit të parlamentarëve në komisionin e ekonomisë dhe më pas për të kaluar në seancë plenare për miratim. Por, ndonëse projektligji u soll në Kryesinë e Kuvendit, ai rezultoi të mos ketë ndjekur procedurën që ndiqet për projektligjet në Kuvend.

Teza tjetër me të cilën Avokatura e Shtetit do të mbrohet në Gjyq mësohet se është fakti se “GE” ka bërë vetë studimin e fizibilitetit dhe po kjo kompani ka marrë përsipër ta ndërtojë atë. Kjo përbën shkelje të ligjit për prokurimet.

b) Gjendja e regjistrimit të pasurive të paluajtshme shqiptare është arsyeja kryesore pse qeveria shqiptare është në gjyq ndërkombëtar me kompaninë italiane “Petrolifera”. Ky duket se është gjyqi i vetëm ku kompania e huaj është në avantazh me qeverinë shqiptare. Mes kësaj kompanie dhe qeverisë shqiptare është lidhur një kontratë, ku 183 mijë metra katror sipërfaqe në zonën e PVC në Vlorë dhe disa ambiente përreth kësaj zone, i janë shitur kompanisë italiane “Petrolifera” për 1 euro metri katror.

Ky ambient do të përdorej për ngritjen e disa depozitave të naftës në këtë zonë. Kushti kryesor i kësaj kontrate shitjeje ishte që “Petrolifera” do të kryente një investim prej afro 12 milionë euro në infrastrukturën e Portit të Vlorës. Por, ndërkohë që ishte mbyllur gjithçka, në zyrat e hipotekës u vërtetua se në këtë zonë pronarë nuk ishte vetëm qeveria shqiptare, por edhe 7 familje vlonjate. Këtu nis odiseja e mbivendosjes së pronës, e cila edhe sot e kësaj dite nuk është zgjidhur. Sipas afatit ligjor, “Petrolifera” duhej të kishte nisur punë që në janar të vitit 2004.

Në qershor të viti 2006 “Petrolifera” i është drejtuar institucioneve ndërkombëtare për të gjetur të drejtën e saj. Në po këtë muaj shteti shqiptar njoftohet se është në proces gjyqësor me këtë kompani.

Cilat janë pretendimet e procesit gjyqësor të “Petroliferës”? Ajo kërkon zbatimin e kontratës me qeverinë shqiptare për t’i dhënë në pronësi 183 mijë metra katrorë sipërfaqe, si dhe kërkon fitimin e munguar për një periudhë 2 vjeçare. Çështja u zgjidh me rinegociim të marrëveshjes mes shtetit tonë e Shqipërisë.

c) Gjyqi më interesant duket ai mes kompanisë daneze “Nielsen” dhe shtetit shqiptar. Të dy palët kanë hedhur në gjyq reciprokisht njëra-tjetrën dhe kërkojnë secila nga 6 milionë euro kundrejt tjetrës. Në vitin 2004 qeveria shqiptare lidh një kontratë me kompaninë daneze “Nielsen” me një shumë

prej afro 2 milionë euro. Projekti ka të bëjë me gërmimin dhe pastrimin e bazamentit në Portin e Durrësit dhe konkretisht të zonës ku ndalojnë dhe shkarkohen anijet.

Pesë muajt e parë pasi u lidh kontrata, kjo kompani nuk u duk në Shqipëri. Pas 5 muajsh, kjo kompani merr një dragë me qira, anije kjo e specializuar për të kryer gërmime në det, pasi pajisjen e saj e kishte në Egjipt për punë. Punimet kanë ecur ngadalë, pasi pajisja që u mor me qira nuk ishte konform relievit të fundit të detit. Në këtë pikë pala daneze pretendon se qeveria shqiptare nuk ka ofruar të dhëna të sakta teknike, duke pretenduar që fundi i detit ishte ranor, ndërkohë në fakt ai rezultoi shkëmbor pas fillimit të punimeve.

Gjatë gërmimeve kompania gjen disa predha të mbetura nga Lufta e II Botërore në Portin e Durrësit. Kaq mjaftoi që kompania të tërhiqej dhe ushtria shqiptare të niste pastrimin e zonës. Si për ta përkeqësuar më shumë situatën, pasi rikthehet draga në ujërat e Adriatikut, ajo merr flakë dhe anija digjet. Afati i punimeve u zvarrit.

Në vitin 2006 qeveria shqiptare i lë një afat kësaj kompanie për të përfunduar punimet, por ai nuk respektohet. Si rrjedhim, qeveria shqiptare nuk bën pagesën e mbetur ndaj kësaj kompanie në shumën prej 900 mijë euro.

Qeveria shqiptare detyrohet të prishë kontratën, ndërsa kompania “Nielsen” nis proces gjyqësor, me pretendimin për prishje kontrate në mënyrë të njëanshme, prishje imazhi dhe kërkon 6 milionë euro dëmshpërblim.

Por Avokatura e Shtetit shqiptar i kundërpërgjigjet me padi kësaj kompanie për zvarritje kontrate dhe kërkon edhe ajo 6 milionë euro dëmshpërblim. Pala shqiptare pretendon se është në avantazh në këtë çështje, pasi kjo kompani ka punuar në të zezë, e paregjistruar në tatime dhe s’ka respektuar afatet ligjore.

c) Kompania turke “BeHaShe”, kërkon 20 milionë euro dëmshpërblim nga shteti shqiptar me akuzën për sekuestrim të paligjshëm të pajisjeve të saj të punës nga qeveria shqiptare. Kjo kompani do të rikonstruktonte rrugën Elbasan- Rrogozhinë, pjesë e Korridorit të 8-të. Kontrata është lidhur që në vitin 1998. Kjo kompani kreu punimet kryesore të projektit, por punimet u zvarritën, duke thyer afatet ligjore të parashikuara në kontratë. Qeveria shqiptare, pasi i ka vendosur disa herë kompanisë afate për të përfunduar punimet, të cilat nuk janë zbatuar asnjëherë, i sekuestroi pajisjet e punës.

Të drejtën për përfundimin e punimeve qeveria shqiptare ia jep një kompanie tjetër, e cila përfundoi në kohë pjesën e mbetur të këtij segmenti rrugor.

Edhe sot e kësaj dite pajisjet e kësaj kompanie vijojnë të jenë të sekuestruara

nga qeveria shqiptare. Kompania turke nisi një proces gjyqësor me pretendimin se i janë bllokuar pajisjet padrejtësisht dhe për prishje të kontratës në mënyrë të njëanshme. Vetëm për bllokimin e pajisjeve “BeHaShe” kërkon 20 milionë euro dëmshpërblim. Qeveria shqiptare do të mbrohet në Gjyq me pretendimin se vlera e pajisjeve është e barabartë me dëmin që i ka shkaktuar qeverisë shqiptare mospërfundimi në afat kohor i punimeve.

Përfaqësimi i shtetit shqiptar në Arbitrazhin Ndërkombëtar

Total - 7 çështje sipas rregullave të ICC, UNCITRAL, ICSID.

Përfunduar -2 çështje:

- *fituar* 1 e mbartur nga viti 2002 (BE-HA-SE vs DPR), me vlerë padie 200 mln Euro,

- *humbur* 1 e mbartur nga viti 2006 (Iliria Consortium vs MPPTT), për të cilën është aplikuar për korrigjim dhe interpretim pranë ICC-Paris nga pala shqiptare.

Rezultati: Parandaluar dëmi në masën 199 mln e 850 mijë Euro.

Konkluzione

Arbitrazhi ndërkombëtar është sot mënyra e parapëlqyer për trajtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia ndërkombëtare.

Në kontekstin ndërkombëtar problemi më i madh i arbitrazhit është mbështetja e vendimeve të dhëna. Rezervat që i janë bërë Konventës së OKB për Njohjen dhe Mbështetjen Gjykimeve të Arbitrazhit të Jashtëm, 1958, nga shtetet anëtare e kanë ndërlikuar mekanizmin e mbështetur të gjykimeve nga vendet nënshkruese.

Shumë vende e kanë pranuar Konventën me një rezervë reciprociteti, çfarë do të thotë se ato mbështesin një vendim arbitrazhi të jashtëm, vetëm nëse ai është dhënë që është palë në Konventë. Çështja është se deri tani këtë Konventë e kanë nënshkruar rreth 115 vende. Krijimi i rregullave të reja ndërkombëtare është një domosdoshmëri në kushtet e zhvillimit të marrëdhëniet tregtare të sotme.

Me një marrëveshje arbitrazhi të hartuar me kujdes dhe në mënyrë të përshtatshme kuadri ligjor i arbitrit ndërkombëtar tregtar:

Siguron një trup gjykues (arbitrues) kompetent dhe përjashton mundësinë e zhvillimit të procedurave paralele praktikisht në shkallë ndërkombëtare;

Lejon përshtatjen në mënyrë fleksibël të procedurave të arbitrazhit për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të palëve, ndërkohë që garanton neutralitetin e trupit arbitruar, një standard minimum korrektësie procedurale dhe

konfidencialitetin e procedurave; përveç kësaj lejon të arrihet në një shkallë të arsyeshme shqyrtimi i provave dhe kufizon rishikimin gjyqësor të vendimeve të arbitrazhit vetëm në disa nga heshtjet më themelore të këtij procesi;

Siguron marrjen e një vendimi legjitim dhe me një shkallë të arsyeshme parashikueshmërie nga një trup arbitrues me njohuri të mjaftueshme mbi ligjin e aplikueshëm, në bazë të të cilit do të merret ky vendim, praktikat përkatëse të fushës tregtare që lidhen me mosmarrëveshje në fjalë dhe çdo çështje tjetër teknike që ka të bëjë me palët;

Lejon të arrihen rezultate përfundimtare dhe të ekzekutueshme në shkallë globale; ekzekutueshmëria e vendimeve të arbitrazhit ka efektin indirekt të nxitjes së ekzekutimit vullnetar apo është të arritje së një zgjidhjeje miqësore, e cila në fund të fundit eliminon nevojën për marrjen e një vendimi nga gjykata e arbitrazhit.

Në bashkësitë tregtare ndërkombëtare ka shekuj traditash e zakonesh të vjetra parimesh, bashkimi i të cilave me arbitrazhin përbën një forum më vete.

Arbitrazhi është mënyra e parapëlqyer për trajtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia ndërkombëtare.

Rritja e transaksioneve të fuqishme tregtare favorizohen nga ndryshimet e shpeshta të natyrës së këtyre transaksioneve.

Zhvillimi i marrëdhënieve tregtare të rëndësishme me vendet në zhvillim dhe sistemet ligjore të ndryshme.

Rregullimi i këtyre transaksioneve nga kontrata të ndërlikuara.

Zhvillimi i transaksioneve të drejtuara nga konsorciumet dhe konfliktet që lindin ndërmjet anëtarëve të konsorciumeve.

Arbitrazhi në kuadrin ndërkombëtar favorizohet falë faktorëve që e bëjnë atë tërheqës për palët e përfshira në mosmarrëveshje tregtare.

Përvoja e vendimmarrësve.

Natyra e formës së prerë të vendimit.

Natyra private e procedurave.

Shpenzimet më të vogla.

Zhdërvjelltësia e procesit.

Shpejtësia më e madhe e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Sigurisht që këto avantazhe nuk materializohen në çdo proces të veçantë arbitrazhi që zhvillohet, por kuadri ligjor i Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar bën të mundur dhe siguron një shkallë të lartë probabiliteti që kjo të bëhet realitet.

Shumëllojshmëria dhe sasia e faktorëve që ndikojnë, tregon se sa e vështirë është të bësh deklarata të përgjithshme lidhur me shpenzimet në një arbitrazh ndërkombëtar tregtar. Megjithatë, disa konkluzione edhe mund të arrihen.

Palët mund të ushtrojnë njëfarë influence lidhur me përcaktimin e shpenzimeve gjyqësore, duke parashikuar një regjim juridik, i cili siguron një procedurë eficiente dhe efektive. Regjimi juridik duhet të përfshijë:

- Zgjedhjen e vendit, ku do të zhvillohet arbitrazhi
- Seleksionimin e arbitrave
- Dhe disa parametra të tjerë logjistik.

Sa më sipër, del e qartë që në kohët e sotme Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar është risi e kohës e domosdoshmëri për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare në kushtet e reja të zhvillimit ekonomik e juridik ndërkombëtar.

Literatura:

1. "International Commercial Arbitration"- Macfarlane, Dispute Resolution, Toronto, 1999
2. "Arbitration and Judicial Adjudication Compared in dispute Resolution, Toronto, Edmond Montgomery Publication, 2002
3. "Garnett, et al, A Practical Guide to International Commercial Arbitration" 2003
4. "L'arbitrato commerciale internazionale" Piero Bernardini
5. "Studim për qendrat e Arbitrazhit si dhe Institucionet e Arbitrazhit Tregtar",
6. "Udhëzues e Manual Ndërkombëtar", botime "Oceana".
7. "Arbitrazhi Ndërkombëtar i Shërbimeve"- Lloyd's of london Press, 2001
8. "E drejta ndërkombëtare publike" Arben Puto, Tiranë 2002, botimi 7-të
9. "E drejta ndërkombëtare private", Ardian Kalia
10. "E drejta tregtare" (cikël leksionesh) Argita Malltezi Berisha
11. "Konventa për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatave të Huaja të Arbitrazhit" (Konventa e Nju Jorkut), hartuar në Nju Jork, 10 qershor 1958
12. "Konventa ICSID" (Konventa e Uashingtonit)
13. "Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar" (Konventa e Gjenevës), 21 prill 1961
14. "Konventa Inter-Amerikane mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar" (Konventa e Panamasë), 1975
15. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë
16. Ligji nr. 9090 dt. 26.06.2003 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve"
17. Ligji nr. 7764 dt. 02.11.1993 "Për investimet e huaja"

Literatura në internet:

1. -www.uncitral.org
2. [Uncitral Model Law on Internacional Commercial Arbitration](http://www.uncitral.org/texts/arbconc/ml-arb.htm)
3. [english/texts/arbconc/ml-arb.htm](http://www.uncitral.org/texts/arbconc/ml-arb.htm)
4. [Uncitral Arbitration Rules](http://www.uncitral.org/texts/arbconc/arbitrul.htm)
5. [english/texts/arbconc/arbitrul.htm](http://www.uncitral.org/texts/arbconc/arbitrul.htm)
6. www.adr.org
7. www.unicitral.org/en-index.htm



Ferdinand ELEZI,
*Prosecutor at the prosecutor's office
 of Appeal Durres. Candidate for PhD*

ASPECTS OF THE EFFECT OF ORGANIZED CRIME ON ECONOMY

The organized crime has always been a disquieting phenomenon which still continues threatening the society and the state. As a social phenomenon with bad consequences in the development of societies and the state, it should be said that this criminal activity has accompanied the the development of modern states' economy and society. The need to combat this phenomenon led to essential legislative provisions not only on national level.

The elements of the organized crime and criminal organizations were ascertained and defined a century ago. Nevertheless, it was difficult to define whether these criminal activities were part of the organized crime, or they were simply criminal elements correlated to such organizations.

Referring to the dispositions of our penal code and penal order concerning the organized crime, the tax avoidance, and the corruption, it is stated that there have been taken into consideration international acts especially, The International Penal Convent. Further, it was enriched with new dispositions stated in the legislation.

The organized criminal activity is specifically exercised by a unit of certain people. It is a permanent unit, with its own determined criminal objectives, and with its own administrative rules set by its leader, and fully accomplished by every member of the criminal organization. In general, these criminal organizations act hierarchically, their discipline is violence and the strict respect for the status of every subject, member of this organization. There is always an individ at the top of the criminal organization who profits the

majority of the income from the criminal activity. It is usually encountered a phenomenon which shows that typical criminal organizations do not get involved in criminal activities with low financial income. These organizations do take control of other smaller criminal activities exercised in their territory. This way they profit from their income but, allowing them to exercise their smaller activities under their protection and local authority in return.

At the beginning of the 90s elements of criminal organizations were found in our country as well. These organizations were mainly parts or segments of the real criminal unities which centres were outside our territory. It is about criminal segments, which were part of the criminal organizations, which arranged the international traffic of drug and weapons. In a short period of time these segments grew into real criminal organizations exercising independantly their activities. These activities were favoured due to the international traffic routes which passed through our territory toward Western Europe. The reaction of the prosecutive entities has been weak until the end of the last century because of already known reasons.

The first reactions of juridical entities dated in the years 1999 – 2000, mainly towards criminal organizations whose activities were evidently agravating the public security, the economy of the countries involved, and lives of many citizens as well. The cooperation with international factors, mainly those of the countries endangered by these activities, increased the pression upon the political factor in our country, imporring the engagement of police unities, secret services, and prosecution entities. This was also accompanied with an improvement of penal legislation and procedures. The lack of these would impede to combat effectively against these criminal activities and also to find the responsible criminals.

The world experience has showed that an important strategy against organized crime is the distraint of the wealth created from the organized crimes, in other words the product and the goal of this criminal activity. Criminal organizations tend not only to provide the financial income, but also to hide and purify it. Thus, they vanish the original sources of their activities by investing the money in legal activities in order to change this criminal product into a legal one.

The detection, identification, prosecution and the confiscation of the wealth, product of a criminal activity, is a crucial strategy against the organized crime. In general, the proces of “the cleaning –up of the money” is directly connected with the activity of criminal organizations which get rid of their income sources by circulating the money in legal enterprises especially in those where the financial control is difficult to trace it back.

The proces of “cleaning-up the money” and the disappearance of the

criminal resources is a serious threat for the whole economy of the world. The movement of such capital assets in many cases caused destability of the economy by weakening the effective capacities of the economy and the state.

At first sight, it seems that the investment of such capitals gives an impulse to the economy of a country but in reality this is a serious threat for the economy. The transfer of capital assets, aimed at destroying their criminal traces, obliges part of the economy to be under the administrative control of the criminal organizations.

The cleaning-up of the money not only allows the criminal organizations to enjoy the products of their activities but also, it helps them to establish a stable basis for the arrangement of further criminal activities in a certain economy or country. This phenomenon effects the economy balance, the requests and offers, it also leads to an informal orientation mainly in sectors such as cassinos, concessions, etc.

The lack of financial control intimidates the trust of the public on the financial system and on the economy. Therefore pure investors are refrained from investing in pure productive activities.

When the criminal organizations accomplish this process successfully, they undertake direct actions to gain financial and economic power, they also invite individuals who do have political power by supporting them especially in those areas where they apply their activities.

Clear indications were the facts brought out by investigations done on these criminal organizations where it resulted that many public and political personalities were implicated, although the penal process for the latest was difficult¹⁾.

One of the most important institutions of our penal procedural right, that helps the process against the organized crime, is that of prosecution anticipated in the acts 208-220 of the Penal Procedural Code, and especially the law nr. 9284, date 30.09.2004 "The prevention and the impingement of the organized crime" which in its concrete field of activity brought important changes concerning the confiscation and sequestration compared to the classical definition anticipated in the above disposites of the Penal Code.

Apart from these changes, the sequestration as a mean to search for proof, even though of its different types, they come to one point, it is a temporary procedure applied to a patrimony, omitting the possibilities of this patrimony to be owned by criminal subjects.

Referring to the albanian penal legislation there are some kinds of sequestration such as : the sequestration as a mean to search for proofs, the

1. Paolo Tonnino "Dirito Processuale Penale " 2008

sequestration as a personal security and the sequestration according to the law nr 9284 date 30.09.2004 “the prevention and the impingement of the organized crime”

- *The sequestration as a mean to search for proofs* is stated in the acts 208 -220 of the Penal Code. In these disposites it is anticipated the object of sequestration, the provided subjects for this action, the rights of the partner in this process, the manner of the sequestrating action, and the administration of the sequestrated things and objects. The sequestration itself means the administration of the things or objects from the procedural unit. They are valuable because they serve as proofs during the penal process. Due to the great importance of sequestration as a mean to search proofs and the limitation of the rights caused to individs, the lawmaker has stated the procedural right of the Prosecutor and the Court to decide the sequestration of a certain thing, object or product.

An exception to the rule is anticipated in the act 299 and 300 of the Penal Code where it is stated the right of the Juridical Police Office to sequestrate objects and correspondence in dangerous cases. In these cases the J.P.Of. is obliged to hand in the sequestrated things and the acts to the prosecutor within 48 hours.

In order to respect the rights of the citizens, the lawmaker has anticipated the right of the person related to the sequestrated object, to complain in the court about the sequestration and the return of the object. This complaint does not suspend the execution of the sequestration. This mean to search proofs can provide explicit or implicit proofs which assert important issues for the penal process. These proofs might assert not only the commital of the penal action and its author, but also information about the mechanism used, the criminal purpose, the criminal product and consequence. *The object* of sequestration might be movable and immovable objects.

According to the material and the penal law, the sequestration objects might be classified as following:

- a) *Objects* which served as a mean to commit the penal action. Such objects maybe appliances for money counterfeit, appliances to produce and mix narcotics, different weapons that criminal organizations use, a ship or other vehicles used for smuggling

- b) *Objects* and monetary income which is a concrete criminal product, these represent in itself the criminal goal of the author in the committal of the criminal action. Such objects and products might be provided from thefts, frauds, robberies, corruption, smuggling etc.

- c) *Objects* and products whose tenancy and alternation constitutes a penal

action. It includes objects produced, preserved and then alternated. This action fully composes a penal action anticipated in the disposites of the Penal Code. Such objects might be narcotics, explosives, weapons, smuggled goods etc.

• *Sequestration as a security norm with patrimonial character*: Sequestrations as proof resources should not be confused with the patrimonial security norm. Conservative sequestration is set by the court upon the suspect's patrimony as a guarantee for the civil duties toward the state, or for the payment of the penal fine and procedural expenditures of the penal proces.

Preventive sequestration is corelated to the object of sequestration, it is set by the court only for the products of the penal action under confiscation effects based on the act 36 of the Penal Code. This security patrimonial norm might be set for objects being sequestrated from the process as a mean to search proofs.

• *Sequestrations based on anticipations of the law nr. 9284 date 30.09.2004 "For the prevention of the organized crime"*. The above treaties of sequestration are part of the penal processes, while sequestrations according to anticipations of this law are specific. This type of sequestration aims at preventing the criminal subects from owning the patrimonies gained from their criminal activities. Therefore, every illegal effort to avoid confiscation is eliminated.

It should be emphasized that even though these sequestrations bring the same effects, they must not be confused with sequestrations of a civil character, because such sequestartions have a penal character and they are explicetly connected with patrimonies as products of penal actions²⁾.

According to the act 13 of this law, it is stated the right of the prosecutor to approach the court to decide the sequestration of a movable or immovable patrimony in the following cases:

- when there are considerable differences between the value of a patrimony and the legal sources of its establishment.
- when there are enough data or founded causes to believe that a certain patrimony is a product or investment of a criminal activity.

According to this law, the subject who urges the court and asks for sequestration is the prosecutor, afterwards the court decides the sequestration based on this law. The court's disposal in these cases is based on the act 13 of this law where it is defined that the court decides the sequestration of patrimony for which there are data stating that such patrimony is under the ownership of the suspect when:

2. Leonardo de Filipi "Il procedimento di prevencione patrimoniale"

1. The value of the patrimony results in levels not corresponding to the declared income or its economic activities.

2. Based on enough data, there are founded possibilities to think that the patrimony is a product of an illegal activity or its investment.

This law is designed and comes in line with Council of Europe Convention on laundering, sequestration and confiscation of the proceeds of crime and terrorist financing “ convention which has been ratified by the Albanian state by Law No.9646 dated 27.11.2006.

The burden of proof in the case of establishing such a sequestration against the patrimony of “*suspects*” belongs according the section 3 of this law to the prosecutor who has to prove that a person under investigation or convicted meets the conditions to be considered as “suspect” to perform criminal acts defined in Article 3 / 1 of this law.

United Colleges of High Court with the decision No.1 dated 25.01.2007 have unified the juridical practice and interpreted in an expand way the provisions of this Law concerning the competence of investigation and trial of the preventive measures to the patrimony, sequestration and confiscation, the phases of these measures, the necessary link between them and where this measures may be made etc.³⁾

United Colleges of High Court have interpreted and unified the juridical practice in this direction by determining the competence only to the Prosecutor at the Prosecutor for Serious Crime and the competence under the provisions of Law No. 9284 dated 30.09.2004 only on the prosecutor at the Prosecutor for Serious Crimes and for the Serious Crimes Court as a court of competent jurisdiction in the trial of these requirements arising from Article 13 of this Law.

As mentioned above one of the goals of organized crime is hiding his resources, criminal products. If the fight against this process will not be completed successfully, the activity of these criminal organizations will be more powerful and organized, because the potential economic and political increasing.

Capital's democracy and affairs that today are considered integral part of societies, economies and modern states bring the phenomenon of organized crime which has an integral part of his criminal activities the violence, corruption, immorality etc ..and in general this reality is derived from the model and liberal-democratic content of the democratic system and market economy that these societies have today.

In these societies and economies that the organized crime, corruption, tax evasion acts, the consequences in the development of these economies are quite heavy.

3. Decision Nr 1 dated 25.01.2007 of the United Colleges of High Court

The impact that this criminal activity closely related with corrupt activities on the economies of developing countries is quite heavy. The realization of benefits from this activity has major negative impact on social and economic development. A society relatively free of criminal activities with an efficient financial and justice system control operating provides a healthy and safe environment for development.

The fight against money laundering strengthens public and private capacities and makes possible the realization of a fair competition based on market economy principles.

Effective mechanisms to fight against money laundering help not only to identify these criminal sources and their sequestration but it also prevents other phenomena detrimental to economies such as tax evasion, imbalance of foreign exchange, inflation, economic informality, etc. ...

The consequences of this activity aren't only of a social and economic character but they also bring direct consequences in the political life of the country. Organized crime infiltration to the financial institutions, can take control of these institutions and different important sectors of the economy. Through investment in public sectors it controls corrupts public officials and individuals with political power. Economic and political influence of criminal organizations can weaken the social structures and institutions of the society. In countries which are in transition and also in development the influence of organized crime is with very serious consequences.

Considering of an great importance the consequences that bring this activity in the Albanian economy and in general to all societies, appreciate that should be made continuous efforts not only to improve the legislation in this regard but also its implementation in practice effectively. The creation of a more complete legal infrastructure for the institutions of audit control, for banking, judicial police, prosecution, court would serve at this purpose.

The establishment of specialized administrative structures which will require taking the necessary information, its selection and processing filing his referral of the prosecution authorities, is considered by me that it would be important stage in this regard. These structures in corporation with the Directory of Fight Against Money Laundering will increase the investigative capacities by referring more fully materials and acts for conducting criminal investigations by the prosecuting authority.

The fight against criminal activity of money laundering by sequestration of these assets itself realized and interrupts effectively the ending goal that leading individuals of organized crime have to dispose and enjoyed these assets. As by my opinion, these would be the strongest blow that can be given to this activity besides penal sanctions already known.

Bibliography

- Constitution of the Republic of Albania - 1998.
- European Convention on Human Rights.
- Penal Code and Penal Procedural Code of Republic of Albania (updated -2009)
- Law No. 9284 dated 30.09.2004 "On Prevention and Suppression of Organized Crime"
- Decision No 1 dated 25.01.2007 unifying the United Colleges of High Court
- Penal Code and Penal Procedural Code of Republic of Italy.
- Summary of international conventions ratified by the Albanian edition of 1996.
- Luigi de Ruggiero, "Issues of proving "L'probatorio incidents"
- Elvio-Fassone, "Three phases of penal proceedings development"
- Paolo Ielo, "Freedom of belief and the truth of the juridical process"
- Paolo Tonnino "Diritto Pocesuale Penale" of 2008.
- Leonardo de Filipi "Il procedimento di prevencione patrimoniale"
- Pina Cusano, Piero Innocenti "Le organizzazioni criminali nel Mondo"

Dr. Gezim SELIMI,

Drejtor i Universitetit Ndërkombëtar, Filiali Gostivar

NDIKIMI I KAPITALIT TË HUAJ NË ZHVILLIMIN E VENDEVE NË ZHVILLIM DHE VENDEVE NË TRANZICION

Hyrje

Lëvizja ndërkombëtare e kapitalit, sot, paraqet formën dominante të marrëdhënieve ekonomike në kuadër të globalizimit të ekonomisë botërore. Eksporti i kapitalit ka arritur përmasa që e kushtëzojnë jo vetëm zhvillimin e regjioneve dhe vendeve të veçanta, por edhe në reproduksionin e ekonomisë botërore.

Për shumë vende të botës e në kuadër të tyre edhe për Republikën e Maqedonisë, shfrytëzimi i kapitalit të huaj është e një rëndësie të veçantë për zhvillimin e ekonomisë kombëtare. Vendet në zhvillim me shfrytëzimin e kapitalit të huaj e risin akumulimin dhe shkallën e investimit që paraqet bazën kryesore për tejkalimin nga një vend në zhvillim në vend i zhvilluar. Për vendet në tranzicion, kapitali i huaj është i domosdoshëm për realizimin e suksesshëm të reformave dhe kalim në ekonomi të hapur, për tejkalimin e problemeve shumëvjeçare dhe për krijimin e kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm ekonomik.

Praktika na ka treguar se shfrytëzimi i kapitalit të huaj duhet të realizohet në bazë të programeve dhe në funksion të përmbajtjes, para së gjithash të eksportit. Në të kundërt, po qe se vjen deri tek mosmundja e kthimit të detyrimeve të kredive dhe huave të huaja, ajo mund të ndikojë në kufizimin e lëvizjes së kapitalit të huaj në ekonominë e një shteti.

Republika e Maqedonisë, si një shtet i vogël dhe me mundësi të vogla për të krijimin e mjeteve të mjaftueshme për investime, natyrisht që është

e orientuar kah shfrytëzimit të kapitalit të huaj. Shfrytëzimi i akumulimit plotësues është me rëndësi për përkrahjen bilancit të pagesave dhe reformave e veçanërisht në krijimin e kushteve për zhvillim dhe rritje të vazhdueshme ekonomike.

Shfrytëzimi i kapitalit të huaj duhet të jetë në sasi dhe strukturë që të japë rezultate optimale në procesin e tranzicionit dhe në krijimin e një zhvillimi permanent të BPB.

I. KUPTIMI MBI KAPITALIN E HUAJ

I.1 Mendimi ekonomik për kapitalin e huaj

Me zhvillimin e ekonomisë në shtetet kapitaliste u përhap dhe u zhvillua këmbimi i jashtëm tregtar në nivel botëror dhe u rrit eksporti i kapitalit, para së gjithash tek vendet në zhvillim. Me eksportin e mallrave realizohet prodhimtaria e rritur, ndërsa me eksportin e kapitalit realizohet shkalla më e lartë e fitimit dhe realizohen edhe qëllime tjera.

Vendet e pazhvilluara, me importin e kapitalit e risin akumulimin dhe shkallën e investimeve, çka nënkupton bazën themelore për tejkalimin e shkallën së pamjaftueshme të zhvillimit ekonomik, ku zakonisht dominojnë bujqësia dhe zejtaria dhe në disa vende edhe industria primare e prodhimtarisë. Zhvillimi i vendeve në zhvillim njëkohësisht jep impuls në aktivitetin ekonomik të vendeve të zhvilluara. Prej këtij rrjedh edhe interesi i përbashkët për eksport, respektivisht import të kapitalit.

Në shek. XX është bërë rritje intensive e eksportit të kapitalit ndërkombëtar. Ai realizohet me ndryshime të rëndësishme strukturore nga format kredituese në forma jokredituese dhe në qasje rajonale.

Eksporti i kapitalit sot ka arritur nivel të lartë dhe ka ndikim të madh në zhvillimin jo vetëm të disa vendeve të veçanta në botë, por edhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik botëror. Prej këtij rrjedh rëndësia dhe interesi për eksportin respektivisht importin e kapitalit në të gjitha vendet e botës, pavarësisht a janë në zhvillim apo të zhvilluara.

Kapitali ndikon në zhvillimin e forcave prodhuese, shfrytëzimin më të madh të stokeve ekzistuese, prodhimtarinë e furnizon me pajisje më moderne, e vendos shkencën dhe arsimin në funksion të prodhimit. Kapitali i huaj, që paraqet plotësim i kursimit vetanak, kontribuon në ndikimin më intensiv të zhvillimit. Kapitali i huaj është i nevojshëm për realizimin e reformave, për ristrukturimin e ekonomisë e veçanërisht për dinamizmin e eksportit dhe për rritjen e nivelit tekniko-teknologjik të procesit prodhues.

Për shkak të arsyeve të lartpërmendura vendet në zhvillim kanë nevojë për shfrytëzimin e kapitalit të huaj. Kapitali i huaj realizohet me ndryshime

të rëndësishme strukturore, me rritjen e investimeve të drejtpërdrejta, investimet portfolio, thithja e mjeteve në bazë të koncesioneve dhe forma tjera jokredituese. Këto forma të kapitalit të huaj janë tepër të rëndësishme për vendet në zhvillim, duke e pasur parasysh nivelin e lartë të kredive të marra dhe problemeve rreth servisimit të borxhit të jashtëm si dhe nevojën për një bashkëpunim më të madh me partnerët e huaj.

Në vendet ku është prezent në masë më të madhe kapitali i huaj janë realizuar rezultate më të mira në zhvillimin ekonomik dhe e kundërta. Shfrytëzimi i këtij kapitali duhet të jetë racional për shkak se, në të kundërtën, efektet mund të jenë kontraproduktive.

Nevoja për shfrytëzimin racional të kapitalit të huaj ka të bëjë edhe me atë pjesë të kapitalit i cili formohet në bazë të formave jokredituese (investime të huaja të drejtpërdrejta IDH, Investimet e huaj portfolio IDH etj.). Ai, para së gjithash, duhet të orientohet kah përkrahja e qëllimeve parësore të ekonomisë kombëtare dhe për rritjen e eksportit.

Kapitali i huaj realisht duhet të ketë karakter të akumulimit plotësues e jo zëvendësimi i saj dhe me rritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik duhet të rritet edhe shkalla e akumulimit të brendshëm. Për shkak të ndikimit pozitiv në zhvillimin ekonomik, vende të ndryshme mundohen të sigurojnë kushte sa më të volitshme për thithjen e kapitalit të huaj. Në kuadër të këtyre me masat e politikës ekonomike dhe nga lëme të tjera parashikohen lehtësi të ndryshme, bëhen promocione të potencialit të ekonomisë dhe realizohen aktivitete të tjera. Kjo tregon se tek këto vende shfrytëzimi i kapitalit të huaj realizohet në bazë të qëllimeve programore në funksion të zhvillimit ekonomik.

Me rëndësi të veçantë është të shikohen motivet, format e thithjes së kapitalit dhe efektet e tyre në degë të ndryshme të ekonomisë dhe në tërë ekonominë. Gjatë kësaj, me rëndësi të veçantë është të analizohet përvoja e vendeve dhe regjioneve të veçanta, për shkak se ajo paraqet komponentë të rëndësishëm në ndërtimin e një konceptit më efikas në thithjen e kapitalit të huaj.

1.2. Motivet për eksportin e kapitalit

Në mendimin ekonomik dominon mendimi se motivi themelor për eksportin e kapitalit është realizimi i profitit më të lartë. Edhe pse gjatë etapave të ndryshme të zhvillimit të mendimit ekonomik ky motiv ka pësuar modifikime të ndryshme, ai është prezent që nga tendencat e para të eksportit të kapitalit e deri në ditët e sotme.

Adam Smiti dhe David Rikardoja lëvizjen e kapitalit prej një vendi në tjetrin e lidhin me lartësinë e shkallës së profitit. Sipas tyre shkalla e profitit të kapitalit është më e lartë në vendet që kanë në masë të madhe resurse natyrore dhe fuqi të lirë punëtore, prandaj edhe kapitali shpërngulet tek këto vende.

Karl Marksi ka vërtetuar se qëllimi i prodhimit kapitalist është shtimi i vlerës së kapitalit respektivisht në përfitimin e profitit. Po qe se vjen deri në hiperprodukcion të kapitalit vjen deri në uljen e shkallës së profitit. Në kushte të këtilla një pjesë e kapitalit ngelet e pashfrytëzuar, ndërsa pjesa tjetër do të ketë një shkallë më të ulët të profitit. Në raste të tilla kapitali shpërngulet (shtegton) në ekonominë ku profiti është më i lartë. Andaj edhe kapitali ka filluar të shpërngulet tek vendet në zhvillim. Gjithashtu, edhe Lenini thanë se maksimizimi i profitit është motivi kryesor për eksportin e kapitalit.

Në mendimin bashkëkohor ekonomik dominon mendimi se profiti nuk është faktori themelor dhe kryesor në eksportin e kapitalit. Sipas tyre rëndësi të madhe kanë: sigurimi i prodhimit dhe përpunimi i lëndëve të para, ndarja monopoliste e pjesëve të veçanta të botës, interesave politike, lajmërimi i shteteve si eksportues të kapitalit, decentralizimi i rrezikut respektivisht shpërndarja e investimeve nëpër shtete¹⁾.

Sipas disa mendimeve, shkaktar kryesor për eksportin e kapitalit ishte procesi i akumulimit të madh të kapitalit, me formimin e monopoleve kapitaliste, e cila eliminon çfarëdo konkurrence të brendshme. Sipas biznesmenëve gjermanë, të cilët i ka elaboruar Lidhja e industrisë gjermane, jepet rangimi i motivit për IDh-të²⁾:

1. Zhvillimi i tregjeve të reja; sigurimi i tregjeve ekzistuese; rritja dhe potenciali i tregjeve të huaja; dhënia e shërbimeve; përgatitja për tregun e vetëm evropian; shpenzimet e ulta të punës; përparësia e vendit nikoqir si bazë për eksport; tatime të ulta; reaksion të barrierave importuese; shkallë më e lartë e profitit; zvogëlimi i rrezikut nga kursi devizor; furnizimet lokale; pengesa më të vogla administrative; qasje tek furnizimet qeveritare; produktivitet më i lartë; nxitja e investimeve; mundësi më të mira për kërkim dhe zhvillim; infrastrukturë më e mirë; dhe kualifikim më i mirë i punës.

Në përgjithësi, kur flitet për motivet e lëvizjes së kapitalit, kryesisht ekzistojnë dy motive: maksimizimi i fitimit dhe siguria në investim.

1.3. Llojet e kapitalit të huaj

Kapitali i huaj plasohet në më shumë lloje, respektivisht forma. Kapitali në marrëdhëniet ndërkombëtare ekonomike lajmërohet në këto forma: hua ose kredi, kapital investiv (prodhues), kapital në formë të ndihmës dhe forma tjera. Në jetën praktike këto lloje të kapitalit janë në varshmëri njëra me tjetrën dhe nuk ekziston një kufi i saktë në mes tyre.

Kapitali që realizohet me formë të kredive dhe huave, në shumë raste është i

1. Lubisha Adamoviq, Teorija megjunarodne trgovine, Savremena administracija, Beograd, 1989, faq.144 dhe 145.

2. Antonija Nikiforovska, SDI vo Makedonija, Ekonomski institute, Shkup, 1997, faq. 60 dhe 61.

lidhur me eksportin e pajimeve dhe mallrave të tjera, me çka janë prezentë edhe elemente të kapitalit prodhues. Edhe e kundërta, eksporti i kapitalit prodhues mund të shoqërohet me kapital kreditues respektivisht kapital hua.

Karakteristikë themelore e kapitalit kreditues dhe kapitalit hua është se ai kthehet me anë të mjeteve devizore, sipas planit amortizues. Për këtë kapital, zakonisht kërkohet garanci nga shteti apo nga ndonjë bankë. Ky lloj i kapitalit duhet të përdoret me shumë kujdes në funksion të zhvillimit të eksportit, me qëllim që të mos vijë në pyetje pagesa e saj.

Kapitali prodhues krijohet nëpërmjet investimeve të drejtpërdrejta, investimeve portfolio dhe formave tjera të bashkëpunimit me firmat e jashtme.

Në fillim lëvizja e kapitalit është kryer nëpërmjet kredive dhe huave. Më vonë ka dominuar kapitali prodhues, i cili ka mundur bashkëpunim më të madh në mes firmave të vendit dhe të huaja. Ky lloj i kapitalit të huaj është më i përshtatshëm për shumë vende të botës, veçanërisht për ato shtete që kanë një shkallë të lartë të kreditimit.

Në literaturën ekonomike, në lidhje me format e kapitalit të huaj dhe përfaqësimit të tyre, theksohet:

-Deri në Luftën e Parë Botërore ishte i përfaqësuar eksporti i kapitalit në formën e kredisë dhe kapitali prodhues;

-Pas Luftës së Dytë Botërore dominonte kapitali kreditues, ndërsa pas viteve gjashtëdhjetë gjithnjë e më shumë dominonte kapitali prodhues, i cili plasoheshte nëpërmjet IDH dhe formave tjera;

Në dekadën e fundit të shekullit njëzet dominonte kapitali prodhues nëpërmjet IDH, IP dhe formave tjera jokredituese.

1.4. Ndikimi i kapitalit të huaj mbi zhvillimin ekonomik

Kapitali i huaj ka ndikim të rëndësishëm mbi zhvillimin ekonomik të vendit mikpritës. Me shfrytëzimin e këtij kapitali rritet akumulimi plotësues, që ndikon në rritjen e prodhimit material dhe shërbimeve.

Me kapitalin e huaj krijohet mundësia e importit të pajimeve me çka ritet niveli tekniko-teknologjik i procesit prodhues. Në bazë të kësaj mundësohet eksploatimi dhe përpunimi i lëndëve të para dhe eksport të mallrave me faza më të larta të përpunimit.

Me kapitalin e huaj mundësohet ndërtimi i infrastrukturës ekonomike dhe lidhja rrugore e vendit me pjesën tjetër të botës me çka krijohen kushtet për rritjen e eksportit.

Kapitali i huaj, po qe se shfrytëzohet si kredi, e detyron vendin të orientohet kah rritja e eksportit, për shkak se detyrimet duhet të shlyhen me mjete devizore. Në zhvillimin e vendit janë prezent kushtet konkurruese të tregut botëror.

Nëse kemi investime të drejtpërdrejta, atëherë krijohen kushte për vendosjen e teknologjisë bashkëkohore në procesin e prodhimit, përmirësohet menaxhimi i burimeve njerëzore dhe subjektit ekonomik, me çka rritet efikasiteti ekonomik. Edhe investimet portfolio në mënyrë pozitive ndikojnë mbi aktivitetin ekonomik në vendin ku investohen.

Kapitali i huaj ka ndikim pozitiv edhe tek vendet në tranzicion, pasi ndihmon në zbatimin e reformave të nevojshme. Kapitali i huaj po ashtu ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendeve të zhvilluara. Mundëson integrim më të madh të vendit në ekonominë botërore, ngrihet niveli tekniko teknologjik i procesit prodhues, rritet eksporti dhe realizohet një aktivitet ekonomik më intensiv.

II. TRENDI I LËVIZJES SË KAPITALIT TË HUAJ DHE EFEKTI MBI EKONOMINË KOMBËTARE

II.1. Pasqyra globale e lëvizjes së kapitalit të huaj

Lëvizja e kapitalit të huaj ka ndikim dhe rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik botëror. Kjo rëndësi e kapitalit të huaj me intensitet më të lartë lajmërohet edhe në proceset bashkëkohore të globalizimit të ekonomisë botërore. Prej këtui, rrjedh edhe rëndësia e madhe e kapitalit jo vetëm për ekonominë ndërkombëtare, por edhe për prosperitetin e ekonomisë botërore në përgjithësi. Deri në Luftën e Parë Botërore ka dominuar eksporti i kapitalit në formën e kredisë (kapitali hua), ndërsa vetëm një pjesë e vogël e kapitalit është realizuar në bazë të IHD-ve.

Vetëm disa vite para Luftës së Parë Botërore kapitali eksportues nga vendet e zhvilluara ka qenë i vlerësuar në 44 miliardë dollarë. Eksportues më i madh i kapitalit ka qenë Anglia, pastaj Franca dhe Gjermania. Këto shtete kanë përfshirë tre të katërtat nga totali i kapitalit të eksportuar.

Pas Luftës së Parë Botërore bartës themelor të kapitalit të huaj bëhen SHBA-të. Në këto vite, për shkak të situatës ekonomike, Anglia dhe Franca në masë të madhe e kanë zvogëluar eksportin e kapitalit, ndërsa për dallim nga këto shtete SHBA-të, si pasojë e zhvillimit të forcës ekonomike, janë bërë kreditorët kryesorë të kapitalit të huaj. Këtë pozitë dominuese SHBA-të e kanë mbajtur deri në vitin 1929, pra, deri tek kriza e madhe botërore.

Pas krizës së madhe botërore Anglia përsëri bëhet eksportues dominant i kapitalit i investuar në formën prodhuese. Në këtë periudhë, si eksportues të ri lajmërohen Japonia dhe Italia. Ky kapitali në masë më të madhe është investuar tek vendet në zhvillim.

Sipas disa përlllogaritjeve në vitin 1938 eksporti i tërësishëm i kapitalit ka qenë në vlerë prej 53 miliardë dollarë, ndërsa 80% nga kjo vlerë ka qenë

investuar në shtetet e pazhvilluara, ndërsa 20% kanë qenë të investuara në Europë edhe atë tek vendet më pak të zhvilluara.

Deri në LDB ka dominuar kapitali hua dhe ai kreditues përballë IHD-ve si dhe kanë qenë të orientuara kah vendet në zhvillim. Kapitali i huaj deri në LDB në pjesën më të madhe ka rrjedhur nga burimet private.

Në vitet e para pas LDB, në strukturën e kapitalit të huaj dominonin krediti dhe huatë publike. Në vitet shtatëdhjetë erdhi deri në rritje të rëndësishme të kapitalit privat, para së gjithash të IHD-ve, ku bartës kanë qenë kompanitë multinacionale (KMN). Eksporti i kapitalit nga vitet 1950 deri në vitet 1980 është rritur dhjetë herë, respektivisht ka arritur vlerën e 500 miliardë dollarëve.

Në vitet tetëdhjetë, nga totali i IHD-ve 30% janë investuar në vendet në zhvillim, ndërsa pjesa tjetër tek vendet e zhvilluara. Andaj mund të konstatohet se deri në LDB vendet e zhvilluara ishin eksportues të kapitalit, ndërsa ato në zhvillim ishin importues të kapitalit, pastaj vendet e zhvilluara u bënë edhe eksportues të kapitalit dhe njëherë edhe importues më të madhej të kapitalit të huaj.

II.2. Efektet globale nga kapitali i huaj mbi zhvillimin ekonomik

Kapitali i huaj në formë të huasë ka pasur efekt mbi zhvillimin e ekonomive të vendeve në zhvillim dhe atyre të zhvilluara. Ky kapital tek vendet në zhvillim është investuar në ndërtimin e infrastrukturës ekonomike dhe eksploatimin e prodhimitarisë primare. Me këtë kapital të huaj janë krijuar kushte për ndërtimin e rrugëve, hekurudhave, limaneve, eksploatimi i pasurive nëntokësore dhe prodhimeve primare bujqësore. Ky aktivitet inovativ tek vendet në zhvillim ka krijuar bazën nxitëse për zhvillimin e ekonomisë dhe kyçje në ndarjen ndërkombëtare të punës.

Pjesë e kapitalit të huaj ka qenë i investuar edhe në degët tjera ekonomike, para së gjithash në tregti dhe në banka. Deri në LPB vlerësohet se kapitali i huaj ka pasur ndikim më të madh në zhvillimin e vendeve eksportuese. Ai ka mundësuar realizimin e profiteve të mëdha, që njëherazi është qëllimi kryesor i eksportit të kapitalit. Dihet se eksporti i kapitalit te vendet në zhvillim nuk bëhet me qëllim të zhvillimit të ekonomisë së tyre, por për shtimin e kapitalit.

Pas LPB, kapitali i huaj është realizuar me një dinamikë më të ngadalësuar, ndërsa në vendet në zhvillim me një vëllim më të vogël. Kjo për arsye se SHBA-të, të cilat kanë qenë donatorë kryesorë, nuk kanë pasur nevojë nga importi i prodhimeve primare nga vendet me ekonomi të pazhvilluar, me çka është ngushtuar mundësia e eksportit nga këto vende. Në kushte të këtilla, vendet në zhvillim nuk kanë mundur t'i shlyejnë detyrimet ndaj kreditorëve, dhe ka ndikuar në rrjedhjen e kapitalit nga këto vende.

Kapitali i huaj rëndësi të veçantë ka pasur në zhvillimin e vendeve në zhvillim pas LDB. Ai veçanërisht pas viteve gjashtëdhjetë ka pasur një rritje intensive, me shfrytëzimin e kredive dhe huave, ndërsa më vonë me IDH, dhe kontribuonte në ndryshimin e strukturës prodhuese dhe në zhvillimin më të shpejtë të vendeve në zhvillim.

III. LËVIZJA DHE NDIKIMI I KAPITALIT TË HUAJ NË ZHVILLIMIN E VENDEVE NË ZHVILLIM DHE VENDEVE NË TRANZICION

Vendet në zhvillim në decenien e fundit me një dinamikë më të lartë u kyçën në globalizimin e ekonomisë botërore. Kyçja në ekonominë botërore këtyre vendeve u mundëson parakushtet për rritje dhe prosperitet të ekonomive kombëtare, për të cilën gjë u mungojnë mjete vendore për investime, për shkak të nivelit të ulët të akumulimit dhe mundësisë për kursim.

Kapitali i huaj tek vendet në zhvillim realizohet me: shfrytëzimin e kredive dhe huave afatmesme dhe afatgjatë, investimeve të drejtpërdrejta, investime në bazë të portfolio investimeve, bashkëpunimi dhe kooperimi prodhues-teknologjik, si dhe në forma tjera. Kreditë dhe huatë afatmesme dhe afatgjata janë nga kreditorë oficialë dhe kreditorë privatë, ndërsa investimet e huaja drejtpërdrejta janë nga KMN të mëdha dhe në një vëllim më të vogël nga firmat tjera private dhe personat fizikë.

Investimet portfolio janë prezentë si tek vendet në zhvillim, ashtu edhe tek ato në tranzicion. Me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore apo shtetërore dhe nevoja për kapital plotësues për ristrukturimin e firmave është gjithnjë më e madhe nevoja për thithjen e kapitalit në bazë të investimit portfolio.

III.1. Shfrytëzimi i kredive të huaja

Në dy dekadat e fundit vendet në zhvillim kanë realizuar rritje të lartë në shfrytëzimin e kredive dhe huave afatgjate dhe afatmesme. Nga kjo, vërehet se kjo rritje kryesisht realizohet me shfrytëzimin e kredive nga kreditorët privatë, si nga ato që janë të garantuara, ashtu edhe nga ato të pagarantuara.

Sipas Raportit të vitit 2010 të Bankës Botërore, vendet në zhvillim në vitin 2008 kanë shfrytëzuar kredi dhe hua afatgjata në vlerë prej 1.366 miliardë dollarë amerikanë, që paraqet një dallim prej afër 1.9 herë në krahasim prej vitit 1990. Në decenien e tetë të shekullit njëzet kjo rritje mesatarisht ka qenë 15% për shkak të problemit me krizën e kredive.

Tabela nr. 1
Flukset zyrtare financiare nga burimet dypalëshe dhe shumëpalëshe tek vendet në
zhvillim nga viti 1990-2008

-në miliarda dollarë

Vitet –llojet	gjithsej donator	donator bilateral	donator multilateral
1990	734.9	368.6	125.7
1995	679.7	385.5	164.0
2000	482.7	333.1	111.6
2008	1.366.8	826.0	309.9

Burimi: www.unctad.org. /World Investment Report 2009

Nga kjo shumë e kredive donatorët bilateralë në vitin 2008 kanë dhënë kredi në vlerë prej 826 miliardë dollarë amerikanë, që paraqet një diferencë prej 458 miliardë dollarëve në krahasim me vitin 1990. Ndërsa donatorë multilateralë në vitin 2008 kanë dhënë kredi në vlerë prej 309.9 miliardë dollarësh, që është një rritje prej 184.1 miliardë dollarë në krahasim me vitin 2008.

III.2. Investimet e drejtpërdrejta të huaja

Në globalizimin e ekonomisë botërore përveç ndërkombëtarizimit të rrjedhës të produkteve dhe shërbimeve, dijes, teknologjisë dhe formave tjera të bashkëpunimit me partnerët e huaj, pa dyshim, ndikim më të madh kanë IDH. Këto IDH me karakteristikat dhe efektet e tyre kanë ndikim të rëndësishëm, e cila rrjedh nga lidhshmëria reciproke dhe determinizmit të globalizmit në ekonomin botërore.

Në dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XX dhe dekadën e parë të shek. XXI u krijuan kushte për ekspansionin e investimeve të huaja. Në këtë ndikonte liberalizimi që ndodhi në marrëdhëniet tregtare multilaterale, kyçja e shteteve në tranzicion në globalizimin e ekonomisë botërore, në procesin tekniko-teknologjik në të gjitha fushat e aktivitetit ekonomik e veçanërisht në telekomunikacion dhe transport. E gjitha kjo krijoi kushte të volitshme për një interesim më të madh, veçanërisht të kompanive multinacionale për IDH në më shumë vende. Qëllimi i IDH-ve është ta përcaktojnë strukturën prodhuese në korniza globale dhe ta risin profitin e tyre.

Në periudhën e kaluar në botë IDH-të patën një dinamikë intensive. Sasia e investimeve të huaja vazhdimisht ka rritje, duke e shikuar nëpër vite dhe në vitin 2008 arriti në 587 miliard dollarë.

Tabela nr. 2.

Flukset hyrëse e IDH-ve

-në miliarda dollarë

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
BOTA	1.410	832	618	558	711	916	1.416	1.979	1.697
Vend.e zhvilluara	1.134	559	441	359	396	542	973	1.359	962
Vend.në zhvillim	267	221	164	175	275	334	434	529	621

Burimi: Unctad, World Investment Report 2009, New York, fq. 251

Nga tabela e lartshënuar shihet se në vitin 2008 flukset hyrëse të IDH-ve janë 1697 miliardë dollarë amerikanë. Kjo vlerë është më e ulët se ajo e vitit 2007 për 282 miliardë \$, por njëherazi duhet theksuar se në vitin 2007 është arritur vlera më e lartë e IDH-ve në nivel botëror. Këtu duhet theksuar se nga viti 2000 kur IDH-të kishin vlerën 1.410 miliardë \$, në vitet në vazhdim 2001, 2002 dhe 2003 pati rrënie të vazhdueshme të IDH-ve deri në vlerën 558 miliardë dollarë.

Po ashtu, nga tabela shihet se pjesa më e madhe e IDH-ve është bërë tek shtetet e zhvilluara, ku tendencat rrjedhëse janë identike si ato në nivel botëror. Ky konstatim vlen po ashtu edhe ndaj vendeve në zhvillim.

Këtu po ashtu duhet theksuar se IDH-të në vitet e fundit është inkurajuese dhe pjesëmarrja e tyre në strukturën e përgjithshme të eksportit të IDH-ve shënon trend pozitiv. Në tabelën nr. 3 do ta pasqyrojmë këtë trend pozitiv të IDH-ve në vendet në zhvillim.

Tabela nr. 3. Flukset hyrëse e IDH-ve sipas përqindjes

vendi-viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
V.e zhvilluara	80.4	72.0	71.4	64.3	55.7	59.2	66.6	68.7	56.7
V. në zhvillim	19.6	28.0	28.6	35.7	44.3	40.8	33.4	31.3	43.3

Burimi: Unctad, World Investment Report 2009, New York, fq. 251

Konstatimi se IDH-të më tepër investohen tek vendet e zhvilluara se tek ato në zhvillim, mundë të shikohet qartë edhe në tabelën e lartshënuar, ku përqindja e IDH-ve në vendet e zhvilluara në mënyrë konstante është mbi 50% . Dallimi më i lartë i IDH-ve të investuara në mes vendeve të zhvilluara dha atyre në zhvillim është në vitin 2000, ku përqindja është 80.4% në favor të vendeve të zhvilluara, ndërsa tek vendet në zhvillim IDH-të janë 19.6%. Nga ana tjetër dallimi më i vogël në mes këtyre vendeve është në vitin 2004, ku në vendet e zhvilluara janë investuar 55.7% ndërsa në vendet në zhvillim janë investuar 44.3%.

Bartës të IDH-ve janë kompanitë e mëdha multinacionale në botë. Këto kompani gjatë dy decenieve të fundit gjetën ambient të favorshëm dhe kushte të mira në një numër të madh vendesh për investimin e mjeteve, në përputhshmëri me programet e zhvillimit dhe tentimit për përfitime maksimale. Në përgjithësi ekzistojnë tre faktorë të përgjithshëm që përcaktojnë vendin se

ku do të investojnë kompanitë: politika e vendit nikoqir, masat proaktive që i merr vendi për promovimin dhe lehtësimin e investimeve, dhe karakteristikat e ekonomisë së atij vendi.

Kompanitë multinacionale, investimet e tyre, i bëjnë përveç faktorëve tradicional (klima e volitshme për investim, mundësia për shfrytëzimin e burimeve natyrore, fuqia e lirë e punës, qasje në tregje) edhe për shkak të faktorit njeri siç janë: zhvillimi teknologjik e deri tek shkathtësitë dhe kualitetet e ndryshme të fuqisë punëtore.


III.3. Portfolio investimet

Në lëvizjen ndërkombëtare të kapitalit, gjithnjë e më shumë vend të rëndësishëm kanë portfolio investimet. Këto investime për qëllim kanë shtimin e kapitalit me një përqindje më të lartë të profitit. Ky lloj i kapitalit realizohet me blerjen e aksioneve në tregun financiar. Një rritje të konsiderueshme të këtyre investimeve ka veçanërisht në deceniet e fundit edhe atë tek vendet në zhvillim dhe tek vendet në tranzicion. Në periudhën deri në vitin 1990 investimet portfolio nuk ishin prezent tek vendet në zhvillim. Pastaj në këtë dekenie ato i rritën nga 3.2 miliardë dollar sa ishin në 1990, në 45.8 miliardë dollarë në 1996, respektivisht në 32.5 miliardë dollarë në vitin 1997. Zvogëlimi i portfolio investimeve në vitin 1997 është pasojë e krizës financiare që i përfshiu vendet e Lindjes së Lartë, dhe u zgjerua në vendet tjera të botës.

Neto portfolio investimet në vendet në zhvillim nga Europa dhe Azia qendrore në vitin 1990 ishte 0.2 miliardë dollarë ndërsa në vitin 1996 u rritën në 8.7 respektivisht në 8.9 miliardë dollarë në vitin 1997.⁴⁾

Karakteristikë për portfolio investimet është ndjeshmëria e madhe e tyre ndaj kushteve të përgjithshme të ekonomizimit në vende të veçanta. Andaj ato zhvillohen me oscilime më të mëdha, shikuar në më shumë vende të botës që një herit mundë të vërehet në grafikun nr. 1.

Grafiku nr.1 Flukset e investimeve portfolio nga 2005-2009 (në miliarda dollarë)



Burimi: World Bank, Global Economic Prospects 2010.

4. The World Bank, Global Development Finance 1998, Washington, p.161 dhe 164.

Siç shikohet nga grafiku oscilimi i investimeve portfolio rritje më të madhe kanë në vitin 2007, por në vitin pasardhës, dmth. në vitin 2008 ka një ulje shumë të madhe e cila arin vetëm në 53 miliardë dollarë.

Portfolio investimet në vendet në zhvillim dhe në tranzicion kryesisht janë të destinuara kah industria, respektivisht në ato degë dhe firma të industrisë që janë të orientuara kah eksporti dhe realizojnë rezultat pozitiv financiar. Vetëm një pjesë e vogël e këtyre mjeteve janë të investuara në veprimtari tjera ekonomike.

Portfolio investimet tek vendet në tranzicion paraqesin faktor i rëndësishëm për thithjen e kapitalit dhe në bazë të sajë ndikon në ritjen e investimeve dhe përkrahjen e zhvillimit. Me këtë lloj të kapitalit të huaj, njëlloj si edhe me IDH-ve, nuk rriten borxhi i vendit nikoqir, që paraqet dimension pozitiv për shfrytëzimin e kapitalit të huaj plotësues.

III.4. Lloje tjera të kapitalit të huaj

Vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion realizojnë thithje të kapitalit edhe me emetimin e fletëobligacioneve, aksioneve dhe letrave me vlerë. Me përmirësimin e performancave ekonomike të vendeve në zhvillim dhe atyre në tranzicion, krijohen kushte për pjesëmarrjen e tyre në tregun financiar ndërkombëtar me emetimin e letrave me vlerë, me qëllim të sigurimit të kapitalit për qëllime të caktuar.

Këto vende në vitet e fundit kanë marrë një sasi të konsiderueshme të kapitalit në formë të ndihmave. Kjo ndihmë realizohet në formë të mallrave, mjeteve devizore, ndihmës teknike etj. Kjo ndihmë ka rëndësi të madhe, pasi këto mjete nuk kthehen.

III.5. Ndikimi i kapitalit të huaj në zhvillimin e vendeve në zhvillim dhe të vendeve në tranzicion

Thithja e kapitalit të huaj tek këto vende ka pasur një ndikim të madh në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të tyre. Me akumulimin plotësues nga jashtë, mundësohet një shkallë më e madhe e investimit nga ajo që mundëson kursimi i brendshëm, realizimi i importit më të madh në funksion të rritjes së nivelit tekniko teknologjik të proceseve prodhuese, realizimit të rritjes së PBB tek vendet në zhvillim. Është dinamizuar eksporti i mallrave dhe janë krijuar kushte për kyçe më të suksesshme të këtyre vendeve në rrjedhat e globalizimit të ekonomisë botërore.

Këto vende në zhvillim dhe në tranzicion me shfrytëzimin e akumulimit plotësues të jashtëm, realizojnë një shkallë të lartë të investimit, që ndikon në ristrukturimin dhe zgjerimin e bazës materiale të ekonomisë.

Gjatë dekadave të fundit vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion me

shfrytëzimin e kapitalit të huaj realizuan një rritje të caktuar të importit të mallrave dhe shërbimeve në funksion të ristrukturimit dhe rritjen e prodhimit dhe eksportit.

Tabela nr.4. % e eksporti dhe importi i mallrave dhe shërbimeve 1980-2009

	1980	1985	1990	1995	2000	2004	2005	2006	2007	2008	2009
vendet në zhvillim	29.4	24.5	24.3	27.7	31.9	33.8	36.2	37.4	37.8	39.0	39.5
vendet në tranzicion	4.2	4.2	3.4	2.3	2.4	3.0	3.4	3.7	3.9	4.6	3.8
vendet e zhvilluara	66.3	69.6	72.2	69.9	65.7	63.2	60.4	58.9	58.3	56.4	56.7

Burimi: www.unctad.org.raport 2010.

Duke e vëzhguar tabelën e lartshënuar lehtë vërehet se vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion kanë një rritje të vazhdueshme të % së eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve. Këtu duhet theksuar se deficitit buxhetor financohet duke shfrytëzuar kapitalin e huaj.

Në dy deceniet e fundit rritja e PPB realizohet në të gjitha vendet, si ato të zhvilluara, në zhvillim edhe tek ato në tranzicion. Ky trend ndryshon vetëm në vitin 2009, ku PPB pati zvogëlim në nivel botëror, ku PPB pati rënie (-1.9%) respektivisht (-6.5% dhe -3.5%) për vendet në tranzicion dhe vendet e zhvilluara. Rritje pozitive të PBB në vitin 2009 patën vetëm vendet në zhvillim prej 2.5%. ⁵⁾

Kapitali i huaj në vendet në zhvillim, përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, kontribuon edhe në mobilizimin më të madh të akumulimit vendor dhe në shfrytëzimin e potencialeve ekzistuese.

Kapitali i huaj ndikon në rritjen e PBB, bën ristrukturimin e ekonomisë, ndikon në investime, si dhe rrit procesin tekniko-teknologjik të prodhimit, e balancon bilancin e pagesave dhe e nxit kyçje në ekonominë globale.

Përveç anëve të theksuara pozitive, shfrytëzimi i kapitalit të huaj ka edhe efektet e saj negative, të cilat me një punë mirë të koordinuar dhe të kujdesshme mund të eliminohen ose së paku të minimizohen. Kjo, para së gjithash ka të bëjë me strukturën e ekonomisë për shkak se kapitali i huaj, duke u nisur nga dëshira sa më e madhe për profit, mund ta prishë strukturën ekonomike të vendit nikoqir (zhvillimi i tregtisë, banka, produkte monokulturore eksportuese, eksploatimi i pasurive minerale etj.).

Kthimi i borxhit të huaj nënkupton nxjerrjen e mjeteve devizore nga vendi nikoqir i kapitalit dhe zvogëlimi i akumulimit që e nxit zhvillimin. Ky problem është tepër i rëndësishëm, veçanërisht tek ato vende që nuk disponojnë me mjete të mjaftueshme devizore.

5. www.unctad.org.raport2010

PËRFUNDIM

Globalizmi si proces botëror mbështetet në ekonominë e tregut të lirë, zhvillimin dhe liberalizimin e tregut të huaj ndërkombëtar, rritjen e kapitalit të huaj, IDH, investimeve portfolio, rritjen e nivelit në procesin prodhues nëpërmjet aplikimit të proceseve tekniko-teknologjike, lëvizjes së lirë të fuqisë punëtore, ngritjes së cilësisë së edukimit dhe menaxhimit dhe e gjitha kjo ndikon në rritjen e një konkurrence të ashpër në të gjitha poret e ekonomisë. Nga procesi i globalizimit fitues janë si vendet e zhvilluara edhe ato në zhvillim. Shumë shtete në zhvillim pas LDB në masë të madhe e ulën varfërinë, duke falenderuar kyçjen e tyre në procesin e globalizimit.

Duke e parë rolin e lëvizjes ndërkombëtare të kapitalit, tentohet që ajo të jetë forma dominante në marrëdhëniet ekonomike, në kuadër të globalizimit të ekonomisë botërore. Siç u pa më lart, eksporti i kapitalit ka arritur përmasa që e kushtëzojnë jo vetëm zhvillimin e regjioneve dhe vendeve të veçanta në tërë globin botëror, por ndikojnë drejtpërsëdrejti edhe në reproduksionin e ekonomisë botërore.

Është i vazhdueshëm tentimi i vendeve në zhvillim për shfrytëzimin e kapitalit të huaj, me qëllim që të rrisin akumulimin dhe shkallën e investimit, e cila njëherit paraqet bazën kryesore për tejkalim nga një vend në zhvillim në vend i zhvilluar. Për vendet në tranzicion, po ashtu u pa se kapitali i huaj është i domosdoshëm për realizimin me sukses të reformave të nisura dhe kalim nga një ekonomi e planifikuar centraliste në një ekonomi të hapur, ku fjalën kryesore do ta luajë tregu me mekanizmat e tij. Kapitali i huaj ndihmon në tejkalimin e problemeve shumëvjeçare dhe për krijimin e kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm ekonomik.

Kapitali i huaj duhet të realizohet dhe shfrytëzohet në bazë të programeve që më parë të përcaktuara dhe të realizohet në funksion të mbështetjes, para se gjithash të eksportit dhe ristrukturimin e procesit tekniko-teknologjik në procesin prodhues. Në të kundërt, po qe se vjen deri tek paaftësia e kthimit të detyrimeve të kredive dhe huave të huaja, ajo mund të ndikojë në kufizimin e lëvizjes së kapitalit të huaj në ekonominë e një shteti. Shfrytëzimi i akumulimit plotësues nga kapitali i huaj është me rëndësi për vendet në zhvillim dhe atyre në tranzicion për përkrahjen bilancit të pagesave dhe reformave e veçanërisht në krijimin e kushteve për zhvillim dhe rritje të vazhdueshme ekonomike.

Përveç anëve të theksuara pozitive, shfrytëzimi i kapitalit të huaj ka edhe efektet e tij negative, të cilat me një punë mirë të koordinuar dhe të kujdesshme mund të eliminohen ose së paku të minimizohen. Kjo, para se gjithash, ka të bëjë me strukturën e ekonomisë për shkak se kapitali i huaj

duke u nisur nga dëshira sa më e madhe për profit, mund ta prishë strukturën ekonomike të vendit nikoqir.

Është fakt i pamohueshëm se standardi jetësor në mbarë botën ka arritur një nivel të lartë dhe kjo nuk do të ishte realizuar po qe se ekonomitë e vendeve të ndryshme do të ishin të mbyllura për lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve e veçanërisht të kapitalit të huaj. Por këtu duhet theksuar fakti se hendeuku në mes shteteve të pasura dhe atyre të varfra është thelluar shumë më tepër gjatë kohës së lëvizjes së lirë të kapitalit të huaj.

Në të ardhmen pritet që të ulët borxhi i jashtëm i vendeve në zhvillim dhe atyre në tranzicion në krahasim me PBB dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Ky zvogëlim i borxhit të jashtëm, së pari, do të kushtëzohet nga dinamizmi i PBB dhe eksportit. Por njëherazi pritet që pas kalimit të krizës financiare botërore, në decenien e dytë të shek. XXI të rriten në një masë të madhe kreditë dhe huat ë afatmesme dhe ato afatgjata, si ato publike, ashtu edhe ato private. Tek vendet me një zhvillim të ulët ekonomik dhe me një rezik më të lartë, edhe në periudhën e ardhshme, shfrytëzimi i kredive dhe huave afatmesme dhe afatgjata do të paraqesë komponentët kryesorë për thithjen e kapitalit të huaj.

Rritje të vazhdueshme pritet të kenë edhe IDH dhe investimet portfolio, si tek vendet e zhvilluara, ashtu edhe tek ato në zhvillim. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e strukturës e kapitalit të huaj dhe për shfrytëzimin më efikas të tij në funksion të ristrukturimit dhe mbështetjes së zhvillimit të përgjithshëm ekonomik. Një rritje e vazhdueshme e kapitalit të huaj në këto vende pritet të arrihet edhe në bazë të tregtimit të letrave me vlerë në tregun financiar ndërkombëtar, në funksion të mbështetjes së zhvillimit, ristrukturimit të ekonomisë dhe reformave strukturore. Po ashtu, në të ardhmen pritet të rritet kapitali i huaj në këto vende në bazë të ndihmave nga vendet e zhvilluara, integriteteve ekonomike, nga institucione të veçanta, donatorëve të ndryshëm dhe individëve, si dhe pritet të rritet hyrja e devizave nga transfere të ndryshme jooficiale.

Pra, me pritjet e lartpërmendura rreth kapitalit të huaj, është e natyrshme që tek vendet në zhvillim dhe atyre në tranzicion, të pritet një zhvillim intensiv ekonomik. Kjo do të arrihet edhe me rritjen e vazhdueshme të akumulimit të brendshëm dhe shfrytëzimit më racional të kapitalit të huaj. Kapitali i huaj do të kontribuojë në rritjen e përqindjes së investimeve, importin e lëndëve të para dhe pajimeve, dinamizmin e eksportit, shfrytëzimin më racional i resurseve ekonomike dhe rritjen e PBB.

Me përmirësimin e kushteve për tregtim të vendeve në zhvillim dhe atyre në tranzicion, do të kontribuojë pozitivisht në zhvillimin e tregtisë

dhe këmbimit të jashtëm si dhe një kyçje më të suksesshme në procesin e globalizimit në ekonominë botërore. E gjitha kjo do të ndikojë në rritjen e PBB tek këto vende dhe njëherazi do të zvogëlohet edhe deficitit buxhetor.

Literatura

- Baldssa Bella, Development Strategies in Semi-Industrial Economies, Baltimore MD, Press, 1982.
- Bliss Christopher, The new Trade Theory and Economic Policy, Oxford University Press, 1987.
- Branko Horvat, Teorija na vrednosta na kapitalot i na kamatite, Shkup, 1998.
- Charles Hill, Internacional Business, New York, 2005.
- Dunning J.H. The prospects for FDI in Eastern Europe, St martin's Press, New York, 1993.
- Debra Johnson & Colin Turner, International Business-Themes issues in the modern global economy, New York, 2004.
- Grupacioni i Bankës Botërore, përmisimi i klimës për IHD, nëntor 1998.
- Kikerkova Irena, SDI vo zemjite vo tranzicija, Fakulteti ekonomik, Shkup, 1998.
- Taki Fiti, Sovremeni pazarni stopanstva, NIP, Shkup, 1992.
- Taki Fiti, Tehnoloski neokolonializëm, Studenstki zbor, Shkup, 1984.
- Taki Fiti, Transnacionalnite kompanii i izvozot na kapital, "Komunist", Shkup, 1989.
- Todor Todorov, Taki Fiti, Megunarodno dvizenje na kapitalot i zemjite vo razvoj, Komunist, Shkup, 1983.
- Todaro Michael. Economic DevelopmentmFifth Edition, New York, London, 1994.
- Nasir Selimi, Globalizimi ekonomik, Tetovë, 2008
- Nasir Selimi, Tranzicioni dhe intergrimet ekonomike, Shkup, 2001.
- Nasir Selimi, Biznesi ndërkombëtar, Shkup, 2010.
- Ilia Kristo, Biznesi ndërkombëtar, Tiranw, 2004.
- Murvete Badivuku, Korporatat multinacionale dhe roli i tyre në krijimin e Rendit të ri Botëror, Prishtinë, 2001.
- Musa Limani, Intergrimet ekonomike europiane, Prishtinë, 2008.
- Skënder Berisha, Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, Prishtinë, 1998
- UN, UNCTAD, WTO, IMF, WB, FDI. WIIW

М-р Билјана Цигловска
International University of Struga

КАРАКТЕРИСТИКИ НА СОВРЕМЕНАТА МЕЃУНАРОДНА ТРГОВИЈА

Анстракт

Секоја економија која е пазарно ориентирана, настојува да ја развива својата надворешна трговија, како еден од основните услови за стабилен и сигурен економски развој. Денес, скоро и да нема економија, која не се стреми кон либерализација на меѓународната трговија, кон обезбедување на слободен пристап на нејзините стоки на странските пазари, посебно во услови на глобализација, кога сите држави настојуваат да ги отстранат бариерите кои го ограничуваат слободното движење на стоките и услугите.

Токму кон тоа се стреми и меѓународниот трговски систем, преку процесот на институционализација на меѓународната трговија, кој започнува со потпишувањето на Општата спогодба за царини и трговија (ГАТТ) и продолжува со создавањето на Светската трговска организација (СТО), како и бројните меѓународни и регионални организации чија цел е регулирање на меѓународната трговска размена.

Клучни зборови: меѓународна трговија, ГАТТ, СТО, регионални спогодби.

Abstract

International trade can play a major role in the promotion of economic development and the alleviation of poverty. In this context, enhanced market access, balanced rules, and well targeted, sustainable financed technical assistance and capacity-building programs have important roles to play.

Although trade liberalization and increasing openness to capital flows and

investment have been fundamental to our economic growth and prosperity, they are now under increasing challenge. The Doha Round of trade negotiations presents a significant opportunity to create new trade in agriculture, industrial goods, and services.

Engagement in the global economy through increased trade has contributed to rising average living standards in the country.

Firms engaged in international trade are more productive, have higher employment growth, and are higher wage firms than domestically oriented firms.

Openness to investment is as important as openness to trade. Each country can benefit greatly from the free flow of capital. International investment fuels the economic prosperity by creating well-paid jobs, importing new technology, and providing healthy competition that fosters innovation, productivity gains, lower prices, and greater variety for consumers.

Key words: international trade, GATT, WTO, regional trade agreements.

ТЕНДЕНЦИИ ВО СОВРЕМЕНАТА МЕЃУНАРОДНА ТРГОВИЈА

Во текот на XX и XXI век односите во меѓународната трговија се во знакот на многуте обиди за координирање на меѓународната трговска политика и зголемување на степенот на либерализација на меѓународната трговска размена. Како што се зголемува развојот на земјите, се зголемува и обемот на светската трговија, со што неминовно се јавува потреба од глобално и универзално регулирање на истата. Првите обиди се направени преку воспоставување на билатерални договори за олеснување на трговијата помеѓу договорните земји. Но после Втората светска војна се создаваат меѓународни организации чија главна цел е унапредување на трговијата преку намалување на царинските и нецаринските бариери.

Она што посебно ѝ дава белег на современата меѓународна трговија е потпишувањето на Општата спогодба за царини и трговија ГАТТ во 1947 година, прва од ваков вид наменета за намалување на пречките во трговијата. Целите на ГАТТ беа успешно реализирани преку организирањето на бројните меѓународни рунди преговори, чиј резултат беше понатамошно сè поголемо намалување и елиминирање на пречките и ограничувањата во меѓународната трговија и зголемувањето на обемот на истата.

Една од основните задачи на Општата спогодба за царини и трговија е да овозможи договорните страни да даваат взаемни царински

отстапувања и олеснувања. Токму поради тоа ГАТТ може да се каже дека претставува еден перманентен меѓународен форум, во рамките на кој се потпишани бројни парцијални спогодби со кои детално се разработуваат одредбите од различни аспекти на стоквата надворешна трговија.

Општата спогодба за царини и трговија својата дејност ја извршува преку спроведувањето на мултилатерални трговски преговори. Досега се спроведени осум рунди преговори за намалување на царините и ограничување на нецаринските бариери во меѓународната трговија, деветтата Доха рунда на преговори сè уште е во тек.

Со цел зголемување на степенот на соработка помеѓу земјите, меѓусебно отворање на пазарите и обезбедување на што послободен пристап до истите, земјите изнаоѓаа најразлични начини за заедничко дејствување кон зголемување на обемот на меѓународната трговска размена. Така, во 1948 година беше создадена царинската унија **Бенелукс** (Белгија, Холандија и Луксембург), во рамките на која беа укинати царините во трговската размена помеѓу овие земји и беа определени единствени царини за увозот на стоки од земји кои не се членки на оваа царинска унија. И покрај напорите на ГАТТ за унифицирање и глобална либерализација на меѓународната трговска размена, земјите продолжуваат да го спроведуваат овој процес на регионално ниво.

Приврзаниците на регионализацијата тврдат дека регионалните спогодби промовираат полиберална трговија и дека овие спогодби се пионери на новите идеи за либерализам во мултилатералниот систем. Овие спогодби преку примена на правилото *“learning by doing”* го покренуваат процесот на пошироко регионално интегрирање, што на крај би резултирало со глобална либерализација.

Исто така според нив, помала група земји со слични економски услови (најчесто соседни земји), меѓусебните трговски проблеми можат полесно да ги решат преку регионално економско интегрирање. Имено земјите членки на регионалните економски интеграции во мултилатералните трговски преговори настапуваат со усогласени барања, односно како трговски блок. Според приврзаниците на регионализмот, во иднина во рамките на СТО ќе преговараат трите светски блока: американскиот, европскиот и азискиот трговски блок како носители на светската економија.

Со создавањето на ваквите регионални економски интеграции и трговијата со стоки и земјоделски производи се одвива според регионалните текови.

Така, во 1951 година е формирана **Европската заедница за јаглен и челик** (земјите на Бенелукс, Франција и Западна Германија), 1957

година се формира **Европската економска заедница** (денешната ЕУ) со цел намалување на трговските бариери помеѓу земјите членки ¹⁾.

Многу економисти го истакнуваат и предвидуваат развојот на трите главни трговски блока во развиениот свет – **ЕУ, НАФТА и Азиско-Пацифичкиот блок**, при што трговијата во рамките на секој блок ќе биде зголемена преку отстранување на трговските ограничувања, но можат да се јават проблеми и потешкотии во преговорите за намалување на трговските бариери помеѓу трговските блокови.

Напорите на земјите потписнички на ГАТТ кулминираат во 1994 година, кога во рамките на Уругвајската рунда преговори се донесе одлука за создавање на Светската Трговска Организација (СТО) како официјално тело кое на глобално ниво и со универзални правила и регулативи ќе ја регулира меѓународната трговска размена. Како институција на универзалниот трговски систем, Светската трговска организација се базира на неколку основни принципи: недискриминација; принцип на реципроцитет; национален третман; заштита на домашното стопанство преку воведување царини; понатамошно намалување на царините преку мултилатерални трговски преговори; тарификација на нецарински инструменти; транспарентност; унификација на заштитните политики; начело на посебен третман на земјите во развој; посебен начин на решавање на споровите²⁾.

Недискриминацијата во надворешно-трговските односи е еден од основните принципи на СТО, чија основа е во широката примена на безусловната клаузула за најповластена нација (МФН) - MFN (*Most favorite nation*). Оваа клаузула ги обврзува земјите членки сите повластици што ги дале, ги даваат или ќе ги дадат во иднина кон една земја, да ги прошират кон сите земји – членки на СТО.

Според **принципот на реципроцитет**, земјата ќе понуди намалување на трговските ограничувања, доколку другата земја ги намали истите во нивната меѓусебна размена. Успешноста на преговорите во рамките на ГАТТ/СТО во многу се должи на принципот на реципроцитет и МФН статусот.

Принципот на **национален третман** значи дека, странските субјекти во секоја земја – членка, треба да уживаат еднаков третман како и домашните субјекти. Овој принцип се применува и за увозните стоки. По спроведената царинска постапка, увозната стока се „национализира“

1. Е.Георгиева, К.Симеонов, Европска интеграција, Софија, 2005, стр.28

2. А.Симова, „Глобализацијата и меѓународните икономически организации“, Софија, 2003, стр.185

односно добива еднаков третман како и домашните стоки. „Национализираната“ увозна стока не смее да подлежи на дополнителни даночни оптоварувања, што не важат за домашните стоки.

Заштитата на домашното производство според одредбите на СТО, може да се врши **само преку воведување на царини- *Tariff-Based Trade Policies*** (освен под специфични услови), при што треба да се почитуваат границите на нивото на царинска заштита определени за секоја земја поединечно.

Поради тешкотиите за откривање и пресметување на ефектите од нецаринските инструменти, се јавува потреба од нивна замена со царини, односно потреба од нивна **тарификација**. Преку овој процес на тарификација, надворешно-трговските политики на земјите-членки стануваат потранспарентни.

Согласно одредбите на финалниот акт, не е дозволена употреба на **квантитативните ограничувања на увозот**. Земјите членки треба да ги конвертираат постојните квоти во царини, кои постепено ќе ги намалуваат. Постојат и одредени исклучоци, каде се дозволува употреба на квантитативни увозни ограничувања само доколку нивната цел е да го ограничат увозот што предизвикува или се заканува да предизвика сериозни нарушувања во домашното производство.

Правилата и постапките за добивање дозволи **треба** да бидат објавени. Постапката за добивање на дозвола мора да биде едноставна и брза, а на барателите треба да им се обезбедат информации и детални објаснувања во случај на неодобрување.

Со цел да ја зголеми **транспарентноста на националните надворешно-трговски политики**, СТО во рамките на Механизмот за контрола на трговските политики, публикува извештаи за трендот на трговските реформи и за проблемите со кои се соочуваат земјите при тие реформи. За таа цел земјите членки имаат обврска до Секретаријатот на СТО да доставуваат податоци за своите надворешно-трговски политики. На неразвиените земји членки СТО им обезбедува техничка помош и асистенција за изготвување на нивните извештаи³⁾.

Според начелото на посебен третман, во многу случаи земјите во развој се ослободени од принципот на реципроцитет. Земјите во развој исто така можат да ја задржат заштитата на младата индустрија, да го ограничат увозот во случај кога се соочуваат со штети во домашната индустрија или проблеми со платниот биланс. За земјите во развој

3. P.Jovanovic I drugi, “Meginarodni ekonomski odnosi”, cetrvrto izdanje, Ekonomski fakultet Beograd, 1999, str 552

се применуваат и посебни правила и одредби за регулирањето на примената на субвенции и компензаторни царини, постапките во однос на антидампингшките царини, заштита на текстилот и земјоделските производи и сл.

СТО во своето дејствување во голема мера придонесува за либерализација на светската трговија и зголемување на обемот на истата, но сепак не треба да се занемари фактот дека и во рамките на СТО во уште поголема мера се зголемува обемот на регионалната и билатерална трговска соработка, за сметка на глобалната, преку големиот број на потпишани Регионални и Билатерални спогодби за слободна трговија.

Постои дилема и полемика помеѓу економистите, дали овој вид на соработка повеќе доведува до нарушување или унапредување на трговијата. Имено ефектите од овој вид на спогодби за соработка се различни за земјите со различен степен на развој. Земјите во развој на пример, имаат негативно искуство од ваквиот вид на соработка, бидејќи истата е внатрешно ориентирана и протекционистички настроена, каде нарушувањето на трговијата е поголемо од создавањето на истата.

Регионалната интеграција помеѓу земјите во развој не резултира со позитивни ефекти врз приходот и економскиот раст на истите, освен во случајот со Јужно-африканската царинска унија. Поради тоа, може да се каже дека, трговската либерализација на земјите преку процесот на отворање на пазарите, многу повеќе влијае позитивно врз економскиот раст на земјите, во споредба со функционирањето на Регионалните трговски спогодби (РТС).

Извршените анализи покажуваат дека после спроведената либерализација, просечниот економски раст на земјите изнесува 1.5%, кој пак доведува до зголемување на трговското учество од 10% ⁴⁾.

Меѓутоа СТО не може да го спречи зголемувањето на бројот на овие РТС бидејќи истите се предвидени во рамките на меѓународниот трговски систем како облик на соработка помеѓу земјите со цел унапредување на меѓународната трговска размена. Уште една причина повеќе за зголемување на бројот на склучени РТС е сè уште не завршената Доха рунда на преговори, која треба да ги намали земјоделските царини и субвенции и царините на индустриските производи. Доколку истата претрпи неуспех, новите обележја на меѓународната трговија би биле, засилен протекционизам и создавање на нови плуратерални трговски спогодби, преку кои ќе се одвива меѓународната трговска размена.

4. A.Thirlwall, Trade, *Trade liberalization and Economic growth: Theory and evidence*, Economic research paper No.63, The African Development Bank, 2000, p.14

Во текот на XXI век, посебно во 2008 и 2009 година, глобалните неповолни економски услови и новата светска финансиска криза даваат нов белег на меѓународната трговска размена и односите помеѓу земјите учеснички во истата. Денес светот е сведок на најголемата експанзија на владината интервенција во економијата, што негативно делува на меѓународната трговска размена и ги уништува сите напори кои досега ги направи СТО за либерализација и непречено одвивање на истата.

Според податоците од Светска Банка, 2009 година е година во која за прв пат после 25 години постојан пораст на меѓународната трговија, е забележан колапс и пад на истата ⁵⁾. Се смета дека причините за колапсот на меѓународната трговија се широката употреба на меѓународните ланци на добавувачи и исчезнувањето т.е. не применувањето на краткорочните трговски кредити. Во услови на светска криза сите земји посегнуваат по низа протекционистички мерки за заштита на своите економии, но како што се развива светот и светскиот трговски систем, така земјите развиваат и нови современи видови на протекционистички мерки и посуптилни начини на нивна примена, за да останат незабележани од останатите земји и од одговорното тело за непопречување и неограничување на трговијата – СТО.

Денес овој вид на протекционизам уште е познат и како **темен, мрачен, прикриен** протекционизам, што опфаќа не директна злоупотреба (нарушување) на обврските од СТО, туку злоупотреба на легитимната претпазливост, која се користи за дискриминација на странските стоки, компании, работници и инвеститори⁶⁾. Овој вид на протекционизам опфаќа злоупотреба на правилата за здравје и безбедност и клаузулите во стимулативните пакети кои ги ограничуваат трошоците и однапред ги определуваат трошоците на домашните производители.

Како инструменти на прикриениот протекционизам развиените земји ги користат субвенциите, а земјите во развој ги развиваат сите форми на заштита, а посебно царините. Така на пример Русија ги зголемува царините за увоз на половни автомобили, Еквадор ги зголемува царините на 900 производи, но се користат и нецарински мерки, како на пример во Аргентина, каде неопходно е поседување на дозволи за увоз на некои производи. Индонезија воведува такви мерки според кои, дозволен е увоз само на 5 производи и тоа само од 5 определени пристаништа или аеродроми⁷⁾.

5. R.Baldvin, S.Evenett, *The collapse of global trade, murky protectionism, and the crisis: Recommendations for the G20*, CEPR, 2009, p.13

6. R.Baldvin, S.Evenett, *The collapse of global trade, murky protectionism, and the crisis: Recommendations for the G20*, CEPR, 2009, p.4

7. Ibid, стр.31

САД со својата трговска политика не претставуваат исклучок од примената на новите прикриени мерки на протекционизам. Имено владата на САД одобрува субвенции на производителите на батерии кои се лоцирани само во границите на САД. Одобрувањето на пакетите за помош и излегување од кризата, се уште еден пример за употребата на скриениот протекционизам, во рамките на кои е вклучена клаузулата *Buy American (Купувајте американско⁸⁾*, која пак е изложена на бројни критики од останатите земји, бидејќи со оваа политика се дискриминираат странските производители и извозници на челик.

Земјите, односно креаторите на трговските политики одат до таму, што ги користат и климатските промени и последиците од истите за да можат да ја прикријат или да ја оправдаат примената на некои протекционистички мерки. Постои опасност за светската трговија од примената на т.н. „зелен протекционизам“, каде многу лидери од Г20 сакаат да постигнат договор за климатските промени на Самитот во Копенхаген во Декември 2009 година.

Но, опасноста е дека овој договор во себе може да вклучи и воведување на нови и комплексни давачки и шеми. Од страна на развиените земји создаден е т.н. *Kyoto – протокол*, според кој брзорастечките земји имаат обврска за контрола на емисијата на штетни гасови, со цел долгорочно ограничување на климатските промени.

Се предвидува и ограничување на увозот од земји кои во недоволна мера ја казнуваат употребата на јаглерод, преку воведување на (гранични такси за емисија на јаглерод).

Светот за прв пат не се соочува со вакви кризи, децении наназад светската економија била потресувана од финансиски, енергетски и валутни кризи и за времетраењето на сите карактеристично е прибегнувањето кон примена на одредени протекционистички мерки, со цел да се спречи пренесувањето на кризата и нејзините последици од една земја во друга. Но, искуството од нивната примена за време на кризите е негативно.

Ваквите мерки наместо да ја ублажат и да го спречат понатамошното ширење на кризата, истата ја продлабочуваат и уште повеќе ги нарушуваат националните системи и глобалниот економски систем.

Во моментов вниманието е насочено кон сите светски лидери, до кои се апелира апстинирање и воздржување од примена на било какви протекционистички мерки, бидејќи светската трговија е навистина

8. Правило со која се предвидува, сите јавни набавки на челик од страна на владата за потребите на државата да бидат извршувани само од американски производители, како би се одржала и стимулирала домашната вранотеност.

во опасност. Која е опасноста од примената на истите? Доколку сега, во услови на светска финансиска криза земјите ги засилат своите протекционистички трговски мерки, било преку зголемување на постоечките или преку воведување на нови царини или други нецарински бариери, ќе го ограничат увозот на производи од другите земји.

По основ на реципроцитет и останатите земји ќе посегнат по истите заштитни мерки и ќе ги заштитат своите економии. Намалениот увоз во една земја, значи намален извоз за друга земја.

Намалениот извоз значи и помал прилив на средства и нерамномерен трговски биланс. Како резултат на тоа се намалува глобалната побарувачка, се намалува глобалното производство, што резултира со зголемување на невработеноста. Гледаме како примената на заштитните мерки доведува до влошување на глобалната економска сосостојба.

За да се надмине денешната светска криза потребно е посебно стимулирање на потрошувачката, а не нејзино ограничување и намалување, потрошувачката е таа која ќе ја придвижи економијата во нагорна линија, која ќе го стимулира светското производство и светска трговска размена.

На развиените земји и земјите во развој на располагање им стојат различни мерки и тактики за заштита на домашните индустрии. Развиените земји во поголема мера би прибегнале кон употреба на субвенциите, односно финансиска помош за домашните компании. Исто така, во услови на криза постои можност развиените земји да го повлечат или укинат Општиот систем на преференции за земјите во развој и најнеразвиените земји. Земјите во развој пак, бидејќи не се доволно финансиски силни за да можат да ги применуваат субвенциите, би ги зголемиле царините и други нефискални мерки на заштита.

Овие земји можат да ги искористат и разликите помеѓу граничните царини и оние кои во моментот ги применуваат⁹⁾. Сите земји можат да ги употребат компензациските царини против оној трговски партнер кој применува дампинг или воведува нарушувачки субвенции. Она што е важно да се напомене е дека, сите овие мерки на некој начин се дозволени според правилата и принципите на СТО.

Доколу земјите навистина ги употребат овие мерки кои им стојат на располагање, загубата и штетата ќе биде голема за сите земји без разлика на нивото и степенот на развој.

Но, на неодамна одржаниот Самит на Групата Г 20, лидерите на најразвиените земји во светот и земјите со забрзан стопански развој, истакнаа дека борбата против светската финансиска криза и рецесија

9. U. Dadush, Resurgent protectionism: Risks and possible remedies, Carnegie Endowment for International Peace, 2009, p.6

е успешна, при што забележана е определена стабилизација на финансиските пазари.

Лидерите истакнаа дека индустриското производство во земјите на Г20 е стабилизирано или е во пораст. Светската трговија веќе бележи опоравување и пораст¹⁰). Но за лидерите на групата Г20 тоа не треба да значи дека кризата е целосно надмината, бидејќи токму сега е клучниот момент кога треба да се утврди и трасира правилниот пат за понатака, пат кој нема повторно да доведе до уште една светска криза.

Текот по кој натаму ќе се движи и правецот кој ќе го заземе меѓународната трговија сега зависи од крајниот резултат кој ќе се постигне во рамките на Доха преговорите и успешното завршување на истите во текот на 2010 година.

Трендот на меѓународната трговска размена ќе зависи и од понатамошното функционирање на СТО како ефикасно преговарачко тело, од кое се очекува дека навистина ќе допринесе за намалување на ограничените царини и субвенции, намалување на големата слобода за решавање во трговијата со услуги и воспоставување на построги казни за случајниот протекционизам (безбедносни мерки, антидампинг и др.). Од СТО се очекува да ги забрза преговорите, да ги земе во предвид различните интереси на сите нејзини членки, да ја подобри дисциплината на истите со цел да овозможи прогрес на вкупната трговска либерализација.

ЗАКЛУЧОК

Врз основа на извршената квантитативна анализа на меѓународната трговија, очигледна е нејзината улога и важност за националните економии. Меѓународната трговија претставува движечка сила за забрзан економски развој на неразвиените земји и земјите во развој, но не помала е важноста на меѓународната трговска размена и за развиените земји.

Од истражувањата, анализите и согледувањата на третманот на меѓународната трговска размена во меѓународниот трговски систем, теоретските аспекти на меѓународната трговија, карактеристиките на современата меѓународна трговија, произлегува заклучок дека, концептите на протекционизам и на либерализација на меѓународната трговија во текот на историјата постојано се испреплетуваат еден со друг во своето дејствување и секогаш кога ќе се достигне максимумот од едниот концепт, истиот станува погрешен за водење на меѓународната трговија и неминовно се заменува со обратниот концепт. Исто така,

10. <http://www.pittsburghsummit.gov/about/index.htm>

анализите покажуваат дека, секој концепт е неопходен и соодветен за примена на одреден степен на развој на земјите. Дури и денес, во услови на глобализација и напори на сите земји за либерализација на меѓународната трговија, протекционизмот целосно не е отстранет од политиките на развиените и земјите во развој. И покрај силниот бран на либерализација на трговијата помеѓу индустриски развиените земји, сепак постои притисок кон зголемување на протекционизмот.

Тоа е една од карактеристиките и на современата меѓународна трговија, која и покрај тоа што се регулира со единствени и универзални правила определени најпрво во рамките на ГАТТ, а потоа во СТО неизбежна е примената на различни видови протекционизам. Денес овој вид на протекционизам уште е познат и како темен, мрачен, прикриен протекционизам, што опфаќа не директна злоупотреба (нарушување) на обврските од СТО, туку злоупотреба на легитимната претпазливост, која се користи за дискриминација на странските стоки, компании, работници и инвеститори. Овој вид на протекционизам опфаќа злоупотреба на правилата за здравје и безбедност и клаузулите во стимулативните пакети кои ги ограничуваат трошоците и однапред ги определуваат трошоците на домашните производители.

ЛИТЕРАТУРА

- А.Симова, „Глобализацијата и меѓународните икономически организации“, Софија, 2003
- A.Thirlwall, *Trade, Trade liberalization and Economic growth: Theory and evidence*, Economic research paper No.63, The African Development Bank, 2000
- Bernard Hoekman, Michael Hoskeni, *The Political Economy of The World Trading System - The WTO and Beyond* ; See Edition, 2001
- Bernard Hoekman, Aaditya Mattoo, Philip English, *Development, Trade, and the WTO*; The World Bank, Washington 2002
- Bankole Sodipo, *Piracy and Counterfeiting GATT, TRIPS and Developing Countries*; Kluwer Law International, London 1997
- Е.Георгиева, К.Симеонов, Европска интеграција, Софија, 2005
- P.Jovanovic I drugi, *“Meginarodni ekonomski odnosi”*, cetvrto izdanje, Ekonomski fakultet Beograd, 1999
- R.Baldvin, S.Evenett, *The collapse of global trade, murky protectionism, and the crisis: Recommendations for the G20*, CEPR, 2009
- U. Dadush, *Resurgent protectionism: Risks and possible remedies*, Carnegie Endowment for International Peace, 2009
- World Trade Organization, *“Doha Declarations”*; WTO Secretariat, Geneva 2002
- World Trade Organization, *“International Trade Statistics 2002”*; Geneva 2002
- World Trade Organization *“Tariff Negotiations and Renegotiations under the GATT and the WTO - Procedures and Practices”*; Geneva 2002
- World Trade Organization *“The Road to Doha and Beyond”*; Geneva 2002



Nagip ARIFI

Magjistër i Shkencave juridike

Zv/Kryetar i Komunës Bujanoc, Serbi

DELIKUENCA E TË MITURVE NË REPUBLIKËN E SERBISË PËR PERIUDHËN 2004-2008

HYRJE

Objekt i këtij hulumtimi shkencor është delikuenca e të miturve në Republikën e Serbisë gjatë periudhës 2004-2008, numri i veprave penale, ku në krye të tyre paraqiten delikuentët e rinj, numri i vendimeve të plotfuqishme të shqiptuara ndaj të miturve që kanë kryer vepra penale, por edhe sanksionet penale që u janë shqiptuar kryesve nga ana e prokurorit për të mitur dhe trupit gjykues për të mitur.

Periudha e zhvillimeve të mëdha ekonomike dhe transformimet e mëdha shoqërore, problemet e grumbulluara me vite bashkohen me problemet që paraqiten, ndërkohë dhe nga njëherë bëhen ose paraqiten edhe si probleme të organizuara.¹⁾

Delikuenca e të miturve në të gjitha vendet e botës është prezente, e para së gjithash është e pranishme në vendet që gjenden në periudhën e tranzicionit, sidomos në vendet që transformohen nga një regjim apo shoqëri totalitare në një shoqëri me pretendime demokratike, ku ky fenomen i delikuencës është në rritje.

Suksesi i ndriçimit të veprave penale të të miturve në një vend varet nga shumë faktorë, por sa më shpejt të zbulohen delikuentët dhe sa më shumë

1. Prof. Dr. Vesel Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, Rilindja, Redaksia e Botimeve, Prishtinë 1982, fq. 3.

që të luftohen, ndikon mjaft në zbutjen ose parandalimin e delikteve, të cilat kryen nga të miturit.

Delikuenca e të miturve është pjesë e kriminalitetit të përgjithshëm në një shoqëri, ka karakteristika të njëjta me kriminalitetin e personave të rritur, por nga ana tjetër, nuk merren masa të njëjta represive të shtetit, por merren masa më të buta me qëllim të ndikimit në risocializimin e të rinjve në shoqëri. Të miturit, si pjesë përbërëse e shoqërisë, paraqesin një botë relativisht të veçantë me psikologji të posaçme, me mënyrë të sjelljes, si dhe reaksione të veçanta ndaj ngacmimeve që vijnë nga bota e jashtme.

Ky punim është një përpjekje që të shqyrtohet delikuenca e të miturve si nga aspekti i zhvillimit dhe i luftimit në kushte të një shoqërie ku janë duke u ndërmarrë reforma të mëdha në sistemin e përgjithshëm shoqëror, e para së gjithash në sistemin e judikaturës dhe procedurës penale, por dhe të masave ndëshkuese ndaj delikuentëve të mitur.

Një i ri shpeshherë gjykon dhe i përjeton veprimet dhe mendimet e veta, ndryshe nga të rriturit dhe, për këtë arsye, edhe në procedurën penale duhet të ketë qasje ndryshe veprimi.

Kësaj dukurie është tentuar t'i kushtohet trajtim i posaçëm edhe në ish-Jugosllavi, por pas fillimit të shpërbërjes së saj, duke u përballur e tërë shoqëria me problemet tjera, kjo kategori e të rinjve është lënë pas dore në çdo aspekt, apo më mirë të themi pa kujdes nga ana e shoqërisë, rrethit dhe familjes, por edhe nga ana e organeve kompetente shtetërore për çka u paraqit fenomeni i rritjes së delikuencës së të miturve. Republika e Serbisë, duke tentuar t'i përmbushë standardet e Bashkësisë Evropiane dhe Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e të Rinjve dhe duke filluar nga ajo që një kohë të gjatë nuk ka bërë ndonjë reformë rrënjësore në të Drejtën Penale apo harmonizimin e procedurës penale, në vitin 2005 Parlamenti i Serbisë ka aprovuar Ligjin mbi kryesit e mitur të veprave penale dhe mbrojtjen penalo-juridike të të miturve, dhe i njëjti ka filluar të zbatohet nga 01.01.2006.

Ky ligj rregullon çështjet e procedurës gjyqësore si dhe masat që mund të shqiptohen ndaj kryesit të mitur të veprës penale.

Qëllimi i këtij punimi është që hulumtuesit e kësaj fushe, por dhe të interesuarit e tjerë që e lexojnë këtë punim të kenë më tepër informacione dhe njohuri nga një shtet i Ballkanit Perëndimor, për marrjen e masave adekuate rreth zbulimit, parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie negative në çdo shoqëri.

PROCEDURA PENALE NDAJ TË MITURVE DHE MBROJTJA JURIDIKO-PENALE E TYRE

I. Disa karakteristika të veçanta të ligjit penal për të mitur në Republikën e Serbisë

Kriminaliteti si dukuri negative nuk është karakteristikë vetëm e personave madhorë, shpeshherë si kryes të veprave penale paraqiten edhe personat e mitur. Mirëpo, zhvillimi fizik e psikik i personave të mitur dallon nga zhvillimi i personave të rritur dhe ky zhvillim karakterizohet me një intensitet të lartë sa i përket rritjes së tyre, ashtu edhe sa i përket lëkundshmërisë lidhur me vlerat shoqërore. Për shkak të papjekurisë së tyre, në ta mund të ndikohet gjatë procedurës, si në aspektin pozitiv, po ashtu edhe në atë negativ. Për këtë arsye në rastin kur të miturit kryejnë vepra penale, të drejtat e tyre në procedurën penale rregullohen në mënyrë të posaçme për trajtimin e tyre, qëllimi i të cilëve në radhë të parë është që i mituri të riedukohet dhe të kompensohet ajo që në edukimin e tyre është lëshuar, me qëllim që i mituri delikuent të bëhet anëtar i dobishëm për shoqërinë. Trajtimi i posaçëm i të miturve që kryejnë vepra penale arsyetohet edhe me faktin se duke pasur parasysh moshën e re të tyre ka më shumë shpresë për përmirësim, e në anën tjetër, ata edhe një kohë të gjatë do t'i shkaktojnë dëm shoqërisë, po qe se nuk ndërmerren masa për përmirësimin e tyre. Me qëllim të rregullimit më adekuat të kësaj problematike, Parlamenti i Republikës së Serbisë në vitin 2005 ka aprovuar ligjin për kryesit e mitur të veprave penale dhe mbrojtjen juridiko-penale të tyre, ku rregullohet në mënyrë taksative procedura penale ndaj të miturve dhe masat që mund të merren ndaj të miturve. Në këtë mënyrë, me kurorëzimin e reformës të së drejtës ndëshkimore, Republika e Serbisë në këtë ligj ka inkorporuar të arriturat dhe standardet më bashkëkohore të vendeve tjera të zhvilluara të Evropës, siç është (Franca, Gjermania, por edhe Kroacia), andaj në mënyrë të veçantë ka caktuar statusin penalo-judirik të të miturve.

Ky specifitet pasqyrohet në më shumë drejtime:

1. Është miratuar Lex specialis, ligji i veçantë mbi kryesit e mitur të veprave penale dhe të mbrojtjes penalo-juridike të personave të mitur, me çka të miturit në pozitën e tyre penalo-juridike në tërësi janë ndarë nga statusi i personave të rritur si shkaktarë të veprave penale.
2. Është caktuar kompetencë e veçantë e gjykatave të qarkut për procedim në lëndët penale të shkaktarëve të mitur të veprave penale.

3. Si risi është paraparë specializimi i detyrueshëm i personave të cilët në organet e gjyqësisë marrin pjesë në procedurën penale ndaj të miturve të veprave penale, ku kërkohet aftësim paraprak dhe dhënia apo marrja e çertifikatave, që është dëshmi se ka njohuri gjykatësi i cili merr pjesë në procedurën penale ndaj të miturit.
4. Krahës sanksioneve penale, ligji ka paraparë që ndaj delikuentëve të mitur të veprave penale të shqiptohen edhe masat e veçanta sui generis-të masave edukative si: masat e rekomandimit, përmes të cilave iu shmanget inicimi ose udhëheqja e procedurës penale.²⁾

Në bazën e sistemit të të drejtës penale të të miturve në Republikën e Serbisë gjenden standarde të caktuara në një numër të akteve juridike ndërkombëtare, të cilat i ka aprovuar ish Republika Federale e Jugosllavisë dhe Republika e Serbisë e këto janë:

1. Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijëve viti 1989,
2. Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore,
3. Standardet minimale për gjyqësinë penale të të miturve (të ashtuquajturat rregullat e Pekinit) e aprovuar nga ana e OKB-së në vitin 1985,³⁾
4. Rregullat e Kombeve të Bashkuara mbi mbrojtjen e lirive të të miturve (rregullat e Havanës) nga viti 1990,⁴⁾
5. Karta e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e delikuençës së të miturve (rregullat e Riadit) nga viti 1990,
6. Rregullat, standardet minimale të Kombeve të Bashkuara për masat alternative ndëshkimore (rregullat e Tokios) nga viti 1990,⁵⁾
7. Rregullat Evropiane mbi sanksionet dhe masat shoqërore për zbatimin e gjyqësisë penale për të miturit (rregullat e Vjenës) nga viti 1977,
8. Rezoluta e Kongresit të XVII e shoqatës ndërkombëtare për të drejtat penale Pekin në viti 2004, ku janë miratuar këto rekomandime:
 - a. Personat e mitur i nënshtrohen ligjit me të gjitha karakteristikat e tyre specifike. Për shkak të këtyre specifikave sistemi i drejtësisë duhet të shqyrtojë përgjegjësinë penale të të miturve si çështje të veçantë në kuadër të elementeve të veprës penale,

2. D. Jovašević, Krivične sankcije za maloletnike u novom krivičnom pravu Republike Srbije, Bezbednost, Beograd, broj 5/2006. godine, fq. 689-711.

3. Rezolucija UN broj 40/33 od 29. novembra 1985. godine.

4. Rezolucija UN broj 45/113 od 14. decembra 1990. godine.

5. Službeni list SFRJ- Međunarodni ugovori broj 15/1990.

- b. mosha për përgjegjësi penale duhet të jetë minimale 14 e maksimale 18 vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale,
- c. personat e mitur që shkelin ligjin duhet t'i nënshtrohen rregullave dhe zbatimin të tij përmes formave të ndryshme deri në zbatimin e masave konkrete,
- d. ndaj të miturve që kanë mbushur 14 vjet mund të zbatohen vetëm masa edukative,
- e. zbatimi i masave edukative ose i masave ndëshkimore mund të zgjerohen me kërkesë të personit të interesuar deri në moshën 25v.
- f. mbi përgjegjësinë penale të të miturve patjetër vendosin organet speciale gjyqësore,
- g. vendimet e gjykatës do të duhej të ishin të bazuara në hetimet multidiciplinore, gjyqësore të hapura për hulumtimin e të dyja palëve, dhe
- h. duhet kushtuar kujdes të veçantë interesit të viktimave dhe një raport human ndaj tyre.

II. Karakteristikat e procedurës penale ndaj të miturve

Me ligjin mbi kryesit e mitur të veprave penale dhe mbrojtjen juridiko-penale të kryesve të mitur në mënyrë të posaçme është rregulluar procedura penale ndaj të miturve, i mituri nuk mund të gjykohet në mungesë, (neni 48.al.1). Me rastin e marrjes në pyetje, të miturin, prokurori publik për të mitur po edhe gjykatësi për të mitur gjithmonë ka për detyrë që të veprojë me kujdes ndaj të miturit, duke pasur parasysh zhvillimin shpirtëror, ndjeshmërinë dhe cilësinë personale të të miturit, në mënyrë që zhvillimi i procedurës penale të mos ndikojë dëmshëm në sjelljet e tij.

Mbrojtja në procedurën për të mitur është e obligueshme, edhe atë prej fillimit të procedurës përgatitore e deri te marrja e vendimit nga ana e gjykatës (neni 49.al.1).

Mbrojtësi (avokati) i të miturve gjithmonë duhet të ketë njohuri të caktuara për të drejtat e fëmijëve. Në qoftë se vet i mituri, prindërit e tij, përfaqësuesit ligjor nuk angazhojnë mbrojtës, atëherë sipas detyrës zyrtare do ta caktojë gjyqtari për të mitur. Në procedurën penale për të mitur askush nuk mund të lirohet nga detyra për të dëshmuar mbi rrethanat e nevojshme për vlerësimin e zhvillimit shpirtëror të të miturit, njohjen e personalitetit të tij dhe të kushteve dhe rrethanave në të cilat jeton (neni 50).⁶⁾

6. Zakon o maloletnim učiniocima krivičnih dela i krivičnopravnoj zaštiti maloletnih lica, (Sluzbeni glasnik Republike Srbije, br.85/2005).čl.40.st.1, čl.49.st 1, čl.50.). čl.53. st.1,2,3.

Karakteristikë tjetër në procedurën penale ndaj të miturit është se, gjithmonë duhet të jetë prezent edhe organi i kujdestarisë, ku prokurori me kohë e njofton organin e kujdestarisë se kur dhe ku fillon procedura, i cili organ ka të drejtë të njihet me zhvillimin e procedurës dhe të bëjë propozime, të tregojë fakte dhe prova të cilat mund të jenë të rëndësishme për shqiptimin e vendimit të drejtë nga ana e gjykatës (neni 53. al. 1, 2, 3).

Me rastin e trajtimit të parimit të publicitetit është se në procedurën për të mitur nuk ka publicitet, këtu gjithmonë publiku përjashtohet. Megjithatë gjykatësi për të mitur apo trupi gjykues në raste të veçanta mund të lejojë që në seancë të asistojnë personat të cilët merren me mbrojtjen dhe edukimin e të miturve, ose me luftimin e kriminalitetit të të miturve, por në raste të veçanta mund të marrin pjesë edhe personat shkencorë që mirren me delikuencën e të miturve.

Përveç procedurës penale ndaj të miturit e cila nuk është publike po ashtu nuk bëhet publike edhe vendimi i gjykatësit për të mitur apo trupit gjykues. Në raste të veçanta mund të publikohet vetëm një pjesë e procedurës apo një pjesë e vendimit për të cilën ekziston leja, por gjithmonë duhet pasur kujdes që të mos përmendet emri i të miturit dhe të dhënat tjera psh. datëlindja, vendbanimi në bazë të të cilave opinioni mund të konkludojë se për cilin të mitur bëhet fjalë (neni 55. al.2).

Procedura penale për të mitur gjithmonë, sipas mundësisë, duhet të zhvillohet me urgjencë, të gjitha organet që kanë të bëjnë me procedurën penale ndaj të miturve raportet apo mendime e tyre duhet t'i dërgojnë me urgjencë tek prokurori publik për të mitur apo gjykatësi për të mitur.

III. Përbërja dhe kompetenca e gjykatës për të mitur

Procedurën ndaj të miturit në shkallën e parë e udhëheq gjyqtari për të mitur dhe trupi gjykues për të mitur pranë gjykatës së qarkut.

Trupi gjykues për të mitur në shkallën e parë përbëhet prej një gjykatësi për të mitur dhe dy gjykatësve porotë të cilët patjetër njëri nga gjykatësit duhet të jetë i gjinisë së kundërt. Gjykatësi për të mitur është edhe kryetar i trupit gjykues.

Organ i shkallës së dytë është trupi gjykues për të mitur pranë gjykatës së lartë e cila përbëhet prej tre gjykatësve. Trupi gjykues i shkallës së dytë vendos për ankesën e cila bëhet ndaj vendimit të trupit gjykues të shkallës së parë dhe ndaj ankesës së vendimit që bënë prokurori publik për të mitur.

Kur shkalla e dytë e gjykatës për të mitur vendos është gjithmonë në përbërje të dy gjyqtarëve për të mitur dhe tre gjyqtarëve porotë.

Gjykatësi për të mitur gjithmonë duhet të jetë gjykatësi i cili ka njohuri për të drejtat e të rinjve, kurse gjyqtarët porotë për të mitur duhet të jenë nga radhët e arsimtarëve, profesorëve, pedagogëve ose persona që kanë njohuri të duhur dhe përvojë me punën me fëmijë dhe të rinj.

Nëse ekziston dyshimi se një i mitur ka kryer veprë penale së bashku me një madhor, atëherë procedura penale zhvillohet e përbashkët para trupit gjykues të cilin e udhëheq gjykatësi për të mitur, por me kusht që madhori në momentin e procedurës penale nuk i ka mbushur njëzet e një vite.

Procedura penale ndaj të miturit mund të ngritet për çdo veprë penale vetëm me kërkesën e prokurorit publik për të mitur (neni 57.al.1).

Për veprat penale për të cilat fillon procedura në bazë të padisë private, procedura mund të fillojë vetëm nëse i dëmtuari ka vënë propozimin për ngritjen e procedurës prokurorit publik për të mitur (neni 57.al.2).

Nëse prokurori publik për të mitur nuk bënë kërkesë për ngritjen e procedurës penale për të mitur, atëherë ai në afat prej tetë ditësh është i detyruar ta njoftojë të dëmtuarin (neni 57.al.3).

I dëmtuari ndaj të miturit nuk mund të ndërmerr padi private, por ka të drejtë në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së lajmërimit nga prokurori publik për të mitur të kërkojë nga trupi gjykues për të mitur të gjykatës së lartë të vendos për fillim e procedurës. Për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi deri në pesë vite burg ose dënim në të holla, prokurori publik për të mitur mund të vendos që mos të paraqes kërkesë për ngritjen e procedurës penale edhe pse ekzistojnë dëshmi se kryesi i veprës penale është i mituri, nëse konstaton se nuk është mirë të zhvillohet procedura penale ndaj të miturit duke e pasur parasysh natyrën e veprës penale rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, jeta e mëparshme e të miturit dhe gjendja e tij personale. Gjykatësi për të mitur mund të vendos që i mituri gjat procedurës përgatitore përkohësisht të vendoset në qendrat e pranimit, qendrat edukative ose në qendrat e njejta që kanë qëllim edukativ, të vihet në kujdesin e kujdestarit ose të vendoset në një familje tjetër nëse është e arsyshme që i mituri përkohësisht të largohet nga rrethi ku ka jetuar ose ku ka vepruar.

Në rastet e veçanta gjykatësi për të mitur mund të bie vendim që t'i caktojë paraburgim të miturit, vetëm nëse konstaton se me masën e vendosjes së përkohshme në një ent edukativ opo familje tjetër nuk mund të arrihet efekti i duhur. I mituri gjatë qëndrimit në paraburgim rekomandohet që mos të jetë së bashku me ndonjë madhor në dhomën e paraburgimit, por kjo mund të jetë vetëm në rastet e veçanta kur vendos gjykatësi për të mitur, por gjithmonë duhet të ketë parasysh që madhori që është në paraburgim me të miturin mos të ndikojë në aspekt negativ, por vetëm pozitiv. Vendimet në procedurën për të mitur jepen në formë të aktvendimit dhe aktgjykimit.

Me aktvendim vendoset kur pushohet procedura ndaj të miturit.

Me aktvendim vendoset edhe kur nuk ekziston leja për ndjekje penale, kur kemi të bëjmë me çështje të gjykuara, kur kemi të bëjmë me rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale, pastaj kur ekzistojnë kushtet për aktgjykim lirues, si dhe kur trupi gjykues gjen se nuk është e arsyshme që të miturit t'i jipet as dënimi e as masa edukuese. Gjykata vendos me aktgjykim kur të miturit i shqiptohet dënim me burg për të mitur.

Me shqyptimin e vendimit në procedurën ndaj të miturit nuk pushon aktiviteti i gjykatës. Gjyqtari për të mitur edhe më tutje duhet të përcjell në mënyrë sistematike zbatimin e vendimit derisa të merret një vendim tjetër për pushimin e zbatimit të masës edukuese e këtë ka të drejtë ta bëjë gjykatësi kur të vërtetojë se ato masa a e kanë arritur efektin dhe qëllimin e duhur ndaj të miturit, ose që t'i ndryshojë, kur të paraqitet nevoja të ndërrohen me masa më të përshtatshme e që japin mundësi të mëdha për sukses dhe prevencë në të ardhmen ndaj të miturit.

IV. Çka nënkuptojmë me të miturit

I mitur është ai person, i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur katërmbëdhjetë vite e që nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vite.

I mituri i ri është personi që në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur katërmbëdhjetë vite e që nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vite.

I mituri i vjetër është personi që në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vite e që nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vite.

Madhor i ri është personi që në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur tetëmbëdhjetë vite e që në kohën e gjyimit të tij nuk i ka mbushur njëzet e një vite (neni 3.al.1,2,3 4).

V. Masat ndëshkuese sipas ligjit penal të Republikës së Serbisë janë:

- Urdhëresat edukative,
- Masat edukative, dhe
- Dënim me burg.

Llojet e urdhëresës edukative janë:

- t'i kompensohet dëmi të dëmtuarit, t'i kërkohet falje të dëmtuarit, me punë ose në mënyrë tjetër ta eliminojë dëmin, gjithë dëmin ose pjesërisht,
- rregullisht të vijohet mësimi ose rregullisht të shkojë në punë,

- të kyçet në punën e organizatave humanitare pa kompenzim ose punë me karakter social lokal ose punë me karakter ekologjik,
- nënshtrimi kontrollit të duhur për shkak të varshmërisë së përdorimit të pijeve alkoolike ose pijeve narkotike,
- kyçja në trajtim të posaçëm në shtëpitë e shëndetit ose ente.

Urdhëresa edukative mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj, dhe gjatë asaj kohe mund të zëvendësohet me një urdhëresë tjetër apo edhe të ndërpritet.

Masat edukative

Qëllimi i masave edukative është që të kontribuojnë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryesit të mitur, duke ofruar mbrojtje ndihmë dhe mbikqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.

Të miturve të rinj mund t'i shqiptohen vetëm masa edukative.

Të miturve të vjetër mund t'i shqiptohet masa edukative, por në raste të veçanta mund t'i shqiptohet edhe dënimi me burg.

Me këtë ligj në kuadër të masave edukative, të miturve mund t'u shqiptohen edhe masat e sigurisë së shtuar.

Lloji i masave edukative që mund të merren ndaj të miturve janë:

1. *Masat e qortimit dhe orientimit.*
2. *Masat e mbikqyrjes së shtuar.*
3. *Masat e entit.*

1. *Masat e qortimit dhe orientimit: qortimi gjyqësor dhe obligimet e posaçme,*

- *qortimi gjyqësor:* shqyrtohet kur shihet qëndrimi i të miturit se ka gabuar ndaj të dëmtuarit dhe kur masa e tillë konsiderohet e mjaftueshme të merret ndaj të miturit dhe mjafton vetëm se të qortohet,

- *obligimet e posaçme janë:*

- t'i kërkojë falje të dëmtuarit,
- sipas mundësive të veta i mituri ta kompenzojë dëmin të cilin e ka bërë,
- që rregullisht të vijojë mësimin ose të mos mungojë nga puna,
- të aftësohet për profesionin që i përgjigjet aftësive të tij,
- që pa kurrfarë kompensimi të kyçet në punë të organizatave humanitare, dhe punë sociale-lokale ose punë që kanë përmbajtje ekologjike, këtu i mituri mund të bëjë më së shumti 120 orë punë gjatë afatit prej 6 muajve sa mund të zgjasë më së shumti kjo masë,

- të kyçet në aktivitete sportive,
- t'i nënshtrohet kontrollimeve të posaçme mjekësore që kanë të bëjnë me varshmërinë e përdorimit të alkoolit ose pijeve narkotike,
- të kyçet në tretmanin e posaçëm apo grupor në institucionet shëndetësore përkatëse ose ente dhe t'i nënshtrohet programit të tyre të cilat i kanë bërë ato institucione për të miturin,
- t'i vijoje kurset për aftësimin profesional dhe të përgatitet për dhënien e provimeve për t'u kontrolluar aftësimi i tij,
- që të mos mundet të largohet nga vendbanimi ose vendqëndrimi, pa pëlqimin e gjykatës dhe lejës së posaçme nga organi i kujdestarisë.

2. Masat e mbikqyrjes së shtuar mund të jenë:

- masat e mbikqyrjes së shtuar nga ana e prindit,
- nga prindi i adaptuar ose kujdestarit të të miturit,
- mbykëqyrja e shtuar nga familja tjetër
- mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë,
- mbikëqyrja e shtuar në qëndrimin ditor në entet për edukim dhe shkollim të të miturve.

Dënimi me burg i të miturve

I mituri i vjetër i cili ka kryer vepër penale, me të cilën me ligj është paraparë dënim më shumë se pesë vite, mundet sipas ligjit penal të Serbisë t'i shqiptohet dënimi me burg, nëse për atë vepër penale nuk do të ishte e arsyeshme t'i shqiptohet masa edukuese.

Burgu për të mitur nuk mund të jetë më pak se gjashtë muaj dhe më gjatë se pesë vite dhe shqiptohet me muaj dhe vite të plota.

Për vepra penale që është paraparë dënimi me burg njëzet vite ose dënim i rëndë, dënimi ndaj të miturve mund të shqiptohet edhe me kohëzgjatje edhe deri në dhjetë vite, po qe se i mituri ka kryer dy apo më shumë vepra penale për të cilat janë paraparë dënim për secilën vepër dhjetë vite burg, atëherë të miturit mund t'i shqiptohet dënimi edhe deri në dhjetë vite burg.

Parashkrimi i ekzekutimit të burgimit për të mitur bëhet: (neni 33)

1. Dhjetë vite nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burg për të mitur për më shumë se pesë vite.
2. Pesë vite nga vendimi i formës së prerë me të cilin i është shqiptuar burg për të mitur më shumë se tri vite.
3. Tri vite nga vendimi i formës së prerë me të cilin është shqiptuar burgu për të mitur deri në tre vite.

*Delikuentët e mitur të dënuar në Republikën e Serbisë nga viti 2004-2008**Tabela nr.1*

Republika e	2004		2005		2006		2007		2008	
Serbisë	numri	ind.%	numri	ind%	numri	ind%	numri	ind%	numri	ind%
Gjithsejt	1983	100%	2234	100%	1566	100%	1996	100%	2229	100%
Femra	92	4,6	106	4,7	71	4,5	95	4,8	109	4.9
Meshkuj	1891	95,4	2128	95,3	1495	95,5	1901	95,2	2120	95.1

Këtu shohim një rritje të dënuarve të të miturve në çdo vit me përjashtim që vetëm në vitin 2006, kemi një stagnim të vogël, po ajo që është më shqetësuese se në çdo vit kemi rritje të përqindjes së veprave penale nga gjinia femërore, kjo përqindje sillet nga 4% deri në 5%. ⁷⁾

Nga studimet të cilat janë bërë nëpër gjykatat e qarkut dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Serbisë, por edhe nga shënimet të cilat janë marrë në Entin Republikan Statistikor, del se veprat penale të cilat i kanë kryer të miturit pa marrë parasysh se a janë të mitur të rinj apo të vjetër del se ato vepra kanë të bëjnë më së shumti me veprat penale ndaj pasurisë, por gati 1/6 kanë të bëjnë me veprat penale kundër jetës dhe trupit të njeriut.

Nga gjithsejt 1.983 vendime gjyqësore të plotëfuqishme ndaj të miturve në vitin 2004, 1.425 janë vepra që kanë të bëjnë me veprat penale kundër pasurisë, kurse 235 vendime të gjykatave që kanë të bëjnë ndaj jetës dhe trupit të njeriut.

Nga gjithsejt 1.983 vendime të plotëfuqishme të gjykatave ndaj të miturve 1.180 janë marrë në Serbinë qendrore, kurse 803 vendime janë marrë në Krahinën Autonome të Vojvodinës.

Nga ky hulumtim shihet se veprat e rënda penale nga të rinjtë më së shumti janë kryer në qendrat e mëdha apo në qendrat ku ka një zhvillim të hovshëm ekonomik siç është Beogradi, Novi Sadi apo Nishi, kurse më pak ka vepra të tilla penale të kryera nga të miturit në vendet më pak të zhvilluar ekonomikisht, sidomos në Serbinë e jugut. psh. nëse e marrim rrethin e Pčinjës ku e përbëjnë shtatë komuna: edhe atë Bosiligradi, Bujanoci, Vlladiçin-Hani, Vranja, Presheva, Surdulica dhe Tërgovishta të cilat komuna njihen si të pazhvilluara ekonomikisht. Në vitin 2005 nga gjithsejt 2.234 vendime të plotëfuqishme të gjykatave ndaj kryesëve të mitur të veprave penale 1.635 vendime kanë të bëjnë me vepra penale të cilat kanë qenë ndaj pasurisë kurse 253 vendime kanë të bëjnë me veprat penale kundër jetës dhe trupit të njeriut.

7. Burimi: Të dhënat statistikore të Entit Statistikor të Republikës së Serbisë, për periudhën 2004-2008 të publikuara në web-faqen e Entit Republikan të Statistikës. www.stat.gov.rs

Në vitin 2006, siç theksuam më lart ka pasur më pak vepra penale të kryera nga të miturit, por njëherit ka pasur edhe vendime më pak të plotëfuqishme, kështu që nga 1.566 vendime të plotëfuqishme nga ana e gjykatave 1.033 vendime të plotëfuqishme janë marrë ndaj kryesëve të mitur të veprave penale, që ka të bëjë me veprat penale kundër pasurisë, kurse 212 vendime gjyqësore të plotëfuqishme të marra nga gjykatat për të mitur kanë të bëjnë me veprat penale të cilat i kanë kryer të miturit ndaj jetës dhe trupit të njeriut.

Në vitin 2007 në krahasim me vitin 2006 siç shihet kemi një rritje të delikuençës së të miturve, kjo shihet edhe nga fletëparaqitjet penale të cilat janë bërë ndaj të miturve, por edhe nga vendimet e plotëfuqishme të gjykatave ndaj kryesve të mitur të veprave penale.

Kështu që në këtë vit kemi 1.996 vendime të plotëfuqishme nga të cilat 1.271 vendime kanë të bëjnë me veprat penale të të rinjve ndaj pasurisë, kurse 318 vendime kanë të bëjnë me veprat penale të të rinjve ndaj jetës dhe trupit të njeriut.

Po ashtu edhe në vitin 2008 kemi një rritje, si të fletëparaqitjeve penale ndaj të miturve të cilët kanë kryer vepra penale, po ashtu shihet se edhe prokurori publik për të mitur, por edhe gjykatat për të mitur kanë qenë më efikase në zbulimin e kryesve të veprave penale të të miturve, kështu që në këtë vit kanë qenë 2.229 vendime të plotëfuqishme ndaj të miturve të cilët kanë kryer vepra penale edhe atë 1.424 vendime kanë qenë vendime që kanë pasë të bëjnë me vepra penale të të miturve e që kanë pasë si shkak dëmtimin, shkatërrimin apo vjedhjen e pasurisë të personave fizikë apo juridikë, kurse 321 vendime ndaj kryesve të mitur të veprave penale kanë pasë të bëjnë me veprat penale ndaj jetës dhe trupit të njeriut.

Pra, në vitin 2004 nga gjithsejt 1.983 vendime të plotëfuqishme të marra nga ana e gjykatave ndaj të miturve 688 janë kryes të mitur të rinj te veprave penale ose 34.7%.

Po ashtu edhe në vitin 2005 nga gjithsejt 2.234 vendime ndaj të miturve 763 kanë të bëjnë me të miturit e rinj apo 34.2%.

Në vitin 2006 kemi një zvoglim të veprave penale nga të miturit, por kemi edhe zvogelim të veprave penale nga ana e të miturve të rinj, kështu që nga gjithsejt 1.566 vendime të plotëfuqishme 490 kanë të bëjnë me të miturit e rinj apo 31.3%.

Në vitin 2007 kemi një rritje të veprave penale nga ana e të miturve, por më shumë kemi rritje tek të miturit e rinj, kështu që kjo përqindje rritet në 41.6%.

Edhe vitin 2008 e përcjellë rritja e veprave penale nga të miturit e rinj, kështu që nga 2.229 vendime të plotëfuqishme të marra nga ana e gjykatave

ndaj të miturve për vepra penale të kryera nga ana e tyre vetëm ndaj të miturve të rinj janë marrë 992 vendime të plotëfuqishme ose 44.5% dhe kjo është përqindja më e madhe në periudhën 2004-2008.

Ajo që është brengosëse për shoqërinë, është se çdo vit janë duke u rritur veprat penale të kryera nga të miturit edhe atë siç vërehet veprat e rënda penale, sepse këtë e dëshmojnë edhe vendimet e plotëfuqishme të marra nga gjykatat për të mitur që kanë të bëjnë me dënimin me burg ndaj të miturve të vjetër, kështu që në vitin 2004 kemi pasur dhjetë dënime me burg ndaj të miturve të vjetër apo 0.8%, kurse në vitin 2007 kemi pasur 30 persona të dënuar me burg ose 2.6% të numrit të përgjithshëm të masave për të mitur, kurse në vitin 2008 kemi 17 persona të mitur të vjetër të dënuar me këtë sanksion i cili është më i rëndi për të mitur apo 1.4% të të gjitha sanksioneve të cilat janë marrë ndaj të miturve dhe kjo dëshmon se shoqëria duhet që të aktivizojë të gjitha mekanizmat e veta për parandalimin e kësaj dukurie negative nga ana e të miturve, e para së gjithash të të miturve të rinj, sepse shpesh këta në të ardhmen mund të paraqiten edhe si recidivistë potencial.

Personat madhorë të dënuar në Serbi në periudhën 2004-2008

Tabela nr.2

Republika e Serbisë	2004		2005		2006		2007		2008	
	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%
Gjithsejt	34239	100,0	36901	100,0	41422	100,0	38694	100,0	42238	100,0
Femra	2973	8,7	3293	8,9	3930	9,5	3661	9,5	3817	9,1
Meshkuj	31266	91,3	33608	91,1	37492	90,5	35033	90,5	38321	90,9

Nga kjo tabelë shihet se diku rreth 5% të veprave penal në Republikën e Serbisë kryen nga delikuentët e mitur, po ajo çka shihet edhe te personat madhorë është një numër i madh i gjinisë femërore bile në vitet e fundit ka një rritje të dukshme, kështu nëse e marrim vitin 2004, ku kemi pasë një përqindje prej 8,7% të numrit të përgjithshëm të dënuarve të gjinisë femërore e në vitin 2007 kemi 9,5%, ose në vitin 2008, 9,1% del se në vitin 2007 kemi një rritje për 0,8% e në vitin, 2008 kemi një rritje për 0,4% por kur marrim numrin e përgjithshëm del se diku prej 50 e deri në 100 femra rritet numri i veprave penale në vit edhe atë me vendime të plotëfuqishme të gjykatave.⁸⁾

8. Burimi: Të dhënat statistikore të Entit Statistikor të Republikës së Serbisë, për periudhën 2004-2008 të publikuara në web-faqen e Entit Republikan të Statistikës. www.stat.gov.rs

Numri i delikuentëve të mitur që kanë pasë fletëparaqitje penale për vepra penale, në Republikën e Serbisë në periudhën 2004-2008

Tabela nr.3

Republika e	2004		2005		2006		2007		2008	
Serbisë	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%
gjithsejt	3120	100	2945	100	3041	100	3434	100	4085	100
femra	148	4,7	149	5,1	227	7,5	206	6,0	301	7,4
meshkuj	2972	95,3	2796	94,9	2814	92,5	3228	94,0	3784	92,6

Nga të dhënat statistikore del se numri i përgjithshëm i veprave penale të kryera nga ana e të miturve nga viti 2004 e deri në vitin 2008, është në rritje edhe atë mbi 30,9%. Kjo rritje tek gjinia femërore paraqitet mbi 103%, kurse tek meshkujt mbi 27,3%. Nëse bëjmë një krahasim të numrit të delikuentëve të mitur që kanë kryer vepra penale sipas fletëparaqitjeve dhe numrit të dënuarve sipas vendimeve të plotëfuqishme të gjykatave për të mitur shihet se më lehtë ka qenë të zbulohen dhe të sanksionohen kryesit e veprave penale të gjinisë mashkullore se të gjinisë femërore.

Rezultatet më të mira janë arritur që nga momenti kur ka hyrë në fuqi ligji penal ndaj të miturve, sepse këtu të miturit kanë një trajtim të posaçëm të bazuar në konventat ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut, po ashtu edhe gjykatësit dhe prokurorët për të mitur janë më efikas dhe më të përgatitur gjatë zhvillimit të procedurës penale ndaj të miturve, sepse gjithmonë duhet të jenë me njohuri të duhura për aktivitetet e të rinjve që paraqiten si kryes të veprave penale para këtyre organeve.

Numri i personave madhor që kanë kryer vepra penale në bazë të fletëparaqitjeve penale në periudhën 2004-2008

Tabela nr.4

Republika e	2004		2005		2006		2007		2008	
Serbisë	numri	%	numri	%	Numri	%	Numri	%	numri	%
Gjithsejt	88453	100,0	100536	100,0	105701	100,0	98702	100,0	101723	100,0
Të njohur për organet	60641	68,6	62370	62,6	63970	60,5	61992	62,8	67407	66,3
Femrat	6319	10,4	6499	10,4	7082	11,1	6431	10,4	7169	7,0
Meshkujt	54322	89,6	55871	89,6	56888	88,9	55561	89,6	60238	93,0

Nga kjo shihet se mbi 60% e deri në 66.3% të veprave penale janë të kryera nga madhorët që janë persona të njohur për organet e punëve të brendshme çka nënkupton se ata janë recidiv në kryerjen e veprave penale.

Po ashtu është shqetësues edhe numri i veprave penale që janë kryer nga gjinia femërore, është shumë i madh e, kjo shihet nga numri i përgjithshëm i

veprave penale të paraqitura, prej 7% e deri në 11.1% të veprave që janë kryer nga ana e gjinisë femërore.⁹⁾

Edhe atë kjo është prezente më së shumti tek moshë e mesme e cila sillet prej 30-40 vjeçare, por është prezente edhe te moshat tjera, por me një përqindje më të vogël.

Të miturit e dënuar sipas sanksioneve të shqiptuara penale në Republikën e Serbisë
Tabela nr.5

Republika e Serbisë	2004		2005		2006		2007		2008	
	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%
Gjithsejt	1983	100	2234	100,0	1566	100,0	1996	100,0	2229	100,0
Të miturit e rinj	688	34,7	763	34,2	490	31,3	830	41,6	992	44,5
Masat disiplinore (masat parandaluese dhe orientuese)	368	53,5	360	47,2	204	41,6	405	48,8	468	47,2
Masat e mbikqyrjes së shtuar	298	43,3	377	49,4	255	52,0	385	46,4	460	46,4
Masat e entit	22	3,2	26	3,4	31	6,3	40	4,8	64	6,5
Të miturit e vjetër	1295	65,3	1471	65,8	1076	68,7	1166	58,4	1237	55,5
Burgjet për të mitur	10	0,8	7	0,5	17	1,6	30	2,6	17	1,4
Masat disiplinore (masat parandaluese dhe orientuese)	568	43,9	617	41,9	383	35,6	481	41,3	479	38,7
Masat e mbikqyrjes së shtuar	659	50,9	793	53,9	605	56,2	614	52,7	684	55,3
Masat e entit	58	3,7	54	3,7	71	8,1	41	3,5	57	4,6

Nga të dhënat statistikore të Entit Statistikor të Republikës së Serbisë del se masat të cilat janë ndërmarrë ndaj të miturve kanë të bëjnë më së shumti me masat edukative ndaj të miturve të rinj, po ashtu edhe atyre të vjetër.¹⁰⁾

PËRFUNDIMI

Delikuenca e të miturve si lloj i dukurisë asociale në Republikën e Serbisë është shumë e ndërlikuar dhe komplekse, sepse çdo vit është në

9. Burimi: Të dhënat statistikore të Entit Statistikor të Republikës së Serbisë, për periudhën 2004-2008 të publikuara në web-faqen e Entit Republikan të Statistikës. www.stat.gov.rs

10. Burimi: Të dhënat statistikore të Entit Statistikor të Republikës së Serbisë, për periudhën 2004-2008 të publikuara në web-faqen e Entit Republikan të Statistikës. www.stat.gov.rs

rritje e sipër, sidomos veprat e rënda penale të kryera nga të miturit, andaj për zbulimin, parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie negative nevojitet një bashkëpunim i ngushtë, por, para së gjithash, i shpejtë, i vazhdueshëm dhe sistematik në mes organeve shtetërore dhe shoqërore. Ndër këto organe vend të rëndësishëm zënë: shërbimet e caktuara të Qendrës për Punë Sociale, organizatat joqeveritare që merren me të drejtat e të rinjve, organet e punëve të brendshme njësitet e specializuara për zbulimin, parandalimin dhe luftimin e delikuençës së të miturve, prokurori publik për të mitur dhe gjykata për të mitur, edhe pse shkalla e ndriçimit të veprave penale të kryera nga ana e të miturve është mbi 65%, ku mund të themi se këto organe kanë sukses në zbulimin e kryesve të veprave penale kur kemi të bëjmë me kryesit e mitur.

Një mundësi shumë të mirë në parandalimin, zbulimin dhe luftimin e delikuençës së të miturve e ka mundësuar edhe aprovimi i Ligjit për kryesit e mitur të veprave penale dhe mbrojtjen juridiko-penale të kryesve të mitur të veprave penale nga Parlamenti i Serbisë, në vitin 2005, Fletorja zyrtare 85, i cili ligj ka filluar të zbatohet më 01.01.2006.

Në këtë ligj, në mënyrë taksative janë caktuar kompetencat e organit të kujdestarisë, ku i është dhënë një rëndësi e madhe gjatë gjithë kohës së procedurës paraprake procedurale, gjatë kohës së procedurës penale, por edhe pas marrjes së vendimit të gjykatës për të mitur, e që ka të bëjë gjatë ekzekutimit të masës edukuese apo ndëshkuese ndaj të miturit. Ajo që është përparimtare në këtë ligj është se vetëm prokurori publik për të mitur dhe gjykatësi për të mitur që ka njohuri të posaçme dhe që është i aftësuar profesionalisht për të drejtat e të rinjve mund të jetë prokuror dhe gjykatës në marrjen e vendimeve për kryesit e mitur të veprave penale, po ashtu në këtë ligj është paraparë që patjetër në trupin gjykues duhet të jetë një gjyqtar i gjinisë së kundërt.

Literatura:

1. Dr. Vesel Latifi: Kriminalistika e delikuençës së të miturve “Rilindja” Prishtinë, Redaksia e Botimeve, Prishtinë, 1982.v.
2. D. Javašević: Sankcije za maloletnike u novom krivičnom pravu Republike Srbije. Bezbednost, Beograd, broj 5/2006.
3. Rezulucija UN. broj 40/33 od 29.novembra 1985.g.
4. Rezulucija UN. broj 45/113 od 14.decembra 1990.g.
5. Službeni list SFRJ. Medjunarodni ugovori broj. 15/1990.
6. Zakon o maloletnim učiniocima krivičnih dela i krivičnopravnoj zaštiti maloletnih lica, Službeni glasnik. Republike Srbije, br.85/2005.
7. Të dhënat statistikore të Entit statistikor të Republikës së Serbisë, për periudhën 2004-2008, në web-faqen, www.stat.gov.rs.

Xhevair BEQIRI

Magjistër i Shkencave matematike, Strugë

INTERVALE OSHILUESE TË EKUACIONIT JOLINEAR DIFERENCIAL TË RENDIT TË DYTË

Abstrakt:

Në këtë punim prezantohen kritere që përcaktojnë zgjidhje oshiluese për tipet e barazimieve jolineare diferenciale të rendit të dytë

$(a(t)x'(t))' + P(t) + Q(t, x) = R(t, x, x')$ dhe $(a(t)x'(t))' + q(t)x(t) = 0$ përkatësisht, ku $a(t)$ funksion jonegativ, kurse $P(t)$, $Q(t, x)$ $q(t)$ dhe $R(t, x, x'(t))$ funksione të vazhdueshme të cilat u nënshtrohen kushteve të caktuara. Kriteret bazohen në konstruktimin e funksioneve të cilat në kushte të caktuara plotësojnë relacion në varshmëri me koeficientët e barazimit.

Keyword: oshilatorik, ekuacion, diferencial, interval, zgjidhje .

Hyrje

Konsiderojmë ekuacionin jolinear diferencial të rendit të dytë

$$(a(t)x'(t))' + P(t) + Q(t, x) = R(t, x, x') \quad (1)$$

ku koeficientët janë funksione të vazhdueshme dhe $a(t)$ funksion jonegativ. Kriteret bazohen në rezultatet e prezentuara në $w1]$, $w3]$, $w4]$ dhe $w8]$.

Nisemi me supozimin se (1) ka zgjidhjenë (t_0, ∞) . Me zgjidhje të (1) nënkuptojmë funksionin $x(t)$, $t \in [t_x, \infty) \subset [t_0, \infty)$, i cili ka derivat deri te rendi i dytë të vazhdueshëm dhe e plotëson barazimin (1) në intervalin $[t_x, \infty)$, ku $t_x \geq t_0 \geq 0$.

Zgjidhja jotriviale $x(t)$ e (1) thuhet se është oshiluese nëse ka një varg zerosh që tentojnë në pambarim, përndryshe ajo quhet jooshiluese d.m.th. $x(t)$ është zgjidhje jooshiluese nëse ekziston $t_1 \geq t_0$ ashtu që $x(t) \neq 0$ për $t \geq t_1$.

Në vazhdim qëndron supozimi se
 $f: \mathfrak{R} \rightarrow \mathfrak{R}, P: [T_0, \infty) \rightarrow R, Q: [T_0, \infty) \times \mathfrak{R} \rightarrow \mathfrak{R}, \quad R: [T_0, \infty) \times \mathfrak{R} \times \mathfrak{R} \rightarrow \mathfrak{R}$, janë
 funksione të vazhdueshme si dhe

$$xf(x) > 0, \text{ për } x \neq 0 \quad (2)$$

$$f'(x) \geq k > 0, \text{ për } x \neq 0 \quad (3)$$

$$\frac{R(t, x, x')}{f(x)} \leq r(t), \frac{Q(t, x)}{f(x)} \geq q(t), \frac{P(t)}{f(x)} \geq p(t), \text{ për } x \neq 0 \quad (4)$$

Pjesa kryesore

Tani duke u bazuar në kushtet e mësipërme për ekuacionin diferencial jolinear të rendit të dytë

$$(a(t)x'(t))' + P(t) + Q(t, x) = R(t, x, x')$$

mund të konstruktohet kriteri oshilues i zgjidhjeve si në vazhdim.

Teoremë . Nëse vlejné kushtet (2),(3),(4) dhe nëse gjendet ρ funksion i diferencueshëm pozitiv në $[T, \infty)$ ashtu që, $\rho' \geq 0$ në $[T_0, \infty)$, atëherë ekuacioni (1) është oshilues nëse

$$\lim_{t \rightarrow \infty} \int_{T_0}^t \frac{1}{\rho(s)a(s)} ds = \infty \quad (5)$$

$$\int_{T_0}^t R(s) ds = \infty \quad (6)$$

$$\text{ku } R(t) = \rho(t)[r(t) + q(t) - p(t)] - \frac{\rho'^2(t)a(t)}{4k\rho(t)}.$$

Vërtetimi : supozojmë të kundërtën se zgjidhja $x(t)$ është jooshiluese d.m.th. gjendet T_0 ashtu që për $t \geq T_0$, kemi $x(t) > 0$. (ngjajshëm vërtetohet edhe për $x(t) < 0$),

Marrim funksionin ndihmës

$$w(t) = \frac{a(t)x'(t)}{f(x(t))} \quad (7)$$

derivati i të cilit në respekt të t është

$$w'(t) = \frac{(a(t)x'(t))'}{f(x(t))} - \frac{a(t)f'(x(t))x'^2(t)}{f^2(x(t))}$$

prej nga

$$w'(t) = r(t) - q(t) - p(t) - \frac{a(t)f'(x(t))x'^2(t)}{f^2(x(t))} \quad (8)$$

nëse (7) shumëzohet me $\rho(t)$ dhe integrojmë në kufinj të prej T deri në t marrim

$$\int_T^t \rho(s)w'(s)ds = \int_T^t \rho(s)[r(s) - q(s) - p(s)]ds - \int_T^t \rho(s) \frac{f'(s)w^2(s)}{a(s)} ds$$

integrohet me pjesë dhe përdoret (3) fitohet

$$\rho(t)w(t) \leq C_T - \int_T^t \rho(s)[q(s) + p(s) - r(s)]ds + \int_T^t \rho'(s)w(s)ds - \int_T^t \rho(s) \frac{kw^2(s)}{a(s)} ds$$

ku $C_T = \rho(T)w(T)$, i cili jobarazim shkruhet edhe në formën

$$\rho(s)w(s) \leq C_T - \int_T^t \rho(s)[q(s) + p(s) - r(s)]ds - \int_T^t \frac{k\rho(s)}{a(s)} W^2(s)ds + \int_T^t \frac{\rho'^2(s)a(s)}{4k\rho(s)} ds$$

ku

$$W(t) = w^2(t) - \frac{\rho'(t)a(t)}{2k\rho(t)}.$$

Tani :

$$\rho(s)w(s) \leq C_T - \int_T^t [\rho(s)(q(s) + p(s) - r(s)) - \frac{\rho'^2(s)a(s)}{4k\rho(s)}] ds$$

$$\rho(s)w(s) \leq C_T - \int_T^t R(s)ds,$$

dhe nëse përdoret kushti (6) në relacionin e fundit atëherë vlera kufitare e $\rho(s)w(s)$

kur $t \rightarrow \infty$ është

$$\lim_{t \rightarrow \infty} \rho(t)w(t) = \lim_{t \rightarrow \infty} \frac{\rho(t)a(t)x'(t)}{f(x)} = -\infty,$$

d.m.th $\exists T_1$ ashtu që për $t \geq T_1$ $x'(t) < 0$.

Poashtu nga kushti (6) vlen

$$\int_T^\infty [\rho(s)(q(s) + p(s) - r(s))]ds = \infty, \text{ pra } \exists T_2 \geq T_1 \text{ et ashtu që}$$

$$\int_{T_1}^{T_2} [\rho(s)(q(s) + p(s) - r(s))]ds = 0 \quad \text{dhe} \quad \int_{T_2}^t [\rho(s)(q(s) + p(s) - r(s))]ds \geq 0$$

për $t \geq T_2$.

Nga ana tjetër nëse ekuacionin (1) e shumëzojmë me $\rho(t)$ dhe integrojmë me pjesë, kemi

$$\rho(t)a(t)x'(t) \leq C_{T_2} + \int_{T_2}^t \rho'(s)a(s)x'(s)ds - \int_{T_2}^t f(x)\rho(s)(q(s) + p(s) - r(s))ds$$

$$\rho(t)a(t)x'(t) \leq C_{T_2} - f(x(t)) \int_{T_2}^t \rho(s)(q(s) + p(s) - r(s))ds +$$

$$+ \int_{T_2}^t x'(s)f'(x(s)) \int_{T_2}^s \rho(s)(q(s) + p(s) - r(s))ds$$

prej nga duke pas parasysh shenjat e $x'(t)$, $f(x(t))$, $f'(x(t))$ fitojmë

$$\rho(t)a(t)x'(t) \leq C_{T_2} \quad (9)$$

për $t \geq T_1$, si dhe nga $\rho(t) > 0, a(t) > 0, x'(t) < 0$ marrim

$$C_{T_2} = \rho(T_2)a(T_2)x'(T_2) < 0$$

me jka nga (9) nëse integrojmë anë për anë fitojmë :

$$x(t) \leq C_{T_2} \int_{T_2}^t \frac{1}{\rho(s)a(s)} ds, \quad (10)$$

i cili sipas kushtit (9) dhe shenjës së $C_{T_2} < 0$ shkruajmë

$x(t) \rightarrow -\infty$, kur $t \rightarrow \infty$ që është në kundërshtim me supozimin tonë që $x(t) > 0$.

Me këtë vërtetimi i teoremës është i kompletuar.

Nëse në vazhdim në raste të caktuara mund të marrim

$q(t) + p(t) - r(t) = \varphi(t)$ atëherë për $R(t)$ marrim

$$R(t) = \rho(t)[\varphi(t)] - \frac{\rho^2(t)a(t)}{4k\rho(t)}.$$

Duke marrë në konsideratë funksionin $H(t,s)$ të përkufizuar si në vijim dhe kushtet (2),(3) (4), fitohet relacion që përcakton natyrën e zgjidhjeve oshiluese të (1).

Themi se funksioni $H = H(t,s)$ i takon klasës X , shkruajmë $H \in X$, nëse $H \in C(D, R_+)$, ku $D = (t_0, \infty)$, $t_0 > 0$ me kushtet $H(t,s) > 0$, për $t > s > t_0$, $H(t,t) = 0$ dhe $\frac{\partial H(t,s)}{\partial s} = -h(t,s)\sqrt{H(t,s)}$. Atëherë vlen kjo.

Teoremë: Le të vlejné (2),(3)dhe (4) atëherë (1) është oshilatorik nëse

$$\limsup_{t \rightarrow \infty} \frac{1}{H(t, T)} \int_T^t H(t, s) \left(\varphi(s) - \frac{a(s)h^2(t, s)}{4k} \right) ds = \infty \quad (10)$$

Vërtetim: Supozojmë të kundërtën se $x(t)$ është zgjidhje jooshilatorike pra gjendet T ashtu që për $t > T$, $x(t) > 0$ (ngjashëm tregohet edhe për $x(t) < 0$).

Nëse relacioni (7) shumëzohet me $H(t, s)$ dhe integrohet anë për anë nga T deri në t marrim

$$\int_T^t H(t, s) w'(s) ds \leq - \int_T^t H(t, s) \varphi(s) ds - \int_T^t H(t, s) \frac{f'(x(t))w^2(s)}{a(s)} ds$$

$$\leq - \int_T^t H(t, s) \varphi(s) ds - \int_T^t H(t, s) \frac{k w^2(s)}{a(s)} ds,$$

$$\text{ku } \varphi(s) = p(s) + q(s) - r(s)$$

dhe nëse integrojmë me pjesë për

$$u = H(t, s), du = \frac{\partial H(t, s)}{\partial s} ds, v = \int w'(s) ds = w(s),$$

kemi

$$\begin{aligned} & H(t, s)w(s) \Big|_T^t - \int_T^t w(s) \frac{\partial H(t, s)}{\partial s} ds \leq \\ & - \int_T^t H(t, s) \varphi(s) ds - \int_T^t H(t, s) \frac{k w^2(s)}{a(s)} ds \\ & \int_T^t H(t, s) \varphi(s) ds \leq H(t, T)w(T) - \int_T^t H(t, s) \frac{k w^2(s)}{a(s)} ds - \int_T^t w(s) h(t, s) \sqrt{H(t, s)} ds \\ & = H(t, T)w(T) - \int_T^t (\sqrt{H(t, s)}w(s))^2 \frac{k}{a(s)} ds - \int_T^t w(s) \sqrt{H(t, s)} h(t, s) ds \\ & = H(t, T)w(T) - \int_T^t \frac{k}{a(s)} (\sqrt{H(t, s)}w(s) - \frac{1}{2} h(t, s))^2 ds + \int_T^t \frac{h^2(t, s)}{4k} a(s) ds \end{aligned}$$

nga $a(s) > 0$ për $s > T$, kemi

$$\int_T^t H(t, s) \varphi(s) ds \leq H(t, T)w(T) + \int_T^t \frac{h^2(t, s)a(s)}{4k} ds$$

prej nga

$$\frac{1}{H(t, T)} \left\{ \int_T^t H(t, s) \varphi(s) ds + \int_T^t \frac{h^2(t, s)a(s)}{4k} ds \right\} \leq w(T)$$

$$\frac{1}{H(t,T)} \left\{ \int_T^t H(t,s) \varphi(s) + \frac{a(s)h^2(s)}{4k} ds \right\} \leq w(T),$$

i cili kontradicion $\infty \leq w(t)$ e vërteton teoremën.

Duke u bazuar në pohimin e mësipërm është i vërtetë ky;

Rrjedhim: Le të plotësohen kushtet (2),(3),(4) . Nëse

$$\limsup_{t \rightarrow \infty} \frac{1}{(t-T)^{2n}} \int_T^t \left\{ (t-s)^{2n} \varphi(s) - \frac{a(s)n^2(t-s)^{2(n-1)}}{k} \right\} ds = \infty$$

atëherë (1) është oshilatorik.

Vërtetim: Nga teorema e mësipërme për

$$H(t,s) = (t-s)^{2n}$$

që plotëson kushtet

$$H(t,t) = 0, H(t,s) > 0, \text{ për } t > s$$

dhe

$$-\frac{\partial H(t,s)}{\partial s} = 2n(t-s)^{2n-1} \text{ dhe } h(t,s) = \frac{2n(t-s)^{2n-1}}{(t-s)^n} = 2n(t-s)^{n-1}$$

me jka vërtetimi është i kompletuar.

Kështu mund të konstruktohen edhe funksione tjera që plotësojnë kushtet e mësipërme.

Në vazhdim kemi në konsideratë ekuacionin jolinear diferencial të rendit të dytë të formës

$$(a(t)x'(t))' + q(t)x(t) = 0 \quad (11)$$

ku $a(t) \in C^1([t_1, t_2], R^+)$ dhe $q(t) \in C([t_1, t_2], R)$,

i cili mund të fitohet nga ekuacioni (1) në kushte të caktuara.

Në [8] është prezentuar kriter verifikues jooshilatorik për ekuacionin (1), i cili jepet me anë të teoremës.

Teoremë 2: Ekuacioni (11) është jooshilatorik nëse dhe vetëm nëse ekziston $T > t_0$ dhe funksioni $h(t) \in C^1([T, \infty), R)$, i cili e plotëson jobarazimin

$$q(t) + a(t)h^2(t) - (a(t)h(t))' \leq 0, \text{ për } t \geq T.$$

Duke u bazuar në këtë teoremë marrim

Rrjedhim 2. Nëse $a'(t) \leq 0$, për $t \geq t_0$, $l(t) \geq 1$, për $t > T$ dhe

$$\limsup_{t \rightarrow \infty} \frac{t^2 l(t) q(t)}{a(t)} < \frac{1}{4}, \quad (11)$$

atëherë ekuacioni (11) është jooshilatorik.

Me të vërtet nga (11) ekzistojnë numrat $T \geq t_0$ dhe $c < \frac{1}{4}$ ashtu që

$$\frac{t^2 q(t) l(t)}{a(t)} \leq c, \text{ prej nga } q(t) \leq \frac{ca(t)}{t^2 l(t)} \text{ për } t \geq T.$$

Le të marrim $h(t) = -\frac{1}{2t}$, atëherë

$$\begin{aligned} & q(t) + a(t)h^2(t) - (a(t)h(t))' \leq \\ & \leq \frac{ca(t)}{t^2 l(t)} + \frac{a(t)}{4t^2} - \frac{a'(t)}{-2t} - \frac{a(t)}{2t^2} \leq \frac{ca(t)}{t^2} + \frac{a(t)}{4t^2} + \frac{a'(t)}{2t} - \frac{a(t)}{2t^2} = \\ & = a(t) \frac{4c-1}{4t^2} - a'(t)h(t) \leq 0, \text{ për } t \geq T. \end{aligned}$$

Konkretisht sipas rrjedhimit (11) mund të konstruktohen edhe funksione tjera .

Literatura

1. Kiguradze I.T. On the oscillation of solutions of the equation $\frac{d^m u}{dt^m} + a(t)|u|^n \operatorname{sign} u = 0$, Mat.Sb. 65 172-187 (Russian)
2. Chanturia, T. A. Kiguradze, I. T. Asimtotic properties nonautonomous ordinary differential equations, Nauka moskow 1990 (Russian)
3. B. Bakulikova , Oscillation criteria for second order nonlinear diferential equations (2006) archivum mathematicum Brno .
4. Moussadek Remli; Oscillation criteria for second order nonlinear perturbed diferential equations ; 2010.
5. Horn Jaan Li; Oscillation criteria for half –linear second order differential equations may 31, 1995
6. wang T. L. Interval oscillation criteria for nonlinear second – order differential equations , july 2001
7. Wang T.L. Interval oscillation criteria for nonlinear second – order differential equations with damping , september 2003.
8. Ravi P. Agarval, Said R. Grace, Donal O'Regan ;Oscillation Theory for second order linear, half-linear superlinear and sublinear dynamic equation 2002 Florida institute of technology



Dr. Fatmir TARTALE

*Zv.dekan i Fakultetit të Shkencave shoqërore
U.F.O University, Tiranë*



Ma. Gerti TARTALE

Jurist

E DREJTA PËR INFORMIM SI NJË E DREJTË E ÇDO QYTETARI, E GARANTUAR NGA KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Hyrje

Në rrethanat e një realiteti, i cili nga dita në ditë zhvillohet me një dinamikë intensive, e drejta për informim, mund të konsiderohet padyshim si një nga elementet bazë të një shoqërie, e cila prej disa vitesh përpiqet të lërë pas të kaluarën e tranzicionit. Në këtë kontekst, studimi ka në fokus të tij konfrontimin e ngjarjeve dhe fenomeneve të ndryshme të shfaqura përgjatë periudhës pas vitit 1990, përkundrejt një pasqyre rregullative ligjore të së drejtës së informimit në Shqipëri.

Studimi shtrihet në tre linja kryesore: Linja e parë është ajo e paraqitjes së një pamjeje të përgjithshme të legjislacionit, i cili rregullon në përgjithësi fushën e marrëdhënieve të informacionit. Linja e dytë është pasqyrimi i fenomeneve që kanë shoqëruar transformimin e shoqërisë mediatike shqiptare, si një nga faktorët që kanë ndikuar ndjeshëm jo vetëm në përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit të kësaj fushe në tërësi, por nga ana tjetër edhe si një forcë që ka inspiruar në transformimin edhe të mentalitetit të shoqërisë. Linja e tretë është ajo e parashtrimit të nevojës për ndryshimet konkrete në aktet rregullative ligjore, të cilat rregullojnë marrëdhëniet e fushës së informimit në përgjithësi,

por në veçanti, studimi parashtron edhe rastet kur duhet të bëhen ndryshimet konkrete në funksion të mirëpërcaktimit të të drejtave dhe detyrimeve përkatëse të subjekteve që marrin pjesë në këtë marrëdhënie juridike.

Duke synuar në arritjen e konkluzioneve sa më të përshtatshme, në studim janë analizuar ngjarje dhe rrethana të ndryshme, të cilat e argumentojnë më së miri qëllimin e këtij studimi, i cili në vetvete synon të lançojë disa ide mbi mundësinë e përmirësimit të legjislacionit shqiptar për informimin në përgjithësi, por edhe integrimin e tij me legjislacionin në tërësi.

E drejta për informim është evidentuar dhe gjen mbrojtje në një sërë aktesh ndërkombëtare, siç janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e 10 dhjetorit 1948, në nenin 19 të saj; Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut e dt 4. 11. 1950, në nenin 10 të saj, që bëjnë fjalë për lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim, etj.

E drejta për informim është trajtuar në përgjithësi së bashku me të drejtën e lirinë e shprehjes dhe të shtypit në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pas së drejtës së jetës. E drejta e informimit është parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku ligjvënësi e ka definuar si më poshtë:

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

E drejta për informim si e drejtë kushtetuese

E drejta për të marrë informacion është një e drejtë e individit dhe jo e shtetit, i cili ka për detyrë ta garantojë. Veprimtaria e organeve shtetërore dhe e personave që ushtrojnë funksione shtetërore, duhet të jetë transparente dhe e hapur për të gjithë, aq më tepër për shtypin, i cili këtë informacion ia bën të ditur publikut të gjerë. E drejta e informimit është thelbësore për zhvillimin e një shoqërie pluraliste dhe për mbarëvajtjen e demokracisë në vend. Vetëm nëpërmjet këtij informimi, shtetasit do të jenë në gjendje të vlerësojnë drejt e në mënyre reale se si e ushtrojnë mandatin e të zgjedhurit e tij dhe nëpërmjet këtij vlerësimi, të ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes. E drejta e informimit për veprimtarinë e organeve shtetërore, nga këto organe, duhet kuptuar si një e drejtë e çdo personi për të marrë informacion, për të cilin ai është i interesuar. Autoritetet shtetërore janë të detyruara të krijojnë lehtësitë e nevojshme për të mos penguar gëzimin e kësaj të drejte.

Parashikimi në ligjin themeltar për të drejtën e pjesëmarrjes dhe informimit në mbledhjet e organeve të zgjedhura si: Kuvendi i Shqipërisë, Këshillat e Bashkisë, Këshillat e Komunës dhe Këshillat e Qarqeve, tregon realizimin e një të drejte të pjesëmarrjes së personave të interesuar, të informacioneve në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke qenë të pranishëm në këto mbledhje. Kjo e drejtë buron edhe nga çka parashikohet në Ligjin Nr. 8475, dt 12. 05. 1999 neni 3 i (Kodit të Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë), në të cilin është parashikuar se: “Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumente zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet.

“Autoriteti publik është i detyruar të japë informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe”.¹⁾

Për sa i përket kufizimit të së drejtës së informimit, ajo mund të bëhet, për të mbrojtur interesa të tjera si sigurimi kombëtar, procedimi penal, reputacionin dhe të dhënat personale të personave të tjerë. Këto kufizime ligjvënësi i janë përcaktuar qartazi në Nenin 4 të Ligjit nr. 8503, dt 30. 06. 1998 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ku është parashikuar: Nëse informacioni i kërkuar për një dokument zyrtar kufizohet me ligj, autoriteti publik i lëshon kërkuarës një deklaratë me shkrim, në të cilën tregohen arsyet e marrëdhënies së informacionit dhe rregullat në bazë të të cilave ai mund t’i kërkojë”²⁾.

Duke ju referuar praktikës së gazetave, televizioneve dhe mediave në përgjithësi, akoma edhe sot del në pah ndikimi i tyre për probleme që lidhen me luftën kundër fenomeneve si korrupsioni, shkeljet e ligjeve etj. Por, megjithatë gazetarët hasin në pengesë e vështirësi në sigurimin e informacionit nga organet shtetërore dhe administratat e tyre. Ka raste siç janë publikuar në shtyp e në televizion që gazetarëve nuk u vihen në dispozicion dokumente, refuzohet t’u jepen intervista për probleme të rëndësishme dhe me interes për publikun, që kanë të bëjnë me mosrespektimin e të drejtave të njeriut, keqmenaxhimin e punës dhe të administrimit të fondeve të caktuara për objekte që janë ndërtuar apo janë në proces pas tenderave të zhvilluar etj. Efekti i publikimeve në media në këtë drejtim ka qenë pozitiv dhe pas publikimeve e verifikimeve që janë bërë nga organet e administratës dhe agjencitë e zbatimit të ligjit janë marrë masa për të rivendosur gjendjen. Kjo situatë kapërcehet, në radhë të parë, me këmbënguljen e gazetarëve në kërkimin e dokumenteve atyre zyrtareve të administratës shtetërore, që janë

1. Ligji Nr. 8475, dt 12. 05. 1999 neni 3 i (Kodit të Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë)

2. Ligji nr. 8503, dt 30. 06. 1998 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

të detyruar t'ua japin në zbatim të ligjit. Insistimi për marrjen e dokumenteve në rrugë ligjore ka rëndësi të madhe, pasi marrja e këtyre dokumenteve sipas kërkesave të ligjit dhe saktësia e tyre e bën të besueshëm informacionin dhe nuk le shteg për keqinterpretime. Prej vitesh janë hapur padi penale, që nga fillimi i ndryshimeve demokratike në Shqipëri e në vazhdim deri më sot. Gjatë kësaj periudhe ka ndodhur që janë arrestuar dhe u dënuan me burg dy gazetarë për një shkrim të botuar dhe që më pas kanë marrë pafajësi nga gjykata. Po t'u referohemi 28 vendimeve gjyqësore për vitet 2001-2009-vjeçare, konstatojmë se gazetarët apo botuesit e tyre paditën penalisht për veprat penale të fyerjes dhe të shpifjes të parashikuara nga nenet 119, 120 të Kodit Penal dhe për dëmshpërblimin civil. Gjykatat i kanë pushuar në përgjithësi ato, pasi nuk kanë konstatuar ekzistencën e veprave penale apo detyrimeve civile; ose vetë personat që kanë ngritur ato kërkesa para organeve të procedimit kanë hequr dorë nga procedimi penal apo civil i kërkuar.

Praktika ka treguar që media e shkruar dhe elektronike, jo rrallë, ka qenë e para që ka bërë me dije shkelje të rënda të ligjit, nga persona që ushtrojnë funksione shtetërore; që kanë çuar organet më të larta të marrin masa para fillimit të procedimit penal kundrejt punonjësve të thjeshtë të administratës publike, ata të nivelit të mesëm dhe deri në prokurorë, gjyqtarë deri edhe në titullarë institucioni qendror të administratës shtetërore.

Vlen të nënvizohet se pas marrjes së informacionit nga gazetari a duhet të tregojë ai në rast se i kërkohet burimi nga e ka marrë informacionin apo jo. Disa mendojnë se nuk duhet të tregohet burimi i informacionit për shumë arsye. Një prej të cilave është ruajtja e këtij burimi nga kundërvënia që mund t'i bëjnë atij individët apo pasojat kur është punonjës i administratës shtetërore. Ka mendime që burimi i informacionit nuk duhet të mbetet anonim, por duhet t'i bëhet prezent publikut për të qenë informacioni i besueshëm. Kjo mbështetet dhe nga gazetarë të njohur, të cilët janë shprehur se: "Mbështetja në fakte me bazë burimore të besueshme ka të bëjë me përgjegjësinë e gazetarit dhe të medias përpara opinionit publik, prandaj lexuesve ose shikuesve duhet gjithmonë t'u thuhet burimi i informacionit. Ata gjykojnë për vlerën e një informacioni, vetëm pasi të dinë burimin e tij"³). Këto mendime janë të drejta, sepse dhe ligji "Për shtypin" nuk ka ndonjë kufizim apo klauzolë që të parashikojë detyrimin e gazetarëve për të publikuar burimet e informacionit dhe parashikimet e nenit 10 të Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut⁴), si dhe nenet 22, 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë⁵), ku është

3. Hamit Borici, Konferenca "Dukuri dhe probleme të gazetarisë", fq.14. 30 Maj 2008.

4. Konventa Europiane e të Drejtave të njeriut, Neni 10

5. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Neni 22, 23. 11

parashikuar e drejta për informim dhe liria e shtypit. Mendoj që burimi duhet identifikuar para gjykatës, referuar në atë çka parashikon ligjvënësi në Kodin tonë të Procedurës Penale, pikërisht në ato të nenit 159/3 të tij, që bëjnë fjalë: “Për ruajtjen e sekretit profesional” për ata që nuk dëshmojnë, për sa dinë për shkak të profesionit. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar përjashtimi nga rregulli për të mos dëshmuar, ata të cilët marrin informacion për shkak të profesionit, duke përcaktuar se: “Dispozitat e parashikuara nga paragrafi 1 dhe 2 zbatohen edhe për gazetarët profesionistë lidhur me emrat e personave nga të cilët ata kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Por, kur të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit”⁶⁾. Deri më tani praktika e organeve të hetimit paraparak dhe ajo gjyqësore nuk ka pasur rast për të pyetur gazetarët si dëshmitarë në gjykim dhe për të shkuar më tej për zbulimin e burimit të informacionit, për emrat e mbiemrat e tyre, por në veprimtarinë e medias duhet të mbahet parasysh ligji aktual në fuqi dhe në rast nevojë ai do të respektohet nga organet gjyqësore dhe besoj dhe nga gazetarët, nëse do të jemi para kushteve që kërkon ligji dhe do të jenë interesat e drejtësisë për dhënien e fajësisë apo pafajësisë një personi të vënë nën akuzë e që gjykohet nga gjykatat shqiptare.

Në radhë të dytë, kur hasen pengesa për mosdhënie informacioni të kërkuar, gazetarët nuk duhet të tërhiqen e të heqin dorë, por të jenë kërkues deri në fund, duke ndjekur si rrugën që aplikohet gjerësisht sot nga gazetarët, duke shfrytëzuar njohjet personale të tyre në organet e ndryshme të shtetit dhe në rrugën administrative të ankimit, duke ju drejtuar me kërkesë organit më të lartë të administratës shtetërore, i cili ka në vartësi organin të cilit ai i është drejtuar më parë, organet e pushtetit qendror dhe vendor, entet publike, organet monokratike dhe vetë drejtuesit e lartë të këtyre institucioneve, duke përfshirë këtu edhe organet e forcave të armatosura, të sistemit gjyqësor, sigurisë kombëtare për sa kohë një gjë e tillë nuk parashikohet ndryshe nga ligji. Mendojmë se Ligji i informimit ka nevojë të pasurohet dhe të parashikojë shkurtimin e afateve të dhënies së dokumenteve apo informacionit dhe që informim të ketë edhe për shoqëritë ku shteti është aksioner apo shoqëri private që kryejnë shërbime që lidhen ngushtësisht me funksione publike, që publiku ka interes të informohet se si e kryejnë ato shërbimin për të. Në radhë të tretë, publikimi i artikullit me atë informacion që disponon, duke pasqyruar dhe kërkesat dhe mosdhënien e informacionit sipas ligjit, shkeljen e dispozitave

6. Kodi i Procedurës së Shqipërisë, Neni 159/3

ligjore dhe për personin përgjegjës që refuzon të japë informacionin sipas ligjit e deri në procedimin administrativ apo penal të personit kompetent që ka autoritetin ligjor për të dhënë informacionin e kërkuar apo për të nxjerrë urdhrin për dhënien e informacionit. Ushtrimi i të gjitha të drejtave për të kërkuar nga ankimi administrativ, publikimi në mediat e shkruara dhe ato elektronike për këtë shkelje të hapur të ligjit, vonesa për dhënien e tij jashtë afateve të parashikuara në ligj do të çojë në atë që informacioni i kërkuar të jepet sa më shpejt, që shtypi të informojë publikun për çdo problem që ai është i shqetësuar e ka interes të vihet në dijeni.

E drejta për informim për subjekte me funksione shtetërore dhe liria e shprehjes në median e shkruar dhe atë elektronike

E drejta për informim, e drejta e jetës private dhe ajo e lirisë së shprehjes për çdo qytetar të këtij vendi gjejnë pasqyrim në aktet ndërkombëtare dhe në ato kombëtare dhe duket sikur përplasen me njëra-tjetrën. Në Artikullin 19 të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut shprehet se: “Liria e Opinioneve dhe e Shprehjes është e drejtë e çdokujt, kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur opinione personale pa ndërprerje dhe për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion dhe ide nëpërmjet të gjitha mediave, pa u kushtëzuar nga kufijtë”⁷⁾.

Veprimtaria e organeve shtetërore dhe e personave që ushtrojnë funksione shtetërore ose shërbime publike duhet të jetë transparente për publikun. Që të vlerësohen sa më drejt dhe e sa më realisht e me përgjegjësi përpara publikut të gjerë dhe që ata të dinë se si sillen zyrtarët në ushtrimin e funksioneve publike brenda zyrave të tyre e jashtë tyre si përfaqësues të tyre, si e kryejnë ata detyrën ndaj taksapaguesve, gjithmonë kur ata janë në ushtrim të funksioneve të tyre si nëpunës publikë, funksionarë politikë apo të zgjedhur, kudoqoftë ai. Edhe në këto raste e drejta për të marrë informacion dhe për të dhënë nga media e shkruar apo ajo elektronike, duhet të ketë parasysh një balancë të caktuar ndërmjet të drejtës për t’u informuar publiku i gjerë dhe të drejtës së tij për pacënueshmërinë e jetës private dhe mbarëvajtjes shoqërore. Natyrisht, këtu nuk e kemi fjalën për të dhënat personale që mbrohen nga Ligji Nr. 8517, datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”⁸⁾, por për të dhëna të marra nga media në jetën e përditshme të tyre, nëpërmjet intervistave, fotografimeve apo filmimeve të tyre kur ata ushtrojnë detyrën apo funksionin.

7. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. 10 Dhjetor 1948. Neni 19

8. Ligji Nr. 8517, datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Në këtë rast lind pyetja: A duhet t'i publikojnë çka konstatojnë apo jo? E drejta për t'u informuar e pasqyruar për publikun gjithçka, rrjedh edhe nga zbatimi i nenit 8 dhe 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Ka ndodhur në vendin tonë ku janë filmuar apo fotografuar zyrtarë të rangjeve të ndryshme deri në ato më të larta të administratës shtetërore, kanë lindur diskutime nëse duhet apo jo të publikohen fotografi apo filmime e regjistrime audio e video. Për këto raste mendoj se është pasur në konsideratë praktika e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut e Strasburgut. Në vendimet e të cilës është pasur parasysh, si liria e shtypit dhe interesi legjitim i publikut për të ditur sesi një person i tillë sillet duke qenë në krye të detyrës apo duke e ushtruar atë. Rëndësi ka ruajtja e balancës e së drejtës për informim e shprehje dhe mbrojtjes së jetës private e të interesit të përgjithshëm të publikut. Mendoj se filmimet e dhëna për rastet e korrupsionit të zyrtarëve në ushtrimin e detyrës kanë qenë me interes për publikun e gjerë. Publiku ka të drejtë të njihet me sjelljen e veprimtarinë e zyrtarëve dhe funksionarëve të emëruar apo të zgjedhur, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës, në zyrë apo jashtë saj, në çdo ambient publik e jo publik, sidomos kur abuzojnë me funksionin dhe në sajë të tij, kryejnë veprime që cenojnë imazhin e një zyrtari të shtetit. Në këto raste e drejta për informim e shprehje prevalon mbi atë të privatësisë së jetës së tyre private.

Pavarësisht nga mendimet e ndryshme në këtë drejtim organet qendrore të shtetit nuk kanë nguruar të marrin masa ndaj këtyre individëve, që nga shkarkimet nga detyra dhe me tej deri në heqjen e imunitetit parlamentar të dy deputeteve, imunitet të cilin ata pavarësisht nga kërkesa e Prokurorit e kanë kërkuar vetë që ta lënë imunitetin sa kohë hetohet çështja nga prokuroria, siç ka qenë rasti i videos së publikuar në media i bisedës së filmuar të ish ministrit të Ekonomisë dhe ish zv.kryeministrit shqiptar. Fakti që është mbajtur qëndrim ndaj këtyre individëve të veshur me pushtet dhe që veprojnë në sajë të detyrës, pas publikimit në media, tregon për atë që media ka bërë punën e vet me luftën kundër korrupsionit dhe veprimeve të pamoralshme apo të paligjshme të konstatuara prej saj, në zbatim të të drejtave që ka ajo, të cilat rrjedhin nga zbatimi i nenit 8 e 10 i Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut, i nenit 22, 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjeve respektive, por që gjithsesi duhet pasur parasysh rast pas rasti dhe do bërë kujdes për respektimin e të drejtës për jetën private dhe kur prevalon interesi të ligjshëm për informim i publikut dhe lirinë e shprehjes.

E drejta për informim dhe publikimi në media i informacioneve që kanë lidhje me fushën e administrimit të drejtësisë

Në kuadrin e të drejtës për informim dhe lirisë së shprehjes, në veprimtarinë e përditshme të shtypit shqiptar, sidomos kohët e fundit janë publikuar në shtypin e shkruar, por dhe në mediat elektronike se në “Gazetën Shqiptare” e televizionin NEWS 24, dokumente të cilat ndodhen në fashikullin e procedimit të çështjes së tragjedisë së Gërdecit. Ka pasur debate nëse duhet të publikohen ato, kur kanë të bëjnë me një fashikull procedimi penal, i cili i ka kaluar gjykatës për gjykim, nëse janë sekrete apo jo. Mendoj se nëse janë sekrete apo jo aktet e hetimit paraprak, ato, së pari, duhet të përcaktohen nga organi procedues, në rastin konkret Prokuroria, e cila, duke iu referuar Ligjit Procedural Penal dhe Ligjit “Për informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror Nr. 8457 date 11.02.1999⁹”, të jetë shprehur për ndalimin e publikimit me akt procedural. Këtu kemi parasysh dhe paragrafin e dytë të nenit 103 të Kodit të Procedurës Penale që ndalimi i publikimit qoftë dhe i pjesshëm i akteve jo sekrete është i lidhur me përfundimin e hetimeve. Kjo çështje është përfunduar nga Prokuroria. Fashikulli i prokurorit për këtë çështje ndodhet në gjykatë dhe po gjykohet në një gjykim me dyer të hapura. Një numër i konsiderueshëm dokumentesh të kësaj çështjeje janë publikuar edhe më parë në media, kështu në rastin konkret nuk kemi nxjerrje dhe publikim sekreti të akteve që janë vënë në dispozicion të medias. Dokumentet e informacionet janë publikuar para se të akuzohen dhe pasi janë akuzuar personat nën hetim, duke qenë burim i këtyre informacioneve e dokumenteve vetë të interesuarit që ishin drejt procedimit penal ose ishin akuzuar. Ajo në kuadrin e informimit të publikut për një çështje që është me shumë interes për të, publikon akte e dokumente të këtij fashikulli të procedimit penal, të cilat i disponojnë dhe të akuzuarit e mbrojtësit e tyre. Gjykata e të Drejtave të Njeriut në rastin “Sunday Times” kundër Mbretërisë së Bashkuar ka shqyrtuar ankesën ndaj vendimit të marrë nga Gjykata e Lartë e Mbretërisë së Bashkuar për ndalimin e publikimit të një artikulli botuar në gazetën e përjavshme britanike “The Sunday Times”, ku bëhej fjalë për lindjen e qindra fëmijëve me deformime të rënda për shkak të përdorimit të një mjekimi talidomid me anë të qetësuesve nga nënat shtatzëna, të cilat kishin hedhur në gjyq fabrikuesin dhe shitësin e këtij mjekimi, Distillers Company Ltd. GJETDNJ ka arritur në konkluzionin se “... Jo vetëm që masmedia ka për detyrë të komunikojë informacione dhe ide mbi problemet që shqyrtojnë gjykatat, por se dhe publiku i gjerë ka të

9. Ligji Nr. 8457 dt. 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar si sekret shtetëror”

drejtë t'i marrë ato. Ndalimi nuk ishte proporcional me qëllimin legjitim të ndjekur, pra, nuk ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike për të mbrojtur autoritetin e gjyqësorit". Pra, ka pasur shkelje të nenit 10/2 të KEDNJ¹⁰⁾. Natyrisht, më parë, në vitin 2003, Këshilli i Ministrave ka tentuar të ndalojë dhënien e informacioneve nga punonjësit e administratës shtetërore, e ka nxjerrë akt për ndalimin e dhënies së të dhënave e informacioneve shtypit. Por ai është shfuqizuar, pasi shtypi dhe organizatat jo qeveritare kanë reaguuar ndaj këtij akti të nxjerrë nga Këshilli i Ministrave. Publikimin nga gazetatat të informacioneve të sipërme, nuk e kufizon asnjë akt i marrë nga ndonjë organ kompetent sipas kompetencave që u jep ligji; se së dyti nuk ka ndonjë klasifikim se cilat nga këto akte që kopjet i disponojnë vetë dhe u janë dhënë sipas të drejtës që parashikon neni 105 i Kodit të Procedurës Penale të akuzuarve e mbrojtësve të tyre, kur janë përfunduar hetimet. Nuk kemi asnjë arsye të mendojmë se botimi i akteve për çeshtjen "Gërdeci" apo artikujve në gazeta do të ndikojnë në publikun e gjerë për të paragjykuar rezultatin e gjykimit. Në një shoqëri demokratike si e jona, parimi i lirisë së shprehjes ka rëndësi të madhe të zbatohet edhe në fushën e administrimit të drejtësisë si dhe në fusha të tjera, për arsyen se jo vetëm media ka për detyrë të publikojë e t'i komunikojë publikut informacione dhe ide për probleme që e shqetësojnë atë, kur ato shqyrtohen nga gjykatat, por edhe se publiku ka të drejtë të njihet me këto informacione për probleme që e shqetësojnë atë dhe ka interes të informohet.

E drejta për informim dhe respektimi i ligjit për publikimet në media për të miturit

Liria e fjalës dhe e shprehjes së mendimeve dhe e informacionit është një nga të drejtat themelore të njeriut. Referuar nenit 10/1 të Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut; "Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione ose ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë..."¹¹⁾ del se liria për të dhënë informacione dhe ide është e rëndësishë madhore për jetën politike, ekonomike, kulturore, sociale dhe strukturën demokratike të një vendi. Liria e shprehjes është një kriter pa të cilin liritë e tjera nuk do të mund të realizoheshin. Mjetet për lirinë e shtypit janë të shumta, me shkrim, nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv, mediave elektronike, masmedia, televizioni etj. Media gëzon një mbrojtje të veçantë

10. Iurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut f. 594-596, Tiranë 2005.

11. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, neni 10

nga Kushtetuta, si burim kryesor i informimit publik. Shteti brenda lirisë së tij të vlerësimit, për interesa të sigurimit kombëtar, mbrojtjes së shëndetit dhe moralit, mbrojtjes së reputacionit të të drejtave të të tjerëve, parandalimin e përhapjes së informacioneve të marra në konfidencë, për të ruajtur autoritetin dhe paanësinë e gjyqësorit, mund të kufizojë lirinë e shprehjes. Liria e shprehjes vlen jo vetëm për informacionet ose idetë që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen të padënueshme ose indiferente, por edhe që prekin, trondisin ose shqetësojnë shtetin ose një pjesë të çfarëdoshme të popullsisë.

Në shtypin e përditshëm në vend zënë një vend kryesor aktivitetet pozitive të fëmijëve të thjeshtë dhe ata që shquhen në olimpiada brenda dhe jashtë vendit, gjenitë mes tyre, fjala e tyre për këto arritje pozitive për ta dhe për moshatarët e tyre, zë një vend jo të vogël pasqyrimi në shtyp i kriminalitetit i të miturve. Media në publikimet që bën duhet të ketë në konsideratë nenin 17 të Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e Fëmijës” e 20 nëntorit 1989, ratifikuar në vitin 1992, në të cilin është parashikuar se: “Shtetet palë njohin funksionin e rëndësishëm që përmbushin mjetet e komunikimit masiv dhe garantojnë që fëmija të marrë informacione dhe materiale që vijnë nga burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos ato që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor.”¹²⁾

Ngjarjet e ndodhura me të rritur e fëmijët e mitur, qoftë kur janë viktimat të krimit në familje, të trafikimit, të krimit ordiner e akteve të dhunës apo kur ata janë autorë të veprave penale, trajtohen me detaje. Këtu do të ndalemi, pasi jo rrallë në media publikohen vepra të ndodhura ndaj fëmijëve të mitur apo që ata kryejnë vetë vepra penale dhe shkruhet për ditë të tëra, se çfarë i ka ndodhur një fëmije të mitur nga një kriminel i rritur apo nga një prind i papërgjegjshëm, duke dhënë detaje të krimit të kryer, karakteristika, vendbanimin dhe emrin apo mbiemrin, inicialet e tyre, e në ndonjë rast edhe fotografi të tyre, çka kanë dëshmuar ata për krimin e ndodhur, për aktet e dhunës që kanë parë apo pësuar etj. Një artikull gazete, dëshmia e një fëmije për një krim, del me titullin: “Mendova se ishte kukull, u tmerrova kur pashë kufomën”¹³⁾ Apo në një gazetë tjetër në një artikull është pasqyruar se: “Alarmi, 124 hajdutë të mitur në Tiranë”, i cili shoqërohet me fotografitë, me emra e mbiemra dhe listën e marrë nga policia”.¹⁴⁾

Kjo siç shihet qartë krijon tek njerëzit një ndjenjë pasigurie për jetën, stres të vazhdueshëm dhe çoroditjen e tyre në veprimtarinë e përditshme pas

12. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës, Neni 17, Botim i UNICEF

13. Gazeta Shekulli, 22 tetor 2006

14. Gazeta Shqiptare, 22 maj 2009

azhornimit që në mëngjes të këtyre lajmeve e informacineve të medias, një rrezik për jetën e këtij dëshmitari të brishtë, një cenim të të drejtave të të miturve edhe kur dyshohen se kanë kryer një krim për të cilin nuk dimë se jemi para një fajtori apo jo. Lind pyetja: A është e drejtë në kuptimin moral dhe psikologjik paraqitja e shpjegimeve të të miturve qoftë si dëshmitar që kanë parë aktet e dhunës apo vrasjet, kur kanë qenë viktime e tyre apo të akuzuar, duke publikuar fotot, shpjegimet e shumë të dhëna të tjera që ata i bëjnë të identifikueshëm, a i shërben fëmijëve apo të rriturve? A ka interes për publikun paraqitja në media i këtyre të dhënave apo fotove apo atë ç'kanë përjetuar ata? A i vlen mbrojtjes së fëmijëve të mitur kjo paraqitje në media, a i mbron ata në rast se janë dëshmitarë të një ngjarje të rëndë apo i vë në rrezik jetën e tyre? A u shërben zhvillimit psikik të të miturve, ajo që bëjnë gazetarët nisur nga qëllimi i paraqitjes sa më të saktë të krimit të ndodhur nëpërmjet intervistimit të të miturve? A do të ndikojë negativisht në formimin e tyre, ripërsëritja e atyre momenteve të vështira traumatike që ata kanë përjetuar më parë.

Referuar praktikës së medias në vendin tonë, në përgjithësi janë munduar që të bëjnë përpjekje për të mos u identifikuar ata, por ka raste që dhe nuk janë respektuar këto masa dhe që bëjnë më shumë dëm publikimet se sa informim të publikut. Jam i mendimit se paraqitja e artikujve të ndryshëm me skena dhune, dëshmi rrëqethëse apo të dhëna që e identifikojnë fëmijën e mitur, natyrisht që i bëjnë dëm formimit të tij psikologjik, dëmtimit të edukimit të tij dhe moshatarëve të tij që ndjekin mediat, për çka shkruhet e thuhet, që krijon stres e ndikim negativ tek ata dhe tek të gjithë shikuesit apo lexuesit e mediave. Do të ishte më e udhës, që referuar etikes së medias, të bëhet më shumë kujdes në këtë drejtim, për pasqyrimin e këtyre informacioneve të marra nga terreni apo nga informacionet e dhëna nga Ministria e Brendshme, Prokuroria apo Gjykata.

Të drejtat e njeriut fillojnë me respektimin e të drejtave të fëmijëve. Një shoqëri që respekton të drejtat e fëmijëve, brenda një gjenerate e më tej, mund të bëhet një shoqëri që respekton me rigorozitet të drejtat e njeriut në standardet më të larta.

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht nenit 54 të saj, fëmijëve u garantohej e drejta të kenë një mbrojtje të veçantë, nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi për punë... që mund të dëmtojnë shëndetin, moralin ose të rrezikojnë jetën a zhvillimin e tij normal". Më tej në Kodin e Procedurës Penale, në nenin 103/4 të tij, me qëllim që të ruhen fëmijët e mitur nga publikimi e cenimi i figurës morale e ekspozimi ndaj publikut është parashikuar se: "Ndalohej publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive

të të pandehurve dhe dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale...”¹⁵⁾ Ligjvënësi ka parashikuar edhe sanksione në rast shkelje të këtij ndalimi ligjor, i cili sjell përgjegjësi, sipas rastit, penale, administrative ose disiplinore. Duke evidentuar detyrimet kushtetuese e ligjore, media, pavarësisht se është përpjekur të punojë me seriozitet, në punën e saj të përditshme e ka dhe duhet ta ketë parasysh kujdesin që duhet treguar ndaj fëmijëve, ndaj pasqyrimin të tyre çdo dite, duke respektuar etikën e Kodit Etik të Gazetarëve dhe ligjin, si dhe vëmendjen e duhur e përkushtimin e tyre, duke mos harruar se janë dhe vetë prindër, vëllezër e të afërm të këtyre fëmijëve që evidentohen e pasqyrohen çdo ditë në media, duke i ruajtur ata me sa të mundën që të mos i dëmtojnë psikologjikisht e ata të mos përjetojnë traumat e kaluara.

Veç dhunës, streseve e ngarkesave që pësojnë fëmijët nga evidentimi i tyre në media me fotografi apo me intervistat e marra, një ngarkesë të madhe traumatike sjell edhe publikimi herë pas here në media edhe kur kanë kaluar vite të rasteve të krimeve të rënda të të rriturve që kanë lidhje me ta. Në mjaft raste janë publikuar në media, fotografi dhe artikuj të prindërve të vrarë apo të zhdukur, siç ka qenë rasti i “Çështjes Enrieta Avdyli”, për të cilat është shkruar, janë publikuar pavarësisht nga koha që ka kaluar me vite, fotografi të saj herë pas here veç komenteve të ndryshme, duke u futur dhe në jetën private të kësaj nëne që ka lënë pas dy fëmijë të mitur. Këto publikime në radhë të parë ndikojnë negativisht tek fëmijët e mitur të saj, që lexojnë, shikojnë apo dëgjojnë të tilla gjëra që veç i dëmton ata duke i traumatizuar, duke i shqetësuar e stresuar për çka dëgjojnë për nënën e tyre, por që edhe njohja e opinionit publik me këto informacione për sot dhe për nesër do të sjellë një dëmtim traumatik edhe për më pas për këta fëmijë që rriten

çdo ditë e kuptojnë që nëna e tyre cenohet e përflitet kur nuk duhet të vazhdojnë më, sepse kështu shkelet dhe e drejta e privatësisë së saj e për rrjedhojë dhe e fëmijëve të saj. Këtu nuk bëhet fjalë për përgjegjësi penale dhe për censurë në shkrimet e botuara në media, por përgjegjësi morale, si qytetar dhe si prind dhe si gazetar, të respektojnë etikën profesionale, pasi në fund të fundit shkelen të drejtat e njeriut. Në raste të tilla shtypi duhet të ketë parasysh kërkimet e nenit 8 të Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut në të cilin thuhet se: “Çdokush ka të drejtë që t’i respektohet jeta private e familjare vendbanimi dhe korrespondenca e tij”.¹⁶⁾

Në zbatim të kërkimeve të këtij neni të Konventës, Gjykata e të Drejtave të Njeriut në shqyrtimin e çështjes Von Hanoverr kundër Gjermanisë ka quajtur

15. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, neni 103/4, Tirane 2010

16. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 54, Tiranë 2010

të padrejtë botimin e fotografive të Princeshës Caroline Von Hannover me fëmijët e saj në jetën private, kur ajo kishte paditur shtypin për botimin e tyre me arsyetimin se nuk kishte të drejtë të botonte fotografitë ku ajo kishte dalë me fëmijët e saj, pasi nevoja e këtyre të fundit për mbrojtje të sferës së jetës së tyre private ishte më e gjerë se ajo e të rriturve. Gjykata ka arsyetuar se vërtet që shtypi ka të drejtën e shprehjes, por duhet të ishte mbajtur parasysh faktori vendimtar që baraspeshimi i mbrojtjes së jetës private me lirinë e shprehjes qëndron në kontributin që ofrojnë fotografitë dhe artikujt e botuar në një debat me interes të përgjithshëm.” Në çështjen në fjalë ato nuk dukej se ofronin një kontribut të tillë... fotografitë dhe artikujt kishin të bënin ekskluzivisht me detaje të jetës së saj private”¹⁷⁾ Duke ju referuar jo vetëm akteve ligjore ndërkombëtare, ligjeve në Shqipëri dhe Kodit të Gazetarit del e qartë që gazetari nuk lejohet të futet në jetën private të njerëzve e intimitete e tyre për më tepër t’i publikojë ato. Në pikën 3 “Jeta Private” të këtij Kodi, është nënvizuar: “Publikimi i materialeve që kanë lidhje me jetën private duhet bërë vetëm atëherë kur kjo është në interes të publikut”¹⁸⁾ Në rastet si i sipërmi apo dhe të tjerë si ai, cenohen jo vetëm të rriturit por indirekt prej tyre fëmijët e mitur, qoftë të atyre që jetojnë apo të atyre që nuk jetojnë më, por që kanë fëmijë të mitur. Në këtë drejtim të këtyre botimeve duhet pasur vëmendje e veçantë dhe të tregohet vëmendje e kujdes i posaçëm kur është e domosdoshme botimi i fotografive, të dhënave apo filmimeve për t’i ruajtur sa më shumë si ata që janë viktima të krimit, autorë apo dëshmitarë të veprave penale të ndodhura. Botimet e bëra nga shtypi nuk cenojnë autoritetin e drejtësisë. Shtypi në rastet konkrete por edhe në përgjithësi, duhet vlerësuar dhe inkurajuar që po kryen detyrën me përpikëri, korrektesë dhe kurajo, për informimin e publikut në zbatim të funksionit të tij të informimit me kompetencë e profesionalizëm, pasi kështu jep një ndihmese të rëndësishme për një qeverisje efçente dhe për progresin ekonomik e social në vend. Publikimet për të miturit, në mënyrë të veçantë, për vetë brishtësinë e moshës së tyre, duhet të jenë të rezervuara që të mos cenojnë ndjenjat e njerëzve të rritur e për më tepër të atyre të mitur, të mos krijojnë shqetësim tek ata e stres, të mos vihen në pozitë të vështirë në ambientin shoqëror, të mos i cenojmë dinjitetin, shëndetin e tyre personal. Të gjithë ne dhe media në veçanti, edukimin, mirërritjen e kujdesin për fëmijët ta ketë si një barometër të saktë të ndryshimeve sociale, ekonomike si në çdo shoqëri dhe shtet demokratik.

17. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, Ledio Bjanku, f.511, Tiranë 2005

18. Gazetaria Nr.2, Hamit Borici, f.54,55, Tiranë, 2004

Literatura

1. Ligji Nr. 8475, dt 12. 05. 1999 (Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë).
2. Ligji nr. 8503, dt 30. 06. 1998 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.
3. Borici H., Konferenca “Dukuri dhe probleme të gazetarisë”. Tiranë, 2008.
4. Konventa Europiane e të Drejtave të njeriut. Tiranë, 2010.
5. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Tiranë, 2010.
6. Kodi i Procedurës së Shqipërisë, Tiranë, 2010.
7. Përmbledhje aktesh ndërkombëtare. Tiranë, 1993.
8. Ligji Nr. 8517, date 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
9. Ligji Nr. 8457 dt. 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar si sekret shtetëror”
10. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut. Tiranë, 2005.
11. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës, Neni 17 Botim i UNICEF.
12. Gazeta “Shekulli”, 22 tetor 2006.
13. “Gazeta Shqiptare”, 22 maj 2009.
14. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, neni 103/4, Tiranë, 2010.
15. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2010.
16. Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, Ledio Bjanku. Tiranë, 2005.
17. Borici H., Gazetaria Nr.2. Tiranë, 2004.



Magjistër Brahim (Ibish) AVDYLI

ZVICRA PËR SHQIPTARËT DHE ÇËSHTJEN SHQIPTARE

Zvicra është një vend karakteristik, i cili ka 40 000 km² dhe mbi 700 liqene të madhësisë së ndryshme. Ajo karakterizohet me alpe të larta e të pasura me kullosa, kurora e të cilave shtrihet në drejtimin verilindje dhe jugperëndim. Alpet zvicerane shquhen me bukurinë, vazhdimësinë dhe lartësinë e majave. Ky shtet ka 7 milionë banorë, ku rreth mbi 2 milionë janë të huaj, apo 35 për qind të popullsisë, që në pjesën më të madhe i nënshtrohet shtetëzimit, d.m.th. asimilimit. Një pjesë të madhe të tyre e përbëjnë shqiptarët, të cilët, deri në vitin 1990-1999 kanë qenë të regjistruar me kombësi të shteteve të krijuara me dhunë në kurrizin e tyre dhe më vonë kanë arritur të regjistrohen si shqiptarë, respektivisht si kosovarë. Aty merren edhe emigrantët e Maqedonisë, që janë kryesisht shqiptarë.

Zyrtarisht, mendohet se në Zvicër banojnë 250.000 banorë shqiptarë nga Kosova. Prej tyre, rreth 50.000 e kanë marrë shtetësinë zvicerane, në 15 vitet e fundit. Nëse del nëpër rrugë ku shëtisin banorët, rrjedhimisht çdo i dyti apo i treti të flet shqip. Kjo të jep përshtypjen se ke të bësh me një gjysmë milioni shqiptarë apo më tepër, që d.m.th. se numrin e shqiptarëve në Zvicër statistikisht e ke gjysmë për gjysmë të zvogëluar.

Rreth zanafillës së pranisë së shqiptarëve në Zvicër nuk kemi ndonjë studim të mirëfilltë historik, sepse kanë qenë të zënë kryesisht nga lufta e pandërprerë me shovinizmin grek, bullgar, serbo-jugosllav e rus. Studimet zvicerane i shlyejnë shqiptarët nga Zvicra para vitit 1660. Disa „*studiues*“ nuk e njohin historinë, gjeografinë, antropologjinë dhe shkencat e tjera, pa marrë parasysh se kishte historianë të vërtetë zviceranë, që shkruanin në të kaluarën për shqiptarët dhe që udhëtonin nëpër Shqipëri. Këta „*studiues*“

ndjekin në studimet e tyre deklaratat shtetërore zvicerane dhe bëjnë të njëjtën gjë me zvogëlimin e numrit të tyre.

Por, një gjë do ta pranojmë, sado që deri vonë nuk e thonë ata: shqiptarët kanë qenë të pranishëm në Zvicër që nga periudha e pushtimit iliro-romak. Mjaftojmë të shënisim nëpër tërë trevën malore, sidomos në Graubünden, do të gjejmë fjalë, fjali, mënyra dhe mjete të jetës ilire, të cilat, edhe sot tingëllojnë shqip. Në fund të shekullit 19, Fridrich Stolz e mbron tezën, se gjuha rete ishte ilire, si dhe Livius nga Padova deklaronte se gjuha rete është e ngjashme me gjuhën etruske (d.m.th. toske). Retija është edhe sot e ndjeshme në Zvicër. Është Räter Prima (e Madhe) dhe Räter Sekunda (e vogël). Kështu, Retija e Vogël është fshat afër Prizrenit, në Kosovë. Retija Prima dhe Retija Sekunda sundoheshin nga Diokleciani ilir (dardan), nga vitet 280-305 të epokës së re¹. Për Retët në Kantonin Graubünden të Zvicrës, të autorëve Ingrid R. Metzger dhe Paul Gleirscher, „Die Räter“, citohet Pittoni, sipas veprës së Ludwig Paulit „Gjurmët e një populli“, të vitit 1940, ku thuhet: „Kur flitet për Retët e asaj periudhe, duhet të jemi të qartë se këtu ka të bëjë shkëlqyeshëm për Ilirët, krahas të cilëve Keltët, ndoshta edhe Etruskët, e luanin një rol modest.“²

Po të marrim toponimet e vendbanimeve të Zvicrës, shohim se ata janë ilirë. Wohlen, qytet i njohur në Zvicrën, do të thotë „vonë lenë=Dielli“, që është një dukuri e rrallë natyrore, se dielli shihet pas orës 13 në këtë qytet. Zuricum (Cyrih) do të thotë Zürich, ndërsa Turikum, do të thotë Turia. Fshati Turia, është sot fshat në Kosovën Lindore. Reuss (Rojs)=ruaj, që do të thotë se liqeni i Luzernit ruante nga kulshedra e Pilatusit (pyellit të Atit), sipas legjendës së Kantonit të Luzernit, ndërsa Burimi quhet burimi i ujit edhe sot në shqip. Në Graubünden, mali Albanatscha do të thotë Albana, kurse fshati dhe banja shëruuese Alvanen do të thotë Albanën. Koria/Kori (Chur) reliefi është i tillë guror, ndërsa Bever (bie/bën verë) do të thotë se Dielli nxenë shumë në këtë vendbanim. St. Moritz (San Murezzan) ka një shpjegim në shqipe, Shën Murtezan. Nga gjuha Rete do të gjejmë mjaft fjalë që kanë kuptim në shqipen e sotme. Fjala *dret*, do të thotë *drejt*; *sgiarba* = *zgrabit*; *spuandar* = *shpërndaj*; *nata gmir* = *nata gdhinë*; *parabla* = *përralla*, *pallavra*; *paja* = *paqë*, *a*; *deces* = *dekje*, *vdekje*; *cufor* = *çoj forcë*, *japë forcë*, *ngushëlloj*; *bun per* = *bëj petë*; *shliar/liar* = *lidhë*; *kanton* = *katund*, *fshat*; etj. ³⁾

Kur të marrin kontaktet e para zvicerano-shqiptare në shqyrtim, vlen të përmenden ato të shekullit XV, sado që duket e pabesueshme. Në të gjitha simbolet e Kantoneve të para zvicerane që përbëjnë Konfederatën Zvicerane, shohim se flamujt e këtyre kantoneve kishin shqiponjën dykrerëshe, që ishte

1. Prof. Vasfi Beqiri, „Retija- përkthime dhe përshtatje në shqip“, vepër e pabotuar, arkivi personal i autorit.

2. Ingrid R. Metzger, Paul Gleirscher, „Die Räter“, Verlagsanstalt Athesia, Bozen 1992, faqe 727.

3. W. Oechsli, Die älteste Geschichte Graubünden, cituar sipas përkthimit dhe përshtatjes së Prof. Vasfi Beqirit, arkivi personal i autorit.

simbol i bashkimit në luftë për liri të vëllezërve të parë shqiptar (pellazg, ilirë): gegëve dhe toskëve (*gigantët, që jetonin në malet e larta-alpeve shqiptare dhe toskanëve, që jetonin në bregdet dhe liqene*). Gigantët kanë jetuar nëpër Alpe (*Shqipëri, Zvicër dhe Austri*) dhe kanë ruajtur këtë lidhje të fortë vëllazërore me toskanët, nga të cilët kanë shkuar nëpër dete dhe liqene dhe është krijuar psh. Toscana në Itali.

Shqiptarët (gegët dhe toskët) kanë ardhur në Zvicër, që në kohët më të lashta. Kështu e kanë ruajtur simbolin shqiptar, shqiponjën me dy krerë, të shtrirë në fushën e gjatë të betejës, të mbuluar me gjak, kuq si gjaku i bijve të rënë në betejat e mëdha për liri. Ata kanë dalë me flamujt e shteteve të tjera, si psh. të Greqisë, të Turqisë, të Bullgarisë, të Maqedonisë dhe të Kosovës, si simbole shtetërore, që janë shumë pak të tyre. Por, në kujtesën e tyre ka mbetur i pandryshuar flamuri me shqiponjën dykrerëshe dhe fushën e kuqe, pa marrë parasysh simbolet e sistemeve politike, fetare apo shtetërore që ka marrë gjatë shekujve. Shqipëria ka fituar vonë një shtet të vogël. Shqiptarët e kanë ruajtur flamurin e tyre në gji, që prej shqiptarit të parë. Për të janë vrarë me nder, me krenari. Këtë flamur e kanë bartur në të gjitha ngjarjet e mëdha të popujve tjerë, sidomos në krijimin e Konfederatës Zvicerane. Ne i gjejmë këto në Basel, në Rathaus (*Shtëpi e Luftës*), që është një nga shtëpitë më të veçanta në çdo komunë, të gdhendura në xham në vitet 1519/20 nga Antoni Glaser,⁴ në të cilat shihen simbolet kombëtare shqiptare, si psh. në Cyrih, Bern, Lucern, Friburg, Soloturn, Cug, Shvic, Shafhausen, Uri, Untervalden, Gllarus dhe Apencel, përpos Bazellit dhe Sakt Gallen ku shihen simbolet fetare. Viti 1519 ishte vit kur kishte kaluar në tjetër jetë Skënderbeu (1468) që kishte ndikuar shumë për mbajtjen gjallë të tendencës së bashkimit të Zvicrës, krahas ruajtjes së ndenjës famëmadhe të pavarësisë së kombit shqiptar nga sunduesit otoman. Pas vdekjes së tij, familjes dhe luftëtarëve të Skënderbeut në tokat shqiptare iu bë e pamundur të jetojnë. Ata emigruan në Itali dhe disa prej tyre në trevat e ndryshme të Zvicrës. Prej këtu e shohim se simboli shqiptar ka mbijetuar edhe në Zvicër në themelimin e tij si shtet.

Kontaktet e para të Zvicrës dhe të shqiptarëve datojnë nga viti 1431. Është i njohur Konkili i Bazelit i të njëjtit vit, në të cilin është debatuar për çështjet kishtarë. Në këtë Konkil të Baselit ishte ftuar nga Shqipëria Andeas von Krim, për diskutim, që është i njohur me emrin e tij Adrea Zamometisch, dhe kishte jetuar në Granea të Shqipërisë, si ipeshk i atij vendi. Mendimtarë të ndryshëm konsiderojnë se mbiemri i tij vjen nga Camaj apo Camemetisch. Ka lindur në Nin në vitin 1420 dhe ka vdekur në Bazel, në vitin 1484.⁵ Kur

4. Hans Peter Treischler & CO, „Abenteuer Schweiz/Geschichte in Jahrhundertschritten“, Dreizehte Buchgabe des Migros-Genossenschafts-Bundes, Limmatdruck AG, Spreitenbach 1991, f. 122-123.

5. Albert Ramaj, Shqiptarët në Zvicër prej vitit 1431 deri më 1940, Gazeta „Albsuisse“, Nr. 001, janar 2008.

ipeshkëv katolik nga Shqipëria ftohet në Bazel, kjo do të thotë se ky vend njihej nga Zvicra. Është shumë i njohur botimi i Bazelit, i veprës së Marin Barletit *“Rrethimi i Shkodrës” (De obsidione Scodransi)* më 1556, në gjuhë latine, një vit pas botimit të *„Mesharit“* të Gjon Buzukut, më 1555, që praktikohej shumë te shqiptarët që jetonin jashtë Shqipërisë, prej nga ishte Marin Barleti, humanisti i madh shqiptar. Kjo është një dëshmi e fortë që kishte populli zviceran për popullin dhe kulturën shqiptare.⁶⁾

Shqiptarët qenë themeluesit e Italisë, të Perandorisë Bizantine dhe pranuan si gjuhë zyrtare gjuhën latine. Gjuha latine ishte një gjuhë artificiale që nuk jetoi si gjuhë e folur kohë të gjatë. Konsiderohej se përdorej dhe shkruhej gjuha shqipe me alfabet të saj. Deri më sot nuk kanë mbetur njohuri që dokumentojnë shkrimin e kësaj gjuhe, deri në formulën e pagëzimit, më 8 nëntor 1462, nga Pal Engjëlli, në Kishën e Shenjtë të Trinisë në Mat të Shqipërisë. Gjuha shqipe, në formën e shkruar, përdorej më parë. Vështirësitë më të mëdha në këtë kohë qenë mungesa e shtypshkronjave në Shqipëri. Ajo ishte e përfshirë në luftën mijëvjeçare për të mbijetuar nga luftërat e pashkëputura të fqinjëve të tij grabitqarë e shovinistë serbë, grekë e bullgarë, krahas armikut kryesor kombëtar të tij, Perandorisë Osmane, që bënin ata për ta shkombëtarizuar, shpopulluar dhe shkatërruar kombin shqiptar nga trojet e tyre autoktone. Nuk kemi mundësi të ndjekim gjatë kësaj kohe dramatike udhëtimet nëpër botë, veçanërisht në Zvicër, ku i gjejmë herë pas here në kulmet e jetës së shtetit zviceranë. Po marrin nga kjo disa shembuj më të njohur.

Familja Curti (Kurti) ka dhënë disa personalitete të njohura. Ajo ka ardhur nga Milanoja, si familje e madhe shqiptare, në vitin 1665. Zvicrës ia ka dhuruar disa personalitete të njohura: Dr. med. Franz Josef Curti (1737-1818) ka qenë Kryeplak i fundit i Rapersvilit, Basil Ferdinand Curti (1804-1888), ka qenë Deputet i Vendit (i Landit), Dr. med. Ferdinand Curti (1826-1921)⁷⁾ ka qenë Deputet i Vendit (Landamann); Teodor Curti (1848-1914) ka qenë Deputet i Kuvendit Kombëtar, Deputet i Vendit dhe publicist; Franz Kurti (1854-1898), kompozitor; Dr. h.c. Franz Karl Curti (1880- 1948), Pater Naker O.S.B; Dr. iur. Alfons Curti (1882-1957) Kryetar i Komunës së Kishës dhe i Komunës së Vendit dhe Prof. Merle Curti (1897-1996) historian. Sheshi i Rapersvilit pranë liqenit mbanë titullin *“Sheshi Kurti”*, nën Kalanë e Rapersvilit, ku janë zhvilluar luftërat nga vendasit kundër tyre. Familja Curti (Kurti) ka qenë familje e njohur e Rapersvilit. Kështu ndodh edhe me shqiptarët e tjerë. Rruga më e mirë që ta mbërrijmë Zvicrën është Italia dhe Austria. Ne duhet t'i shohim me kujdes këto rrugë. Shqiptarët kanë qenë shumë të njohur në botë, por nuk janë të njohur si shqiptarë.

6. Artikulli i cituar më poshtë.

7. „Medizin im Linthgebiet/100 Jahre Medizinische Verein von Linthgebiet“, Botim i botuesve, Rapperswil- Jona 2002

Më me rëndësi është femra shqiptare. Kushte më të mira për botimin e librave dhe për shkollim kishte Elena (Helena) Gjika, e njohur me emrin e autorësisë, Dora d'Istria. Ka lindur më 22 janar 1828 në Bukuresht, si bijë e Princit Mihail Gjika, mbesë e Princit të Mirditës Gregor Gjika, një familje e njohur aristokratësh shqiptar. I ungji i saj, Grigor IV, ishte Dukë i Vllahisë. Ata kishin shkuar nga Mirdita në Maqedoni, për në Rumani. Fatlumentarisht, Helena Gjika ka pasur fatin e madh të marrë një edukatë të fortë familjare dhe një shkollim të mirë në Bukuresht, Vjenë, Venedik, Dresden, Berlin e St. Petërsburg.

Përveç gjuhës rumune dhe shqiptare, ajo mësoi mirë greqishten e vjetër e të re, italisht, frëngjisht, gjermanisht, anglisht dhe rusisht. Ka bërë në publicitet të jashtëzakonshëm në veprat e saj anë e mbanë Evropës, në Rumani, në Greqi, në Austri, në Gjermani, Britani e Madhe, Belgjikë, Francë, Itali dhe në Zvicër. Ajo luftoi me këmbëngulje për barazinë e femrës dhe burrit si dhe për pavarësinë dhe njohjen e kombit shqiptar në Ballkan. Libri i saj *"Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore"*, botuar 1866 në revistën letrare *"Revue des deux mondes"*, luajti mjaft rol të madh në lëvizjen kombëtare shqiptare të periudhës së Rilindjes Kombëtare.

Për familjen Gjika, Helena Gjika ka shkruar një histori të gjatë prej 455 faqesh, *"Shqiptarët në Rumani. Historia e Princërve Gjika në shekujt e 17-të, 18-të e 19-të"*, të botuar 1873, në Firence të Italisë⁸⁾. Në Zvicër ka jetuar prej vitit 1855, pas ndarjes nga Princi rus, Aleksander Koltsov-Masalski, deri në vdekjen e saj në Florenz të Italisë, më 1882. Në Zvicër ajo ka publikuar 10 libra të saj, nga të cilat vlen të përmendim librat *"Zvicra gjermane dhe ngjitja e Mënhit"*, Paris 1856, në gjuhën frënge dhe *"Zvicra gjermane dhe ngjitja e Mënhit"*, Cyrih 1858, në gjuhën gjermane; *"Zvicra, një pioniere e Reformimit apo Zvicra gjermane"*, Londër 1858; *"Zvicra gjermane. Vendi, populli dhe historia"*, Cyrih 1860 (3 pjesë); *"Një rrëfim i udhëtimit. Kujtime nga Zvicra italiane"*, Paris 1861, etj. Ajo është e para femër që ngjiti vargmalet e Alpeve të Bernit, majën më të lartë të saj, Jungfrau-joh, të Mënhit (lartësia 4107 m), si femër shqiptare, të cilën ajo e shtroi në veprën vijuese „Zvicra gjermane dhe ngjitja e Mënhit”, më 1858, një vit pas ngjitjes së saj më 1857, në bjeshkët e larta të Alpeve të Bernit. Ka shkruar për Zvicrën gjermane, franceze, italiane dhe retoromane, të cilat i ka njohur mirë.

Nga tokat shqiptare dhe si pasojë e rrethanave të ndryshme kanë ardhur pjesa më e njohur shqiptarësh, përkohësisht apo më gjatë, si psh. Naim Frashëri, Sami Frashëri, Mid'hat Frashëri, Anton Zako Çajupi, Leonik Tomeo, Lazër Shanto, Pol Adhamidhi, Gjergj Kokali, Ajet Libohova, Ali Këlcyra, Ismail Qemali, Fan Noli, Luigj Gurakuqi, Faik Konica, Dervish Hima, Mustafa Kruja, Eqrem Bej Vlora, Visar Dodani, Aleksandër Moisiu, Dr. Mihal

8. Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, botim i dytë, Dukagjini, Pejë, 2001, f. 143.

Turtulli, e shumë të tjerë. Qysh në atë kohë Sami Frashëri ia prezantoi Mit'hat Frashërit modelin e bashkëjetesës dhe të paqes së Zvicrës për Shqipërinë. Naim Frashëri nuk kishte qenë në Baden të Austrisë, por në Baden të Zvicës për shërim, ndërsa 10 vite kishte shërbyer si prift në kishë Lazër Shantoja, në La Motte, të Zvicrës.⁹⁾

Anton Zako Çajupi erdhi për të studiuar drejtësinë, në Gjenevë, Zvicër, në vitin 1887. Pas përfundimit të studimeve të drejtësisë, më 24 tetor 1892 mbeti edhe në vonë, gjë që e shohim në dokumentet zvicerane dhe shqiptare. Nga vepra e tij poetike, *“Baba Tomori”* dhe në prozat e tij *“Besa-Besë”* dhe *“Mysafirët e Çajupit”* e kuptojmë si kishte qenë jeta e tij në Zvicër. Ishte i martuar me zviceranen që e dashuroi në mënyrë të denjë, e cila vdiq në vitin 1892, duke ia lindur djalë të vetëm, Stefanin, për të cilin shohim si digjet shpirti i poetit kombëtar shqiptar këtu e deri në Egjipt. Ishte një nga shqiptarët më të organizuar në lëvizjen patriotike shqiptare për liri, pavarësi dhe të drejtat e legjitime, në Konferencën së Paqes në Paris, përmes Memorandumit të Egjiptit, që bashkë me patriotët shqiptarë ia dërguan opinionit ndërkombëtar.

Aleksandër Moisiu ka vdekur në Zvicër më 22 mars 1935 dhe është varrosur në varrezat e Morkotës, mbi liqenin e Luganos, në Zvicër, ku kam qenë në Simpoziumin Ndërkombëtar për Aleksandër Moisiun, të organizuar nga shoku im i lëvizjes studentore në demonstratat e vitit 1981, gjatë studimeve në vitin 1979/80, Sylë Mujaj,¹⁰⁾ apo ta vizitoj me nxënës shqiptarë të shkollës së teatrit dhe të filmit, nga Cyrihu, në vitin 2004, që shkruan për ne Dashnim Hebibi, gazetar i „*Botës Sot*“, një reportazh të veçantë.¹¹⁾

Nga Italia ka pasur shumë arbëreshë të ardhur në Zvicër. Një pjesë është inkadruar në kishat katolike romake dhe një pjesë në jetën private dhe shoqërore të Zvicrës. Vlen të përmendim shkrimtarin arbëresh, Xhysepe Gangale (Guiseppe Gangale), i lindur në vitin 1897 dhe i vdekur në vitin 1978. Ka mbështetur me të madhe të kaluarën retoromane të Zvicrës dhe veprimtarinë ndër shqiptarët, që ka mbetur në analet e historisë¹²⁾.

Në Tiçino ka mjaft arbëreshë. Ndër ta, ndonjëri është mjek. Dr. Giancarlo Politta, në Gordola të Tiçinos, nuk e di shqipen letrare, por nga pak „*arbëresh*“, që është një dialekt i vjetër i shqipes letrare. Para shtëpisë, ndodhet e ngrirë në dru statuja e luftëtarit të madh shqiptar, Giorgio Castriotto (Skënderbeut). Të parët e tij e dinin mirë shqipen. Me ndjenja të forta për kombin shqiptar kanë qenë gatuar të gjithë luftëtarët e Skënderbeut.

9. Albert Ramaj, vep. e cit..

10. Shih „Qëndresën“, Nr. 10-11, mars-prill 1994, Ekskluzive: Intervistë e Bujar Skendos me Sylë Mujajn, „Simpoziumi ndërkombëtar është sprovë e madhe për ne“ dhe skica ime për Aleksandër Moisiun.

11. Dashnim Hebibi, „Askush nuk vdiq aq shpesh dhe aq mrekullisht bukur në skenë sa Moisiu“, Bota Sot, 22 mars 2004.

12. Albert Ramaj, artikulli i cituar.

Sa u përket gazetave shqipe në të kaluarën, vlen të përmendim 4-5 tituj shqip mes të viteve 1903-1936. Në Rumani dhe në Itali, kur kanë dalë gazetat shqiptare, nëpër to kanë vepruar kolonitë shqiptare mbi 100.000 shqiptarë. Në Zvicër kanë dalë në këtë kohë gazetat e njohura: „*Shqipëria-l'Albanie*“ (1903-1906), në Gjenevë; „*Shqipëria-Albanie*“ (1915-1916), në Losanë; „*Liria kombëtare-La liberté Nationale*“ (1925-1935), në Gjenevë dhe „*Biblioteka: Zëri i Shqipërisë- La Voix de l'Albanie*“ (1935-1936). Po në këtë kohë kanë dalë një varg veprash të njohura për shqiptarët, si psh. vepra e atdhetarit kombëtar Mit'hat Frashëri (pseudonimi Lumo Skendo), „*Les Albanais chez eux et à l'étranger*“, Lausanne 1919 dhe autori i njohur shqiptar, Krist Maloki „*Leksikon der Frau*“, në Zürich ¹³).

Shqiptarët, edhe pse të padeklaruar, kanë qenë një numër i konsiderueshëm. Ismail Qemali, Luigi Gurakuqi, Faik Konica, Fan S. Noli, Dervish Hima kanë qenë personalitete të njohura shqiptare që bënë çmos për njohjen dhe pavarësinë e shqiptareve. Bajram Curri, ka qëndruar në Zvicër 2 javë në bisedime me kryetarin e njohur të botës politike, Presidentin amerikan, Vilsonin. Shqipëria, ajo pjesë që shpëtoi nëpër kthetrat e përgjakura të fqinjëve të saj me gjakun e madh shqiptar, është njohur si shtet i pavarur më 1912, ndërsa me punën diplomatike shqiptare në vitin 1920 është e pranuar në Lidhjen e Kombeve. Atë kohë, Fan Stilian Noli ishte kthyer në Zvicër, në Gjenevë, ku merr pjesë në Organizatën e Lidhjes së Kombeve, ku i rrëzon të gjithë kundërshtarët e tij ballkanas në mënyrën më mjeshtërore dhe me buzë në gaz, me fjalimet e ngjeshura oratorike. Deri në vitin 1921 ndodhet në Zvicër, pastaj kthehet në Shqipëri. Në këtë kohë janë drejtuar mjaft letra politike, protesta e memorandumet të pandërprera.

Në vitin 1915 Faik Konica takohet me Mit'hat dhe Mehdi Frashërin dhe boton në gjuhën frënge traktatin „*L'Allemagne e l'Albanie (Gjermania dhe Shqipëria)*“, ku fshikullon padrejtësinë e diplomacisë gjermane për ndarjen e Shqipërisë midis grekëve dhe sllavëve. Më 1916 detyrohet të largohet nga Zvicra, për shkak se austriakët e shikojnë si të dyshimtë për qëndrimin akuzues ndaj Austrisë dhe Gjermanisë.

Marrëdhëniet diplomatike me shtetin e Zvicrës janë vendosur që nga angazhimi i shqiptarëve për lirinë dhe pavarësinë e tokave tona nga Perandoria Osmane. Në këtë kohë Ballkanin e përfshinë një lëvizje e popujve për pavarësinë e tyre, pra edhe të shqiptarëve. Në jetën tonë, ka pasur një shpërthim të gjithanshëm të fqinjëve më të afërt me dhunë, krime dhe ndjekje. Ndonëse jemi të vonuar me organizimin e rezistencës sonë, nuk i kemi menduar dinakëritë dhe thellësinë dhe zgjerimin e krimeve nacionale. Atëherë, nuk kemi pasur mekanizma të mbrohemi nga dhuna e shfrenuar e fqinjëve tanë.

13. Cituar sipas Albert Ramajt, artikulli i cituar, që nuk dihet shtëpia botuese dhe viti i botimit.

Përpjekjet e para diplomatike nuk mund të quhen ato kontakte të individëve shqiptarë të natyrës tjetër. Në Zvicër ka pasur udhëtime e qëndrime të individëve të ndryshëm, që prej kohës së pavarësisë dhe krijimit të Konfederatës Zvicerane. 500 vjet ka zgjatur sundimi osman mbi tokat shqiptare, të shumtën i përcjellë me kryengritje kombëtare, deri në Lidhjen e Prizrenit, më 1878. Rilindja Kombëtare me aktet e veta largpamëse është prioritare për zhvillimin e kontakteve ndërkombëtare.

Në Periudhën Osmane ka pasur udhëtime të shtetasve të perandorisë së tyre, që kanë qenë edhe shqiptar, por nuk u dihet kombësia. Ndër më të pasurit, ka pasur ndonjë që ka kryer shkollë në Zvicër, sepse Zvicra ishte më e njohura dhe kishte pedagogë me renome anë e përtej shtetit. Anton Zako Çajupi, ka kryer Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Gjenevës, në vitin 1892. Ai është personalitet intelektual i Rilindjes Kombëtare të Shqiptarëve që ngritet në Zvicër. Pra, marrëdhënie të rregullta diplomatike mund të merren ato marrëdhënie në prag të pavarësisë së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës.

Kërkesa e parë shqiptare drejtuar Zvicrës për njohjen e pavarësisë së shpallur më 28 nëntor 1912 është nga Qeveria e Vlorës, diplomati Ismail Qemali, i cili, ka qenë në këtë shtet. Ai iu drejtohet të gjitha shteteve të njohura të Evropës dhe të botës për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë, me të gjitha pjesët e tokës sonë. Kërkesa e Ismail Qemalit është kërkesë e parë e qeverisë së parë shqiptare, sado që kjo qeveri ishte krijuar në maj të vitit 1912, në Junik të Gjakovës, në Kuvendin e Junikut, e cila kishte si mbështetëse 13 viset e Kosovës dhe të Malësisë, në të cilën fisi i Morinës jepte kontributin e saj, ku ishin marrë pjesë një numër i denjë shqiptarësh me renome, si p.sh. Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Azem Galica, Zefi i Vogël, Zog Avdyli ¹⁴⁾ etj.

As Qeveria e Vlorës nuk ka jetë të gjatë. Kërkesën e dytë për njohjen e Mbretërisë së re, të krijuar në Shqipëri, e ka bërë me 06.05.1914 Vilhelm von Vid. Në këtë letër ai njofton se ka marrë fronin e Mbretit të Shqipërisë dhe kërkon njohjen e Mbretërisë së Shqipërisë. Kjo ndikon në Parlamentin Zviceran për njohjen e Shqipërisë. Zvicra interesohet të marrë informacione përmes përfaqësive diplomatike të Romës dhe të Vjenës rreth kësaj çështje. Ministria e Punëve të Jashtme e Zvicrës merr nga përfaqësia diplomatike në Vjenë një rekomandim që mos ngutet me njohjen e Mbretërisë së Shqipërisë, e cila ishte në „situatë lufte“. Një kërkesë e ngjashme i ishte dërguar Austro-Hungarisë, por qeveria e këtij shteti e konsideronte jo stabil dhe mbreti Vilhelm von Vid së shpejti do të jetë i detyruar të ikë shpejt nga vendi.

Me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, Shqipëria okupohet nga trupat italiane, bullgare, serbe, greke dhe nga fuqitë e qendrës Evropiane,

14. Kësaj qeverie nuk i kushtohet sa duhet rëndësi, në të cilën ka marrë pjesë edhe vëllai i babagjyshit tim.

Austro-Hungarisë e Gjermanisë. Kjo ishte një kohë e zezë për shqiptarët. Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore u ndanë dhe u copëtuan me dhunë edhe njëherë tokat shqiptare. Dy të tretat e tokave tona mbetën nën kthetrat e shovinistëve grekë, bullgarë, malazezëve dhe serbë. Mbretëria Serbo-Kroato-Malazeze okupoj me dhunë pjesë të madhe të tokave shqiptare.

Kërkesa e tretë drejtuar shtetit zviceran i drejtohet më 21.01.1921 nga Fan S. Noli, diplomat i njohur i Shqipërisë. Ajo ju drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Zvicrës nga delegacioni shqiptar në Hotelin Metropol të Gjenevës, të nënshkruar nga Fan S. Noli së bashku me një memorandum të nënshkruar nga i njëjti, në të cilat njoftoj se Shqipëria ishte njohur nga shtetet e tjera të Evropës dhe Ballkanit. Ministri i Punëve të Jashtme të Zvicrës falënderon delegacionin për këto njoftime për njohjen e pavarësisë dhe më 25.01.1921 u shkruan përfaqësive diplomatike të Zvicrës që ta njoftonin Ministrinë e Punëve të Jashtme të Zvicrës se a e kishin njohur hap pas hapi pavarësinë e Shqipërisë me kufijtë e tij të vitit 1913, që e kishte njoftuar delegacioni shqiptar në Zvicër, kur ishte mbajtur Konferenca e Londrës, në të cilat ato ishin akredituar. Në këtë këmbim shkresash zyrtare ka një këmbim shkresash dhe raportesh të përfaqësive të diplomacisë nga Belgjika, Britania e Madhe, Franca, Rumania, Spanja dhe Austria. Nga marrja e detyrës së konsullit shqiptar në Vjenë, më 22.12.1921, përfaqësia e diplomatike e Zvicrës në Vjenë, i drejtohet me një shkresë si qëndronin raportet e Shqipërisë me Zvicrën.

Kërkesa e katërt kishte ardhur më 30.01.1922, kur sekretariati i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ia adreson një letër qeverisë së Zvicrës si kërkesë për njohjen *de jure* të Shqipërisë, drejtuar nga Ministri i Përkohshëm i Punëve të Jashtme, e cila thirret në Konferencën e Ambasadorëve të Parisit, më 09.11.1921. Qeveria e Zvicrës i drejtohet me një letër përfaqësive të saj në gjithë botën që ta njoftojnë se cilat do të ishin qëndrimet e shteteve ku ato qenë akretiduara si përfaqësi diplomatike lidhur me çështjet e pavarësisë së Shqipërisë, në të cilën ishin të kyçura qeveritë e Italisë, Japonisë, Francës, Britanisë, Gjermanisë dhe Austrisë. Kërkesa e fundit nga i njëjti sekretariat i Lidhjes së Kombeve, i datës 24.02.1922, e cila kërkon që qeveria e Zvicrës ta njohë Shqipërinë si shtet të pavarur. Qeveria dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Zvicrës e vlerësuan si kohë të përshtatshme për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë, kështu që Ministria e Punëve të Jashtme të Zvicrës ia drejton Qeverisë së Zvicrës një shkresë për njohjen e Shqipërisë si „shtet të pavarur“, më 01.03.1922, gjë që fatbardhësisht pason.

Çështja shqiptare hyn pas një periudhe të gjatë luftimesh, ndjekjesh, përpjekjesh të pandalura për shkatërrimin kombëtar e fetar. Qeveritë shqiptare ndërrohen e humbin shpejt nga ndjekjet e armiqve tanë. Kombi shqiptar, megjithatë me një çerek të tokave shqiptare të shpallura si të pavarura, ec përpara për ta mbajtur gjallë ndenjen e fortë kombëtare.

Literatura

- “Kërkesa për t’i njohur Kosovës statusin e Republikës është e drejtë”, SHB “8 Nëntori”, Tiranë 1981.
- “Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundërrevolucion/Letër e të burgosurve politik shqiptar, dërguar RSFJ-së”, “Zëri i Kosovës”, Biel-Bienne 1986.
- “Ushtria çlirimtare e Kosovës, Dokumente dhe artikuj”, Zëri i Kosovës, Aarau 1998.
- „Qëndresa“, Organ i pavarur mbarëshqiptar, Botues dhe Kryeredaktor Ibrahim I. Avdyli, autor i këtij punimi, Zvicër 1990-1995.
- Andrea, Fatos “Tirqët dhe fustanella në Gardën Kombëtare Shqiptare”, ANASH-Approaching Science, viti IV, Nr. 6, Dhjetor 2009.
- Arkivi i UNIKOB-it, te Kryesuesi i saj, Ibrahim Avdyli, Postfach 1270, 8640 Rapperswil, Zvicër.
- Avdyli, Ibrahim “Skicë për veprimtarinë e Bacë Bajramit”, material i pa botuar, arkivi personal i autorit.
- Avdyli, Ibrahim, “Shpërdorimi i një date historike për qëllime të errëta dhe gjakatare”, përgaditur si fletë volante e KKIOB, me 1989, dedikuar opinionit të gjërë botëror, dokument i pabotuar, arkivi i autorit, Zvicër.
- Bajrami, Vehbi, “Shqiptarët e Amerikës”, Albanian Publishing, New-York 2003.
- Bashkësia Islame-Shqiptare, “Integrimi i muslimanëve në shoqërinë Zvicëranë”, “Hëna e Re” Kreulingen 2004.
- Bashkurti, Prof. Dr. Lisen, “Europa, Ballkani dhe sfidat e Kosovës”, GEER, Tiranë, 2006.
- Bashkurti, Prof. Dr. Lisen, “Kombet e Bashkuara dhe rendi i ri botëror”, GEER, Tiranë 2010.
- Beqiri, Prof. Vasfi “Retija-përktihme dhe përshtatje në shqip”, vepër e pa botuar, arkivi personal i autorit.
- Çeku, Ethem, “Struktura politike e ilegales së Kosovës”, Brezi 81, Prishtinë 2006.
- Danaj, Koço, “Totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare”, Java, Tiranë 1996.
- Dehari, Avni - Destan Hajdini, “Arif Seferi në shërbim të popullit”, SHKB “Pjetër Bogdani”, Biel-Bienne 1993.
- Demaçi, Adem, “Republika e Kosovës është shpallur në zemrën e popullit tim”, Zëri i Kosovës, Zvicër 1990.
- Demo, Elsa “Eduard Lear, një mit për ne”, Gazeta Shekulli, Tiranë, 27 prill 2009.
- Dervishi, Kastriot “Bashkëpunëtorët e Wilhelm von Wiedit“, Speciale, Gazeta 55, Tiranë 9 mars 2009.
- Dumishi, Xhefer, “Organizatrat politike shqiptare në Europë, 1979-1985”, artikull te www.zemrashqiptare.net.
- Elsie, Robert, “Historia e letërsisë shqiptare”, Dukagjini, Pejë 2001.
- Goldstein, Joshua S., “Marëdhëniet Ndërkombëtare”, SHB “Dituria”, Tiranë 2003
- Gorani, Prof. Dr. Hajrullah, “Puntoria Kosovare, forcë reale për liri kombëtare dhe demokraci”, Dega e BSPK në Zvicër, Biel-Bienne 1991.

Dr. Sc. Zija ZIMERI

VLERËSIMI I TRASHËGIMISË RURALE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT NË FUSHËGROPËN E KUMANOVËS

Abstrakt

Trashëgimia rurale është një koncept shumë i gjerë, që përfshin trashëgiminë materiale: qendrat arkeologjike, monumentet historike, objektet e kultit, vendbanimet dhe banesat, punimet artizanale, veshjet, veglat e punës etj. Në hapësirën rurale; trashëgiminë sociale: mënyrat e organizimit të familjes dhe shoqërisë rurale, normat shoqërore etj.

Trashëgiminë shpirtërore: ritet, besimet dhe vallet, legjendat etj. Si e tillë ajo ka një rëndësi të veçantë, pasi mbart në vetvete elemente të identitetit të çdo hapësire rurale dhe të vendit në tërësi. Por, në të njëjtën kohë ajo përfaqëson edhe një burim potencial të ardhurash dhe punësimi falë shfrytëzimit të saj për qëllime turistike.

Fjalë kyçe: Trashëgimi rurale, trashëgimi materiale, trashëgimi sociale, trashëgimi shpirtërore, valorizmi, turizëm rural, zhvillimi i qëndrueshëm etj.

1. QENDRAT ARKEOLOGJIKE DHE MONUMENTET HISTORIKE

Zonat rurale në Fushëgropën e Kumanovës ofrojnë një pasuri të madhe për sa i përket lokaliteteve arkeologjike, të cilat kanë një vlerë të rëndësishme kulturore, por dhe ekonomike si vende mjaft të vizituara. Përmendim qendrat arkeologjike të Kumanovës dhe të Likovës. Një tjetër përbërës i rëndësishëm i trashëgimisë rurale janë edhe monumentet historike, të përfaqësuara në

Kumanovë dhe rrethinë, ajo e Pelicës, Lopatit e Opajës, Mlado dhe Staro Nagoricanit etj.

Objektet e kultit në zonat rurale të Kumanovës i korrespondojnë elementeve natyrore, duke qenë kështu dëshmitarë të një mënyre të jetës dhe të një ekonomie të bazuar tërësisht në natyrë. Bëhet fjalë për objekte natyrore si: fusha, male, gurë, shkëmbinj, shpella, pyje, pemë, lumenj, burime etj. Përmendim kultin e kullotave pranë një burimi uji, ku pemët nuk duhet të priten nëse bagëtia vjen për të kullotur tri vite rresht, kultet e bimësisë të përfaqësuara nga drunj shekullorë, pranë të cilëve besohet të ketë ndodhur një ngjarje e pashpjegueshme, kult i diellit, Kozjaku dhe Karadaku, të cilat të përbëra me lokalitete të shumta arkeologjike, si edhe vetë Fusha e Kumanovës, momiat e gjetura në Kolishte të Likovës dhe qeramikë e zbukurime të tjera në Pelincë, Bedinjë, Vincë, Agino Selo Dobroshanë etj. Megjithatë, kultet më domethënëse janë ato të bujqësisë dhe të blegtorisë, me vite që lidhen me veprimtari specifike si fillimi i korrjes, shtegtimi i bagëtive, krasitja e rrushit, fillimi i korrijeve, dita e verës, Shëngjergji, Dita e Dimitrit, festa myslimane etj.

2. VENDBANIMET DHE BANESAT RURALE

2.1 Vendbanimet rurale

Vendbanimet rurale në rrethinën e Kumanovës shfaqin një larmi të madhe për sa i përket pozicionimit dhe organizmit të tyre. Kështu gjenden vendbanimet rurale të përqendruara ose të shpërndara, përgjatë rrugës ose lumit, të izoluar ose fare pranë qendrave urbane etj. Më karakteristike janë ato të zonave kodrinore ose malore, veprimtaria kryesore e të cilave është blegtoria. Këto vendbanime organizohen tradicionalisht në tri hapësira: vendbanime malore që kanë mbetur fshatra të vjetra, bile edhe të depopulluara, por interesante për procese të rivitalizimit të tyre në vendbanime malore turistike; vendbanime fushore të cilat karakterizohen me një zgjerim të theksuar dhe me shtëpi të planifikuara me qëllim jetese dhe pranimin e miqve dhe turistëve dhe hapësira urbane e qytetit të Kumanovës, që është qendra kryesore turistike me shumë monumente dhe objekte interesante të funksionimit të turistëve (banjat, muzetë, arkivi historik, viset malore, lokalitete arkeologjike të sjella dhe të vendosura në muzeun e posaçëm të arkeologjisë në Kumanovë, sheshi i Kumanovës etj.

Mjaft vendbanime rurale karakterizohen nga një element qendror, i cili i identifikon dhe rreth të cilit ato organizohen. Kështu përmendim praninë e një rrapi, një burimi etj., të cilët njëkohësisht mbartin vlera sociale dhe kulturore.

2.1.1. Banesa rurale

Banesa si një element themelor i jetës përfaqëson jo vetëm një mjedis banimi, por edhe një objekt me domethënie sociale dhe kulturore. Banesat rurale në Fushëgropën e Kumanovës si në pjesën e Karadakut, Sredorekut e Kozjakut, ashtu edhe në pjesën fushore të Kumanovës shfaqin një larmi të dukshme dallimesh e specifikash të karakterit lokal dhe më gjerë. Në shumë vendbanime fshatare në rajonin e Sredorekut-Kozjakut ende janë me kulme të mbuluara me rrasa guri, të ndërtuara me mure guri, ndërsa si lidhëse paraqiten edhe druri si pjesë përbërëse e kompleksit ndërtimor të periudhave më të hershme. Shtëpi të këtilla pothuajse gjenden në tërë rajonin e Komunës së Nagoricit të Ri, komunën e Kumanovës dhe komunës së Likovës.

Në rajonin e Sredorek-Kozjakut rreth 36 fshatra dallohen si të tipit të vjetër, ndërsa në rajonin e Likovës, fshatrat e Karadakut përbëhen gjithashtu me mure gurësh dhe gardhesh të lyera me baltë të përzier me kashtë. Në monumentet e sotme ato janë interesante dhe karakteristike për shumë vizitorë dhe turistë, sepse në disa vendbanime kanë filluar të bëhen revitalizime dhe ndërtime të objekteve të reja për funksionimin e nevojës së uikendeve për rekreacion dhe pushime verore, por ato nuk janë të rralla edhe për pushim dhe rekreacion dimëror.

2.1.2 Banesa e tipit modern-evropian

Në shumë fshatra të Fushëgropës së Kumanovës e sidomos në rajonin e Likovës, për shkak të punësimit të një numri të madh të njerëzve aktivë për punim në botën e jashtme, sidomos në shtetet e zhvilluara të Evropës Perëndimore, në fshatrat e tyre kanë ndërtuar tipe të ndryshme të shtëpive me plane dhe arkitekturë të ndryshme, me bukuri të veçanta nga pamja e jashtme, por edhe me funksione moderne edhe brenda për brenda tyre, me shumë dhoma, banja, ballkone, të lyera me ngjyra të ndryshme, disa prej tyre nga jashtë me fasada gurësh me ngjyra të ndryshme me shatërvane, kopshte te bukura, pemishte, bare e parqe speciale, lulishte në oborret e tyre etj.

Në fshatin Runicë, Allashec, Vishtic, Burim, Goshincë, kanë filluar të ndërtohen edhe shtëpi të tipit modern, jo vetëm për çështjen e jetesës së banorëve të këtyre fshatrave, por edhe për pranimin dhe zhvillimin e turizmit rural, që një pjesë e biznesmenëve po e shohin si perspektivë dhe strategji të zhvillimit të tyre për të fituar të ardhura për mbajtjen e familjeve të tyre.

Në brigjet e liqenit të Likovës gjer më tani janë ndërtuar tri restorante të bukura, të cilat jo vetëm që karakterizohen me interieret interesante të tyre, por ato shprehin një dukuri të re për tërheqjen e vizitorëve dhe të turistëve nga viset lokale të rrethinës së Likovës e Kumanovës, por nuk janë të paktë edhe mysafirë - turistë edhe nga viset jashtë Kumanovës dhe Likovës.

Ndër banesat e tipit të vjetër, ekzistojnë në Goshincë, të përbëra prej gardhiqeve dhe në më shumë vendbanime rurale në rajonin e Sredorek-Kozjakut. Cilësia e tyre interesante është ajo se një pjesë e tyre përbëhen prej tipit klasik të vjetër të shtëpive orientale, me çarqe të mëdha, si duket këto janë shtëpi të tipit të përzier maqedono-turk, por e njëjta dukuri mund të hetohet edhe në vendbanimet rurale në rajonin malor të Likovës.

2.1.3. Banesa me vatrën e zjarrit në vendbanime malore

Në shumë fshatra të Sredorekut dhe Kozjakut edhe në Karadakun e Kumanovës, ende në mesin e dhomës kanë vatrën e zjarrit, që dikur para 70-80 viteve, kanë qenë të njohura dhe pothuajse e gjithë arkitektura banesore e fshatrave malore, por edhe e fshatrave fushore. Këto shtëpi dhe fshatra kanë pasur një karakter të përbashkët për grumbullimin e gjithë anëtarëve të familjeve të tyre rreth zjarrit qendror, si anëtarët e familjes, ashtu dhe miqtë dhe mysafirët që i kanë zhvilluar bisedat e tyre, lojërat e ndryshme, si ajo e peshkirit, unazës, tregimi i përrallave, tregime popullore, muzikë veglash të ndryshme, sidomos ajo e kavallit, çiftelisë, fyellit etj. Përreth vatrës së zjarrit gjenden disa pjesë që komunikojnë me njëra-tjetrën në një ose dy kate. Disa prej tyre shërbejnë si dhoma gjumi për çiftet dhe të tjerat për nevoja ekonomike. Në çdo banesë gjejmë një pjesë të quajtur dhoma e miqve, ky organizim i brendshëm i banesës lidhet me praninë e familjeve patriarkale me shumë anëtarë dhe disa kurora, ndonëse gjithnjë e më të kufizuar në numër. Elemente të tjera përbërëse të këtij tipi banese janë edhe mjediset e veprimtarive ekonomike. Këto mjedise mund të jenë të përhershme ose të përkohshme. Më të përhapura janë: kasollet (si banesa të përkohshme, depo për ushqimin e bagëtisë, strehë për bagëtinë), hambarët, hajatet dhe strehët e tjera (depot për veglat e punës, bagëtinë etj.), mullinjtë, pusët dhe burimet e ujit të pijshëm, rezervuarët për ujtitje, këndi i larjes së rrobave, depot e bulmetrave, stanet verore ose dimërore etj.

Ndërtesa kryesore, dhomat e fjetjes dhe mjediset e veprimtarive ekonomike gjenden në oborrin e shtëpisë. Organizimi i oborrit varet kryesisht nga relievi. Në fshatrat e zonave malore, të cilat kanë një shtrirje më të gjerë, vendosja e njësive përbërëse të oborrit është më e "lirë" se në fshatrat e zonave të ulta. Oborret janë pjesërisht ose tërësisht të rrethuara me gardhe ose mure të gurta.

Mes banesave me vatrën e zjarrit në qendër ndër më tipiket është banesa e miqve, konaku, ku janë pritur miqtë dhe mysafirët, ku janë zhvilluar bisedat rreth fejesave, dasmave, problemeve të familjes, fshatit e më gjerë.

Karakteristikë e saj është se vatra e zjarrit ngrihet përgjatë dy kateve: sipër për banim dhe poshtë veprimtaritë ekonomike dhe mbajtjen e bagëtive. Në pjesën e sipërme gjenden shtatë dhoma gjumi si dhe dhoma e miqve, të gjitha

të lidhura në brendësi me këtë të fundit nëpërmjet një ballkoni, që i rrethon në nivelin e katit të dytë. Dhoma e miqve përbëhet nga një platformë hekuri e hapur në brendësi, që del përtej mureve, duke u mbështetur në kolona guri: katër dritare dhe dy oxhaqe, njeri për t'u ngrohur dhe tjetri për të përgatitur kafënë. Banesa tiranase shfaqet edhe në një formë tjetër me hajat dhe çardak, si vazhdim i vatrës së zjarrit dhe dhomës së miqve, duke i dhënë pjesës së jashtme nga një pamje të hapur.

3. ARTI POPULLOR

Arti popullor në rajonin e Fushëgropës së Kumanovës si dëshmi e vazhdimësisë së historisë së popullit të kësaj ane tregon se tradita dhe forca e krijimtarisë artistike të tij kanë ekzistuar qysh prej kohërave më të hershme. Pos punimeve artizanaleve janë bërë edhe prodhime të ndryshme prej leshit, lëkurës, pexhurave, qilimave, tjerres e thurjes së fanellave, ndërtimin e sofrave, furkave, rrotaqeve të karrocave, përpunime të ndryshme të tjera prej drurit, hekuri, veshje, robraqepësi etj.

3.1 Artizanati rural

3.1.1 Punimi i gurit, baltës dhe drurit

Popullsia malore e Kumanovës dhe Likovës dallohet për një traditë të hershme të përpunimit të gurit. Ata llogariten si muratorë të mirë të mureve prej gurit, banesave me material guri e druri, gurë mulliri për bluarjen e drithërave, punime prej druri prej lugëve e deri te furkat për bar të thatë (sanë) dhe mbledhjen e kositjeve në livadhet malore të fshatrave të këtyre anëve. Nga nevojat që kanë pasur me këto prodhime ata gjithashtu, këto prodhime guri e druri i kanë shitur edhe në fshatrat e tjera dhe në qytetin e Kumanovës. Ende edhe sot flitet se në kohën kur në këto vise kishte sunduar “turku” prodhimet e këtilla janë shpërndarë edhe në tregje të tjera të Maqedonisë, bile kanë arritur edhe në tregjet më të mëdha të Perandorisë turko-osmane. Zonat më të përmendura në këtë mjeshtëri janë Allasheci, Runica, Burimi dikur edhe Shtraza, Rrkoci e tjerë, ndërsa në pjesën e Sredorekut-Kozjakut ky proces prodhimi ka qenë edhe më i përhapur në pjesën lindore të Maqedonisë.

Përpunimet më të rëndësishme të botës, baltës argjilore kanë qenë të njohura fshatrat rreth lumit të Pcinjës, duke filluar prej vorbave, ibrikëve”, tepsive prej balte”, qerpiçëve, tullave, qeramikës së jevgjeve e tjerë. Përmes qendrave kryesore rurale të dalluara për përpunimin e qeramikës përmendim Cetricën, Konjarenë e Epërme dhe të poshtme, Tabanocin, Llopatin, Opajen, Doreshanen, Brzakun etj. Tregu kryesor, por dhe prodhimi kryesor është

bërë në qytetin e Kumanovës në lagjen “Sredoreku i Kumanovës”, ku janë bërë shitjet më të mëdha jo vetëm në këtë qytet, por edhe në Preshevë, Bujanoc, pastaj në Shtip e Veles, Kriva Pallanketj. Bota e kuqe është marrë nga deluvimet argjilore të luginës së Pcinjës, rrjedhjes së poshtme të Ball tepes etj. Dekorimet e tyre janë realizuar me metodën e incizionit me pika që formojnë vija ose me kordon qeramike të vendosur mbi to.

Punimi i drurit përfaqëson një tjetër traditë që vazhdon të ruhet edhe në ditët e sotme. Këto punime i gjejmë në çdo shtëpi fshatare, duke nisur nga objektet e vogla: lugë, çibukë, kuti duhani dhe kafeje, krehra etj., deri te karriget, dollapët, portat dhe dritaret, tavanet dhe muret e dhomës së miqve etj. Zonat më të përmendura në përpunimin e drurit janë fshatrat malore të Sredorekut e Kozjakut nga njëra anë edhe ato të Karadakut të Likovës nga ana tjetër.

3.1.2 Punimi i metalit

Kumanova si qytet i shekullit 17 e ka pasur të zhvilluar shumë punimin e bakrit (tepsi bakri), kallajisjet e tepsive, përpunimin e hekurit, duke filluar prej sëpatave, lopatave, kazmave, çekiçëve, furkave prej hekuri, plugjeve etj. Në qytetin e Kumanovës kanë qenë zhvilluar edhe artizanatet e artit dhe të argjendit, punishtet e rrobaqepësisë, pjatave prej hekuri, kallajisja e tyre, tabakëve, tenxhereve, pjatave, lugëve, xhezve, por edhe armeve.

3.1.3. Veshjet dhe shtrojat

Një fushë shumë e pasur e artit popullor në zonat rurale të Fushëgropës së Kumanovës është edhe ajo e tekstileve prej leshi, pambuku dhe mëndafshi. Përmendim copat mëndafshita të qytetit të Kumanovës, qëndisjeve të shamive dhe çarçafëve, dyshekëve, jorganëve, tapete muri, dollapë, sënduqe për palosjen e tyre. Copat përdoren gjerësisht në përgatitjen e veshjeve tradicionale si shajaku i xhokave ose pelerinave si dhe shajet rripet etj. Më të pasurat janë veshjet e femrave, të përbëra nga shumë elemente të hershme maqedone, shqiptare, turke, me funde të valëzuar në formë këmbane, këmisha prej mëndafshi ose liri tallagani. Të gjithë këto ndryshojnë nga një fshat në tjetrin, pastaj prej fshatrave me qytetin e Kumanovës dhe Preshevës: përzierja e brumit me lopate druri, vendosja e brumave në sofër, gatimi etj.

Edhe dalja e vajzës nga shtëpia shoqërohet me një sërë ceremonish tradicionale. Në disa fshatra vëllau i nuses e merr atë prej dore dhe e rrotullon tri herë përreth oxhakut dhe para se të hipë në kalë nusja vendos mbi kokë duvakun, një copë e kuqe në formë konike për ta mbrojtur nga të “këqijat e të ligat”. Arritja e nuses në shtëpinë e saj të re është e mbushur me rite interesante. Në zonat veriore djali pret familjen e vajzës në oborr duke shtënë disa herë në ajër. Në traditë për shumë zona të vendit është hedhja e grurit

ose leblebive mbi kokën e nuses, që ajo të shtohet sa më shumë. Moment mjaft domethënës gjatë ceremonisë së ardhjes së nuses është kalimi i pragut të derës të shtëpisë së re. Në disa fshatra ajo duhet të puthë hyrjen e shtëpisë, të lyejë me mjaltë pjesën e sipërme të portës etj.

3.1.4 Ritet e vdekjes

Në traditën kulturore dhe shpirtërore të popullsisë rurale në Maqedoni dhe në rajonin e Kumanovës një vend të veçantë zënë ritet e lidhura me vdekjen. Tradita më të spikatura janë ato të zonave malore në veri të vendit. Besohet se shpirti i të larguarit nuk gjen paqe nëse nuk i gjenden pranë të gjithë njerëzit e tij të dashur, prandaj ai që e mban në krahë gjatë çasteve të fundit përmend të gjithë emrat e njerëzve që gjenden rreth tij, pasi besohet se kjo ia lehtëson vuajtjet. Pas vdekjes, burrat nisin të “gjamen” e tyre duke qarë dhe thirrur emrin e të ndjerit, ndërsa femrat nisin të vajtojnë, duke rrahur gjoksin e duke grisur rrobat.

3.1.5 Këngët tradicionale

Këngët historike dhe sociale dhe në veçanti ato të trimërisë kanë qenë gjithmonë pjesë e argëttimeve, festave popullore, lindjeve, martesave etj. Në botën rurale në fushëgropën e Kumanovës me to është trashëguar njëkohësisht ndjenja ndaj të afërmeve lindjeve fisnore e etnike dhe trimërisë. Krijimtaria historike shqiptare bazohet në legjendat epike, të cilat i këndojnë trimërisë dhe forcës së mbinatyrshme të fshatarësisë në mbrojtje të trojeve të tyre. Djepi i tyre është veriu i Shqipërisë, Malësia e Madhe, Dukagjini etj. Një vend të veçantë zënë edhe baladat e kënduara me lahutë, çifteli, fyell ose pa vegël muzikore.

PËRFUNDIME

Në zonat rurale në Fushëgropën e Kumanovës në të kaluarën dhe sot, sidomos në fshatrat malore në disa shtëpi të vjetra ekzistojnë dëshmi të një të kaluarë interesante të jetës së njerëzve të kësaj ane. Mënyra e jetesës së tyre, arkitekturës së shtëpive, rregullimi i brendshëm dhe i jashtëm kanë qenë dhe janë objekte që zgjojnë edhe sot interesim të turistëve, sidomos nga rajonet urbane dhe nga vendet e tjera. Këtu në këtë trevë janë interesante edhe qendrat arkeologjike të Kumanovës dhe të Likovës. Një tjetër përbërës i rëndësishëm i trashëgimisë rurale janë edhe monumentet historike të përfaqësuara në mënyrë të veçantë janë monumentet fetare (kishat dhe xhamitë) monumente historike në Kumanovë dhe në rrethine, ajo e Pelices, Lopatit, Opajes mlado dhe staro Nagoricanit etj.

Objektet e kultit në zonat rurale të Kumanovës, kultin e kullotave, kultet e bimësisë, të përfaqësuara nga drunj shekullorë, pranë të cilëve besohet të ketë ndodhur një ngjarje e pashpjegueshme, kulti i diellit, lokalitetet e shumta arkeologjike, momiat e gjetura në Likovë, enë qeramike e zbukurime të tjera në Pelincë, Bedinje, Vincë, Agino Selo Dobroshane etj. Megjithatë, kultet më domethënëse janë ato të bujqësisë dhe blegtorisë, me rite që lidhen me veprimtari specifike si fillimi i korrjes, shtegtimi i bagëtive, krasitja e rrushit, fillimi i korrjeve, dita e verës, shëngjergji, dita e dimrit, festa myslimane etj.

Vendbanimet rurale të përqendruara ose të shpërndara përgjatë rrugës ose lumit, të izoluara janë ato të zonave kodrinore ose malore, veprimtaria kryesore e së cilës është blegtoria. Zona urbane e qytetit të Kumanovës shumë objekte dhe monumente interesante për funksionimin e turistëve (banjat, muzetë, arkivi historik, viset malore, lokalitetet arkeologjike në Kumanovë, banesat rurale shfaqin një larmi të dukshme dallimesh e specifikash të karakterit lokal dhe më gjerë. Në shumë vendbanime fshatare me kulme të mbuluara me rrasa guri, të ndërtuara me mure guri, ndërsa si lidhëse paraqiten edhe druri si pjesë përbërëse e kompleksit ndërtimor të periudhave më të hershme, edhe sot paraqesin një ekzemplar të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit rural në këto anë.

Literatura

1. Selmani.A&Lindita Selmani(2006): Fushegropat e Shkupit. Studim fiziko-gjeografik, Logos-5,Sak-Stil, Shkup.
2. Санев, В.(1992) Неолит во Македонија, Водич низ археолошка поставка, Музеј на Македонија, Скопје.
3. Санев, В(1994) Младо камено доба, Археолошка карта на Република Македонија, том.6, Скопје
4. Филиповски Ѓ,(1997) Почвите на Република Македонија –том Ш.Ману, Скопје.
5. Масевски, Д& Арсовски, М-Болто(1996) Куманово,прилози за изучување на неговото минатот од праисторијата до денес,Куманово.
6. Selmani, A.(1995) Likova dje, sot dhe neser, Ekoritmi, Shkup.
7. Celevi, E.(1967) Putopis, odlomci o Jugoslovenskim zemljama, Svjetlost, Sarajevo.
8. Здравковски, Д(1983-1984) Истражување на локалитетот На Брег село Младо Нагоричање, бр.9, Macedonia Acta archaeologica, Скопје.
9. Cabej, E.(1977) Emri I Dardanise dhe izoglosat Shqiptaro-kelte ne Studime gjuhesore, IV, sv.1, Prishtine.
10. Novak, G(1969) La nazionalita dei Dardani in Arhiv za Arbanasku starinu, jezik I etnologiju, knj.IV, sv.1, Prishtine.
11. Здравковаски, Д.(1983-1984) Истажување на локалитетот На Брег село Младо Нагоричање,бр.9, Macedonia Acta archaeologica,Скопје 43-49.

M.A. Dhurata BILO

LLOJET E PERSONAVE JURIDIKË

Ekzistenca e numrit të madh të personave juridik ka bërë që ato të klasifikohen. Shkenca juridike ka bërë ndarjen e personave juridik, në dy grupe të mëdha:

1. Personat juridikë publik dhe

2. Personat juridikë privat.

1. Personat juridik publik

Klasifikimi i personave juridikë publik dhe privat është bërë që në të drejtën borgjeze. Kriteri, që është marrë për bazë për një ndarje të tillë është natyra e funksioneve që ushtrojnë vet personat juridikë, përkatësisht mënyra e krijimit të tyre.

Personat juridikë publik, janë institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore, që financohen vete ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera me karakter publik. Nëse personi juridik ushtron funksione publike juridike, atëherë ai person është person juridik publik, si psh. shteti, komuna, etj. Ato krijohen (themelohen) me vendim të organeve shtetërore për ushtrimin e funksioneve apo pushtetit publik.

Në këtë kuadër, duke marrë për bazë veprimtarinë të cilën do ta ushtrojnë personat juridik publik, ato mund të klasifikohen, ne:

- Persona juridikë publik, *që nuk ushtrojnë* funksione ekonomike, psh. ministrinë, institucionet dhe entet e ndryshme shtetërore, njësitë e vetad-ministrimit lokal, universitetet etj.
- Persona juridikë publik, *që ushtrojnë* veprimtari ekonomike psh. ndërmarrjet shtetërore.

2. Personat juridik privat

Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari, përkatësisht funksione të karakterit juridik privat, konsiderohen **persona juridikë privat**.

Persona juridikë privat, janë:

- **shoqëritë**
- **entet**
- **institucionet e ndryshme të karakterit privat**, etj.

1.a. Shteti (organet shtetërore), si person juridik

Në raportet juridiko civile, si palë mund të paraqitet edhe shteti përkatësisht organet shtetërore.

Në të drejtën e vjetër romake, shteti romak – ***populus romanus***, nuk është konsideruar si person juridik, sepse pasuria e shtetit është konsideruar si pronësi kolektive dhe u ka takuar anëtarëve të tij. Kur shteti romak ka hyrë në raportet juridike civile me subjektet të tjera, përkatësisht me personat privat, keto mardhenie, janë rregulluar nga e drejta publike. Në të tilla raste shteti ka hyrë në raporte juridike si titullar i sovranitetit publik shtetëror.

Në kohën e mbretërisë romake kemi një ndarje të pronësisë shtetërore, në atë mënyrë që: një pjesë të saj ka administruar Senati (***“Aerarium populi Romani”***) – pasuria në formë të parasë në arkën shtetërore ndersa, pjesën tjetër mbreti (***“Fiscus principis”***).

“Fiscus principis” është trajtuar si pronësi private e mbretit dhe ka bërë pjesë në fushën e të drejtës civile. Ajo ka filluar të përfshijë edhe pasurinë e përgjithshme shtetërore. Kështu, edhe shteti romak si ***“fiscus”*** bëhet subjekt i së drejtës civile, por asnjëherë në tërësi nuk ka mundur të barazohet me subjektet tjera të së drejtës civile, përballë ekzistencës të numrit të madh të ***“privilegia fisci”***. Gjatë zhvillimit të mëvonshëm prej fiskusit është nxjerrë pasuria e veçantë e mbretit ***“patrimonium Caesaris”***, e cila ka kaluar tek trashigimtarët e mbretit.

Gjatë periudhës së feudalizmit të vonshëm, nuk kemi hasur ndonjë dallim midis pronësisë së mbretit dhe shtetit dhe pse, mbreti është konsideruar pronar i tërë territorit shtetëror. Megjithatë, në monarkitë absolute, ***fiscus*** është zhvilluar si institucion juridik. Për rrjedhojë, ***fiscus*** fillon të konsiderohet si subjekt i së drejtës civile ¹⁾. Që në atë kohë dhe sot, shteti paraqitet si bartës i pushtetit shtetëror dhe titullar i të drejtave juridike civile. Në bazë të këtij fakti, shteti si subjekt i së drejtës civile mund të dalë në qarkullimin juridik dhe ekonomik dhe të hyjë në raporte juridiko civile edhe me personat privat.

Shteti si imperium (në kuptimin e aparatit shtetëror), mund të jetë kryerës i ekspropriimit ²⁾. Ai, si subjekt i të drejtës së pronësisë mbi pasurinë e tij, ka të drejtën e gëzimit, posedimit dhe disponimit. Të drejtat e posedimit dhe të gëzimit ai mund t'i kalojë edhe tek subjektet e tjerë të së drejtës civile. Ndërsa, të drejtën e disponimit nuk mund ta mbartë mbi ndonjë subjekt tjetër në qoftë se, nuk është parashikuar me ligj.

Administrimi i pasurisë shtetërore bëhet nga organet shtetërore që janë të përcaktuara me ligj, nga ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore. Mbi pasuritë që konsiderohen publike, shteti është i detyruar t'i ruajë, administrojë, gëzojë e posedojë dhe jo, të disponojë me to apo t'i ndryshojë destinacionin e tyre.

1.b. Organizatat (ndërmarrjet) ekonomike si persona juridik

Shteti, përkatësisht organet shtetërore, mund të themelojnë organizata ekonomike për ushtrimin e veprimtarive të caktuara, duke u dhënë atyre në administrim, pasuri apo mjete financiare që do të përbënin mjetet themelore (kapitalin themelor) të organizatës. Për këto mjete, ekziston regjimi i veçantë i administrimit. Pasuria që i jepet organizatës, është në pronësi shoqërore.

Në organizatat ekonomike bëjnë pjesë: ndërmarrjet industriale, ndërmarrjet ndërtimore, minierat, ndërmarrjet bujqësore, ndërmarrjet për shfrytëzimin e pyjeve, ndërmarrjet tregëtare, ndërmarrjet turistike, ndërmarrjet botuese, entet për sigurim dhe risigurim, etj.

Të gjitha organizatat ekonomike, mund të hyjnë në raporte juridike civile me organizatat e tjera ekonomike, me organet shtetërore, me institucionet publike, me shoqëritë tregëtare si dhe me personat fizik. Ato, kur paraqiten si palë në raportet juridike civile, kanë cilësinë e subjektit të së drejtës civile (person juridik) dhe posedojnë aftësi, që të jenë titullar i të drejtave dhe detyrimeve juridike civile.

2.a. Personat juridik privat

Si subjekt i së drejtës civile paraqiten edhe shoqëritë, fondacionet dhe entet tjera me karakter privat. Të gjitha këto, janë formacione shoqërore, formë e organizimit të qëndrueshëm kolektiv nëpërmjet të cilëve, realizohen qëllimet e përbashkëta. Personat juridikë privat formohen nga organizimet kolektive vullnetare. Ata krijohen me vullnetin e lirë të anëtarëve të tyre. Anëtarët mund të jenë dy ose më shumë persona. Të gjithë anëtarët që do të krijojnë personat juridikë privat marrin për sipër detyrime, që të arrijnë qëllimin e përbashkët,

zhvillimin e një veprimtarie të caktuar. Qëllimet e personave juridikë privat mund të jenë të natyrës ideale (joekonomike) dhe fitimprurëse (ekonomike).

2.b. Shoqëritë tregtare

Shoqëritë ekonomike (tregtare), paraqiten si subjekte të së drejtës civile në qoftë se kanë, personalitet juridik. Shoqëritë e personit janë të privuara nga personaliteti juridik ³⁾, ndërsa shoqëritë e kapitalit janë të pajisura me këtë personalitet.

Shoqëritë e personit nuk mund të arrijnë personalitetin juridik, kurse shoqëritë e kapitalit ekzistojnë juridikisht vetëm nga momenti në të cilin arrijnë personalitetin juridik⁴⁾.

Personalitetin e tyre juridik shoqëritë tregtare ***e fitojnë në momentin e regjistrimit të tyre në regjistrat tregtarë***. Në vazhdim të punimit do t'i zbërthejmë çështjet që kanë të bëjnë mbi kuptimin, tipet dhe organizimin e shoqërive të kapitalit në Maqedoni.

2.c. Fondacionet

Fondacionet ⁵⁾ fitojnë subjektivitet juridik me aktin e krijimit.

Akti i krijimit të fondacioneve, prodhon efekte në bazë të deklarimit të vullnetit të themeluesit të fondacionit. Themelues mund të jenë një, dy apo më shumë persona. Fondacionet kanë dy elemente:

- **pasurinë** – të cilën e krijon themeluesi i fondacionit nga të mirat materiale, duke i destinuar për një qëllim mbiindividual dhe
- **aktin e organizimit** – strukturën organizative të fondacionit.

Akti i themelimit është një akt që ka për qëllim të krijojë një subjekt të ri të së drejtës ⁶⁾. Ky subjekt i ri në fakt, paraqet një kompleks të mirash materiale të destinuara për një qëllim të përbashkët – *Universitas bonorum*.

Megjithatë, fondacionet në një farë mënyre janë një lloj i organizimeve njerëzore – kolektive, ku pasuria është thjesht një mjet për realizimin e qëllimit. Pasuria e destinuar për qëllimin e caktuar, paraqet masën pasurore të fondacionit, ndërkaq personat – themeluesit veprojnë në cilësinë e organit të fondacionit.

Me fjalë të tjera, fondacionit i prijnë akti i themelimit, përkatësisht akti midis të gjallëve ose nëpërmjet testamentit, si per shembull, fondacionet e themeluara për dhënien e bursave të studimit, akti për përcaktimin e trashëgimtarit në qoftë se është përfshirë në testament, etj.

Kuptimi i shoqërive tregtare

Shoqëritë tregtare janë organizime kolektive të dy a më shumë personave fizikë apo juridikë të cilët, disponojnë para, sende dhe të drejta pronësie-juridike, dhe që do t'i shfrytëzojnë ato, për ushtrimin së bashku të një veprimtarie ekonomike nga e cila, do ta ndajnë së bashku fitimin e realizuar dhe së bashku, do të pësojnë nga humbjet eventuale.

Shoqëria formohet me anë të kontratës, ku marrin pjesë dy ose më shumë persona, e cila karakterizohet si kontratë potencialisht shumëpalëshe: palët e reja mund t'u shtohen palëve fillestare, pa çuar në lidhjen e një kontrate të re⁷⁾.

Në raste të përcaktuara me Ligjin mbi shoqëritë tregëtare, shoqërinë tregëtare mund ta themelojë edhe një person i vetëm, i cili vet jep si kontribut të mira materiale ose shërbime për ushtrimin e një veprimtarie ekonomike me qëllim që të realizojë fitim.

Personat të cilet disponojnë në kapitalin themelor, janë ortakët e shoqërisë perkatesisht aksionerët e shoqërisë.

Të mirat materiale dhe shërbimet e depozituara në shoqëri, llogariten në para, të cilat në atë mënyrë përfaqësojnë kapitalin themelor të shoqërisë.

Shoqërinë mund ta themelojnë, personat fizik apo juridik, të vendit dhe të huaj. Në bazë të Ligjit mbi shoqëritë tregëtare të Maqedonisë, personi i huaj është: *"secili person juridik që ka të regjistruar firmë në regjistrat zyrtarë në vendin e huaj, ose nëse ka të regjistruar firmë në regjistrat tregëtar në vendin e vet dhe çdo person fizik që është shtetas i huaj, refugjat apo apatrid"*.

Në qoftë se, themelues i shoqërisë është shtetasi i Maqedonisë që ka edhe nënshtetësi të huaj, me ligjin në fjalë parashikohet se, ai mund të zgjedhë ne se do të paraqitet si shtetas i Maqedonisë apo me status të personit të huaj.

Karakteristikat e tipave të shoqërive tregtare

Shoqëritë tregtare janë persona juridikë, të cilat në mënyrë autonome ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike për të realizuar fitim.

Shoqëritë, sipas Ligjit mbi shoqëritë tregëtare të Maqedonisë, formojnë një sistem të përbërë nga një shumëllojshmëri tipesh, ku çdonjëra prej tyre paraqitet me karakteristikat e veta, dhe çdonjëra prej tyre është e destinuar që të zhvillojë një funksion të caktuar në fushën e sistemit ekonomik të vendit.

Shoqëritë që kanë për objekt ushtrimin e një veprimtarie tregtare, duhet të krijohen sipas njërit prej tipeve të parashikuara me ligj.

Ligji, parashikon dy lloje të tipeve të shoqërive tregtare (pavarësisht çfarë është veprimtaria e tyre):

a. Shoqëritë e personit

b. Shoqëritë e kapitalit.

Shoqëritë e personit, justifikojnë emërtimin e tyre si shoqëri të personit, në bazë të faktit se, ato themelohen me një kontratë, e cila paraqitet si një detyrim kontraktor që bashkon mes tyre shumë sipërmarrës, të cilët ushtrojnë së bashku dhe jo individualisht të njëjtën shoqëri. Ortakët merren këtu në konsideratë në mënyrë thelbësore nga vlera e pasurisë së tyre dhe nga zotësia e tyre si sipërmarrës.

Shoqëritë e personit, karakterizohen me përgjegjësi të pakufizuar dhe solidarë të ortakëve për detyrimet e shoqërisë, me tërë pasurinë e tyre që e posedojnë, e jo vetëm me kontributet që i kanë dhënë në shoqëri. Secili ortak i shoqërisë se personit ka statutin edhe të administratorit të shoqërisë. Pushteti i administrimit përfshihet në mënyrë të drejtëpërdrejtë në cilësinë e ortakut. Secili ortak merr pjesë në drejtimin e sipërmarrjes së shoqërisë.

Kontrata e themelimit të shoqërisë së personit është e patransferueshme, pa vullnetin e ortakëve që e kanë themeluar shoqërinë. Për shitjen e kuotave, apo transferimin e tyre në bazë të ndonjë raporti të caktuar juridik, nevojitet vullneti i ortakëve të tjerë dhe e vet personit tek i cili është transferuar kuota perkatëse.

Shoqërive të personit, me karakteristika të tjera, u kundërvihen shoqëritë e kapitalit tek të cilat, cilësitë personale të ortakëve në parim, humbin çdo rëndësi dhe ortakët merren në konsideratë në bazë të kuotës së kapitalit të shoqërisë që e posedojnë ato ⁸⁾.

Paraqitja dhe zhvillimi historik i shoqërive të kapitalit

Shoqëritë e kapitalit i përkasin një faze të caktuar të evolucionit të historisë së kapitalizmit. Lindja e shoqërisë aksionere është prototip i shoqërisë së kapitalit dhe lidhet me fazën e mëvonshme të evolucionit të kapitalizmit. Ajo është forma juridike tipike e kapitalizmit modern që mbështetet mbi prodhimin dhe shpërndarjen industriale masive. Këto kërkonin përdorimin e kapitaleve të mëdha, dhe në këtë mënyrë nxitën krijimin e lehtë të kësaj shoqërie, pasi përgjegjësia e kufizuar e tyre i siguronte afaristët nga rreziku i humbjeve totale.

Transformimi i sistemit produktiv në sistemin e prodhimit masiv dhe të shpërndarjes masive, e shton rëndësinë dhe rritjen e numrit të shoqërive aksionere.

Shoqëritë aksionere janë bërë tipi më i përhapur i shoqërive të sotme dhe i përmbushin kërkesat e sipërmarrjeve të mëdha.

Shtytës për lindjen dhe shtimin e tyre është edhe përgjegjësia e kufizuar e anëtarëve të shoqërisë aksionere. Shtytje të papërballueshme, ato kanë ushtruar edhe në marrëdhëniet e prodhimit dhe shpërndarjes masive në Maqedoni. Prandaj edhe jurisprudenca e Maqedonisë u jep formë juridike shoqërive aksionere.

Shoqëritë aksionere janë organizime kolektive, të krijuara për ndjekjen e një qëllimi për ndarjen e fitimeve të realizuara nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike. Ato krijohen për të përmbushur interesin e një numri të mbylltur subjektesh që koïncidon me sferën e atyre që e përbëjnë, me mundësi të aderimeve të reja, të anëtarëve të rinj, perkatësisht të kapitalit të rinj, brenda kufijve të aktit të krijimit të saj.

Shoqëritë aksionere kanë rëndësi juridiko-kushtetuese dhe rol kyç në ekonominë kapitaliste. Ajo kënaq realizimin e parimeve kushtetuese, kur individët bëjnë zhvillimin e personaliteteve të tyre në formacionin shoqëror të caktuar, duke e shfrytëzuar të drejtën që të organizohen lirisht në shoqëri për qëllim dhe interes që ligji nuk i ka ndaluar ⁹⁾. Pra, ato janë shprehje e autonomisë së individëve, të cilëve u lejohet të krijojnë marrëdhënje shoqërore ekonomikisht të nevojshme për ekonominë kapitaliste.

Jurisprudenca e Maqedonisë i është përmbytur rregullit sipas së cilës, shoqëritë aksionere njihen si persona juridikë nga e cila rezulton, pajtueshmëria e strukturës dhe sistemit organizativ dhe funksional të tyre me atë të personave juridik si subjekt të së drejtës. Ato kanë zotësi veprimi, atë të kontraktimit, autonominë e fondit të përbashkët. Ato mund të fitojnë të mira materiale, ndërkaq për detyrimet e mara përsipër, përgjigjet shoqëria me gjithë kapitalin e vet.

Pranimi i konceptit normativ, nuk e vë si kusht të nevojshëm që shoqëritë aksionere të mund të veprojnë si subjekte të veçanta të së drejtës, por që anëtarët e Këshillit të administrimit, të fitojnë disa prerogativa të veçanta të përgjegjësive së kufizuar ndaj veprimeve të tyre me të cilat realizojnë në praktikë funksionin e shoqërisë aksionere, brenda kufirit të vlerës nominale të kapitalit themelor të shoqërisë.

Shoqëritë aksionere janë tipi më i përhapur i shoqërive tregtare të sotme. Shtytjen për marrjen e iniciativave ekonomike për krijimin e shoqërive aksionare, e ka bërë ndarja e kapitalit të shoqërisë në aksione dhe mbledhja e pasurisë në një masë të madhe nga financuesit e vegjël. Pozicionimi i volitshëm i financuesve të vegjël gjatë posedimit të fletëaksioneve, qoftë duke i nënshkruar ato me aktin e krijimit të shoqërisë, qoftë duke i blerë ato, në një shoqëri të krijuar më parë, në realitetin e sotëm ekonomik, i mundëson atij vetëm apo së bashku me të tjerët, drejtimin e shoqërisë, ose realizimin e investimeve në para.

Ky fenomen i aksionizimit të kapitalit ka marrë dimensione të mëdha, sa që edhe shoqëritë e tjera tregtare, transformohen në shoqëri aksionere, qofshin në ato që ushtrojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë veprimtarinë ekonomike, të prodhimit ose të shkëmbimit të të mirave materiale.

Kuptimi i shoqërive aksionere

Shoqëritë aksionere janë shoqëri të kapitalit, që në vete përmbajnë tërësinë e të mirave materiale të dhëna si kontribute nga ana e anëtarëve që i themelojnë ato. Personaliteti i anëtarëve që e themelojnë shoqërinë aksionere është irrelevant, gje që do të thotë se me rëndësi është kapitali i bashkuar nga ana e anëtarëve të saj.

Me statut, shoqëritë aksionere si shoqëri tregtare i ka të përcaktuar fletëaksionet dhe kapitalin themelor të saj, në të cilin marrin pjesë anëtarët e shoqërisë me një apo me më shumë fletëaksione.

Shoqëritë aksionere janë një tip i shoqërisë që dallohen prej dy karakteristikave : e para qëndron në përkufizimin e përgjegjësisë së ortakëve, deri në shumën ose deri tek e mira materiale e dhënë si kontribut në shoqëri; karakteristikë tjetër, nga e cila rrjedh edhe emri i kësaj shoqërie, konsiston në rrethanën që “kuotat e pjesëmarrjes së ortakëve përfaqësohen nga aksionet” ¹⁰⁾.

Anëtarët e shoqërisë ndërmarrin operacione ekonomike brenda shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar juridike deri në lartësinë e “kuotës” së pjesëmarrjes së tyre në të, ndonëse shoqëritë aksionere janë shoqëri të kapitalit të bashkuar nga ana e anëtarëve të saj, të cilat kanë të drejta të kufizuara në bazë të kontributeve të tyre materiale, ku secili nga anëtarët merr pjesë me një apo më shumë aktivitete të caktuara ekonomike ¹¹⁾.

Themelimi i shoqërive aksionere

Shoqëritë aksionere themelohen me një kontratë në mes anëtarëve të saj të ardhshëm, të cilët marrin obligime për ekzekutimin e detyrimeve të caktuara që vlerësohen ekonomikisht. Kjo kontratë në vetvete i përmban elementet themelore të vet aktit të krijimit dhe të statutit të shoqërisë.

Shoqëri aksionere mund të themelojnë të paktën tre persona fizik ose juridik. Në bazë të kushteve të veçanta të përcaktuara me ligj, atë mund t’a themelojë edhe një person. Personi juridik ndaj të cilit është hapur procedura e falimentimit, nuk mund të jetë themelues i shoqërisë aksionere. Themeluesit e shoqërisë janë anëtarët që e nënshkruajnë aktin e themelimit, i cili verifikohet me akt noterial ¹²⁾.

Akti i themelimit të shoqërisë aksionere përmban dispozita për:

- firmën dhe filialën
- lëndën e punës
- vlerën e kapitalit themelor
- vlerën nominale të fletëaksioneve, numrin e përgjithshëm të fletëaksioneve të dhëna, llojin e fletëaksioneve
- udhëheqjen dhe administrimin e shoqërisë aksionere
- kohën e zgjatjes së subjektivitetit juridik të shoqërisë aksionere
- ndarjen e fitimit, dividendës.

Jurisprudenca e Maqedonisë njeh dy mënyra të themelimit të shoqërive aksionere:

- simultan dhe
- suksesiv.

1. Themelimi simultan

Shoqëria aksionere mund të themelohet në atë mënyrë, që themeluesit vetë, apo bashkërisht me personat tjerë, personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesit, në një apo më shumë deklarata, bëhen posedues të të gjitha fletëaksioneve, pa shpallje publike dhe japin deklaratë se është themeluar shoqëria. Themelimi i shoqërisë aksionere në këtë mënyrë quhet themelim simultan.

Themeluesit e shoqërisë që bëhen posedues të fletëaksioneve, i marrin përsipër obligimet për pagimin e fletëaksioneve, gjë të cilën e publikojnë me hartimin e raportit të shkruar gjatë fazës së themelimit të shoqërisë. Në raportin themelues, tregohen edhe kushtet themelore të pagimit të fletëaksioneve, numri i fletëaksioneve që janë marrë prej anëtarëve të organit të administrimit, perkatësisht prej këshillit mbikqyrës, forma dhe mënyra në bazë të të cilave anëtari i organit të administrimit, të këshillit mbykqyrës, krijon beneficion të veçantë, dëme apo shpërblime për pjesëmarrje në themelimin e shoqërisë.

Anëtarët e parë të organit të administrimit dhe të këshillit mbykqyrës, emërohen në statutin e shoqërisë. Nëse statuti i shoqërisë ka përcaktuar se, emërimin e këtyre anëtarëve e bën kuvendi i shoqërisë, themeluesit për shkak të emërimit të tyre për anëtarë të këtyre organeve therrasin mbledhje të posaçme me poseduesit e fletëaksioneve, në të cilën bëhet emërimi i anëtarëve të organeve të shoqërisë ¹³⁾.

2. Themelimi suksesiv

Shoqëria aksionere mund të themelohet edhe me regjistrim të të gjithëve ose numrit të caktuar të fletëaksioneve në bazë të konkursit publik.

Konkursi publik me të cilin bëhet thirrja për regjistrim të fletëaksioneve, përgatitet në pajtueshmëri me dispozitat e aktit të themelimit. Regjistrimi i fletëaksioneve bëhet në institucionet financiare ¹⁴⁾.

Regjistrimi i fletëaksioneve bëhet në formën e bazuar në deklaratën me shkrim dhe ajo është e afatizuar, me çka nuk mund të zgjatë më tepër se tre muaj, nga dita kur fillon regjistrimi. Nëse regjistrimi ka qenë i suksesshëm, themeluesit brenda pesëmbëdhjetë ditësh, pas kalimit të afatit të caktuar në shpallje për regjistrimin e fletëaksioneve, e bëjnë ndarjen e fletëaksioneve në mes të regjistruësve.

Pas regjistrimit të fletëaksioneve, dy muaj pas kalimit të afatit të caktuar me shpallje për regjistrim të fletëaksioneve, themeluesit i therrasin regjistruësit në kuvendin themelues të shoqërisë, ku bëhet emërimi i anëtarëve të organeve të shoqërisë, dhe merren vendime të rëndësishme për themelimin e shoqërisë aksionere dhe regjistrimin e saj në regjistrat e shoqërive tregtare.

Literatura:

- 1 Shih: Voislav Spaiç, Osnovi na gradjansko pravo, Sarajevo, 1957, fq. 153
- 2 Ekspropriimi (shpronësimi) është kalimi i pronës private në atë shtetore, për interes të përgjithshëm dhe me kompensim për titullarët e pronës private
- 3 Shoqëritë e personit janë shoqëri të cilët nuk krijohen sipas tipeve të veçanta të shoqërive tregtare, përkatësisht janë shoqëri që nuk kanë për objekt ushtrimin e një vepërimtarie tregtare
- 4 Shih: Francesko Galgano, E drejta private, Tiranë, 1999, fq. 625
- 5 Fondacionet përkufizohen si një organizëm i qëndrueshëm i krijuar për destinimin e një pasurie private për një qëllim të një rëndësie publike, nëpërmjet të cilave personat fizik ndjekin qëllime mbiindividuale
- 6 Juliana. Latifi, E drejta civile, pjesa epërgjithshme, Tiranë, 2000, fq. 83
- 7 Shih: Francesko Galgano, vep. e cit. fq.660.
- 8 Shih: Galev “E drejta e shoqërive”, ligjerata të autorizuar në Fakultetin Juridik, Shkup 2002
- 9 Transformimi i ndërmarrjeve me kapital shoqëror, bëhet me organizimin e ndërmarrjeve në shoqëri aksionare ose me shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital në pronësi private, përkatësisht me pronar të caktuar në bazë të kushteve dhe procedurës së paraparë me Ligjin mbi transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror si dhe me Ligjin mbi ndërmarrjet. Transformimi bëhet edhe me shitjen e kapitalit shoqëror ose pasurisë së ndërmarrjes. Kur në transformimin si blerës së fletëaksioneve paraqitet personi i huaj, së bashku me Ligjin për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror, zbatohen edhe dispozitat e Ligjit mbi investimet e huaja.
- 10 Francesko Galgano, vep. e cit. fq. 697.
- 11 M. Velimiroviç, Privredno pravo, Sarajevë, 1982, fq. 316.
- 12 Shih: Ligjin mbi shoqëritë tregëtare i R.M. viti, 1996.
- 13 Po aty, neni 252.
- 14 Po aty, neni 259.

Av. Firdusi AJAZI

TRAJTIM I SHKURTER I VEPRAVE PENALE NË LIDHJE ME FENOMENIN E KORRUPSIONIT SI FORMË E SHFAQJES SË KRIMIT TË ORGANIZUAR

Korrupsioni është një nga karakteristikat më universal te Krimit të Organizuar duke qënë gjithashtu një pengese serioze për zhvillimin e shoqërisë dhe demokratizimin e mëtejshëm të vendit. Në luftën kundër tij një rol të veçantë luan dhe legjislacioni penal duke përcaktuar veprat penale që lidhen me këtë fenomen e për rrjedhojë personat subjekt të tyre duhet të përgjigjen penalisht.

Në seksionin e veprave penale të kryera kundër veprimtarisë shtetërore nga shtetasit në nenin 244 parashikohet se¹⁾: *“Propozimi për shpërblime, dhurata, ose përfitime të tjera që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore, apo një shërbim publik që të kryejë, ose të moskryejë një veprim që lidhet me detyrën, apo shërbimin, apo të përdorë ndikimin e tij me autoritetet e tjera për të siguruar favorizime, dalime e çdo përfitim tjetër denohet me gjobe, ose me burgim deri ne 3 vjet”*.

Objekti janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar veprimtarinë e rregullt të organeve shtetërore e të shërbimit publik, veprimtari e cila mund të cënohet nga korrupsioni i punonjësve që kryejnë detyra shtetërore apo të shërbimit publik.

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime aktive të kundraligjshme që konsistojnë në bërjen e propozimeve për shpërblime, dhurata ose përfitime të tjera materiale punonjësit që kryen detyrë shtetërore apo në shërbim publik që të kryejë ose të mos kryeë një veprim të caktuar që lidhet me funksionin ose detyrën ose të përdorë ndikimin e tij në autoritetet e tjera për të siguruar

1. Neni 244 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

favorizime, dallime apo përfitime. Një rast i tillë do të supozohej propozimi që mund ti bëhej gjyqtarit apo prokurorit në të holla për të pushuar çështjen penale.

Subjekti i krimit mund të jetë cdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm.

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje direkte dhe me qëllim për të përfituar favorizime, dallime, etj.

Në nenin 245 të K.Penal parashikohet vepra penale e dhenies së shpërblimit punonjësit që kryen detyrën shtetërore. Në këtë dispozite parashikohet; *“Dhenia e shpërblimeve apo përfitimeve të tjera punonjësit që kryen detyrë shtetërore apo në shërbim publik për të kryer apo moskryer një veprim që lidhet me detyrën apo shërbimin apo të përdorë ndikimin e tij në autoritetet e tjera për të siguruar favorizime dallime e cdo përfitim tjetër dënohet me gjobe ose me burgim gjer në 5 vjet”*.

Figura e veprës penale e parashikuar nga kjo dispozite ndryshon nga figura e veprës penale e parashikuar nga neni 244 vetëm persa i përket anës objektive, pasi në këtë figure krimi konsiderohet i dhënë shpërblimi dhe i marrë përfitimi dhe nuk mbeten keto veprime në kuadrin e propozimeve si në veprën penale të trajtuar më sipër. Krimi quhet i kryer që nga casti i dhënies së shpërblimeve apo përfitimeve.

Në nenin 259 ²⁾ që përfshihet në seksionin e veprave penale kunder veprimtarisë shtetërore parashikohet se; *“Kryerja e veprimeve nga punonjësi i ngarkuar me funksion shtetëror apo me shërbim publik për të kërkuar ose urdhëruar dhënien e shpërblimeve që nuk i takojnë ose më shumë nga sa i takojnë sipas ligjit dënohet me gjobe ose me ligj deri në 7 vjet”*, vepër penale që ka të bëjë me kerkim për dhenie mite.

Objekti i krimit janë mardhëniet juridike të vendosura për të garantuar funksionimin normal dhe autoritetin e aparatit shtetëror si dhe interesat e ligjshme të personave fizik apo juridik të mbojtura posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime të paligjshme që konsistojnë në kerkimin ose urdhërimin për dhënien e shpërblimeve që nuk i takojnë ose më shumë sesa i takojnë sipas ligjit. Ligji nuk kërkon ardhjen e pasojës.

Subjekti i krimit janë vetëm personat e ngarkuar me funksione shtetërore ose me shërbim publik, pra janë subjekte të posaçme.

Nga ana subjektive krimi i kerkimit për dhënie mit kryhet me dashje direkte dhe me qëllim përfitimi material.

2. Neni 259 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Në nenin 260 të K.Penal parashikohet vepra penale e marrjes mite sipas së cilës; *“Marrja e shperblimeve, dhuratave ose perfitimeve të tjera nga punonjësi i ngarkuar me një funksion shtetëror apo në shërbim publik dhe në ushtrim të tyre për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me funksionin apo shërbimin ose për të përdorur ndikimin pranë autoriteteve të ndryshme për ti siguruar cdo personi favorizime, dallime, vënde pune e perfitime të tjera denohet me burgim deri në 10 vjet”.*

Objekti i krimit është i njëjtë me krimin për kërkim për dhënie mite.

Nga ana objektive krimi i marrjes se mites kryhet me veprime e mosveprime të kundraligjshme që konsistojne në marrjen apo pranimin e shperblimeve në të holla, dhuratave ose përfitimeve të tjera dhe keto me karakter material. Marrja e mites bëhet për të kryer apo moskryer veprime që lidhen me funksionin apo shërbimin, pra brënda kopetencave të caktuara. Për kualifikimin e veprës penale nuk ka rëndesi nëse personi e kreu ose jo veprimin. Mita mund të merret para ose pas kryerjes së veprimit.

Subjekti i krimit te marrjes se mites mund të jetë vetem subjekti i posaçëm që kryen një funksion shtetëror apo shërbim publik.

Nga ana subjektive krimi i marrjes së mitës kryhet me dashje direkte dhe me qëllim përfitimi material.

Në kushtet sociale të vendit tonë kur shtetasve ju lindin interesa të ndryshme dhe kur kushtetet për realizimin e tyre nuk gjejnë garanci të plotë, krijohet terren për marrjen dhe dhënien e mitës, por praktikisht është shumë e vështirë të evidentohen këto raste për tu vene para përgjegjësise personat, pasi secili prej tyre ka përfitimet e veta nga ky veprim i paligjshem dhe duke e pare fenomenin të lidhur ngushtë vetëm me interesin personal nuk u intereson që veprimet apo mosveprimet e dëshiruara të mos realizohen. Janë pikerisht ndoshta këto rrethana që në praktike ka shumë vështirësi për zbulimin, gjykimin dhe dënimin e personave që konsumojnë këto vepra penale. Dispozita në thelb me elementet antikorrupsion në Kodin Penal ka dhe të tjera, si të tillë mund të përmendim nenin 312 të K.Penal që parashikon korrupsionin ose kanosjen për deshmi, ekspertim, ose përkthim të rremë. Në këtë nën parashikohet ³⁾;

“Propozimi ose dhenia e shpërblimeve, dhuratave apo përfitimeve të tjera ose kanosja apo vepra të tjera dhune që i bëhen personit për të siguruar dëshmi, ekspertim apo përkthim të rremë ose për të refuzuar kryerjen e detyrave të tyre përpara organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet”.

Objekti i këtij krimi janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të

garantuar funksionimin normal të organeve të drejtësisë, si dhe të drejtat dhe liritë e personit që mbrohen në mënyrë të posaçme nga legjislacioni penal nga veprimet dhe mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime të kundraligjshme dhe që në kuadrin e trajtimit të kësaj teme, konsiston në bërjen e propozimeve ose dhënien e shpërblimeve, dhuratave e përfitimeve të tjera. Vepra quhet e kryer që nga casti i bërjes së propozimit apo dhenies së shpërblimit, dhuratave apo përfitimeve. Arritja e rezultatit nuk ndikon në kualifikimin ligjor të veprës, por mund të cmohet nga gjykata në rastin e caktimit të masës së dënimit.

Subjekt mund të jetë cdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjigjshëm.

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje direkte dhe me qëllim që të sigurohet deshmia, ekspertimi apo perkthimi i rreme. Motivet mund të jenë nga më të ndryshmet por nuk ndikojnë në cilësimin ligjor të veprës.

Në Kodin Penal parashikohet gjithashtu vepra penale e kërkimit apo marrjes së shpërblimit. Sipas nenit 319 të këtij kodi përcaktohet saktë;

“Kërkimi apo marrje të padrejta të shpërblimeve, dhuratave dhe përfitimeve të tjera si dhe sigurimi i premtimeve për to nga ana e gjyqtarit, çdo anetarit të trupit gjykues, prokurorit, çdo arbitri të caktuar për një çështje me qëllim që të kryejë a të moskryejë një veprim që lidhet me funksionin dënohet me burgim nga 5 – 10 vjet”. Ndërmjetesimi i bërë nga personi që ka interes për çështjen ose nga çdo person tjetër për shpërblime, dhurata apo përfitime të tjera ndaj personave të cituar në paragrafin e parë të këtij neni dërgohet me burgim deri në 3 vjet⁴⁾”.

Objekti i këtij krimi pra janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar autoritetin e organeve të drejtësisë, veprimtarinë e rregullt të tyre si dhe të drejtat e personit të mbrojtura nga legjislacioni penal nga veprimet e mosveprimet e paligjshme.

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime aktive të kundraligjshme që konsistojnë në kërkimin apo marrjen e shpërblimeve, dhuratave... nga ana e gjyqtarit, prokurorit apo e çdo arbitri tjetër për një çështje. Në paragrafin e dytë parashikohet rasti i ndërmjetësimit për të kryer këto veprime që mund të kryhen nga cdo person lidhur me subjektin e posaçëm. Për të patur përgjegjësi ligjore sipas këtij paragrafi nuk kërkohet ardhja e pasojës.

Subjekt i krimit është i posaçëm, mund të jetë gjyqtari, prokurori, etj. Kurse në paragrafin e dytë subjekt mund të jetë cdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjigjshëm.

4. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje direkte dhe me qëllim që të realizohen synimet e cituara më sipër. Motivet janë nga më të ndryshmet por nuk ndikojnë në cilesimin ligjor të veprës.

Në nenin 328 të këtij kodi parashikohet kundravajtja penale që ka të bëjë me fenomenin e korrupsionit në sistemin e zgjedhjeve. Në këtë nen parashikohet se;

“Ofrimi dhe dhënia e të hollave, bërja e premtimeve për vende pune ose për favorizime të tjera të cilësdo formë më qëllim për të marrë firmën për paraqitjen e kandidatit për të votuar pro ose kundër një kandidati apo për të marrë pjesë ose jo në votim, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj. Pranimi i të hollave, premtimeve dhe favorizimeve të tjera për të kryer veprimet e sipërme përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë”.

Objekti i kësaj kundravajtje penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të garantuar sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe procedurave ligjore të percaktuara në ligj.

Nga ana objektive kundravajtja penale kryhet me veprime ose mosveprime të kundraligjshme të percaktuara në forma të ndryshme siç janë cituar në dispozite.

Subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën 16 vjeç dhe është i përgjegjshëm.

Nga ana subjektive kjo kundravajtje penale kryhet me dashje, qëllimi është realizimi i përfitimeve që kanë të bëjnë me marrjen e firmes, votimin apo përfitimin material. Motivet nuk kanë rëndësi për kualifikimin ligjor të veprës.

Ndryshimet e bëra në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr.8733, datë 24.01.2001, në drejtim të luftes kundër krimit të organizuar

Në ndryshimet e bëra në Kodin Penal me ligjin e cituar më sipër u shtuan disa dispozita që parashikonin ktimet që kryhen nga organizata kriminale për të realizuar qellime dhe përfitime të paligjshme.

Parashikimi i ketyre dispozitave në Kodin Penal ishte rezultat i nevojave të kushtezuara nga dukuri negative të jetës në këtë periudhë ndryshimesh dhe që detyrimisht për nevoja të ndeshkimit të tyre duhet të parashikoheshin si vepra penale në Kodin Penal. Kryesisht ndryshimet kanë të bëjnë me llojet e trafikimeve, prodhimit dhe fabrikimit të lëndëve narkotike dhe pastrimit të parave të pista.

Po trajtojmë disa dispozita të parashikuara në Kodin Penal në lidhje me keto ndryshime ⁵⁾.

Neni 110/a i K.Penal parashikon trafikimin e njerëzve, që ka të bëjë kryesisht me marrjen e organeve. Dënimi i parashikuar është nga 5 – 15 vjet burgim për paragrafin e parë dhe jo më pak se 15 vjet dhe me burgim të përjetshëm kur kjo veprë është kryer në rrethana cilësuese.

Kur kjo veprë është kryer nga organizata kriminale personat do të përgjigjen dhe për nene 333, 334 të K.Penal, duke bërë me pas bashkimin e denimeve në dënimin përfundimtar.

- Neni 114/b trafikimi i femrave për prostitucion që bëhet me qëllim përfitimi material apo cdo lloj përfitimi tjetër. Në paragrafin e dytë parashikohen rrethana cilësuese që në fakt i korrespondojnë rrethanave rënduese. Dënimi është i rëndë ashtu si dhe dispozita e cituar më sipër. Ky fenomen është mjaft shqetësues për shoqërinë tonë dhe pothuajse çdo ditë vihem në dijeni të kësaj dukurie që mban vulën e krimit të organizuar.

- Neni 128/b ka të bëjë me trafikimin e fëmijëve. Dhe ky krim bëhet me qëllim përfitimi material dhe në rrethana cilësuese. Sanksionet janë të rënda.

- Neni 138/a trafikimi i veprave të artit dhe kultures është një fenomen që në situatën e shndërimeve sociale në vendin tonë ka demtuar rëndë trashëgiminë tonë kulturore, pasi kjo veprë kryhet me qëllime përfitimi si nga individë ashtu dhe nga organizata kriminale.

- Neni 141/a trafikimi i mjeteve motorike. Dhe kjo dispozite është vendosur me qëllim që të parandalohet importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi i mjeteve motorike të vjedhura në kundërshtim me ligjin.

- Neni 278/a trafikimi i armëve dhe i municionit dhe kjo është një veprimtari fitimprurëse për organizatat kriminale dhe kuptohet që zhvillohet në bashkëpunim me organizatat kriminale të vendeve të tjera.

- Neni 282/a trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse helmuese dhe radioaktive. Një aktivitet i tillë mbulohet shpesh nën maskën e një aktiviteti të ligjshëm. Dhe kjo veprë penale mund të kryhet në bashkëpunim midis organizatave të vendit dhe të huaja.

- Neni 283/a trafikimi i narkotikeve. Duke u bërë ndryshimet përkatëse, përse i përket organizimit, drejtimit dhe financimit të kësaj veprimtarie u parashikua dhe një dënim i rëndë, duke parashikuar dënimin minimal jo më pak se 15 vjet burg. Parashikimi i një dënimi të tillë të rëndë ndikon në parandalimin e një fenomeni të tillë që në situatën e sotme, si në vendin tonë dhe në vendet e tjera është një veprimtari e përhapur dhe fitimprurëse e organizatave kriminale. Gjykimi i çështjeve përballa, etj. Në Gjykatën e Rrethit Tiranë e akuzuar për trafikim të narkotikëve, flet për organizimin e kësaj veprimtarie kriminale në shkallë ndërkombëtare.

- Neni 284/c prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope

dhe në këtë nen parashikohen sanksione të rënda për personat që krijojnë të ashtuquajturat laboratorë, ku prodhohet dhe përpunohet droga. Në paragrafin e fundit të këtij neni parashikohet një përgjegjësi e veçante për personat që merren me organizimin, drejtimin dhe financimin e kësaj veprimtarie, çka tregon rrezikshmërinë shoqërore të një veprimtarie të tillë.

-Neni 287/a pastrimi i parave të pista është një dispozitë e re në Kodin Penal. Raste në praktikën gjyqsore nuk janë evidentuar, porse në jetën e përditshme ndoshta dhe në organet e shtypit përflitet për një dukuri të tillë, lufta kundër së cilës kërkon seriozitet, kontroll, përgjegjshmëri nga ana e organeve kompetente për zbulimin e fenomenit dhe dënimin e personave përgjegjës.

Literatura

- *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*
- *Kodi i Proçedurës Penale*

M.A. Edlir AJAZI

KËNDVËSHTRIM I PËRGJITHSHËM, BALLKANI DHE KRIMI I ORGANIZUAR

Hyrje

Në kohët e sotme *krimi i organizuar* përbën një rrezik real dhe në një mënyrë të veçantë në ato vende me shtete e demokraci akoma të pamirëkonsoliduar. Megjithëse janë bërë shumë takime ndërkombëtare, akoma nuk ka një definicion për *krimin e organizuar*, për të cilin të kënë rënë dakort të gjithë. Ne këtë shkrim janë trajtuar disa fenomene dhe jemi munduar ti bëjmë një analize *krimit të organizuar* në rajonin e Ballkanit.

Lëndë e këtij punimi paraqitet krimi i organizuar në Ballkan dhe aspektet specifike të tij:

- Të pasqyroje tiparet kryesore të krimit të organizuar në Ballkan dhe rreziqet që ai paraqet.
- Të evidentojme aspektet, mënyrat, mekanizmat, mjetet dhe format e shumta të realizimit të objektivave të tyre.
- Si ka funksionuar apo funksionon ai në këtë rajon?
- Burimet e ushqimit të këtij fenomeni.
- Pasojat rrjedhoje e këtij fenomeni?
- Fitimi i një koncepti të qarte për problem të cilat shkakton krimi i organizuar në rajonin e Ballkanit.
- Evidentimi i aktiviteteve operative të krimit të organizuar në rajonin e Ballkanit.
- Një pasqyre e qartë për ato çka paraqet krimi i organizuar në rajonin e Ballkanit.

Krimi i organizuar në Kroaci

Mund të konstatohet se *krimi i organizuar* në Kroaci është relativisht në nivel më të ulët krahasuar me ato vënde të Ballkanit Perëndimor, të cilët u përballuan me embargo. Ekspertët vlerësojnë se numri më i madh i grupeve të *krimin të organizuar* në Kroaci sillet ndërmjet 1 dhe 10. Sa i përket strukturës së brendshme, mund të thuhet se grupet kriminale në Republikën e Kroacisë nuk mund të konsiderohen për organizata kriminale ose shoqata kriminale në kuptimin klasik të fjalës, sepse nuk ekzistojnë raporte hierarkike ndërmjet anëtarëve të këtyre grupeve kriminale. Mund të theksohet se anëtarët e këtyre grupeve janë të lidhur në forma të njohjeve personale dhe kanë interesa të përbashketa në përfitimin e materialeve joligjore të fituara përmes një ose më shumë veprave kriminale¹⁾.

Ngjashëm si edhe grupet tjera kriminale regjionale, grupet kroate marrin pjesë në tregtimin e drogës nga Azia deri te Europa Perëndimore. Për sa i takon tregtisë me njerëz, shtetet post-sovjetike dhe post-jugosllave zakonisht janë vende me origjinë të trafikimit të grave dhe femijëve, ndërsa destinacioni është Italia. Daskalovic (2006) konstaton se vitet e fundit, në mënyrë të konsiderueshme është zvogëluar migrimi jolegal në Kroaci, e cila atribuohet para së gjithash për nga sjellja e ligjeve prej anës së Qeverisë Kroate, por edhe për shkak të regjimit më të rreptë të migrameve në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Serbi. Për atë shkak, mund të theksohet se Kroacia para së gjithash, është vend në tranzitim dhe vetëm në një shkallë të caktuar është vendi i origjinës ose destinacionit përfundimtar ²⁾.

Mund të konkludojmë se në kohët e tashme *krimi i organizuar* në Kroaci është ndërmjet më të dobhtëve në rajon dhe situata në Kroaci mund të krahasohet me atë në Maqedoni. Domethënë lulëzimi i krimin të organizuar kroat ishte gjatë kohës së luftës. Në atë kohë kriminelët ishin të angazhuar nga ana e njësive paramilitare dhe forcave të sigurisë zyrtare në procesin e spastrimit etnik.

Krimi i organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë

Në kontrast me Kroacinë, mund të theksohet se Bosnja dhe Hercegovina është nën ndikimin e krimin në masë më të madhe. Gjërësisht krimi i organizuar dhe korrupsioni paraqesin problemet më të mëdha në vend. Ndonëse

1. Transcrime (2006) The contribution of data Exchange system to the fight against the organized crime.

2. Corruption and Organized Crime in Croatia Daskalovic (2007)

korupsioni ende paraqet një nga veçoritë tipike të administratave në shtetet Ballkanike, krimi i organizuar shkon kah rritja në dekadën e parë të shekullit të XXI. Si rezultat i luftës shumëvjeçare në vend erdhi deri tek kolapsi i plotë i tregut. Mungesa e resurseve themelore ekonomike, si dhe sanksionet ekonomike të imponuara nga ana e bashkësisë ndërkombëtare kundër Republikës Federate Jugosllave (RFJ) plotësisht e rrezikoi zhvillimin ekonomik të të gjithë vendeve ballkanike dhe përgjatë kësaj krijoi kushte ideale për zhvillimin e ekonomisë së përhimët, korupsionit, tregtimit jolegal dhe paraqitjes së sjelljes kriminale në strukturat më të larta politike ³⁾.

Mund të konstatohet se gjatë kohës së luftës, u krijua e ashtëquajtura rrjeta e organizuar kriminale “ekstreme”.

Respektivisht, u paraqit një lloj “Trekendeshi” në të gjitha komunitetet etnike. Elita politike, policia e tyre dhe forcat e armatosura; grupet kriminale ekzistuese; si dhe njësitë paraushtarake e formuan këtë të ashtëquajtur trekendësh të rrjetit të organizuar kriminal.

Por fundi i luftës, nuk do të thoshte edhe fundi i aktiviteteve të tyre - por përkundrazi, ajo do të thoshte ekspanzion i tyre. Pas mbarimit të konfliktit, aktivitetet e tyre kriminale, në një fare mënyre edhe u lehtësuan. Njesia ndërkombëtare IFOR (*Forcat për Implementim*) dhe më pas SFOR-I (*Forcat për Stabilizim*) ishin fokusuar kryesisht në pezullimin e armiqësive, në themelimin e misionëve paqeruajtëse, dhe më vonë, pas arrestimit të kriminelëve të luftës - lufta kundër krimit të organizuar nuk konsiderohej si një nga prioritetet kryesore të vendit.

Sipas *Transcrime* (2006), ekzistojnë midis 5 dhe 15 grupeve kriminale të cilat punojnë në Bosnjë dhe Hercegovinë, me mesatarisht prej 5 deri në 50 anëtarë. Mund të theksohet se struktura e brendshme e krimit të organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë nuk mund të definohet si organizatë kriminale me hierarki piramidale, por si një strukturë në kornizat e rrjeteve lokale, të cilat kryejnë projekte kriminale ⁴⁾.

Mund të konkludohet se lufta kundër krimit të organizuar në Bosnjë dhe Hercegovinë ballafaqohet me shumë problem: dy problemet më të rënda tashmë i theksuam – mosdashja e organeve lokale të ballafaqohen me strukturat kriminale dhe pjesëmarrja e elitës politike në aktivitetet jolegale. Problem i tretë deri kohët e fundit ishte joekzistimi i një Ministrie të përbashkët për punë të brendshme (Ministria e Sigurimit), që të punonte në nivel shtetëror. Kjo Ministri për sigurim ishte themeluar në vitin 2004 me mandate të mbulojë dhe të koordinojë aktivitetet e gjithë aksioneve policore në Bosnje dhe

3. Hedl, D (2005) Organizer Crime in the Broader Balkan Region

4. Transcrime (2006)

Hercegovinë. Mund të thuhet se për suksesin e kësaj ministrie ende nuk ka ndonjë rezultat të rëndësishëm.

Krimi i organizuar në Serbi

Embargoja ekonomike, e cila filloi me bojkotimin e prodhimeve sllovene në Serbi u kthye në fillimin e viteve nëntëdhjetë në formë të sanksioneve nga ana e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në vitin 1992.

Embargoja ndërkombëtare katërvjecare, si dhe angazhmani i RF të Serbisë në konfliktin e Bosnjës ishin arsye, të cilat sollën që krimi i organizuar serb të lulëzojë dhe të prosperojë me një shpejtësi të madhe. Hulumtimet e shumta sugjerojnë faktin se krimi i organizuar serb jetonte në simbioze me qeverinë në vend, ku të dy lojtarët (qeveria dhe kriminelët) përfitojnë nga kjo simbiozë.

Si edhe rasti me Bosnjën dhe Hercegovinën, forcat e specializuara shtetërore ishin të formuara nga kriminelët nga të ashtëquajturit nëntoka e krimit të organizuar. Me angazhimin e tyre në forcat e sigurisë shtetërore, ato ishin praktikisht “imune” pa marrë parasysh se çfarë sjellje të keqe bëjnë. Këto “forca të sigurisë shtetërore” ishin kuptuar si masë e dobishme në luftën kundër “armiqëve shtetëror”. Njësi për operacione special i njohur si Beretat e Kuqe (*Crevene Beretke*), u formua në vitin 1991. Anëtari më i njohur i kësaj njësie ishte Milorad Luković, i njohur si Legija, i cili shërbeu në Legine franceze të të huajve⁵⁾.

Mund të theksohet se keto njësi e përjetuan madje edhe rënien e regjimit të Millosheviçit, dhe aspak nuk ishin të shqetësuar nga ndërrimi i regjimit. Si një nga arsyet kryesore se pse ky grupim “kriminal” vazhdoi me veprimet, është për arsye të fragmentimit në skenën politike, dhe ekzistimi i një periudhe vakum, në të cilin nuk ekzistonte debat i vërtetë për pezullimin e këtyre forcave. Por, sido që të jetë, atentati i kryeministrit Zoran Djindjic përfaqesonte një impuls të fortë për fillimin e “gjuetisë” së kriminelëve të kësaj njësie speciale.

Mund të konkludohet se shkalla e lartë e krimit në Serbi është shkaktuar kryesisht nga veteranët e luftërave kroate dhe boshnjake, të cilët kanë luftuar në kornizat e grupeve paraushtarake nga ana e qeverisë serbe. Krimet më të zakonshme, të cilat këto veteran i kanë kryer janë: atentatet, pengmarrjet, tregëtimi i njerëzve, grabitjet, pastrim i parave, shantazhi ose prodhimi jolegal i softuerëve, etj. Përfitim i lartë nga aktivitetet kriminale mjedisi i korruptuar,

5. Milosavljevic, B (2003) Reform of the Secret Security Services.

si dhe mundësia për pastrim të parave janë burime kryesore të shqetësimeve të komunitetit ndërkombëtar. Gjërësisht, komuniteti ndërkombëtar supozon se ky kapital i fituar jo legalisht ndoshta do të investohet në aktivitetet terroriste, të cilat do të kishin ndodhur në rajonin e Ballkanit. Këto supozime kohëve të fundit dalin në shesh të aktivitetet e organizates kriminale të Darko Shariç narko bos serb, që duke qënë në arrati u kërcenohet presidentit Boris Tadiç, ministres për drejtësi Snezhana Malloviç dhe prokurorit special Mirko Radisavljeveç, si hakmarrje të aksionit policor “*ballkanski vain*” (luftëtari ballkanik) në të cilin u sekuestruan mëse 3 ton kokainë e paster. Për realizim të këtij kërcenimi shërbimet serbe të ngarkuara për zbatimin e ligjit, kanë informacione se grupi kriminal ka ndarë një fond prej 30 milione euro para këto të fituara nga aktivitetet e krimit të organizuar.

Krimi i organizuar në Kosovë

Bandat e organizuara kriminale shqiptare e morën kontrollin e rrugëve ballkanike nga kolegët e tyre turq, të cilët u paraqitën gjatë viteve 1970.

Mund të theksohet se Diaspora shqiptare në Europën perëndimore, luante dhe ende po luan një rol të madh në skenarin e lartpërmendur. Williams (2003) pretendon se bashkësitë e ndryshme etnike mundën të konsiderohen si burim i rëndësishëm i krimit të organizuar. Rekrutimi i anëtarëve të rinj në bazë të përkatësisë nacionale lehtësohet në regjionet ku grupet emigrante nuk janë pranuar në shoqërinë e re. Emigrantët shqiptarë në Europën perëndimore nuk integrohen në shoqëritë në Belgjike, Gjermani ose në Hollandë, kështu që diaspora shqiptare shërben si bazë për sigurinë e rrjetit shqiptar të krimit të organizuar, e cila shtrihet nga Europa Lindore përmes Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë deri në Europën Perëndimore dhe SHBA madje edhe me mafian kolumbiane⁶.

Krimi i organizuar në Mal të Zi

Ngjashëm si në Serbi, Mali i Zi kishte forca të forta policore në vitet e 1990. Policia kishte lidhje të forta në arenën politike, si dhe botën e krimit. Në një periudhë, Mali i Zi kishte një ndër forcat më të forta policore krahasuar me cilin do vend nga UE. Në vitin 1997, policia malazeze numëronte 5.000 të punësuar, ndërsa në vitin 2000 ai numër është rritur në 18.000.

Një numër i madh i hulumtimeve çojnë kah faktit se policia e Malit të Zi

6. Williams. P (2003) Combatin Transnational Crime Concepts, Activities and Responses

shpesh herë ka qënë e involvuar në aktivitete jolegale, me atë që vendi shumë shpejt u bë parajsë për të gjitha llojet e tregtisë së njerëzve. Gjithashtu, mund të theksohet se Mali i Zi në UE është i njohur si vendi importues i automjeteve të vjedhura, jo vetëm nga Europa perëndimore, por gjithashtu edhe nga Serbia⁷⁾.

Grupet e krimit të organizuar në Mal të Zi janë simbol i tregëtisë me njerëz dhe trafikim me mjete motorike të vjedhura, armë, droge dhe cigare. Ngjashëm si në Serbi, grupet në Mal të Zi janë të organizuar në formën horizontale, pa hierarki të rrepte, dhe ekzistimit të shkallës së lartë të pavarësisë.

Mundet të përfundojmë se vendi i filloi reformat në polici në vitin 2003 në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut, depolitizimit të institucioneve, decentralizimit, trajnimit adekuat të personelit, themelimit të përgjegjësisë, efikasitetit të zgjeruar të kontrolleve të brendshme, bashkëpunimit ndërkombëtar nga ana e policisë dhe përshtatshmërisë me vlerat bashkëkohore demokratike me qëllim që të krijohet shoqëri e sigurtë. Por, përsëri, nga perspektiva e sotme shumë vështirë është të thuhet sa sukses pati kjo reformë e policisë⁸⁾.

Kur bëhet fjale për pyetje lidhur me krimin e organizuar, mund të theksohet se Qeveria malazeze në vitin 2005 e miratoi strategjinë e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, miratoi ligje për luftën kundër korrupsionit dhe krijoi një numër të madh institucioneve. Ato janë: Agjencia për luftën kundër korrupsionit, Komisioni për furnizimet publike, Prokurori special për luftën kundër krimit të organizuar, etj.

Krimi i organizuar në Maqedoni

Krimi i organizuar në Maqedoni nuk paraqet ndonjë problem të madh. Ekzistojnë diku afër 10 grupe kriminale me ndikim. Struktura e grupeve të këtilla kryesisht janë hierarkike. Mund të theksohet se Maqedonia kryesisht është vend transit për heroinë nga Azia Juglindore, Afganistani, dhe në një masë më të vogël për kokainë nga Amerika Jugore me destinacionin e fundit - Europa Perëndimore. Sa i përket tregtimit të njerëzve, deri disa vite më parë, Maqedonia ishte vetëm vendi i origjinës dhe tranzitit; por në kohë të fundit ajo bëhet destinacioni i fundit.

7. Lopusina A (2003)

8. Government of the Republic of Montenegro. Program for fighting against Corruption and Organized Crime

Arsyeja mund të kërkohej në aktivitetet e Bashkësisë Ndërkombëtare në këtë vend –punës së organizatave ndërkombëtare dhe vellimi i rritur i lidhur i kërkesave nga ana e klientelës së pasur për prostitucion. Sa i takon prostitucionit në Maqedoni mund të përfundohet se ka afër 1.500 - 2.500 gra të huaja nën kontrollin e bandave kriminale në shumë qytete mbarë vendin. Këto gra vijnë në Maqedoni nëpërmjet Bullgarisë dhe më tej bëhet trafikimi tek organizata tjera kriminale, si dhe në tregjet perëndimore për nevojat e industrisë së seksit.

Ngjashëm si edhe në vendet fqinje, krimi i organizuar maqedonas merret me vjedhje të automjeteve, me tregtimin e qënieve njerëzore dhe me ri-shitjen e cigareve. Mund të theksohet se pastrimi i parave si dhe angazhimi i zyrtarëve shtetëror dhe një grupit të pjestarëve të forcave të sigurisë në zbatimin e aktiviteteve të krimit të organizuar konsiderohen si punë normale në vend. Përseri, duhet theksuar se Maqedonia është ndër vendet e pakta në rajon me një numër shumë të vogël të grupeve të organizuara kriminale, çka do të thotë se situata është e ngjashme me atë në Kroaci.

Krimi i organizuar në Shqipëri

Pas vitit 1990, që përkon me përfundimin e luftës së ftohtë dhe nisjen e proceseve demokratizuese në një ser vëndesh të Europës Lindore, për shkak të shumë faktoreve krimi i organizuar ndryshoi jo vetëm në formë, por edhe në përmbajtje. Krimi i organizuar në Shqipëri hodhi shtat me kalimin e sistemit demokratik dhe u perfeksionua me shpejtësi duke tronditur ndjeshëm stabilitetin politik, ekonomik dhe sigurinë e vendit.

Shqipëria u përball me situata të ndryshme të kriminalitetit e sidomos me krime të panjohura më parë siç ishin çështjet e drogave, kultivimi, tregtia e përdorimi i tyre, llojet e ndryshme të trafikëve si të armëve, drogave e qënieve njerëzore, etj. Nuk mund të lëme pa përmendur edhe veprimet masive të njerëzve të cilët ishin në kërkim të të drejtave të tyre, kryesisht ato me karakter ekonomik, politik, etj., ku herë pas here keto lëvizje edhe nxiteshin nga grupime të ndryshme të subjekteve partiake. Në këtë kuadër, shteti shqiptar dhe sidomos policia u ndesh me lëvizje si greva, greva urie, demonstrata, të cilat jo vetëm juridikisht nuk njiheshin më parë, por edhe nga pikpamja ligjore, profesionale e strukturore shteti shqiptar nuk ishte i përgatitur për përballimin e tyre. Krimi i organizuar në Shqipëri fillesat e veta i ka në vitet 1993-1994. Format e para të shfaqjes së krimit të organizuar ishin kultivimi i bimës narkotike Cannabis Sattiva dhe organizimi i trafikut të qënieve njerëzorë, sidomos i femrave me qëllim shfrytëzimi për prostitucion, *(vleresohet*

se numri i grave shqiptare, të cilat punojnë si prostituta është diku të 15.000 në Itali, 5.000 në Greqi, 100 në Francë, etj) trafikimi i mjeteve motorrike⁹⁾. Fillimisht elementë me prirje kriminale në territorin shqiptar filluan të lidhen me persona me precedent penal e policor të emigruar në vendet e tjera kryesisht në Itali, Gjermani etj. Ata vepronin në grupe të vogla mbi baza shoqerore e fisnore, duke organizuar trafikimin e bimës narkotike dhe qënieve njërezore, nga të cilat siguronin fitime të konsiderueshme. Lëndet narkotike që kalojnë nëpërmjet Shqipërisë realizohen vetëm nëpërmjet organizatave të krimit të organizuar që përfshijn disa shtete si Turqi, Bullgari, Maqedoni, Itali dhe më tutje.

Gradualisht ata zgjeruan aktivitetin e tyre duke u lidhur me trafikantë të këtyre vëndeve ku siguronin lëndë narkotike kryesisht heroinë e shpërndarjen e tyre në vendet e Europës Perëndimore. Suksesi për shpërndarjen e këtyre korridoreve të lëndëve narkotike apo të armatimit, siç ishte ai me destinacion Mali i zi – Shqipëri – Maqedoni ka qëndruar vetëm kur midis shërbimeve sekrete dhe policore është vendosur një bashkëpunim profesional. Në sferën ekonomike elementet e parë të krimit të organizuar filluan të shfaqen në momentet e fillimit të privatizimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë si të lokaleve të tregëtisë, reparteve të ndryshme të shërbimeve dhe të industrisë së lehtë e ushqimore etj.

Në vitet 1991-1996 situata kriminale karakterizohet nga krime jo shumë cilësore, evidentoheshin kryesisht krime kundër jetës, shëndetit, pronës dhe keto kishin si bazë edhe problemet e paqëndrueshme të ekonomisë, pasi ndryshimi i formës së pronësive solli edhe acarime të marrëdhënieve midis njeri-tjetrit. Gjithashtu kjo periudhë pati dhe realizimin e krimeve në fushën ekonomike financiare. sidomos në aspektin e ushtrimit të llojeve të ndryshme të kontrabandave në lidhje me mallrat monopol të shtetit dhe të atyre me akcizë.

Subjektet kryesore të konsumimit të figurave të krimeve ishin kryesisht individë të veçantë, por pati edhe krijime të grupeve kriminale, kryesisht në grabitje të ndryshme ose në vrasje, motivet e të cilave ishin për hakmarrje, motive fitimi, zona influence për krijim terreni në krimet e kontrabandës, etj.

Periudha e mësipërme pati një përmisim të dukshëm deri në mesin e vitit 1996, kur nga institucionet ligjore të shtetit si policia, prokuroria e gjykatat u shënuan rezultate pozitive në drejtim të shtypjes së kriminalitetit.

E veçanta e kësaj periudhe ishte organizimi, krijimi, funksionimi dhe falimentimi i firmave piramidale, ku qeverisja e asaj kohe nuk pati fuqi të kryente

9. Trimcev. E (2004) Organized Crime in Albania

investigime të plota dhe të distancohej nga keto subjekte fiktive financiare. Nje shtate e tille solli qe në Shqipëri brenda nje kohe 1 -vjecare të njiheshin aktivitetet e ketyre fimiave dhe ato të falimentonin. Pasojë e nje gjëndjeje të tillë ishte acarimi në kulm i popullsisë, e cila kishte futur në firma paratë dhe fillimi i protestave masive në shumë qytete e rrethina te vendit, sidomos në zonën e jugut të Shqipërisë.

Kulmi i krimit organizuar në Shqipëri mund të themi se arriti në periudhën e vitit 1996-1997 me krijimin e organizatave te krimit te organizuar financiar me ndertimin dhe lulezimin e skemave piramidale të perfaqesuara nga bankat rentiere: Vefa, Gjallica, Sudia, Kamberi, Populli, Xhaferri e të tjera si këto. Pasojat e ketyre organizatave të krimit të organizuar vendosën në pikpytje egzistencën e shtetit shqiptar, duke humbur jetën mbi 2000 qytetarë, zhdukjen e mbi 1.2 miliard dollarëve nga pasuria e qytetarëve dhe miliarda të tjera nga shkaterrimet që pasoi pasuria kombëtare duke e cuar vendin në një krizë të përgjithshme politike, ekonomike, shoqërore. Viti 1997 është shënuar në memorjen e shqiptarëve si viti i zi, pasi kemi përkeqësim të funksionimit të shtetit, rritjen galopante të kriminalitetit, krijimin e grupeve kriminale deri të armatosura, rënien e forcës shtrënguese të shtetit¹⁰).

Ushtria u shpërnda dhe u hapën depot e armatimit, institucionet kryesore të qeverisjes u paralizuan, u hapën burgjet dhe kriminelet u armatosën, u sulmuan dhe u vodhën bankat në shumë rrethe të vendit, në disa akse rrugore nacionale vepronin vetëm bandat e armatosura, etj.

Vlerësimi i bërë nga ana e shtetit për shpalljen e situatës se jashteza-konshme si dhe masat e marra në atë kohë ër rivendosjen e rendit e sigurise publike nuk ishin në eficencën e duhur, për pasojë kemi rënien e plotë të qeverisjes, krijimin e një qeverie teknike për mbajtjen nën kontroll të situates dhe realizimin e zgjedhjeve të qershorit 1997.

Në këndveshtrimin e situates kriminale, kjo periudhe pati fillesat e saj në drejtim të kryerjes së akteve terroriste. Grupe të ndryshme kriminale, të nxitura edhe nga segmente politike, kryenin veprime që ngjallnin panik në radhet e njerëzve dhe dobësonin sigurinë publike në vënd. Filloi vendosja e gjobave ndaj biznesit në fushën ekonomike financiare, marja e pengjeve për motive të ndryshme, përdorimi i eksplozivave në demtimin e rrugëve, urave, linjave telefonike e elektrike, vrasja e subjekteve të posacme si punonjës policie, personave me imunitet, etj. Zgjedhjet e qershorit 1997 krijuan mundësi për nderhyrjen e shtetit dhe pas një periudhe 5-6 mujore, pra në fund të vitit 1997, mund të themi se u mor situata e rendit dhe e sigurise publike në du-

10. Siguria Kombetare Krimi i Organizuar Xhavit Shala

art e shtetit, kur rifilloi stabilizimi i jetës, akset kryesore ishin nën kontroll, bashkëpunimi dhe harmonizimi i institucioneve polici-prokurori-gjykatë solli goditjen e grupeve kriminale, institucionet e makinës shtetërore rinisën nga funksionimi i tyre, duke sjellë një fare normaliteti në jetën politike-ekonomike e sociale të vendit.

Krimi i organizuar me kalimin e viteve ka ardhur gjithnjë në persosje dhe sofistikimin e veprimtarisë së tyre. Pozita gjeografike e Shqipërisë, lufta e Kosovës si dhe mangësia e elementeve të nevojshme ligjore kundër krimit të organizuar ishin arsyet kryesore që e transformuan vendin në një marshutë kryesore për tregtimin legal nga lindja në perëndim. Mund të theksohet se krimi i organizuar është gjërësisht i përhapur si në Shqipërinë veriore ashtu edhe në atë jugore. Shantazhet, frikesimet dhe zhvatja përfaqësonin dukuri të shpeshta në tërë vendin. Gjatë kohës së konfliktit kosovar numri i plackitjeve të armatosura dukshëm u rrit, kështu që edhe punëtorët humanitar dhe karvanet me ndihma humanitare ishin viktimë të krimit të organizuar. Konflikti në Kosovë kontribuoi për zgjerimin e mëtejshëm të tregtisë me njerëz. Numeri i madh i shqiptarëve lane Shqipërinë dhe në mënyrë të rrejshme deklaroheshin se janë shqiptarë të Kosovës, me të vetmin qëllim që të fitojnë azil politik ose qëndrim të përkohshëm në Europën Perëndimore.

Në vitin 1999 është vlerësuar se ndërmjet 25 dhe 100 grupeve kriminale janë të pranishme në Shqipëri, me numër të përgjithshëm pjesëmarrësish ndërmjet 500 dhe 2.500 presona. Transcrime (2006) sjell faktet se strukturat e grupeve kriminale shqiptare tipike janë hierarkike dhe në formë të klaneve. Shumë nga rrjetet kriminale bazohen në lojalitet (me rregulla të rrepta të sjelljes), besën dhe traditat e klanit, dhe janë relativisht të “modes së vjetër”, në disa raste të strukturave të mafias italiane nga vitet e dyzeta të shekullit të kaluar ¹¹).

Mund të themi se krimi i organizuar në Shqipëri vazhdon të jetë prezent me paratë që i vidhen pasurisë kombëtare nëpërmjet tenderave të të gjitha niveleve që zhvillohen, ku pjesën më të madhe e marrin ministrat përkatës dhe ekipi i tij i besuar, në shitjen e objekteve të ndryshme shtetërore, në deformimin e zgjedhjeve elektorale dhe vjedhjen e votës së qytetarëve, në mbulimin e të ardhurave financiare dhe kalimin pa doganë të eksporteve apo importeve të rëndësishme, në trafikimin e lëndëve narkotike duke e përdorur Shqipërinë urë kalimi për në perëndim, në kultivimin e lëndëve narkotike brenda Shqipërisë dhe eksportimin e tyre nëpërmjet organizatave kriminale që funksionojnë për këtë qëllim, trafikimi i qenieve njerëzore etj.

11. Transcrime (2006)

Të gjitha këto veprimtari kriminale nuk mund të kryhen nga një njeri dhe nuk mund të bëhen pa përfitime financiare. Prandaj ato radhiten te krimi i organizuar. Për ta mbrojtur dhe realizuar këtë krim të organizuar, vazhdimisht direkt ose indirekt pjesë e tij bëhet politika dhe pushtetarët e veshur me imunitet. Këtë e kanë treguar edhe shumë krime të organizuara, të cilat janë zbuluar ose janë aktualisht në hetim. Të gjithë mbrapa kanë një mburojë politike. Kur krimi i organizuar rrezikohet nga goditja shtetërore, atëherë ai kalon deri në veprimtari terroriste, ashtu siç ka ndodhur shpesh deri në asgjësimin e drejtuesve dhe efektivave të policisë apo vendosjes së tritolit në shtëpitë ku ata banojnë.

Të gjitha këto veprimtari janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen në prezencën e shtetit, i cili është edhe përgjegjesi kryesor ligjor për shpartallimin e krimit apo organizatave të krimit të organizuar. Deri tani shteti shqiptar nuk e ka justifikuar në kuptimin e gjerë luftën ndaj krimit të organizuar dhe organizatave të krimit të organizuar.

Megjithatë, mundësite për ta goditur, çorientuar dhe asgjësuar pjesë-pjesë janë të plota. Kryesorja është pastrimi i politikës nga politikanët e korruptuar dhe që kërkojnë të marrin imunitetin politik vetëm për të fshehur dhe mbrojtur krimin ekonomik dhe financiar që kanë bërë apo që kane planëzuar për ta realizuar. Shqipëria është vend i vogël dhe nëse ekziston predispozicioni dhe pastërtia politike e politikanëve, krimi i organizuar dhe veprimtaritë terroriste do të ulëshin në minimum.

Disa dukuri të grupeve kriminale shqiptare ¹²⁾

1. Organizatat nuk pretendojnë të jenë të vetme në territorin në të cilin veprojnë brënda vendit. Me parimin se “ ka për të gjithë”, në një territor veprojnë disa organizata, të cilat në heshtje, respektojnë njera-tjetrën duke iu shmangur përplasjes.
2. Grupet kriminale shqiptare nuk kanë një strukturë vertikale, hierarki ndaj njëri-tjetrit, nuk kanë një kupolë drejtuese, por veprojnë secili “për hesap të vet”. Ndoshta, me vonë me ndryshimin e faktorëve të mjedisit, do të ndryshojë dhe organizimi strukturor i tyre.
3. Anëtarët e grupeve kriminale shpesh ndërrojnë padron, pra kalojnë nga një grup në tjetrin. Tipike kanë qënë këto lëvizje, sidomos në vitin 1997.

12. Drejtoria e Policisë Shtetit (Shqiperi) Analize

4. Grupet kriminale shqiptare, që veprojnë në perëndim, njihen si shumë të dhunshme. Sipas ekspertëve të huaj, nëse grupet e etnive të tjera ulen në bisedime me njëra-tjetrën për problemet që kanë për të zgjidhur dhe kur nuk arrijnë t'i zgjidhin, përdorin gjuhën e armëve, grupet shqiptare u paraprijnë qëllimeve të tyre duke përdorur fillimisht armët dhe duke detyruar palën tjetër të ulët në bisedime në pozita inferioriteti.
5. Grupet kriminale shqiptare në Perëndim, në shumë raste janë të organizuar mbi bazën e qyteteve shqiptare prej nga ata janë, si p.sh. laçianet, peqinasit, fierakët etj.
6. Në qarkullimin e parave, grupet shqiptare përgjithësisht parapëlqejnë qarkullimin "cash" dhe jo nëpërmjet kanaleve bankare.
7. Megjithëse në komunikimet telefonike përdorin pseudonime, përgjithësisht nuk janë të kujdesshëm. Kjo ka bërë që në Perëndim, ku ekzistojnë mundësitë teknike për përgjimet e telefonatave, të mos ketë shumë vështirësi në goditjen e grupeve kriminale shqiptare.

Përfundime

Gjate veshtrimit të mundësive, të cilat policia i ka në dispozicion në luftën kundër krimit të organizuar, duhet të kemi parasysh disa aspekte të rendësishme të këtij problemi. Për shembull, krimi i organizuar është fenomen, i cili vazhdimisht peson : ndryshime. Disa grupe me rrjedhjen e kohës perfitojnë ndikim, dhe pastaj zbehen dhe zhduken dhe vendin e tyre në nentoken dhe mbi token ua lëshojnë të tjerëve, të cilët behen gjithnjë e më të fortë dhe më mirë inkorporohen në shoqëri.

Si shpjegim për këto situata, mund të përmenden shumë arsye. Për shembull, perpjekjet e shërbimeve të ngarkuara për zbatimin e ligjeve ndonjëherë janë të përgjegjshme për tërheqjen e grupeve, perceptikisht disi të fortifikuara, të krimit të organizuar. Disa grupe tjera, si bandat rebele të motogjigjësive dhe sindikatave nga qytetet e mëdha, ekzistojnë me rrjedhjen e kohës sigurisht duke iu falenderuar rritjes së resurseve financiare, vetë numri i tyre dhe aftësia që të hyjnë në industritë legjitime ashtu dhe atë jo legjitime. Në disa raste tjera, ndryshimet në përzierjen etnike, si dhe ndikimi shoqëror dhe politik, gjithashtu luajnë një rol të caktuar në aftësimin e grupit që të qendrojnë testit të kohës. Si do që të jetë, aftësia e grupit që të haftësohet në kërkesat e ndryshueshme dhe nevojat e opinionit do të mund të kontribuojë për jetegjatesinë e vet.

Tregjet e krimit të organizuar janë tejet të mëdha dhe përfaqësojnë një

sfide të vazhdueshme për pushtetet, të cilat duhet të përqendrohen si ndaj kërkesave ashtu edhe ndaj ofertave të prodhimeve dhe shërbimeve. Në vitet e kaluara janë shqyrtuar një numër i madh i strategjive të ndryshme për luftë efektive kundër rritjes dhe ndikimit të krimit të organizuar, Disa nga ato ishin fokusuar në identifikimin dhe arrestimin e personave, të cilët janë të involvuar në furnizimin me prodhime dhe shërbime jolegale; ndërsa strategji të tjera fokusoheshin mbi arrestimet e njerezve, të cilët i kërkonin shërbimet e tyre.

Edhe pse disa hulumtime të krimit të organizuar moti argumentojnë se dekriminalizimi i legalizimit është një nga menyrat për zvogelimin e tregut të krimit të organizuar, qëndrimin e tillë nuk e ndajnë edhe konsensusi publik dhe një numër i madh i njerezve zyrtarë të ranguar lartë në shërbimet, të ngarkuar për zbatimin e ligjeve.

Literatura

- *Transcrime (2006) The contribution of data Exchange system to the fight against the organized crime.*
- *Corruption and Organized Crime in Croatia Daskalovic (2007)*
- *Hedl, D (2005) Organizer Crime in the Broader Balkan Region*
- *Transcrime (2006)*
- *Milosvljević, B (2003) Reform of the Secret Security Services*
- *Williams. P (2003) Combating Transnational Crime Concepts, Activities and Responses*
- *Lopusina A (2003)*
- *Government of the Republic of Montenegro. Program for fighting against Corruption and Organized Crime*
- *Gjëndja e Krimit të Organizuar në Shqipëri, Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni dhe problemet që lidhen me të (Qendra kërkimore Studimore – Tiranë)*
- *Shqipëria dhe Kosova bashkëpunojnë në luftën kundër krimit të organizuar (Nga Erlis Selimaj 13.01.2006)*
- *Siguria Kombëtare, Krimi i Organizuar (Xhavit Shala)*
- *Kriminologjia (Ragip Halili – Prishtinë 2008)*

Search

Quick Links

Formular Aplikimi
Konkurs dhe Particpimi
Orari
Bursa
Aktivitete Studentore
Regullore
Akomodimi
Premiset

Locations

Preshevo
Gostivar

Gallery



Kontributorët
e këtij numri:

Gëzim MUSTAJ
Edmond BRANESHI
Majlinda CUKALLA
Flora SELA KASTRATI
Mark MOLLA
Flamur HOXHA
Ferdinand ELEZI
Gezim SELIMI,
Билјана ЦИГЛОВСКА
Nagip ARIFI
Xhevair BEQIRI
Fatmir TARTALE
Gerti TARTALE
Brahim (IBISH) AVDYLI
Zija ZIMERI
Shpëtim CAMI
Dhurata BILO
Firdusi AJAZI
Edlir AJAZI



Ambasadori i Mbretërisë së Spanjës, Shkëlqesia e Tij z. Fernando de Galainena, së bashku me studentë dhe pedagogë gjatë vizitës në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës.



Çmimi: 15 €

